

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I SHTATË



PRISHTINË, 2013

KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS
SECTION OF LITERATURE AND LINGUISTICS

Ali Podrimja

WORKS

VII

Editorial board:

Ali Aliu, editor
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
SEKSIONI I GJUHËSISË DHE I LETËRSISË

Ali Podrimja

VEPRA

VËLLIMI I SHTATË

Redaksia:

Ali Aliu, redaktor përgjegjës
Rexhep Ismajli
Eqrem Basha
Sabri Hamiti
Mehmet Kraja



PRISHTINË, 2013



LOJA NËN DIELL

Tregime, Jeta e re, Prishtinë, 1967

VJESHTA E VONË E NJI MOTI

Të lehunat e qenve pushuen.

Ushtari që bante roje në kodrën e xhveshun e të ftoftë herë mbas here shikonte kah stacioni hekurudhor, shtrëngonte pushkën për trup dhe kthehej përsëri në drejtim t'urës së drunit dhe ulej aty në breg. Lumi rridhte pranë tij tue grugullue monotonshem nëpër shelgjishten e dendun dhe t'errtë, ikte tue bajtë natën e randë, të lagët nga shiu i vjeshtës së vonë. Majet e lisave dukeshin se prekshin qiellin skëterrë tue shushuritë. Nganjihërë shushurima e tyne përzihej me do qeshje t'ushtarëve, të cilët shetitshin poshtë e nalt e ndaleshin përsëri në vendet e caktueme. Tevona lëshohej një heshtje e randë në kodrinën e bame rrëmujë, një heshtje sa nuk ta merr mendja.

Flokëkuqi ende nuk dukej.

Çka ndodhi me Xhegjen?!

Xhegja ishte i shtati që e përcolla.

Rexhepin ashtu e pagëzuem n'aradhën tonë. Ai kurr nuk më ka nxjerrë prej zemre. Më ka dashtë sa mund duhet njeriu.

Sot në mëngjes kur e muerën rojet e burgut ishte me ta edhe Flokëkuqi, gjithmonë i vrazhdë me at fytyrë të zbetë e të heshtun. I thanë se kanë me e lirue. Së pari ngurroi, por, ma vonë, u nis si i humbun me një buzëqeshje të dhimbshme për mue.

– Shko, shko Xhegja! – i thash – edhe unë kam me qenë në mesin tuej.

Mirëpo, kur u ktheva në kaushin tim, nëpër dritaren e vogël vëreja Xhegjen e varun si luhatej në rrjetën e telave plot gjemba jo larg rrugës, e cila zbritte në stacionin hekurudhor. Pranë tij qëndronte ende Flokëkuqi me një buzëqeshje t'idhtë. Kuptova se as ai nuk kishte mundë me u kapë për re, me iu ikë qenve.

Para një ore e përcollën edhe djalin e fqinjës, ndërsa mue më sollën në breg të lumit

Më thanë se kam qenë ma kokëforti.

Nana, kurr ma nuk ka me më thirrë katuleshi i nanës, kurr ma nuk ka me luejtë me mue...

Nana.

Drejt tij marshonte diçka si valë uji. Hove-hove. Marshonte diçka e randë, me një ushtimë të mbytur kumbonash, e cila vinte nëpër majet e gishtave të thyem e thembrat e kambëve me shputa të djeguna e i përplasej për tepe të kresë. Dhe, përsëri zinte t'i zdirgjej ngadalë me një ushtimë ma të fortë se herën e parë e i ndalej mu n'arrëz. Tash kollitej. Hapte gojën. Dibatte thellë dhe, një re avulli fillonte t'ia kaplojë tanë trupin mandej i vërsulej një shtresë e ajrit të ftoftë, e cila niste t'ia lëbardhi zverdhimin e fytyrës. Kishte fillue me vdekë ngapak e solemnisht – madhështor, në mes trupit të zbrumun dhe shpirtit që hiqte me lemeri si dritë e llampës së vajgurit kur nis me u sosë. Kishte fillue me vdekë me at zburmë heshtjeje të papërsbkrueshme që i qarkullonte ende poshtë e nalt nëpër dej e gjak si dridhje e fortë korenti, të cilën vazhdimisht e ndiente tue iu rritë sa mu tash i dukej se do t'i shpërbente nga krabnori ai zjarr i madh, i pritun, që çonte aq potere me at marshim të ngadalshëm e të përhershëm sa, nganjherë, ajo ushtimë e përdridhte si thuprën n'erë dhe e hudhte në pozicione të ndryshme. I babej se at gufim shpirtnor e kishte ndrydhë dhe shtrihet gjatë n'at anë kah mendonte se tanë at luftë kishte me e fitue. E zgjatte dorën kah qielli skëterrë, dora i bante disa dridhje të shpejta dhe, prapë, rrëxobej si gja e këputun dhe e randë aty diku pranë trupit të tij. Përsëri e hapte gojën e, mbasi merrte frymë thellë, bante një këcim e një këcim tjetër dhe shumë këcime tjera e ngrihej në bërryla. Dridhej. Prap hinte, tash ma randë se herën e parë, hinte me fytyrë kah balta e diçka vazhdimisht pushtonte hapsinat e trupit të tij – diçka që ecte me hapa të randë drejt tij me një zburmë zanesë që e moliste edhe ma, që ia çkulte ngadalë fuqinë; diçka që e ndiente si pickim, si therje të jashtme. Gjithë kjo ndodhte mbrenda, në thellsinë e tij, kah bulonte edhe tanë ajo dritë në fytyrën e zbetë e të ndrydhun. As copat e qiellit, tashma, nuk i shifte aq mirë nëpër degët e lisave që i lubatte fuqishëm stuhia e zgjueme e vjeshtës, të cilat

merrshin trajta të pacaktueme dhe që, tevona, humbshin diku mbas do hijeve picagjate e të rrumbullakta që ngriheshin mbi te e që, prap, largoheshin tue shpalue qiellin e zymtë në bebzat e tija të hapta. Ma vonë një rigë shi e këndelli pak. Përsëri e ngriti dorën. I shpërthekoi pullat e këmishës së linit dhe u shtri ma lirisht n'at anë kah mendoj se do të çlodhej ma shum. Mirëpo, kur bani të ngribet, e theri diçka në trup, iu ngul thellë. Prej së nalti kur u tërhoq ajo hije e shpejtë, e mbuloi gjaku. Qëndroi ashtu galuc derisa ajo zburmë e padurueshme dhe monotone filloi t'i zhbresi përsëri kah pjesët e poshtme të trupit – kah gishtat e thyem, kah shuplakat e djeguna para tri ditësh kur shokun e tij, Rexhepin, e morën dhe e çuen dikah. Qëndroi derisa në vesh zu t'i përplasej fort e ma fort ajo stubia që frynte nga jashtë në mbrendi, ajo zbullima e madhe e ajrit e era e vdekjes që e shtrëngonte mu në fyt dhe, ma vonë, niste ta kaploi një lum i ftoftë ndjerse e të dendësohet ai avull në fytyrën e tij të përgjakun - sidomos kur pikat e shiut nisën të bahen ma të rrepta. E zgjati dorën, binte shi curril.

Jetojshim si të gjithë njerzit prej gëzimit: unë, nana dhe baba. Ma vonë vetëm unë dhe nana. Babën e hangër gurbeti.

– Edhe na do të kemi bukë me ngranë, – thoshte nana, kur e ndiente vedin ma mirë – edhe na do të kemi bukë.

Unë padashtas qeshnja, ndërsa, ajo fillonte diçka me përbi, me luftue në vedi. Dhe, me sytë e përlotun, të shterun, më shikonte dhimbshëm.

– E dij, e dij por... – thoshte e ikte tue qa. Sytë e mëdhej dita më ditë i fikeshin me at bukuri të hershme në gropa të thella, të vrukta, që tregojshin vuetjetet dhe përpjekjet e saja me jetue. Rrallë i shkrepshin xixa gjallnive e jete. Por edhe pse ishte e sëmune dilte me lypë, se duhej me jetue me çdo kusht për të nesërmen e ardhshme. Dilte me lypë e këte zakonisht e bante ditëve të premte. “Vetëm në kët ditë njerzit janë të mirë si të kremteve” – thonte.

Njerzit!

A thue çka ban nana tash?

Nisi t'eci bërrylas. Ecte dhe ndalej. Merrte frymë me gojë të hapët dhe përsëri nisej tue zhagitë, por e kthente një za i fortë, i vrazhdë e i pakuptueshëm. Kur nisej përsëri t'eci, përpara sluturonte diçka në drejtim të tij një hije e madhe dhe e zezë, që e hudhte në kokërr të shpinës. Madje edhe një tjetër e shumë tjera që, në takim me te, lëshojshin një za të topitun. Mbas pak u mbështet në një krab. E ngriti kryet kah qielli, andej kah helmetet dhe kryqat e thyem në setra, që nisën me ia mëshebë edhe rrishtë e mbramë të qiellit, dhe përsëri e uli kryet. Iu dukën se ishin të panumërta edhe helmetat, edhe kryqat e thyem. Iu ba se ata trupa, aq të vegjël prej urrejtjes së tij, tash ishin rritë shumë, më shumë se lisat, të cilët ngjiteshin tenalt natës si thika të mprehta. Atëherë, n'at heshtje e cila zgjatte ku me e dëjti se sa, tue u shkue me shikime pyetëse e anmiqore, kujtonte se ishte krejt i vdekur, se i ngjante heshtjes së vorrit. Prandëj, nisi të përplitej, të sillet mbrenda atij rrethi të ngushtë t'asaj atmosfere të ftoftë që e thyente ndonji qeshje e thatë ose pingrimë zogju – gja që ishte tepër e shkurtë, por jetëdhanëse, që e zgjonte e i jepte fuqi me qëndrue. Tash kur, për të satën herë, prap nisi me mendue për vdekjen, i erdhi me qeshë. Si vdes njeriu – këte kurr nuk e kishte kuptue. Asnjherë nuk i kishte fjetë në zemër se vdekjet dallojnë njana prej tjetrës, se njeriu mund të vdesë edhe si kafshë e vogël, e urtë dhe e dashtun. Por, cila ishte vdekja ma e mirë prej të gjitha vdekjeve? Kjo ishte gja e pashpjegueshme për te...

Ditëve të fundit nana ankohej ma shumë. Sëmundja vazhdimisht e brente ngapak, rrinte tash larg meje.

Çudi pse flakën nuk ia sheh njeriu njeriut!

Digjesha e kurrkund nuk e gjejsa ngushëllimin e vogël të ditës.

Vuejtja asht etje, gjithmonë mendojsja, nuk ka fuqi që e zhbinë.

Kështu, plot vuejtje e thirrje kalojshin ditët, me to ikshin edhe të premtet e gëzimit tonë të vogël.

Nana kurr ma nuk duel me lypë. Jetonte me ate çka i sillsha unë, me ate çka e kishim dhe viente për ate çka e andrrojshim na si dhe të gjithë njerzit si na.

A thue çka ban nana tash?

Ra në baltë. I ngriti duert e përgjakuna kah helmetet e shumta, që notojshin n'ajrin e randë rreth kokës së tij. Nji copë herë i mbajti ashtu. Vazhga e gjakut të varrës së re përsëri e mbuloi. Qielli përsëri zu t'i çilet katmer, ato re të baben dikah, përtej atyne majeve të lisave të naltë, diku, në pakthim, dhe erdhi e i mbet vetëm nji helmetë mbi te, e cila shtrembnohej, e shikonte në nji mënyrë të çuditshme, të llabtarshme. Për pak kohë ndjeu se po sharronte në diçka të pakuptueshme, në nji gorrë të thellë, si ajo kupa e qiellit që i dukej shumë e naltë, ma e naltë se sa e kishte pa dikur në fëmëni. Çuditëj se si kurr nuk i kishte shkuë mendja për at thellësi kaq të madhe, e cila, kur u largue edhe helmeti i mbramë, zu t'i sillte vërdallë, t'i humbi në do rrahë shumë t'imtë, sa njiherë mendoj se kishte nisë me e prekë, apo se gjindej mbi at kupë të thellë diku atje naltë. Dhe, sa nisi me i ardhë nji dritë e t'i shpërndabej nëpër fytyrë, ndjeu do hapa të randë që iu afruen, u sollën disa herë rreth tij e u ndalën përsëri në vendin e maparshëm. Para tij. E pa prap at hijen e zezë si korbi kah çobej prej baltës në fluturim drejt tij. Mandej nji tjetër, e shumë tjera...

Jeta dhe vdekja kambë e duer m'i kanë lidhë, nuk po mundem ma me jetue as me vdekë. Nuk po mundem ma me folë. Diçka në mue po shembet, po kallet.

Çka po shoh?

Nana gjithmonë më ka thanë: – Ruej sytë, o bir!

Sa i fort qenka njeriu, ma i fortë se guri...

Më kujtohet, krejt më kujtohet. Po!

Secila ditë që vinte më bahej ma e randë, ma e padëshirueshme se e para. Bridhsha rrugëve ditë e natë, e këto ishin hijet e para të jetës sime të vogël, por tashma të dashtun, shumë të dashtun, e cila i lëshoi thellë rranjë të botën e fëmënisë sime.

Blerimi vinte tue ikë me gazin e pranverës, me gjethet, me dallëndyshet kurse në mue, vetëm në mue, më dukej se diçka

vlonte. Nuk dij çka ma parë – vuajtja apo fuqia e zgjimit. Kjo ishte diçka krejt e re. Si dashunija ime. Si mosha ime. E nxehtë si gjaku im.

Dhe – një ditë ia mbërriu djali i fqinjës prej malit, me te edhe shumë tjerë.

At pranverë iu bashkëngjita edhe unë kolonës së tyne, e cila marshonte ditë e natë një diell, kah jeta.

Djali i fqinjës!

A thue çka banë me te.

Ai ishte i teti që e përcolli Flokëkuqi.

Ishte sbtri i tanë kur, me sy t'errsuem, e përcillte çizmen që i afrohej disi randë, ma e randë se ma parë, e iu ba se dikush thyente gurë në kokën e tij të randë dhe, atëherë, i lindi një ide përdreq – me e sulmue çizmen. I shkrepri një buzëqeshje. Nisi t'i mbushi grushtat me baltë, ta gjuej çizmen e përloçun që i afrohej vazhdimisht me një takt të matun e gracioz, e të rrëshqasi kah ajo gjujaz. E gjuente. Çizmjia vetëm bante do lëvizje të parregullta. Ngrihej si hije e zezë e fluturonte kah ai. Ndërsa ky përsëri zhagitej. E gjuente tash ma shpejt. Me gishtin e vetëm që i kishte mbetë në dorën e djathtë, i cili dukej krye breshke, zgjatej ta zhysë çizmen që i shmangej të prekunit të tij. Mundobej t'ia prishti at bukuri vizllimi me at gishtin e vetëm që tash e zgjatte kah çizmjia që ikte, e ky e ndiqte gjujaz derisa shkelmi tjetër e hudhte në kokërr të shpinës. Dibatte thellë. I shifte çizmet si afrobeshin ngadalë, randë, si i këcejshin në dorë dhe ia shkelshin gishtin e vetëm. I mbyllte sytë. Herë një dritë i shkonte, herë një tjetër i vinte. Por, kur e ndiente ndonjanën që shkundej me tanë peshën e vet mbi gishtin e shtypun, i çilte sytë. E shikonte at fytyrë të gjatë e t'ajun prej mllëfit, që niste të dridhej e t'i zbardhi dhambët e rrallë, të qeshte. Atëherë edhe ky niste të qeshi – përbuzshëm. Kurse ai tërbiqej ka ushtarët, ngritte dorën. I fishkëllonte qenit e buzëqeshte, mandej përsëri fishkëllonte e një ushtar vraponte e ia vente qenit hekurat e mprehtë e të randë në turi. Heshtja përsëri babej copa grima. Qeni bante do këcime të çuditshme. Nuhatte rreth trupit të tij të përgjakun e në fytyrë, rreth qafës, binte në dy kambët e para e hudhej mbi te, mandej zinte ta shtyej e ta lodhi derisa e futte nën barkë, derisa e

mundtte. Ma vonë ndihej prap një fishkëllimë, qeni këcente tue luejtë bishtin cub e largohej. Kapteri qeshte ende nën vetulla.

Ushtari që bante roje ishte ulë pranë lumit e hudhte gurë në te. As vetë nuk e kuptonte çka bante. Por, i kishte ardhë disi me veprue ashtu, me zhubravitë at heshtje të frigshme, që shtrihet rreth tij e në kodrinën e ftoftë. E kur valët nisën të thyehen në trapin e shembun, që tretshin nën urën e drunit, i kujtuen diçka të largët, vetullat iu varën dhe zu, ma rrëmishit t'i hudhi edhe gurët tjerë. Secila valë që vinte në drejtim të tij e përplasej për at trap i dukej ma e madhe se tjerat dhe i kujtonte diçka. Kështu, posa i humbte një valë prej syve, e ndiqte valën tjetër që shtyhej nga të përplasunit e valëve tjera deri aty e thyhej përsëri për at trap. Atëherë ngrihej. Kthehej mbas, ose nisej ngadalë në drejtim të Kapterit, me një pamje të zymtë. Kalonte pranë të dënuemti tue shtrëngue buzët. E shikonte thue donte me thanë: edhe ti je rast i humbun. E shikonte, por posa i dënuemi e ngrinte kokën, ushtari ulte shikimin, kthehej prap në vendin e maparshëm – Njerzët janë të mirë, edhe... edhe... Po – mendonte – secili njeri duhet të jetojë ngapak edhe për tjetrin. Qeshi disi në dyshim.

Çfarë dite do të zbardhë?

Larg ndihej kanga e gjelave të parë.

Nata ngadalë po ikte.

Ushtari kur u kthye te ura menjiberë vrapoi në drejtim të Kapterit tue ngritë dorën, bërtitë me zë disi të dridhun.

– Po vijnë!

– Rreshtobuni!

Nuk u vonue e u duk prej së largu tue ardhë Flokëkuqi, si gjithmonë i vrazhdë me at fytyrë të zbetë e të heshtun. Mbas tij ndërsejshin qent me bekurat e randë e të mprehtë në turi.

Dy ushtarë zënë të kallin zjarrin.

Shiu kishte pushue.

Jo, jo kjo natë nuk i ngjan as një nate të jetës sime, kjo asht diçka krejt tjetër: e randë dhe e dashtun.

Unë jam ba guri. Po i ngjaj heshtjes së gurit.

Unë gjithmonë kam qenë guri.

Nata u duk se, mbas shiut, kishte nisë me marrë frymë ma lehtë, megjithëse, terri babej gjithnji ma i dendun, ma i frigshtëm terri i agimit që aty diku pranë kishte nisë me e zgjue. Mbi bjeshkën e naltë e vërejtë hanën kah ngrihej përtej plepave tue lanë një hark të këputun drite si bisht hardhuce, por që ta merrte mendja se donte ta dajë qiellin përgjysmë.

U pajtue edhe Flokëkuqi.

Qenve përsëri u vunë bekurat e randë në turi.

– Ma vonë gent! – tha Kapteri!

Nana kurr ma nuk ka me më thirrë katuloshi i nanës, kurr nuk ka me luejtë me mue.

Sa bukur asht me jetue!

Heshtjen që kaploi tanë kodrinën e xhveshun e të ftoftë e thyen pingrimat e zogjve. Era ulurinte.

Nata si kufomë.

Nata si pëshpëritje.

Zemrën a kanë me ma nxjerrë – dashuninë e nanës.

A thue çka ban nana tash?

– Komunist – tha kapteri.

– Komunist – tha ai me za:

Ai mbasi i bani edhe disa hapa rreth tij i dha shenjë Flokëkuqit, i cili e përshëndeti me buzëqeshje Kapterin e u nis kah qeni që ndërsejshin pa pra.

I shtrëngoi grushtat, bani edhe një përpjekje e ra. Tash ma filloi të çojë kryet me mund. E kishin mundë varrët dhe heshtja. Në vesh i rritej zani i

panjoftun me një ushtrimë të mbytur kumbonash. Në sytë e mekun filluen t'i shkrepin do shkëndija, gacë iu banë sytë. U palue në baltë. Heshtte dhe përgjonte hapat që vijshin kah ai, krejt afër, të ngadalshëm e të randë, të cilët afroreshin vazhdimisht edhe ma randë edhe ma ngadalë. Mandej, shikonte at çizmen e përloçun, e shikonte me sy të picirruem dhe nisi t'i shkrepin një buzëqeshje kah i vërente çizmet tjera si afroreshin dhe at helmetë si ngrihej e ia mësbehte qielli e verbët dhe të naltë. Tash i mblodhi kambët e duert, u orvat me e shtrëngue trupin e nisi të qeshi, qeshte me zë, e shikonte çizmen përsëri kah afrohej, at helmet dhe – posa fluturoi ajo hije e zezë si korbi në drejtim të tij, këceu nalt mbi te.

Do britma të llahtarshme dhe lehjet e qenve e therën natën në breg të lumit të shqetësuem, i cili lante trupin e përgjakun e të shkreruem t'asaj vjeshte të vonë.

Ushtarit dy pika lot i rrëshqitën nëpër mollzat e faqeve.

Mandej ra një heshtje e randë dhe u ndie një valë buzëqeshjesh thue kurrja nuk kishte ndodhë. Në ballin e tij shpërtheu një kërue i kuq që ia mbulonte sytë me një dritë të fortë verbuese. Diçka të fuqishme e të padukshme ndjeu në veditë, e kjo e rrëmbeu kah një zë që thyhej mbrenda e jashtë tij.

– Sytë i ke ma të bukur në mahallë, o bir... Ruej sytë!

Prap u zgjatën do hije mbi te – picagiata e të rrumbullakëta me gjithfarë formash. Por nuk pa asnjë helmetë tue ia mësbehë qiellin dhe – as kurr ma...

Një hije u lëshue andej kah stacioni hekurudhor tue bërtitë dhe nuk u duk tjetër.

Ishte ushtari gjerman, i çmendun asaj vjeshte të vonë.

LOJA NËN DIELL

Shtatë netë e shtatë ditë Njeriun e urtë e kërkuen, por askund nuk i ranë në gjurmë thue se e kishte lëshue toka. Të lodhun e të dëshpruem nga ajo bredhje e kotë u kthyen të mendimit se Njeriu i urtë ishte ba “tebdil” ose ia kishte “gjetë kullën Zotit”. Disa nisën me u hudhë në harresë, mbasi atij i kishte ardhë koha me e harrue, me ia ndezë një qiri sa për shpirt se ka jetue dikur. Do tjerë e pritshin se kur ka me u dukë në njanën nga dyert e panumërta e të mëdha të qytetit n’at fushë të shurdhët, ku hynte e dilte ajo botë përditë e përnatë e që askush nuk e dinte se kah i bante furtuna e jetës.

Si gjithmonë, dyert e padukshme të qytetit mbylleshin me lindjen e ndonji vdekje t’ardhshme a me krismën e ndonji pushke gacatore, që ua ngjeshnin mbas cubave, të cilët zbritshin në lum e tinëz i grabitshin çika ku ishin ma të bukurat. Ndërsa, çilleshin me vdekjen e ndonji qytetarit, të cilin e përcillshin me klithje e grushta të ngritun. E përcillshin deri te skaji i horizontit, ku dukej se takohej qielli e toka në një pikë të vetme të dritës, të territ dhe ktheheshin me krenë t’ulun, ndaleshin para orës së madhe të qytetit si para ndonji lteri të shenjtë e të heshtun.

Mirëpo, qielli që mbulonte tanë at bukuri të shpërthyeme dukej se u rrëshqitte vazhdimisht prej kokave përtej asaj bjeshkës së naltë e të mveshun me blerim e heshtje, që ngrihej mbi qytet si çadër e madhe e që u dukej njerëzve se po ua vidhte dikush prej syve të kallun e t’etshëm. Prandej, ajo që ndodhi asaj dite të kobshme, menduen se e kishin dhuratë po prej atij hajnit të regjun e të rritun në hajni. Të mendimit të tillë ishin ata që shkëlshin nëpër tetëdhetat vjet, që nuk kishin pasë rast me udhtue ma larg se ajo bjeshkë, që pikonte frigë e ftoftësi, që i luteshin në mbrëmje e mëngjes për çdo lindje e vdekje.

Shpejt u përhap lajmi se ajo dridhme fatkeqe, që hyni e plasi si bombë midis qytetit, kishte ardhë mu prej aty – se mu n’at bjeshkë mëshihej ai deti që kërkonte hapsi e shtrimje, të cilin të parët e tyne e kishin ngujue n’at kurthë të madhe, ia kishin mbyllë të gjitha rrugët e ikjes me mjeshtri të rrallë.

Prapseprap ma të vjetrit që kishin pasë rast me ndëgjue prej gjyshave tregojshin se qyteti i tyne paska qenë i rrënuem edhe nja dy herë: kur e paskan sundue sulltanat e do, besa, shkojshin edhe ma larg – kur paska pasë sundue ajo e bukura Kleopatër. Por, as atëherë kurrfarë rrjedhimi nuk paska pasë prej atij detit të heshtun, të zi, për të cilën tregoheshin edhe sot prralla të shumta si për bjeshkën, që njerëzve ua merrte mendja se një ditë ka me e prekë qiellin me atë kreshtë të bardhë.

Të rijt kur nisën të flasin me mllef për bjeshkën, pleqt filluen të fyhen, e të dalin prej qytetit e të mos shihen fare ose lëshoheshin mbas cubave që zbritshin në lum e tinëz i grabitshin çikat ku ishin ma të bukura – sa që, nganjisherë, bahej gjaku deri në gju. E këte pleqt e bajshin për me u tregue të pafeve trimnitë e tyne, edhe pse prekeshin për perënditë e tyne që pushojshin diku atje nalt në bjeshkë. Sidoqoftë – edhe kësaj here të parët e tyne nuk u shpëtuen pa u sha prej breznive, që filluen të shihen edhe lakuriq rrugëve, aq sa as gratë nuk patën kohë të pëshpërisin për kët bukuri të pashoqe, mbasi edhe ato mundoheshin me mëshehë cullakun e shpluem. Ndërsa, të shenjtit zunë t’i çohen hijes së “allahut” në kambë e t’i përuken deri në tokë, mandej të tregojnë se si e kishin pa n’at “dakik” të shpirtit Zotin kur kishte zbritë mbi shtëpijat e tyne.

Madhsinë e tij kur merrshin me e tregue, e krahasojshin me ndonji lis ma të naltë që gjindej diku në dy brigjet e lumit, i cili rridhte përmes fushës dhe e rritte bukën në veri e jug të qytetit. Kur pyette ndokush se çfarë ngjyre kishte Zoti, të shenjtit luejshin vendit e, pa u lodh, ia ngjishnin ate që u binte ma parë ndërmend.

Çka nuk u trillue ato ditë, por bjeshkës ma nuk iu friguen e as atij detit të mbyllun n’at bjeshkë – megjithëse zunë t’i lutën si

ma parë në mbrëmje e mëngjes për çdo lindje e vdekje. Friga tash iu vinte nga mbrendija, nga ato shtëpija të rrëxueme si kutia shkrepse prej atij termeti. E, ku mendofshin se ende gjindej ndonji hije e zotit. Kështuqë, ditën tjetër u zgjodhën nga të dymbëdhjetë mahallët, sa i kishte qyteti, trimat ma të mirë dhe u nisën me kërkue Zotin. Të tjerët vendosën që ata, të cilët e pritshin perëndimin e mbramë me kalue lumin për me i vorrue e që ishin mbyllë në vdekje papritë e pakujtue – ta dënojnë Zotin.

Mirëpo, kërkohet Njeriu i urtë, mbasi flitej në tanë qytetin se vazhdimisht bisedonte me shpirtrat e perënduem kahmot. Njeriut i urtë ishte i vetmi njeri, si mendojshin, me ndihmën e të cilit do të mundeshin me i ra në gjurmë Zotit, po i cili, nji ditë, u humbi sysh e nuk u pa ma tue bredhë në tepe të kresë. U mbyll në kasollen e vet atje në pyll prej kah e vërente botën me sy kalimtarë si hynte e dilte n'at qytet, stinët si vijshin e shkojshin, fluturimin e ndonji korbi që bante disa rrotullime të bukura e zhdukej në pakufi. Nganjisherë, padashje, ai fluturim e shtynte ta nderonte e t'i përulëj deri në tokë sikur t'ishte haxhi, të vraponte kah grumbulli i njerëzve, të cilët i ngulshin sytë në qiell.

– Shpirti dritë i pastër! – tha heshtas në vedi.

Ma vonë.

– Qe edhe nji! – bërtiti nji fëmijë.

Korbi kur humbte nga horizonti, njerzit këndoishin urata, nxitoishin me ia ndezë nga nji qiri, me ia ndriçue rrugën për në botën tjetër – si thojshin plakat. Ai atëherë largohej pa trazue as ma të voglën thërmi t'ajrit, kthehej ma i piklluem se shkonte. Përsëri zinte me e vërejtë botën nga kasolla e vet, prej kah kishte pa sa e sa ushtri të mbretit kur kishin hy, njerzit kur i kishin dëbue me una të votrave prej qytetit.

Gjithashtu, ishte zakon në qytet se ai që humbte e kërktojshin i madh e i vogël derisa e gjejshin, ose derisa e kuptojshin se shpirti i tij ishte ngjitur në qiell atje nalt dhe, atëhere, njizanit e shpallshin si njeri t'urtë. Para shtatë ditëve, para shtatë netëve kur ai humbi pa gjurmë e nishan, njerzit filluen me u

strukë nën hije të drujve të mëdhej pranë lumit, të vërejnë me gojë të hapët kah qielli.

– Kush thot se nuk ka Zot? – pyeti njani.

– Sa shumë kisha dëshiore me e pa! – tha tjetri.

– Ka Zot! – tha një i tretë me bindje.

– Nuk ka! – u ndie përsëri një za prej turmës.

Çka ishte ma keq në trunin e disave me të vërtetë ishte ngulitë Zoti si thumb, që kurrkush nuk mundte t’ua çkuli nga mendja, – madje as ai profesori plak, i cili u flitte se edhe ajo që kishte ndodhë në qytetin e tyne nga ajo bumbullimë e hatashme nuk ishte prej zotit, por ishte shkaktue prej do gjanave toksore – si i quente ai – e që ata fare nuk i kuptojshin. Kur u thonte se nuk ka zot ikshin prej tij e do tjerë shkojshin mbas tij. Kështu ata, para se të niseshin me e kërkue Zotin të cilin e kishin shpallë si rebel, të padëshirueshëm, ktheheshin së pari te ajo ora e madhe, e cila mezi rrinte varun në murin gadi të rrëxuem. Ora për ta ishte e vetmja dëshmitare e asaj loje, që kishte kapërcue kufijt e jetës. Ulshin krenët e murmurojshin në vedi tinës njani tjetrit, niseshin në drejtime të caktueme.

– Sa e çuditshme asht jeta: sot je, sot s’je! – tha njani.

– Sot t’adhurojnë, sot t’harrojnë... – shtoi tjetri.

– Sot të dashunojnë, sot t’urrejnë! – shtoi grueja me fëmi ngryk.

Mirëpo, sa niseshin një ditë, u përhap lajmi se Njeriu e urtë e kishin pa tue hy në pyll. Atëherë hodhën topuzat e thikat, ndezën fenerët e pishat e u nisën me e gjetë. Me ta shkoi edhe ajo gruaja me fëmi ngryk, që solli at lajm aq të pritun.

Njeriu i urtë ishte ma i vjetri në qytet. Kurrkush nuk mundte me ia qëllue nëpër të satin vjet shkilte. Mandej tregojshin se Njeriu i urtë ishte zbardhë mbrenda një minuti at ditë kur kishte plasë si bombë ajo bumbullimë midis qytetit dhe, tue mos dëshirue me qeshë bota me te, ishte tërheqë në pyll. Jetonte i vetmuem dhe kishte nisë me e ndie praninë e vetit në jetë. E,

ç'ngjitte për rreth tij ai i shifte, i ndiente edhe cubat të cilët zbritshin në lum tinës e i grabitshin çikat ku ishin ma të bukurat. I ndiente edhe ata që nisën ta kërkojnë e të cilët çuditeshin edhe vetë për at ndieshmëni dhe andrroshin me qenë ai i cili mëshihej prej botës nën kunorat e drujve të naltë. E – ai gjithmonë lumit përpjetë ecte ma rreptë derisa zinte në thu e binte në gjumë. N'at gjumë e ndiente qytetin si merrte frymë thellë, i shifte të lashtat si rriteshin me bollyk në të dy anët e trupit të tij, si zbritte ajo bija e Lalës në krahun e tij e i vilte të gjitha ato fryte të harrueme; e ndiente gjinkallën si ia xiglonte shpirtin e shfletuem në fërflaza të zgjueme, si i jepte fuqi me ecë kah bregu i lumit kah ai burim i largët. Atëherë nishin me i buzëqeshë sytë, mustaqet dhe, kur e ndiente në pyll ndokend se si e rrëxonte ndonji plep, zgjohej saora, i vehej mbas derisa e flakte jashtë pyllit, ia ndërsente qent. Por kur ata hapa e ato britma të njerëzve nisen mos me e lanë të qetë – e kuptoi se e kërkonte tanë qyteti. Atëherë lakoi udhën e u nis kah lumi, që gjindej kundruell bjeshkës e qytetit, ku edhe e pa ajo gruaja që ngarendte.

Po at ditë kur turma mbërrijti te pylli. Njeriu i urtë ndodhej n'anën tjetër të lumit, ku ishin mbyllë në vdekje të papritun ata prej asaj bumbullimes së kobshme, të cilët ishin shpallë si njerëz t'urtë.

Në breg e pritën gjatë – por ai nuk u duk. Ishte përvjedh prej tyne, dhe ngjitej lumit përpjetë. Posa shkeli n'at fushë të ftoftë e të shurdhët, e vrau në sy një dritë e fortë. Nuk e pa fare gruen me fëmijen ngryk, as vargun e gjatë të turmës që dilte prej pyllit të madh, të dendun e të frigshëm e ngjitej andej kah dielli. Nuk i ndjeu as lutjet e të shenjtëve, të cilët kishin dalë me pa “Allahun” kur do të çohesh si tym i madh ose kur do të dilte si ka i zi prej qytetit të rrënuem. Për herë të parë Njeriu i urtë ndjeu në vete se diçka e kishte trathtue keq. E ngriti kryet dhe vrapoi nën diell kah lumi, andej ku zbritshin cubat në lum e i grabitshin çikat ku ishin ma të bukurat dhe, kur gjithçka menduen se kishte marrë fund, plasi një buzëqeshje si pushkë e papritur. Njerzit kthyen kokat e përgjumta ka zani. Në qiellin e heshtun e të skuqun prej

diellit të mbramjes u pa edhe një korb kah fluturoi, që zhdukej në horizont e të cilin nuk e mbyllte asnjë mur i naltë, asnjë derë e qytetit.

– Qe, vdiq edhe një Zot! – tha profesori tue u drejtue kah turma.

– Edhe një Zot – tha gruaja që e mbante fëmijën në ngryk, e që përbihej nëpër turmë.

– Sa çudi me vdekë zotil! – tha dikush.

– Jo, jo – tha një tjetër tue ba kryq.

– A po e shihni, secili prej nesh mban nga një Zot në vete, – u ndie përsëri profesori.

– Zoti im asht i vrazhdë, prandej kurr s’ka me hy në parajsë – tha i pari, e u lëshue tue qeshë vrap kah rrjedhja e lumit.

– Na të gjithë jemi zotna – tha me za një tjetër nga turma.

– Zotna! tha një tjetër.

– Jemi ma të mirë se Zoti! – përsëri tha ai nga turma.

Heshtje vorri. Të shenjtët ulën kokat dhe ikën pa kapuçë e çallma. Turma shtyhej tue bërtitë në breg të lumit. Gruaja që mbante fëmijën ngryk doli para tyne dhe u afrue pranë Njeriut t’urtë, e kapi dorën e tij të përgjakun, e ngriti nalt dhe desht me thanë diçka. U përbi dhe çoi kryet kah bjeshka. U kthye përsëri andej kah pylli i madh, i dendun dhe frigshëm, të ngarendi. Fëmija qeshte në ngrykun e nanës, buzëqeshte me largësi të zgjueme dhe e luate dorën. Mbas saj u nis edhe profesori plak e vargu i gjatë i turmës.

– Jeta asht pyll i përhershëm – tha dikush. – Pyll, vetëm pyll.

– Jeta asht luftë e vazhdueshme – shtoi tjetri.

– Sa çudi gjithmonë e ndjekim, e ndjekim e prap na mund – tha i pari.

– Kurr s’mbërrimë me e kalue at pyll – shtoi i dyti tue shikue në largësi. – Pyll, vetëm pyll.

Njertzit prap zunë t'i hudhin shikimet kah bjeshka e naltë dhe e blertë, por kurr ma nuk iu friguem. Deti i zi dhe hija e Zotit i takonte vetëm së kaluemes së tyne të largët dhe krenare.

Vocrrakët, thikën e gjetën at mbasdite në breg të lumit, me të cilën kishte ba vetëvrasje. Njeriu i urtë, e ngulën thellë në tokë dhe filluen ta gjuejnë me copa buke – megjithëse at mot kishte marrë thatësi e madhe.

Ajo ishte loja e tyne ma e bukur nën diell.

Ditën e tetë e vorruen Njeriun e urtë.

DETI

Ditëve me vapë e pa furtunë, në luginën e thellë e të paskajshme, deti ta çonte mallin e një vashe që flen randë e andrron trimin në kalë. Posa puhija e lehtë çohet e frynte andej kah jugu, zgjonte detin e lugina e vetmueme nën diell mbushej me ushtimë. Njerzit atëherë dilshin në breg, lakmojshin detin nuk dijnë për çka dhe deti, si gjithmonë, i rrahte brigjet e veta të përhimta e humbte n'ushtimën e vet.

– Ju thashë: deti asht i pa fund – tha ajo.

Ai luejti kokën e në fytyrë i vetoi një buzëqeshje e tharptë. Rroku një guri dhe e hudhi diku atje poshtë nën kala. Ma vonë, prap, u ndie një za dhe rropllima e artekut të gurëve tjerë.

– Thuej se deti nuk i ngjan njeriut, – tha përsëri ajo. – A i ke vu re sa i urtë asht e sa i egër? Do të dëshirojsha të jem det!

– Deti asht frigacak i madh, – tha ai – por edhe trim i pashoq; si të gjithë frigacakët që janë trima kur i mund friga. Deti asht i bukur derisa nuk e njeh, kur e njeh deti asht i shëmtuet.

– Njerzit thonë: qofsh i thellë si deti, të marrtë deti – ia prit ajo.

– Njerzit thonë: rueju zjarrit dhe detit.

Ajo uli kokën e heshti. Nuk deshti, si mbramë, me kundërshtue. Zatën, deti për të dytë ishte engimë e pazgjidhun. Kush e ka kuptue detin deri më tash? Prapseprap ajo nuk pajtohej as atëhere kur ai thonte se deti asht ma femnorë se mashkullor, nuk pajtohej as atëhere kur ai thonte se edhe deti e ka një farë autobiografije. Ndërsa, kur e pyette a vdes deti, ajo thonte me pikëllim – vdes unë.

Pulëbardhat e çanë qiellin. Diçka dukej në det. E, si gjithmonë, posa e ndijsbin fluturimin e pulëbardhave, njerëzit delshin në breg tue vrapue. Në sytë e tyne të zgurdulluem piklonte dëshira për jetë, ia kishin lakmi detit nuk e dij për çka dhe pritsbin deri vonë. Tevona shpërndaheshin tue pështy në det dhe ktheheshin dy herë ma të vetmuem. Secili shkante rrugës së vet i debun prej vetvetes dhe detit. Atëherë ngjitej edhe fëmija me sytë e kaltërt në lagjen e epërme, ngjitej atje në kodrën e blertë ku detarët thojshin se dita shkante natën me e kalue, ngjitej kodrës dhe këndonte një kangë për detin, për ata detarë që për ta flitej aq shum sa që ndodhitë e tyne tregobeshin si prralla. Zani i tij i hollë dhe i fortë dridhej e babej shum i pikllueshëm, kur kanga flutte kab mbarimi për betejën e trimave që kishte zgjatë sa ditë e sa netë me shtrëgatën. Prej atëherit kishte hy në prrallat e tyne edhe Arapi i zji me ato anijet e mëdha e të drujshta. Ngjitej fëmija e, herë e herë, e kthente kryet andej kab deti që ditëve me vapë e pa furtunë ta çonte mallin e një vashe që flen randë e andrron trimin në kalë. Buzëqeshte dhe, me dhimbsuni, e luente kokën e kab i shifte ende njerëzit që pritsbin me orë nën kala atje në breg. E, kur qetësohej fare në luginën e thellë e të paskajshme, fëmija e urrente detin si gjarprin, trimat për të cilët bante fjalë kanga i dukeshin të pavërtetë dhe zanin e ngritte. Kanga e tij tash nuk i ngjante kangës si thojshin do, kurse tjerët që e dijsbin çka asht vaji i zemrës i hapshin dritaret dhe bashkoheshin me zanin e tij kumbues, që zhbravritte qetësinë e ditës së shurdhët n'at luginë të blertë e të vetmueme.

- Tepër i vogël asht njeriu – tha dikush.
- Ma i vogël se mundet me qenë – shtoi tjetri.
- Qe, po këndon – tha i pari.
- Po nesër? – shtoi i dyti.
- Ishte, ishte... – shtoi përsëri i pari.

Vërtet fëmija këndonte, por për veti, këndonte qyshse ishte ba me djitë për me dashtë jetën, për të cilën edhe baba i tij ishte nisë si detar me gjetë vedin në vorbujt e saj. E, disa i thojshin se babën e ka pasë pirat, disa tjerë se babën e ka pasë gjakësor të regjun, vrasës, e disa i flitsbin se baba i tij kishte shkue diku larg e se do të kthehej.

Mirëpo, fëmija i besonte vetëm Xha Simonit të lagjes s'epërme, i cili jetonte dikund në kodrën e blertë. Ai i kishte thanë se baba i tij ka qenë

burrë i mirë dhe trim i rrallë – si ai, Gjergj Elez Alija. Kështuqë, kangën që e këndonte, bante fjalë edhe për at kalorsin e urtë dhe të largët.

Ma vonë tha ajo:

– Pse s’jemi të thellë si deti edhe na njerzit?

– Deti asht shumë i cekët përkundër njeriut – tha ai, mendueshëm.

Ajo i hapi krahët, thue se donte me përqafulë detin.

– A kishe dëshirue me qenë det?

– Det me qenë asht randë – tha ai.

– Detit kurr s’kisha dëshirue as me i ngja – tha ajo tue i mbledhë vetullat e gjata.

– Detin e kanë lindë pamundësitë...

– Dhe andrrat, me qenë i thellë.

– Me qenë i pamundun, si deti.

– Me durue njisoj, si deti – shtoi ajo ma vonë dhe vrapoi.

Mbas saj vrapoi edhe ai derisa e mbërrijti, mandej vrapoi ai derisa e thërriste ajo me u ndalë.

– Detin e adhurojmë ma së shumti kur jemi larg tij.

– Dhe kur dëshirojmë me qenë dikushi.

– Po – tha ai ngadalë tue qeshë.

Ajo i mori erë agulices e vrapuen kah bregu dorë përdore.

Në luginë vetëm deti ushtonte, vetëm deti.

Fëmija fare nuk e ktheu kryet kah zani i fortë i njerëzve që vinte kah bregu. Kanga e tij veç kishte pushue. Ngjitej në kodrën e blertë ku Xha Simoni me ferë dilte e shtrihet n’at shkamb të rrahun prej diellit dhe ernave. Nga aty ia kishte anda me e pa detin e madh, të pamposhtun. E shikonte si në mëngjes zgjohet nga thellësija e luginës, si mbasdite përplasej e përplasej dhe humbte prap n’ushtimën e vet. E ajo ushtimë, kur rritej, i rrënqethej trupi e ftyra e verdhë niste t’i nxibet. Ofshante. E shikonte edhe fëmijën si

*ngjitej kodrës së blertë dhe si kthehej përsëri në luginë. Atëherë këcente maje
nji guri, i hapte sy e dier kah qielli e bërtitte:*

– Deti! Deti!

*Zani i tij ndihej larg. Tash edhe fëmija e donte detin. Strukej
buzagaz nën kunorën e ndonji fiku, ose merrte vrapin e binte atje poshte
buzë ujit nën kala, në mes njerëzve, të cilët si rëndom, dilshin me pritë posa
dukej diçka në thellsi. Sepse – fëmija dëshironte me e pa detin gjithmonë të
gjallë, të zgjuet, t’errtë dhe të shqetësuem. Vetëm atëherë Arapi i zi dhe
trimat e humbun një ditë i dukeshin të fortë – ashtu si thonte kangë, që e
këndonte sa herë ngjitej në kodrën e blertë.*

– I njajti det: vetëm ushton, vetëm ushton.

– Sa i madh asht e sa i thellë – tha fëmija.

– Qe sa kobë i njajti det, i njajti det: vetëm ushton.

*Xha Simoni sbtrihej në rrasën e bardhë e të lëmuet, e përqafonte gurin
me faqe të djegun nga dielli e, kur fëmija prap niste me këndue at kangën për
detin, do pika lot ia lajshin mjekerrën, ku me dijtë se çka i kujtonte dhe –
zani kumbues i fëmisë kur e pushtonte, atëherë niste t’i çelej balli, e
shtrëngonte at rrasë si trup grueje fort, fort, mandej kthehej me fytyrë kah
qielli, gjatë e vërente diellin. Fëmija kur pushonte së kënduemi, plaku ngrihej
ngadalë dhe ulej pranë tij. E vërejsin në heshije lojën e pulëbardhave dhe
rrugën e diellit, mandej stubinë, e cila çohet e frynte andej kah jugu, e deti
gjatë e gjatë i rrahte brigjet e veta të përhimta.*

– Vështirë asht me harrue, e të gjitha kanë qenë...

– Kanë qenë – tha fëmija.

– Dhe tash nuk janë, asht vetëm deti, vetëm deti.

– Sa çudi, vetëm deti! Vetëm deti ka mbetë e ata nuk janë...

*Fëmija kur zbritte në breg, Xha Simoni mbette deri vonë atje nalt.
Mbasi qetësohej deti, zinte dhe në mend e përcillte at hije grueje që përvidhej
nëpër degët e denduna t’ullinjve; ajo zbritte e iu bashkoej vargut të gjatë të
njerëzve që dilshin e vrapojshin sa herë pulëbardhat e përshektojshin qiellin.
Kur shpërndabeshin, kthehej edhe gruaja tue luejtë kokën, e çonte kryet kah
kodra e blertë.*

– As sot, as sot...

Xha Simoni e shikonte përvjedhtas gruen. – Sa i marrë je, o Xha Simon! - mendonte, e prap e kthente kryet kah deti e errej në fytyrë, mandej nuk dij si i bahej dhe shikonte përsëri gruen, e shikonte derisa humbte në pyllin e dendun t'ullijve. Ia merrte mendja se e mbyllte në sytë e përflakun edhe detin, edhe gruen e fqiut të humbun një ditë me djalin e tij. Tash nuk mundte me e nda as detin prej grues, as gruen prej detit. Kurr nuk pajtohej as me ate se ajo ishte ma e pasun se deti, e detit ia kishte lakmi nuk e dij për çka. Tevona niste e zbritte nga kodra e blertë tue qeshë, vraponte e zhytej n'ujë, notonte deri në mbrendi. Atëherë ndibej në breg një zë, ndibeshin shumë zëne, edhe zëni i fëmisë edhe zëni i grues në mes njerëzve...

Puhija e lehtë frynte. Ajo e shikonte detin dhe buzëqeshte.

– Dashunisë i vjen era det – tha ai.

– Dashuniija asht e thellë, si deti.

– Asht e rrëmbyeshme, si deti.

– I ka sytë e detit dhe ngjyrën e barit – tha ajo me lakmi.

– Po e ndiej se po më vjen era det.

Ajo e vu kryet në krahnorin e tij.

Dielli i gushtit dukej se kishte ra në valë e po shetitte nëpër zemra.

– Na të rijt i ngjajmë detit, apo jo?

– Gjithkrah kalojmë vetëm koha na i ndal frejt.

– Ah koha! – tha ajo e pikllueshme.

I mori erë aguliçës përsëri dhe e vuni në mes të gjijve.

Në luginë vetëm deti ushtonte, vetëm deti.

– A më ke dashtë ndonjiherë? – tha ajo.

Ai ngriti kryet e në fytyrë i vetoi një buzëqeshje e tharptë. E rroku një guri dhe e hudhi diku atje poshtë, nën kala. Ma vonë prap u ndie një zë dhe rrapllima e ortekut të gurëve tjerë.

– Detin njeriu mundet me e kalue lehtë – tha ai.

– Gjithmonë e ka kalue.

– Edhe mbas tashit.

Ajo e hapi shuplakën e dorës e i fryu aguliçës, puhija që frynte nga deti e mori dhe e treti.

Ai fare nuk e ndjeu kësaj here çka flitte ajo për detin, ecte dhe nuk e kthente kryet kah deti.

Ikte prej detit.

Ret e murme erdhën e u banë ma të denduna prej stubisë së fuqishme që u zgjue pak ma parë. Ndonji pulëbardhë rrallë tash ua vidhte shikimet njerëzve andej kah jugu. E, deti ushtonte, si gjithmonë, ushtonte thue se donte me dalë e me ikë prej asaj lugine të thellë e të vetmueme. Përplasej e përplasej për brigjet e përhimta dhe humbte n'ushtimën e vet. Atje poshtë, nën kala, dukej ndonji peshkatar i vonuem tue përgatitë diçka, i cili ikte prej stubisë, e heshija prap, mbas pak kohe, niste me u lëshue në luginë.

– I giatë do të jetë ky dimën – tha grueja.

– Ndoshta, – tha Xha Simoni me dyshim.

– Shih! Sa i errtë asht deti – tha grueja.

– Shum.

– Kurr nuk e kam dashtë të tillë.

Xha Simonit i preku buza në gaz. E ktheu kryet kah grueja, e cila qëndronte në kambë maje atij shkambet të naltë e të bardhë nga kah Xha Simoni qe sa vjet, dëshironte i pari me i pa ata kalorsit e kaltërt, që përditë i pritshin njerzit atje në breg.

– Gjithmonë deti asht i errtë – tha grueja.

– Po, – tha Xha Simoni – gjithmonë asht i errtë dhe i thellë. I tillë ka genë edhe atëherë...

– Oh! Do të ktheben, Xha Simon, do të ktheben! – tha ajo me dhimbsuni.

Xha Simoni e hudhi prap shikimin kah deti.

Frynte jugu.

– Nuk e njihni detin ende. Njerzët e dashunojnë dy-tri ditë, kurse me e dashtë tanë jetën asht vështirë.

– Vërtet detin ende nuk e njoh! – tha grueja ma tepër në vedi.

– Në det çka humb kurr nuk dubet ta kërkojsh. E unë jam në det, e det po kërkoj me qenë. Sa çudi, deti me kërkuu për me qenë det!

Qeshi.

– Do të kthehen, Xha Simon, do të kthehen!

Grueja u lëshue vrap kab bregu nën kala dhe u kthye mbas pak kohe. Xha Simoni mbet tue këqyrë andej kab shtegu i rrëzue nëpër të cilin, si gjithmonë, kthehej e kalonte grueja e fqint. Andej ngjitej ajo tue luejtë kokën dhe humbte në pyll. Ndërkaq, ai shtrihet përsëri n'at rrasë të lëmuet e të bardhë, pështynte në det sa herë atje poshtë në breg pështyjsin njerzët tue u largue. Fëmija tash e urrente me shpirt edhe Xha Simonin; mendonte se ai pështynte në fytërën e atyne trimave që slijsin, ndoshta, diku në fundin e detit e që, një mëngjesi, kishin udhtue e kurr ma nuk ishin kethye, kurse njerzët për ditë dëlshin e i pritsin deri vonë posa dukej diçka në thellësi. Kur largobeshin, Xha Simoni ngrihej, e pështynte prap. Fëmija qante, zdirgjej tatpjetë kodrës së blerië, ikte sa ma larg detit dhe tij.

Disa ditë kalojshin dhe nuk shibej fare.

Para sa ditësh, kur u përhap lajmi në tanë qytetzën se Xha Simoni i lagjes s'epërme kishte vdekë i vetmuem dhe i harruem atje nalt, fëmija qau, për herë të parë e urrejti vedin dhe kurr ma nuk dëshiroi me ndie as për Arapin e zj, as për ata trimat për të cilët tregobeshin ndodhitë e tyne si prralla. I bindun se kishte humbë diçka shumë të dashtun, u nis dikah një mëngjes – e sot e at ditë kurrkush nuk e din se kab shkoi.

Thon se ishte nisë me e gjetë vedin në grumbullin e njerëzve, kurse detarët tregojnë se e ka marrë deti një ditë pranvere, kur kishte dalë me e pritë ate që kurr nuk e kishte njoftë në jetë as baba i tij, as Xha Simoni...

– Po, po deti asht shumë i thellë pse na njerzët jemi tepër të vegjël – tha dikush.

– Kurrkushi! – shtoi tjetri.

Pulëbardhat përsëri e përshekuen qiellin e kthjelltë dhe të naltë...

Kishin ardhë edhe shum e shum të tjerë dhe detin e kishin
lanë gjithmonë në luginë e thellë e të paskajshme tue shtue.

Sa çudi të njajtin det, të njajtin det.

MATANË LUMIT

Lëshohej vrap rrugës së pluhunueme e gjarpnore. Mbas tij mbetej qetësija e prishun e lagja e trazueme. Te lumi i përville kambzat e pantallonave ose kalonte nëpër gurët e mëdhej që i kishin vu laset e petkave qysh verën e kalueme. Sa çelë e mëshel sytë dilte matanë. Mirëpo, kjo ndodhte vetëm ditëve të verës, të thatësisë, kur lumi nuk ishte ma i thellë se një kaçik pule, kur dhe ma të vegjlit zbritshin pa frigë atje në luginë se ka me i marrë, sepse dimnit e vjeshtës së vonë, sidomos ditëve të para të pranverës, lumi rritej breg më breg, bahej det e nuk shihej me sy. Në te, ec e hyn. Të prente nga të ftohtit dhe vështirë i shpëtonte kush valës së rrëmbyeshme e t'egër që rrëshqitte si gjarpën i zi, me plot tmerr nëpër luginën e ngushtë. Ato ditë vetëm ato ma dorëhollët zbritshin në lum me sjellë ndonji landë ure nëpër shtëpijat e tyne, edhepse flitej se vjet për vjet lumi nuk lente pa ia hangër kryet ndokujt, e këte e dijshtin edhe ata, të cilët zbritshin me dofarë litarësh e krrabash të hekurta.

Ditëve të verës i lëkeheshin mbas edhe fëmijet e lagjes, kurse ma të vjetrit që rreziteshin para dyerve, luejshin kryet pikllueshëm derisa ai nuk dukej fare. Pëshpëritshin do lutje të “madhit”. Kjo ndodhte përditë. Gadi në të njajtën kohë ndëgjohej në tanë lagjen e përkotun po ai za, po ata hapa të shpejtë e të randë, po ato lutje, po ato shamata të fëmijve që mejshtin vetëm kur binte shi i rehtë ose kur fillonte të ngrihej bagla në fushë. Atëherë dilte në krye të lagjes. I qetë. Dilte pa e diktue kush dhe kalli vetëm nisej kah ura e drunit.

Mbas tij mbetej qetësija dhe lagja e patrazueme.

Derisa mbërrinte matanë lumit ajo nxitonte kah dyert e shtëpisë së bardhë. Mëshihej diku në katin ma të naltë. Kambë e krye bahej bashkë. Strukej pranë do stufave të vjetrueme e të

lanuna mbas dore, në një qoshe ku kurrkujt nuk i shkonte mendja me e kërkue. Përvjedhtas e shikonte ate nëpër dritaret e thyme, e shikonte në fund të lulishtes si ulej në karrigën e gjelbërt dhe si e pritte, si kthehej përsëri mbas një kohe andej kah kishte ardhë, për në bregun tjetër të lumit e si ndalej në krye të lagjes kokë ulun.

Ngase e kishte mashtruar edhe kësaj here, ajo fillonte të këcejë prej gëzimit, të nxjerri do klithma jo të zakonshme. Por, kur ai zhdukej krejt nga syni i saj, si rrufeja zbritte shkallëve tue britë vajshëm dhe, mbas pak kohe, i dilte menç, e harronte, bahej pa një të keqe. Ma vonë i zgjonte të gjithë dhe u tregonte fille e për pe për te. Nuk i shpëtonte gja pa u tregue – as grimasat ma të vogla në fytyrën e atij që kishte diktue atëherë kur kthehej në bregun tjetër të lumit. Krenohej njëherë, por nuk kalonte as një minutë e pendohej. Sytë i madhnoheshin dhe i vërente hajnisht gratë për rreth që i afroheshin ngadalë si hija, të shqetësuese, të kërlëshuna e me sy të flakosuna. Ajo tash niste me u tërhjekë. Tërhiqej nga dera, qetas, pa lëshue asnjë fjalë, me duert të ngritura sikur të mprohej nga të ramet e randa. Posa e çilte derën, fluturimthi dilte përjashta. Vraponte kah lulishta, ku i bahej se ende e pritte ai. Merrte frymë thellë, shumë thellë dhe binte si e fikun, ashtu gjatë niste ta thërrasi, derisa dilte ai në krye të lagjes. Dhe, posa ai lëshohej vrap rrugës së pluhnosun e gjarpnore në drejtim të saj, ajo nxitonte përsëri me u mëshehë dikund. Kacavirrej nëpër degët e denduna e t'ulta të blijve dhe rrëxohej, të shumtën e herës nga se nuk mund të mbahej vetëm me një dorë – sepse kishte do ditë qyshse iu ishte marrë krahu i djathtë. Binte në kokërr të shpinës dhe brofte në kambë menjherë, i bante edhe një dy hapa e binte prap. Kërkonte ndonji kaçubë me u mëshehë sa ma shpejt derisa ai të kthehej prap në bregun tjetër të lumit. Niste me ecë. Ecte bërrylash dhe zhytej nëpër barin e rritun deri në brez. Por, kur ai ishte krejt afër, para asaj, ajo vraponte kah dyert e shtëpisë së bardhë tue bërtitë, ose shpejtonte hapin të përzihej, të mëshihej në turmën e vizituesve që vijshin dy herë në javë me pa të vetët, në të njëjtën kohë, në të njëjtën ditë. Mirëpo, për te ditë të caktueme nuk kishte, sepse, at ditë kur ai nuk dukej

matanë lumit, tanë lagja çohet në kambë nga britmat e saj të gjata, të forta, pse ajo, atëherë, niste të vajtojë e të këndojë gjatë pa lidhje derisa ai dilte në krye të lagjes. Kur ai ia behte pranë telave, ate që e kishte sjellë ia hudhte prej së largu. Ajo e zgjatte dorën e tue u dridhë, e frigueme. Gjuhën e nxirrte jashtë e dihatte. Përgatitej si vrapueset në nisje me nga posa ai të bante edhe një hap në drejtim të saj. Përshpëritte do emna të rëndomtë, që ditëve të fundit i silleshin nëpër kokë. Sytë e zmadhuem e t'errësuem i ngulte diku në trupin e tij, sikur donte me e gëlltitë. E shikonte me njëfarë mosbesimi, mandej, kur ai e qitte hapin tjetër, ndëgjohej një za i fortë në lulishte.

– Hesht, nanë, hesht! A nuk po më njeh?... Unë jam.

– Drangonin e ka hangër kulshedra! Drangonin e ka hangër kulshedra...

– Nanë!

Ai binte në gjuj para saj, kurse ajo, posa mbërrinte me u ikë duerëve të tij, langohej vrap, qëndronte nja dhetë metra larg e këcente tue bërtitë:

– Drangonin e ka hangër kulshedra! Drangonin e ka hangër kulshedra!

Ai ngrihej. Ecte me kokë t'ulun. Ajo e shikonte zgurdullueshëm, me dyshim, tue luejtë kokën pikllueshëm. I rudhte sytë, përsëri pëshpëritte po ato emna të maparshëm. Edhe emnin e tij. Atëherë ai çonte kryet, buzëqeshte dhe do pika loti i shkëlqejshin në sy. Ecte me duer të zgjatuna kah ajo, kurse ajo zbrapset vazhdimisht derisa ikte e ai ngante mbas saj. Mbas disa minutash ai ia kthente shpinën dhe nisej për në bregun tjetër të lumit. Ajo tash niste t'eci mbas tij, e shpejtonte hapin pa e ndi, ecte në maje të gishtave lehtë, shumë lehtë. Kur mbërrishin në fund të lulishtes, ai i kalonte telat, langohej pa thanë asgjë, ndërsa ajo, si e kalamendun, fërfllohej në gjemba, përgjakej duerve, fillonte ta thërrasi n'emën. E namte. Hija e harrimit ende nuk kishte mundë me ia puthë dorën si ma parë. Atij i frigohej si gjarpnit; sidomos madhësisë së tij. Ashtu, e shqetësue me dhe e kërlëshun, përbihej

nëpër turmën e vizituesve, tue shty me bërrylat e cullakuem. Mandej, kur i afrohej, e çonte gishtin tregues kah ai thue se e gjykonte, i shtrëngonte dhambët fort, të cilët lëshojshin një kërcimë të randë e të padurueshme. Gjatë qëndronte e shtërngonte në trup. Dora kur niste me iu lodhë kthehej kah vizituesit, të cilët shikofshin me habi. Qeshte me za të naltë. Ulte kokën dhe blejt e flokëve të premë ia mbulojshin fytyrën thatore e të zbetë, e kur niste me bërtitë dejt e qafes i dilshin të trashë sa gishti i vogël. Vraponte në drejtim të shtëpisë së bardhë. Ulej atje në një karrige me ngjyrë të blertë, mandej, kur turma e vizituesve dyndej, çohet e sa hapa që bante merrte qëndrime të ndryshme – herë-herë t'atyne njerëzve që përgatiten për hakmarrje në pusi, herë-herë t'atyne që kërkojnë mëshirë, lëmoshë.

Ndërkaq ai, posa e ulte kokën, ajo i mblidhte gishtat, i bante grusht e turrej si stuhi e hatashme, e kërleshun flokësh, e çartun sysh vraponte kah ai tue bërtitë. Dorën e djathtë e ngrihte zvarë, e cila rrinte ma ultë se e majta. N'at pjesë të trupit, si duket, dhimbja i peshonte ma randë. Ngante pjerrtas me një anë, shpej e me tanë fuqinë i binte në krahnor e bërtitë derisa shkrehej në vajë. Ai ulte kokën e shtrëngonte dashunisht, si nanën. E mëshifte lotin. Duert e gjata i zhytte në flokët e saj të qethun renda-renda, e qafonte.

– Nanë, unë jam, nanë... A nuk po më njeh?

Butësisht i flitte kur ajo përsëri largohet e, n'at fytyrë thatore e të zbetë, i dukeshin qartas eshnat kur i shtrëngonte dhambët në dëshprim. Ia kthente shpinën.

Për te, tanë ai trup i tij i hjedhun nuk ishte kurrëgjia tjetër vetëm një shtyllë mjegulle që notonte n'ajr. Kur e shikonte prej majës së kresë e deri te thembrat e shikonte si ndonji çudi që frigon me e prekë e jo ma diçka tjetër. Dhe ajo fytyrë e mjegullueme në sytë e saj për çudi fillonte t'i bahet ma e qartë kur niste me e shikue prej së largu. Diçka atëherë i kujtohej, por që menjherë i humbte përsëri kur ai afrohej. E zgjatte dorën kah ai tue u dridhë, me vaj në buzë, tue pëshpëritë emnin e tij dhe, posa ia prekte majet e gishtave të gjatë, e tërhiqte dorën me një

shpejtësi të rrufeshme e niste me bërtitë. Nga friga fillojshin t'i zmadhohen bebzat e syve, rrathë-rrathë. Mbasi largohej kambë-kambë, zinte ta grithi fytyrën e t'i hajë nejtë e gishtave.

Hija e tij kur zgjatej deri te ajo, ndalej e shikonte ate me sy, ngitte mbas hijes së tij, mandej, e shikonte prap dhe ia shkilte hijen me kambë, këcente në te, pështynte me urrejtje. Mandej, fillonte të sillet rreth tij, tue ba gjithfarë grimasash; këcente kamba klinc dhe, kur lodhej, ulej nja dhetë metra larg tij e niste me i ra tokës me grushta. E shikonte dhe i binte derisa ndiente dhimbje, derisa hija e tij fillonte me u largue ngadalë. Atëherë, shtrihej në kokërr të shpinës. I mbyllte sytë e pëshpëritte po ato emna të drangojve, kulshedrave, zanave, pëshpiritte diçka pa lidhje e rrokullisej nëpër barin e shkelun. Rrokullisej disa herë dhe, posa ndigjonte hapin e tij si largohej, brofte në kambë, hutueshëm, e ndiqte mbas, e thërriste n'emën. Tash ai ndalej, e kthente kryet dhe, prap, ecte – ndërsa ajo ulej nën hijen e nji blini, mblidhte do gurë e përsëri e mbërrinte, sillej rreth tij dhe, kur ai e bante hapin tjetër, e gjuente. Me urrejtje. Shpejt, shum shpejt dhe sa herë e goditte, qeshte me të madhe dhe e gjuente përsëri e qeshte me za. Ai e çonte herë dorën e djathtë, herë të majtën herë këcente e herë ulej galuc. Mprohej prej rrebeshit të gurëve që ia lëshonte mbas dhe, kur i shkëlqente ndonji pik gjaku në trupin e tij, ajo këcente prej gëzimit dhe e gjuente prap, e gjuente derisa nisej për n'anën tjetër të lumit. Ajo ditë e mërziatshme kështu kalonte, e randë dhe e padëshirueshme, e cila, sa niste të grysej, ai shpejtonte hapin me u largue prej syve të botës që i dukeshin copa akulli, gjylypana shum t'imta që iu ngulshin në trup.

Ajo nuk fliste kurrgjë derisa ai largohej prej synit të saj, e mandej, ndigjoheshin po ato britma, po ato lutje, po ato qeshje, po ata hapa të randë e të shpejtë kah lëshohej ai vrapë rrugës së pluhnueme e gjarpnore. – Dhe – qysh prej asaj dite kur ajo udhtoi te njerzit që duhet me lindë përsëri, ate askush ma nuk e pa në krye të lagjes as matanë lumit.

Në lulishten e shtëpisë së bardhë shetitte vetëm hija e mallit.

KUJTIMI PËR GRUEN E ÇMENDUN

Përditë voglushja shihej n'at ballkon sa herë niste të tymojë ai oxhaku si qafë lejleku i shtëpisë përdhese. Posa ndihej zani i shterun i grues së çmendun, voglushja e dinte se ajo e kishte fikë zjarrin me ujë. E ulte kryet e ballin e ngushtë e vente mbi tehun e ftoftë të parmakëve të hekurtë, kurse me majën e këpucës i binte cimentos së plasaritun derisa e thirrte nana me hangër mëngjes. Çka të bante për t'u çuditë ishte se voglushja dilte n'at ballkon posa ai tymi i oxhakut ngrihej tenaltë e shpërndahej nëpër tanë qiellin e lagjes si re e dendun shiu. Voglushja qeshte dhe duertrokite, kur tymi shtohet panda dhe e mbulonte at kulmin e shtëpisë përdhese. E kuptonte se e çmenduna kishte kthye nga pazari – sepse ajo, menjëherë sa kthente, e ndizte zjarrin me ato krande që i kishin teprue prej dje, nxitonte nëpër oborr për të gjetë ndonji mbulojë të rrëxume muri apo ndonji drrasë të vjetër që e kishte pa dikund e tash nuk i kujtohej, ose e nxirrte tinëz at sopatën të randë e të topitun dhe orvatej me rrëxue ndonji degë t'ultë peme.

Mbasi dielli këcente edhe nja një pllambë mbi kokë, e çmenduna i vishte shpejt e shpejt ato teshat e rëndomta: po at xhemper të zi, po at fustan të larmë e fundin me do katrorë e lule po at shami të shkyeme që e hudhte mbi kokë e – dilte. Voglushja, tash i mbyllte sytë dhe i çilte kur e ndiente at zhurmë të çelsave, posa e çmenduna e mbyllte derën e shtëpisë dhe t'oborrit. Po kjo zhurmë e çelsave ndodhte edhe me kthimin e saj të vonshëm, të heshtun e shpeshherë të përvaishëm, të cilin voglushja e shikonte me një dhimbsuni.

Ajo që ndodhte mbrenda atyne mureve nuk kalonte krejt në heshtje. E çmenduna, kur binte në ekstazë, voglushja thërriste nanën. Ajo dilte dhe e kapte për dore e hyjshin mbrenda, kurse e

çmenduna fillonte ta luej lojën me shkopij. Në dy duert, plot zdral e të rame lëkure, pranë çdo gishti vinte ndonji shkop dhe i lidhte me një pe të kuq, i hapte krihët dhe vraponte tue nxjerrë një za të çartun e të sëmunë, imitonte diçka, vraponte derisa rrëxohej si e nyrkosun, e kur rrëxohej i thyente shkopijt dhe qante. Nana e vajzës atëherë i lëshonte perdet dhe e çmenduna ikte mbrenda.

Por, një ditë, kur e hetoi voglushen se si dilte n'at ballkon dhe e shikonte, çoi poterë në tanë lagjen dhe, prej asaj dite, zu të zgjohet ma heret se rëndom, t'i përvidhet tinëz atij ballkonit e të kthehet me natë. Voglushja tash çuditej se çka kishte ngja me të çmendunën. E pritte derisa binte muzgu, derisa ajo grueja e pashme, nana e vajzës, dilte dhe e sillte voglushën mbrenda. Kjo nuk zgjati shumë kohë. Prap nisi të zgjohet po n'orën kur dilte edhe voglushja në ballkon, që tash ruhej e mëshihej. Voglushja fillonte të përcjellë atë se ç'ndodhte n'oborrin e të çmendunës, e cila edhe kësaj here e kishte hetue, por nuk e mësleh ma. E vërente përditë voglushen n'at ballkon, kurse voglushja, sa e kuptoi se as e çmenduna nuk mëshihej prej saj doli, e ngriti dorën e vogël dhe e përshtëndeti si ditën e parë. E çmenduna, tash e ngritte dorën edhe pa dashtë, niste t'i zdeshi dhambët e nximë. Ndërkohë, prap e çmenduna filloi të ruhet prej vogëlushes, nisi ta urrejë, t'i zgërdhiet e të vrapojë me grushta të ngritun deri te muri i naltë, që e mëshifte atë në hijen e vet, të thejë me gurë xhama dritaresh përtej murit. Sepse kishte sa ditë që nuk mundte të vrapojë nëpër oborr as të shtrihet pranë arkës së vjetrueme të pusit. Prej atij ballkoni filloi të frigohej. Prandej tanë ditën ulej pranë luleve, të cilat i ujitte në mëngjes e në mbramje. Ulej me shpinë kah ballkani e lulet me shtat ma të rrituna i lidhte me pej për disa gozhda të nguluna nëpër murin e ramë mistrije. Mandej, largohej disa hapa, e harronte at ballkon dhe fillonte të heqi valle e të qeshi. Niste me vrapue. Po at za të çartun e të sëmunë e nxirrte. Voglushja atëherë e shikonte habitshëm dhe, kur ajo kalonte në ekstazë, e grishte nanën. Të çmendunës kur i binte ndërmend ballkoni, e kafshonte buzën si vajzë e turpshme, ulej pranë arkës së vjetër të pusit dhe, posa grueja e pashme me shtat

të hjedhun dilte n'at ballkon i mblidhte plaçkat shpejt e shpejt, pështynte e hynte mbrenda. Murmuronte. Shante. Ulej pranë dritares ose zinte t'ua ndërrojë vendin orendive të shpërndame nëpër dhomën e vogël. Së voni ulej prap në minder, e vërente at botë të vdekur jashtë, që shtrihej si hije nëpër oborrin e ftoftë, të ndytë e të rrethuem me ato mure të nalta.

Kur nuk dukej grueja e pashme, nana e voglushës në ballkan, e çmenduna dilte përsëri përjashtë. E shikonte me bishtin e synit voglushen, e cila rrinte ende pip në kambë, ma vonë fillonte ta grishi – së pari me sy, mandej me dorë e me za t'ultë. Por, njëherë, voglushja frikohej. Ikte te nana e vet. Mbas pak kohe përsëri dukej dhe luate kokën. E vente gishtin e vogël në buzë dhe i varte vetullat, e shikonte të çmendunën ndër sy. Ikte prap dhe kthehej.

Kur, për herë të parë, voglusha e kapërceu pragun e të çmendunës tanë lagja vrapuen kah britma që plasi. Sepse prej të çmendunës të gjithë frigoheshin, saqë edhe fqinjët e saj nxituen t'i mbyllin arkapijat me gozhda e t'i lyejnë me baltë shpraztinat në mes të drrasave o t'i bajnë mure, të ruhen prej synit të saj shitues. E, kjo ndodhi menjëherë posa e hetuen se grueja kishte luejtë menç. Ndërsa e çmenduna mbyllej në shtëpi dhe këndonte do kangë të moçme, ose vraponte nëpër oborr ashtu si përditë. Merrte at sopatën e randë dhe të topitun e nxitonte t'i prejë degët e ulta të pemëve.

Mirëpo, qyshse voglushja zu ta vizitojë, të përvidhej prej të vetëve e të botës, të trokisi në derën e saj – e çmenduna e mëshehi sopatën, kurrkush nuk ia pa ma. Prapsepap prindët zunë me i bërtitë vogëlushes e mundoheshin vazhdimisht me i zgjue urrejtje ndaj të çmendunës. Voglushja atëherë qante dhe trikatër ditë shkante e nuk u shihej as n'oborrin e saj e as në ballkon. Dhe sa i harronte të gjitha ato, në derën e të çmendunës ndihej një trokitje e vogël, gadi e heshtun, të cilën e çmenduna e njihte; atëherë, ajo vraponte pa zhurmë e ia çilte ngadalë me një buzëqeshje të nxehtë, e përqaftë dhe qante. Vogëlushja nxirrte nga xhepat atë çka i kishte sjellë, uleshin pranë luleve dhe hajshin

bashkë. Tevona e çmenduna fillonte t'i kallxojë prralla. Voglushja i vente të dy duert e vogla në mjekrrën e rrumbullakët dhe e ndëgjonte me vemendje, buzëqeshte sa herë që trimat e atyne prrallave ngadhnejshin. Kur ndonjani i ngatrruhej së çmendunës pa e cekë, vogëlushja me kambëngulje kërkonte të përsëritet prralla për derisa të ngjallej ai trim, që nuk i binte ndërmend as të çmendunës, por që vogëlushes i kujtohej prej ditës së maparshme. Kështu, përherë e shtynte t'ia kallxojë ose niste të bërtasi, që ta ndërprejë at tregim të llahtarshëm për ujkun e vajzën e humbun në pyll, të cilën prrallë e çmenduna e tregonte disa herë në ditë. Kur mbaronte së treguemi, heshte dhe niste me shetitë nëpër oborr. Padashtas, nganjherë, i vente nëpër gishtat e hollë e të gjatë shkopijt e i lidhte me at penin e kuq, që e mbante të mbështjellun në dorën e majtë, e niste të vallzojë. Po at za të çartun e të sëmune e nxirrte dhe kur lodhej binte si e nyrkosun. Atëherë voglushja çohej, nisej ngadalë kah ajo. Shikimet e tyne, posa takoheshin, e çmenduna e mëshefte fytyrën në shuplaka e vetullat i çonte nalt. E kafshonte buzën e poshtme me dhambë mu si vajzë e turpshme. Voglushja tash fillonte e ia hiqte një nga një të gjithë shkopijt nga gishtat e penin e kuq ia mbështillte përsëri në dorën e majtë, kurse e çmenduna e shikonte me një buzëqeshje të sëmune sa që muskujt e fytyrës nisnin t'i lëvizin edhe ma shpejt, t'i ngrehen def. Kur, nga ballkoni, ndihej ai za i fortë i grues së pashme, voglushja largohej vrap. Te dera ndalej e pëshpëritte diçka, kurse e çmenduna e kthente kryet andej kah zani, e pështynte me pahir, çohej e mbyllej në dhomë...

Mirëpo, ditëve me shi e çmenduna rrinte mbrenda e këndonte me za do kangë të moçme, kurse voglushja zgjatej në dritare, këcente në kanape. Përndryshe e shikonte të çmendunën kah nxitonte në pazar, po me ato tesha të rëndomta, dhe ndalej para derës s'oborrit dhe e kthente kryet kah ballkoni. Kur nuk e shifte voglushen, ikte vrap. Por, posa e ndeshte në xham fytyrën e saj çonte dorën, e përshëndette dhe nisej për pazar. At ditë kur vogëlushja nuk shihej fare as në ballkon, i cili bahej se ditë e natë i rrinte pezull mbi krye. E, po kjo ndodhte edhe gjatë dimnit.

Voglushja, ato ditë, vetëm nga ballkoni e përshëndette, sepse flitej në tanë lagjen se grueja e çmendun e mbante të mëshehun nën krye një sopat, të cilën e nxirrte tinëz vetëm atëherë kur donte me rrëxue ndonji degë. Por thojshin edhe këte – se me at sopat mbrohej edhe nga shpirtnat e këqij që i vijshin natën në gjumë dhe që i ndiqte deri te dera e oborrit tue bërtitë e qa me za. Mu atëherë edhe lagja i frigohej shumë vetmisë së saj. Prandej, ato ditë, vogëlushen e mbajshin të mbyllun në shtëpi. Ndërkaq e çmenduna nuk i shkoqte sytë prej ballkonit, e vërente vogëlushen si luate me vllaun e vet e, padashje, nganjihërë sytë i terroheshin dhe një buzëqeshje e idhtë i shkrepse në buzë. Kur voglushja fillonte të qajë nga të ramet e vllaut, atëherë largohej prej dritares e fillonte të prejë diçka me gërshanë. Mbas pak kohe gropat e thella të syve i mbusheshin me lotë.

Kur niste pranvera me e qitë synin edhe n'oborin e saj, e çmenduna shihej tue mbjellë lule e tue ba pllajë pranë arkës së vjetër të pusit. Atëherë ia behste edhe vogëlushja. E lagja çuditej. Njerzit ndaleshin të habitun dhe e vërejshin voglushen se si trokitte buzagaz e pa fije frige në sy n'at derë të shtëpisë së vetmueme, se si e çmenduna ia çilte dhe e përqafonte fort. Njerzit luejshin kokat e zhdukeshin saora, ose afroheshin me voglushen deri te dera e saj e, kur ajo qitte kryet, pëshpëritshin diçka e ikshin.

Një ditë kur njerzit e kishin fitue at betejë të mbrendshme e të gjatë, e çmenduna nuk u duk ma rrugëve, nuk ishte dhimta e askujt, jetonte e vetmueme, e huej dhe e largët. Pranvera, që kishte ardhë, ishte pranvera e saj e mbramë. Me gjethin e parë që falej me blerimin, e përcollën të çmendun tanë lagja, me nderimet ma të mëdha. Në krye të vargut të gjatë të njerëzve ecte grueja e pashme dhe voglushja me një tubë lule të mbledhuna për gruen e vdekun.

Ajo shkoi e lagjen ende e mundon kujtimi për te.

Shikimin e drejtoi në fushën e gjanë e të paskajshme, të mbytur në bardhësinë dimnore – andej ku dy lumejt takoheshin e ikshin nga qyteti nën rranzën e kodrinës ku ngrihej si bjeshkë e rrënueme kështjella e lashtë. Sa të madh e ndiente vedin në kët hapsinë të pacaktë. I dukej se tanë ai horizont i cili shtrihej atje, po fillonte e mbaronte mu në synin e tij të madh që e picërronte nga drita e fortë e borës, e diellit.

– S’ka gja ma të lumtur se me jetue për dikend e njeriu, sado i keq qoftë, jeton për njeriun! – e theu heshtjen ajo dhe e puthi në buzën e poshtme.

– Njeriu dhe jeta! – tha ai tue qeshë e sytë fare s’i shkoqte nga largësija. – Por, si me e jetue jetën? – tha.

– Njeriu e jeton jetën e vet derisa e vjedh jeta! – tha ajo mendueshëm.

– Jo! Ai e jeton jetën tue u mundue me e pushtue vdekjen dhe vetëveten. Ashtu, një ditë, ik i vjedhun prej jetës, prej vetëvetes.

Prap heshtje. Ajo rrinte e mbështetur në te. I thithte gishtat e hollë e të gjatë. I hukatte duert. Ja hudhte rreth qafës, e zinte të buzëqeshi. Lidhej për trupin e tij që qëndronte para saj si statujë. Mandej, ia prekte buzën e poshtme me gishtat e gjatë dhe i zgjatte buzët lazdrueshëm, ngrihej në maje të gishtave. E thithte në qafë. Qeshte. Qeshte me një za të tingllueshëm dhe, posa ai e këputte shikimin, zinte t’i flisi diçka. I pëshpëritte.

– Njerzit janë kafshë të bukura – tha ai tue qeshë me ironi. – E ti je maca ime, apo jo?

Ajo luejti kokën në shenjë pohimi.

– Kuj nuk i ngjasin? Disa, për me jetue, bahen palaço e shetisin nëpër botë. Disa...

– Dhe të gjitha kanë vetëm një dëshirë: me jetue – tha ajo.

Shikimin përsëri e fërfilloi n'at fushë të haptë dhe kurrë nuk e pengonte – as fjalët e saj plot melankoli që i flitte ma vonë për fëmininë e bjerrun diku nëpër rrugët e shumta të këtij qyteti. Edhe ky ka dëshirue me qenë fëmijë i qytetit të madh si ky, me e kërkue vedin gjithmonë prej fëminisë ose me mbetë kujtimi i largët, i ndritshëm, në grumbullin e njerëzve. Por, kjo ishte e pamundur, mbasi moti kishte kalue ajo kohë andrallash. E, për mos me ia këputë fillin e tregimit për një fëminë të qytetit të madh, shtihet se e ndëgjonte. E puthte në ball, rreth qafe. Ndërsa ajo ngrihej në maje të gishtave. E kapte për palltë. Mundohej t'i zhytej sa ma thellë në krahnorin e tij. Ritmikiisht merrshin frymë. Së voni e gjithë kjo iu ba neveritëse. E shtyni rrëmisht. Ajo zu t'i përthejojë pullat e fustanit e të palltos.

– Kam dëshirue të jetë rrenë – tha ai me za.

– Përsëri doni të më tregoni diçka të kalueme, që i takon vetëm të kaluemes?

– Njeriu i takon së kaluemes ma tepër se t'ardhmes. Prandej, e due të kaluemen t'ime, megjithëse ka qenë e idhtë. Kisha dëshirue të jetë gjithçka rrenë.

Dhe – derisa ra ora e mesditës, i ndërruen disa druj. Flitshin e heshtnin. Ashtu kënaqeshin që të dytë në mënyrën e vet. Kur i tha se ka dëshirë me jetue në një qytet të këtillë, ajo e shtrëngoi me tanë fuqinë femnore dhe i fshiu dy pika lot kur e lanë parkun, ndërsa ai nxitoi me e zanë autobusin që nisej për në qytetin e studentëve, përtej urës, në qytetin e ri. Gjithë ajo që i kishte thanë ishte e vërtetë.

E vërtetë ishte edhe ai kthimi i tij në vete që i ngjante kthimit të lumit n'amën e vet gjatë muejve të thatësisë. Sepse, mbas vdekjes së babës zu të përplitej nëpër zallinat e jetës, të zhytet në vedi e të kërktojë diçka të largët që i takonte vetëm harrimit që kahmoti kishte nisë me iu shpërngulë nga truni.

Jetonte prej së kaluemes. Rrallë kush e shihte të buzëqeshun. I ra njëfarë hije e fëmisë bonjak. Dhe, qysh atëherë kur ndjeu se ka humbë diçka, zu të kqyri punën e vet, si ai Luli i Migjenit. Përvidhej prej ditës në ditë. Nuk i ngjante ma atij të hershmit buzagaz, sa u çuditte edhe lagja me te. As ato lëvizjet e tija të gjalla e të shpejta që ia njihnin të tanë, tashma i gjente në sytë e carrokëve. Mirëpo, kush mund ta ngucte këte që, si thonë, kurrkujt nuk ia prishte tymin e duhanit, që kurrkujt nuk ia thonte një fjalë të keqe. Mjer ai që e shante. Pika e sherrit e nxinte. Të gjithë i lëshoheshin në shpinë. Përnjimend, gjithkush e donte – sepse ishte e mira e gjithkujt. Në te mugullonte urtësija, dashunija, butësija. Shpeshërë thonte se nuk asht fajtor që prindët nuk e kishin mësue me urrejtë, me përbuzë dikend. Ata që nuk e njihnin sa duhet, nuk flitshin një të bardhë për te. Por, ky përsëri ua shtrëngonte dorën, buzëqeshte, sharronte thellë në botën e vet dhe e linte të kalojë gjithçka, pra edhe ato shamjet e randa. Fati i tij ka qenë i tillë me e shikue me at sy përbuzës, edhe pse kurr nuk pat rast me iu rrëfye kujt, me iu tregu se nuk asht i atillë, se jetën e don shumë, pse jeta asht e bukur edhe kur njeriu e ndien thikën e saj në brijë, edhe kur nuk ka me thanë diçka ma tepër, ma të meçme se tjerët. Ma së shumti i frigohej shpraztësisë së jetës atëherë e ndiente vedin krejt të vetmuem e të huej ndaj njerëzve dhe botës. Gjithashtu, rrenë ishte edhe ajo që thojshin disa se asht dheltnak i regjun, se din me e hudhë gurin e me e mëshehë dorën, se urren në mënyrë të mësheftë e të çuditshme. Njerzit e tillë i ka vërejtë dhimbshëm si kafshët e sëmuna. Vetëm ata ka dijtë me i urrejtë, i ka çue në drej të mallkuem, përherë ka dëshirue me iu ikë sysh. Ata nuk janë të mirë për vedi e lene për mue. Njeri, njeri gjithkush – një ditë edhe gomari kur ta quej vedin njeri thoshte sa herë pështynte në hijet e tyne dhe thekte hapin për me i shkelë kur largohej prej tyne i dëshpruem. Ai gjithmonë ia ka thanë njeriut të mirën dhe të keqën në sy. Me pëshpëritë mbas shpine i dukej se vedin e krahasonte me kurrgjë, i dukej vedi tepër i vogël, ma i vogël se një thnegël. Edhe sot i kujtohej mirë një ditë e fëminisë kur luate me top cuklash në

rrugën e Qarrit me mocanikët e vet. Padashtas që zanë me njanin. Kurrqja nuk i pat ba as kur ai e goditi me gurë në lule të ballit. Edhe prindët i pat gënjye, kinse ishte rrëxue te ura e Tabakut tue këcye n'ujë. Ate kurr nuk e urrejti. As vetë nuk e dinte pse. E donte edhe ma fort. Në klasën e ardhshme, kur u regjistrua, iu lut mësueses ta qesin në një bankë bashkë me te. Duheshin si vllazën. Edhe ma fort. Nanës sa herë i shkruante, i lutej ta qafonte, t'i përshëndesë edhe ata fëmijë tjerë të lagjes, që tashma ishin rritë e disa, madje, martue e ba prindë. Nganjisherë, kur kthente në vendlindje, kalonte orë të tana me ta. Vrapojshin livadheve, brigjeve t'Erenikut, ngjiteshin atje nalt në Çabrat, dathun, ashtu si në fëminin e bridhshin deri vonë, derisa ngrysej. Por kurrsesi nuk e ndiente at kënaqsinë e dikurshme. Rikujtojshin ato ditë vocrrije, që nuk u ngjashin aspak këtyne ditëve të mbarsueme me jetë, nuk mundeshin me u pa me to. Mbas katër-pesë ditëve, sa rrinte në shtëpi, kthehej përsëri i mallëngjyem dhe i bahej se diçka kishte harrue me e marrë prej atij qyteti. E kthente kryet herë mbas here, thyese tash do ta gjente ate çka kishte humbë moti nëpër ato rrugë e i dukej se e shkilte. At ditë të gjithë dilshin me e përcjellë. Edhe ata vocrrakët që pëshpëritshin emnin e tij panda. Por, një ditë, kur jeta për të njëzet e dytën herë e gatitte për betejën e mëtejshme, vrau guri i vdekjes edhe një herë n'oxhakun e shtëpisë përdhese. Ai i mbylli sytë, qau me za për herë të fundit, për dhimbjen e tij të gjatë që mbet vetëm, kalli vetëm tue kërkue vedin me ai hudhë çelsat e shtëpisë që ia sollën kushërijt nga vendlindja në mesin e njerëzve të rij. Kundruell tij jeta nuk kishte as një urë për në bregun tjetër të dritës. Kurrfarë andrrash nuk thurte ma. Jetonte mbrenda mureve të vetvetes dhe, përditë e përnatë, pëshpëritte një emën. I bahej se gjithkush po hynte e po këputte diçka në kopshtin e tij. Në trup i rritej vazhdimisht një zjarr i madh, që i dukej se do t'i shpërthente nëpër majet e gishtave – zjarri që me kurrqjë nuk mundte me e shndërrue në hi, as me shinat që reshnin në te. Në te digjej diçka si shtregë sane e reshte, e reshte pa pra, digjej e reshte. Kurr nuk pat mendu se edhe nanën nuk ka me e pa tue vdekë. Këte asnjisherë nuk e ka

ndie në vedi e as nuk i ka shkue ndërmend. At ditë dimni kur e pat vorrue babën e qe betue se ka me e vorrue edhe ate me duert e veta. E tash, e tash i dukej se po zgjohet nga një andërr e keqe e tanë një botë, e cila e mundonte, e brente.

Çfarë ndërgjegje ke, bre?

Çfarë?

Egoist je! Egoist!

Jo! Jo!

Ik! Ik! prej meje! –

Humbte një za në mbrendinë e tij.

E shembej diçka e afërt dhe e largët, krejt pranë tij, në te. Qetas, tash tërhiqej në vedi e mbyllej si guackë e madhe deti. Kurrkujt nuk dëshironte me i folë për nanën e për babën e vet. Dëshironte t'ishte rrenë gjithçka ajo që flitte ai në mbrendinë e tij dhe rreth tij. Kur heshtte, ndiente njëfarë lehtësimi shpirtnor – megjithëse pikllohej pamasë kur tjerët flitshin me aq kreni për prindët e tyne. Atëherë, largohej pa e diktue kush, tinëz. Shtihej se lexonte ose bahej se nuk i ndiente fare ato shamata të forta, therse, tallse.

Me të vërtetë ky nuk kishte se çka me u tregue për prindët e vet. Çka me thanë për babën që i vdiq në midis të pazarit nga pika e gjakut si rrogtar i përhershëm; çka me thanë për nanën që i vdiq në mes të kushërijve e nuk mbërrijti as në vorrimin e saj. Çka me i rrëfye për të kaluemen e tij si fëmijë që nuk ishte ma aspak interesante për askend. Kurse me trillue kurrsesi nuk dëshironte, sepse atëherë tepër i vogël i dukej vedit, kurrkushi. Ndërsa, të vërtetën e ka thanë gjithmonë, edhe kur buza i ka shkelë në gaz, edhe kur s'i ka besue kurrkush – anipse i thojshin se asht tepër vehtiak, se jeton vetëm për vetvedin, megjithëse e kërkonte vedin përherë me ia hudhë çelsat e shtëpisë që ia sollën kushërijt nga vendlindja e të shajë zotin e dreqin në gjuhën ma të ndytë të djerraditëve. Dhe – tash i bahej se gjithçka po kthehej në vetveten e andrrueme: edhe vërshima e lumit; edhe ai fshisi që kthehej në të

gëdhimë tue bërtitë vetë me vedi me qerre; edhe ajo, vasha, me buzë të kafshueme diku në përçafimin e natës; edhe sharrëxhiu fjalaman e i përgjumshëm. Dhe, mendonte, se sa herë udhtonte, zbulonte diçka krejt të panjofitun te njerzit që ishte edhe e tija – edhe ajo dhimbja e tyne, edhe ajo vdekje e tyne. E vokte dëshira dhe nuk e dinte as vetë pse në fillim nuk i kandej të kthehej përsëri atje ku mendja i rrinte gjithmonë. E mundonte një kujtim i largët. Mirëpo, tash kishte nisë me iu shpërngulë edhe ajo ndjenjë e çuditshme nga kujtesa dhe, për herë të parë në jetën e vet, nisi me e dashunue ma shumë se kurr at trenin e bardhë që çponte hapsinën e Jugut si plumb pushke përditë, përnatë, që e bante kah ai kujtim i largët gjithnji e ma shumë, kah vedi që i vinte era vendlindje. Me padurim pritte me u kthye. Thellë e kishte ndie jetën e qytetit të madh, at monotoni që i fishkllonte nëpër gjak, nëpër damarë si erë e egër mali, e llastueme. Dëshironte me qenë sa ma larg asaj qetësi të vdekur. Qyteti i madh për te ishte qetësi e frigueshme dhe ma tepër një njoftje me vetëvetën e një qortim, një gjezdisje e kotë, një braktisje. Njeriu duhet me jetue jetën kudo edhe në majë të thikës. Nisoj asht me jetue jetën kudo ose nesër, por vetëm duhet me e dijtë me e jetue, me e dashtë vedin. Qeshi.

Dhe – pak pa ra ora e gjashtë e mëngjesit, u nis për në stacion, mbërrijti posa erdhi edhe ajo. E nderoi si gjithmonë tue ngritë dorën dhe, së voni, kur e vërejti turmën e njerëzve se si dyndej në peron, i shkrepë një buzëqeshje e dhimbshme në skajë të buzëve e me gjysëm zani tha:

– Njerzit kurr nuk vdesin krejt, as prindët e mij nuk kanë vdekë.

Ajo u ndal. Nuk dinte se çka me thanë. Mbet e shtangueme, sikur ta kishte therë në qafë dikush me thikë. Mbas pak kohe qeshi në dyshim. Deshti me i thanë: – Deri mbramë më the se nuk ke prindë e tash, e tash... U përbi.

Mirëpo, ai vazhdoi të thotë me kambëngulje se ka prindë. Ajo iu hodh në krahnor. Dneste. Nuk e dinte pse e donte kaq

fort. Kush ishin prindët e tij, vallë? Mendonte – ata që herë ngjalleshin, herë vdisnin! Shikoheshin. Dashunisht. Etshëm. Përmallshëm. Belbzojshin. Por, kur i tha se ka me e pritë, ai e shtrëngoi fort për krahësh sa ajo ndjeu një dhimbje dhe rrudha e vetme që i kishte dalë në ballë iu thellue. Nuk mundi pa i tregue se kurr takimet nuk i dëshiron me diçka që ka humbë, se nuk i pëlqente ma as qyteti i madh, se vedin e ndiente krejt të vdekur në te, të huej dhe të tepërt.

Asaj i lëvizi buza në vaj. Uli kokën turpshëm, vrapoi, vrapoi kah turma e njerëzve.

– Kam dëshirue të jetë rrenë – pëshpërit ai.

Treni i tij udhtonte për në Jug, por udhtimi në vedi ende nuk kishte marrë fund.

QYTET I TAKOI EMILISË

Njisoj i ndiente takimet dhe ndamjet, si pranverën, si vjeshtën – kur erdhi n’at qytet. Kështu, ngjyra e re që u duk në pëlhurën e tij, e cila e simbolizonte edhe qytetin, e bani të qeshi për herë të parë në këtë monotonë. Mbasi e zgjati edhe një vijë ma të mbylltë mu n’anën e djathtë të krahnorit, iu duk se e plotësoi at shpraztësi t’asaj pjese; hija tash rrëshqiti prej thimthit të gjiut kah fundi i barkut që humbte n’errsinën e ngjyrave. E muer me mend se edhe hija tjetër, që zu ta tërheqi prej kërdhokllave kah puplat e kambës së djathtë, do të jetë gjegjëse e asaj së parës. Me kohë vërshuen edhe një tubëz vijash dhe hijesh, të cilat i dhanë një tansi ma të qartë pikturës.

Zakonisht, me hije bante krahasime të vazhdueshme gadi në çdo pikturë. Mu në këtë synim të tij pak të çuditshëm qëndronte edhe enigma e shumë punimeve, të cilat çmoheshin me të madhe. Si mundet njeriu me qenë hije dhe këpurdhë? – mendojshin dhe me sa e sa teori të çuditshme përpiqeshin me e vërtetue se njeriu sadopak i ngjan edhe këpurdhës. Jo, njeriu i ngjan vetëm njeriut, s’i ngjan as hijes, as këpurdhës! – shtojshin tjerët. E piktori largohej tue buzëqeshë. Njeriu i ngjan ma tepër ujkut – thojshin tevona. – Hiroshima! Po, njeriu asht edhe këpurdhë edhe ujk, hije s’asht. Sa çudi me qenë edhe këpurdhë, edhe ujk! E këpurdha bien edhe vitin e ardhshëm, edhe mbas sa vjetëve e shekujve e ujku mbetet vetëm ujk, prallë, hije si fisi i tij. Prandej, njeriu asht ma tepër këpurdhë – pajtoheshin. Vërtet të çuditshme ishin ato piktura ma se të thjeshta që mahnitshin vizituesit, të cilët rreshtoheshin me orë të tana për t’i pa. Sepse, n’at qytet çdo pikturë e re e tij ishte senzacion i vërtetë. Posa lajmi e merrte dheun, pëshperitej ose shkruente ndonji gazetë, niseshin grupe njerëzish kah katedralja, e cila gjindej në krye të qytetit.

Dyndeshin nga të katër anët. Nganjihërë numri i tyne ishte aq i madh sa edhe piktori çuditej. Po çka kishin ardhë me pa: njeriun këpurdhë, njeriun ujk e, mandej, hije!

Qeshte.

E shuente cigaren dhe largohej prej turmës.

Shumëkush prej vizituesve e kalonte tanë ditën pranë pikturave të çuditshme që, ma vonë, zunë t'i shajnë – sepse gadi kurrë nuk kuptojshin në to, megjithëse fama e piktorit kishte mbërrir larg. Domethania e tij për jetën e njerzit në pikturë ishte ma se e pabesueshme. Këtë një ditë mundi me dreqnina me ia zbulue një gazetar i panjoftun deri m'atëherë, i cili, në saje të bisedës me piktorin e ri, u ba shumë i popullarizuem.

Piktori thonte se hija zgjatet me lindjen e diellit dhe nuk zhduket as kur dielli pik mbas shpinës së malit kur dita i fik kallijt e dritave e shkon me pushue. Hije për te ishte moskthimi i secilit njeri në jetë – të jetës që ia kthente shpinën vedit. Hije e quante edhe vedin, madje hije qesharake.

– Si? Njeriu hije, edhe ujk, edhe këpurdhë? Ah! Pse bash këpurdhë? – i mblidhte vetullat vizituesi e largohej.

Ai vazhdimisht e ndiente vedin ma të dobët para botës e kohës, sidomos ndaj ditëve dhe stinëve që vidheshin përherë n'ikjen e tyne kah harrimi, kah mosha, andej kah i dukej se secila ditë shëmtonte profilin e jetës. Dhe, sa herë e vërente në grumbullin e njerëzve ndonji fytyrë të shqetësue, të rrahun nga shuplakat e jetës, ndiente dhimbsuni, e hudhte shikimin në tjetër anë, i merrte flakë dëshira me pikturue jetën nga skajet e dhimbjes.

E tillë qe edhe Ajo kur e ndieu vedin gjurmues në jetën e saj, atëherë posa pat fillue me i shplue krihet e andrrave mbi hapsinat e pashtegta të mërzisë, valëve të harlisuna t'eshpeve të përflakuna për me jetue.

Me at ditë kur Ajo u shpërngul për në qytetin e panjoftun, nuk dëshiroi fare ta kujtojë. Ajo që i takoi asaj ishte ma e fortë se ky – vetëm i shkoi ndërmend me e ndërrue qytetin, si Ajo.

Njertzit, për me qenë ma të lumtur – mendonte – duhet s'paku dy-tri herë në vjet me ndërrue qytetin! Sepse, ata gjithmonë dëshirojnë me qenë ma të panjoftun për me qenë krejt të vetmuem, të qetë dhe të lumtur. Njertzit dëshirojnë me i ngja ma tepër zogut ose gjakut se sa drunit ma të bukur e ma të naltë – në mes të stuhisë kurrkush nuk dëshiron vetin me e pa.

Për pikturën ma të re që pati rast me e shikue, gazetari i panjoftun shkroi se rrallë asht pa një punim i këtitllë edhe n'ekspozitat ma të njoftuna të piktorëve të mëdhej. E kjo ishte vetëm një këpurdhë e zakonshme, e çpueme në katër anë prej do hijeve; në midis kishte një sy të madh, që vizituesit i habitte dhe largoheshin tue thanë:

– Sa çudi. Njeriu hije dhe këpurdhël!

Përherë e ndiente ma fort shkuemjen e saj të padëshirueshme. Gjithashtu i vinte keq që ishte sjellë aq pahishëm mu natën e vjetit të ri, kur ajo, gjatë e gjatë, i kishte folë për ditëlindjen e përbashkët të njerëzve, e që kishte zgjue një ndienjë të çuditshme për at natë dhe njertzit – sidomos për at natë, kur të gjithë njertzit sado pak u ngjanë hijve dhe këpurdhave, qingjave e luajve, kaprojve dhe lumejve. E këtij mu at natë i erdhi ajo e vetja me i çue në drej të mallkuem të gjitha! I kishte lindë një ide e përçuditshme se – kurr në të vërtetë nuk i kishte dashtë netët e vjetit të ri. Gjithmonë i janë dukë të mërzitshme, të randa e të pikllueshme. Net që kurrkujt nuk i takojnë. Si mashtrim i një nate. Kurse ky ka dëshirue me qenë i mashtruem gjatë. Tanë jetën. Prandaj edhe kur vinte vjeti i ri dëshironte t'ishte sa ma larg asaj nate aq të randë...

Saherë zinte, tash, të punojë në pikturën e pakryeme – ato buzë si dy harqe ngjyrëgjaku, n'at fytyrë të hajshme të vajzës që i vizatoi posa ktheu at natë, e vritshin, ia kujtojshin buzët e njerëzve të zbetë e të lodhun të pikturave të Modelanit. At natë

ajo iu duk e tillë ndoshta se lodhja i kishte zbritë deri në shpirt, ose pse, mbas tetë muejve e njëzetë e tetë ditëve, e kremtonte ditëlindjen e vet të vogël. Në buzën e poshtme, e cila harkonte kah fulqija në ngjyrën e verdhë, tërhoqi edhe një vijë të kuqe. Shihej qartas se buza ishte zgjatë për puthje, që tash e vërente krejt i qetë pa fije dëshire apo mënjje.

Uli kryet dhe ndezi cigaren.

Ditët kalojshin n'udhtimin e tyne, por ky ende nuk kishte mundë me e paraqitë buzëqeshjen e saj të ftoftë kur iku prej saj pa ia urue as vjetin e ri. Çuditej, ma tepër se njerëzve gjithmonë u rrin ma bukur urrejtja në buzë sa buzëqeshja. Mbas do ditësh në vendin e dy harqeve të buzëve hijoi një kryq prej dy ngjyrash dhe një hije e randë n'anën e majtë të fytyrës. Ndërsa në ballin e gjanë që ngrihej si breg i pjerrët nga vetullat, i tërhoqi me majën e pendës edhe disa viza që mezi shiheshin. Ngjyra e ndritshme, e cilat vinte tue u ba ma e randë ballit përpjetë dhe ajo e flokëve që formojshin faqet e kubit, ia trembën zogun e fantazisë. Ishte e bindun se gruen ende nuk kishte mundë me e pikturue siç e kishte paramendue, ashtu sikur kishte këndue edhe Tagora. Çfarë natyre e forme me i dhanë andrrës? E ajo – ishte vetëm një andërr që kishte nisë me lanë dalngadalë? Zu të baj disa verzione. Njiherë vizatoi një çerdhe dhe zogun tue fluturue kah naltësitë. Vizatimi që i punuem prej dy ngjyrave. Ngjyra e kaltërt iu duk ma afër realitetit. Ajo e kuqja i përgjigjej ma tepër dashunisë. Herën tjetër vizatoi një zog të mbyllun në kuvli tue i rrahë krahët për shufrat e hekurta dhe synin e njeriut si gja të plotfuqishme. Por, prapseprap ma i qëlluem iu duk verzioni i parafundit, i cili paraqitte gruen tue çelë derën e shtëpisë – caku i vetëm në mes të njerëzve të tij, ndërsa grueja çelsi i parë me mbërritjë në botën e dëshirueme...

Pranverë ishte kur e kreu pikturën. Tre vjet tjera kishin kalue deri m'atëherë. Ajo ma nuk jetonte në te. Kishte mbërrë me ikë hijes së saj dhe kostarët e harrimit me pre në bel ato kujtime të shpërndame që kishin një datëlindje me pikturën, të cilën e pagëzoi “Grueja me një sy, ose kujtimi i cunguem për Emilin”.

Atyne që patën rastin me e pa n'ekspozitën e tij të fundit, për shumë kohë iu mbet e paharrueshme – sidomos grave që kthejshin gadi çdo ditë e që, sa herë, largoheshin, pyetshin habitshëm: a asht e mundshme me e pasë na vetëm një sy? Gjithfarë pyetjesh i bajshin njana tjetrës. Ndaleshin para asaj pikturë të çuditshme, e që ishte vetëm një kërpudhë e zakonshme e çpueme nga të katër anët prej do hijeve dhe kishte një fytyrë e një sy si t'atij Polifemit të Homerit. Mandej, i rrudhshin sytë, nuk pajtoheshin se kanë një sy dhe se njeriu asht edhe hije, edhe këpurdhë e thjeshtë. Nëse njeriu ka trup si të këpurdhës, nuk ka një sy – mendojshin. E pyetshin edhe ate, i cili i shikonte gjakftoftë tue luejtë kokën derisa largoheshin.

Kah fundi i muejit qysh se ishte hapë ekspozita, ia behu edhe një fytyrë e panjoftun femne, e cila hyni në sallonin e madh pa e vërejtë kurrkush. Kërkoi diçka me sy e, tevona, u nis drejt kah piktura “ma e çuditshme e shekullit të ri” – si e pagëzuen gazetarët. Gjatë qëndroi tue shikue me një buzëqeshje të njerëzve të penduem. Syni i madh i grues në pikturë dukej se donte me e përbi tanë hapsinën, ndërsa ajo vetull e punueme me mjeshtri thue ngrihej si ai harku i të moçmit me goditë dikend. Ajo e shikonte, i mbyllte sytë dhe i lëpinte e i kafshonte buzët bante herë do hapa para, herë do mbrapa, e lakonte kokën anash.

– Unë them se asht mundue me pikturue dashuninë e humbun ose diçka të tillë – e trazoi një vizitues.

– Ashtu mendoj edhe unë – tha ajo si e hutueshme. – Vetëm, mendoj, ma tepër asht përpjekë me paraqitë një urrejtje, një ironi.

– Urrejtje!? – tha vizituesi habitshëm tue shikue pikturën.

– Po! Urrejtjen, urrejtjen – tha ajo përsëri.

Vizituesi luejti kokën dhe bani me dorë tue mos dijtë me u përgjegjë. E kqyri gruen dhe u largue tue varë buzën. Grueja vazhdoi të shohë pikturën, derisa hapat e vizituesve, të cilët ktheheshin në mesditë, e trazuen qetësinë.

Në të dalë, në fytyrën e zeshkët dhe picigjate të piktorit u rrëxue një hije e randë. Ishte Ajo...

Kur e la qytetin e katedraleve dhe kumbonave të mëdha binte shi. Një erë e lehtë frynte herë mbas here, i trette giethet e rame nëpër trotuaret e paskajshme kah lugina e lumit ku vjeshta ishte dukë tue ardhë me krushqit e vet të zez. Si kujtim muer vetëm një panoramë ku shihej katedrala dhe kumbonarja e madhe që përditë e zgjonte me ferk t'agimit. Kurr nuk besoi se kaq shumë e kishte dashur atë. E linte qytetin mbas dhe një buzëqeshje, e cila shembej me at urrejtnjen e vet këpurdhë të madhe. Prej vetvetes e ndiqte ai njeriu i zi i verbët që hiqte shpirt diku në fundin e tij e, që ky dëshironte me e humbë përgjithmonë larg njerëzve e botës.

Me at ditë qyteti i takoi Emilisë.

LETRA

Në bebzat e syve të mjegulluem qielli erdhi e i humbi ngadalë derisa i mbet pikë shumë e vogël, gadi e padukshme. Iu ba njollë e pashlyeshme e ditës së fundit, e cila linte si të gjitha ditët tjera, të mundun. Fijen e barit vjeshtak që e vuni ma parë në gojë tashma e kishte grisë krejt. Gjithçkafit si dukej i jepte emën dhe ngjyrë, simbas trajtës, natyrës e vendit në botë. Njeriu asht thjesht urë – mendonte – çka mundet me qenë tjetër pos urë nëpër të cilën kalon edhe e mira edhe e keqja.

Disi, kur erdhi, mezi i kalojshin ditët, edhepse ngarendte palidhje. Ndërmend kurr nuk i shkante se këtu ditët ta lejshin me gisht në gojë. E pat kapë një mërzi e randë, që e bante krejt të huej ndaj vedit dhe asaj fije jete që i ikte dhe e linte korube të shprazët. Por, kur pa se ia mbërriu edhe e mbrama – ajo plogështi tashma e kishte lëshue dhe e mundonte diçka tjetër që ishte shumë ma fort se ajo, një fuqi e brendshme dhe e pashpjegueshme, që e kishte rrokë e që as vetë nuk e njihte – nisi me shetitë vetëm. Nuk dëshironte ta trazojë askush, as Fani.

Posa zgjohej e lante fytyrën, shkante për me ngranë mëngjes dhe, si hije që zhduket me diell, humbte në blerimin e livadheve. Në mbrëmje kthehej vonë me natë e, shpeshherë, edhe me ferkun e mëngjezit. Kthehej vetëm. Kur e kërkonte ndokush prej brigadës, vraponte me e gjetë te lisi i madh ose te stacioni hekurudhor, që gjindej jo fort larg barakave – që t'i kujtojshin tbanët e Bjeshkëve të Nemuna. Atje kalonte gadi tanë ditën, sepse, thojshin, se pritte dikend po kurrkush nuk e dinte kend.

Mirëpo kur numronte ditët për me u kthye, iu zgjua një ndienjë ma tepër kureshtare. Gjithçka filloi ta shikojë në një mënyrë krejt tjetër. I vinte keq pse kishte qenë i atillë gjatë tanë muejit, pse kishte kërkue disa herë me u kthye. Kjo iu kishte ba

pikë në zemër e, tash, kurrjë nuk i dukej ma e afërt dhe ma e dashtun se vetmija. Qetësi gjente vetëm në largimin prej asaj tollovije që e rrethonte. Por, çka ishte ma mirë, i besonte vetit. Përsëri kapej për bisht të ndonji andrre. Dëshironte të mbes aty. Kurr ma shum se tash se donte praninë e vetit në kohë.

Dy ditët e fundit nuk u duk fare te stacioni e as te ai lisi i madh ku gjithmonë e kërkoshin. Askend ma nuk e pritte, as trenat – në qytetin ku studjonte kishte pa trena të panumërt, gjithfarësh, nga të gjitha anët e botës; kishte pa njerëz me gjithfarë buzëqeshjesh e veshjesh, njerëz që nuk kanë stacion të fundit, ata që gjithmonë kërkojnë vedin; kishte pa andrrimtarë të përhershëm, njerëz që u ngajjnë agimeve, muzgjeve, zgjimeve, ata të pashëm që i shikonte me një sy krejt tjetër... Thoshte: të gjithë njerzit kanë diçka të bukur në vete, as shëmtimi ma i vrazhdë nuk asht krejt shëmtim. Këtë mendohej me e përfocue me shembuj të vërtetë. Shpesh bante fjalë për një magjup të lagjes së tij që ishte sakat dhe i vrazhdë, por të cilin njerzit e quejshin të bukur, ma të bukurin në lagje – ku me e dijtë se pse; tregonte poashtu edhe për një vajzë nga vendlindja të cilën ky e radhitte me familjen e Patës e Patashonit, ngase ishte, si thonte, një minaturë e zakonshme, me një trup të vogël të deformat – mirëpo, edhe këtë njerzit e quejshin të bukur m’u për at fytyrë të çiltërt e të rrumbullakët, që e mveshte njëfarë hije femne. Me këso shembujsh, që kishte shënue në ditarin e vet, e cikrrime tjera jetësore e pedatje qe fat. Por, prapseprapë, krahasim ma të qëlluem për bukurinë e jetën nuk gjente sa atëherë kur mirrte fijen e barit dhe e krahasonte me vetveten aq të paqëndrueshëm ndaj asaj pjese të jetës së vet që ikte e që e lente korubë të shprazët. Kështuqë, kët zbrazti të tij që ishte një vakuëmë, shpellë kohe, e ndiente edhe ma si një humbje të ditëve të kalueme, që kishte ngarendë e kërkue me u kthye e tash – kishte vendosë se derisa udhton vetë nuk ka me dalë ma me i pritë as me i përcjellë trenat. I dukej se trenat përditë po i vidhshin diçka të dashtun, po e lejsnin ma të vetmuem.

Me vjet e kishte pritë nëpër stacionet e qyteteve at trenin, që kurr nuk ishte ardhë për te. Kudo që mbërrinte dilte në stacion

e i pritte trenat. I pritte edhe këtu. Pendohej. E kishte dashtë. I pat besue. “A më don?”, një ditë i tha ajo. “Po!” “Shum?”, kishte pyetë ajo me dyshim. “Shum. Vetëm ti nuk më don”. “Kemi me pa”, i kishte thanë ajo me besim, tue i zhytë gishtat në kaçurrelat e tij të verdhë. Dhe – i patën besue njani tjetrit. Por, një ditë, ai nuk u kthye, sikur i kishte premtue, me këputë at mollë të vashnisë së saj.

Ditëve të fundit nisën të thonë se vajza e tij ishte po ajo vajza për të cilën shpeshherë tregonte sa e sa ndodhina, të cilën e quente gjithçka dhe e radhitte në familjen e Patës dhe Patashanit. As vetë s’e dinte pse, prap e donte edhe si t’atillë, dhe, pse vazhdonte të tregonte për te. Një gja e tillë kurrsesi nuk dëshironte t’i ndodhi tash me Fanin. Mendimet e tij, shumë herë të pacaktueme, filluen t’i shpërngulen nga truni i tij ngjashëm me ikjen e dallëndysheve, me zverdhjen e gjetheve në vjeshtë.

“Pse të ketë ndamje? Njeriu ka lotë ku me i derdhë. Pse mos me pasë vetëm takime? Të ketë njeriu ma shumë kangë e dashuni në jetë. Për shembull, po i lindi grues shterpë fëmijë mbas shumë vjetëve, kush ka me këndue? E, dikush duhet të këndojë për gëzimin e saj! Ose, po i vdiq djali i dëshirit vejushës, kush duhet të qajë për fatin e saj?”

Heshti. Zogun që e përcillte para sa minutave nuk e pa ma. Ret e denduna uleshin në krahët e ditës që ecte me vrap. Muzgu kishte fillue me i fikë buzët e kalluna të lindjes në suprinë e lumit, që ikte për bri rrugës së re. Kandet e ngushta që formoheshin prej rrezeve të diellit me kurrizin e kodrës së blertë të mbjellun me vneshta e trupa pemësh, erdhën e humbën prej shllungave të tymit të lokomotivës që gërhatte pa ia nda aty afër livadhit. Ora rrihte rand në tamthat e tij. Nëpër të lashtat e pakorrura e çatija e shtëpijave përdhese strukeshin zogjt, lajmtarët e parë të jetës.

Nata dukej tue ardhë si kali hamshor.

“Nuk kam me përcjellë kurrkend. Të tjerët le të përcjellin njëherë edhe për mue. Ndamje sot, ndamje nesër, e mbasnesër ofshamë dhe dhimbje! Jo, nuk kam qaj për të mijt kur kanë vdekë

e jo ma për të tjerët për këte... Por ata janë të vdekur e këta të gjallë dhe ajo...”

U rrokullis livadhët të kositun. Fytyrën zeshkane ia kaploi një gëzim që e ndjeu thellë në vedit.

“Po! Po!”

Shtrëngueshëm i shtriu duert e kambë, zu t’i marr erë livadhët, ta qafojë, e sytë t’i shëndrisin si pikla yjsh n’errsinën e natës. Kishte andrrue një herë të vetme me qenë i fortë, ma i fortë se shkambi, me i ngja bjeshkës ose gurit ma të vogël vetëm të jetë i pathyeshëm. Kishte andrrue me i ngja fijos së barit kur të vijë ajo qetas me e gjetë at lule që piprronte në jetën e tij. Por, gjithçka kishte qenë e kotë edhe ajo pritje e tij e gjatë, edhe ato bredhje poshtë e nalt në vete – sa që kishte ardhë në përfundim se njeriu asht qenia ma e vetmueme në botë, anipse jeton në mes të njerëzve.

Thonte: jeta e vdekja e tij askujt nuk i takon, se bota gjithmonë ka ma shumë lindje se vdekje; se njeriu lind secilën ditë ngapak, se njeriu nuk lind as nuk vdes përnjherë. Njeriu lind shumë ma vonë mbas lindjes së vet, njeriu mundet me vdekë shumë ma vonë mbas vdekjes së zakonshme. Dhe – kurrkush nuk duet me e bindë se ate që e thoshte ishte e vërtetë, se jeta e tij ishte dhe nuk ishte gëzimi i tjerëve.

“Po, po, njeriu asht një urë e thjeshtë – mendonte. – Çka mundet me qenë tjetër pos urë nëpër të cilën kalon edhe e mira edhe e keqja?”

Në kujtesën e lodhun e gaditë përkotun prej qetësisë, reshte një mallë, bahej vërshimë në shpirt – lum i thellë e, diku në mesin e tij, mbetej si ishull i vdekur në detin e paanë. Si zogu pa krih që frigoget me e puthë së pari kaltrin e qiellit, ashtu edhe ai frigoget e nuk dëshironte me e pa vedin të tillë. Kur i tha një ditë Fani se meshkujt i dashunojnë femrat vetëm për epsh, i tha: – Rrenë asht!

Atë ditë që ngjitë rrugës vetëm, ndërsa ajo e priti atje buzë lumi edhe nesër, edhe mbasnesër. E pritte përditë. Por, kurrkush

nuk e pa tue u lëshue asaj kambisore që të çonte në lum. Vraponte te stacioni i trenave ose te ai lisi i madh e shtrihej në livadh.

Tash, kur e hodhi shikimin e lodhun andej kah rruga e re, për të cilën mendonte se kanë diçka të përbashkët, buzëqeshi e vu edhe një fije bari në buzë, e grisi ma rrëmisht se të parat. Mizën, që i rrëshqiti ftoftë tue ba disa dridhje nëpër trupin e tij gjysmë lakuriq, e lëshoi pa neveri në shuplakën e dorës, mandej në fijen e barit të thamë nga flaka e vjeshtës. Dhe, kur ndjeu se kishte nisë nata të derdhej edhe në kaçurrelat e tij, u çue, vrapoi kah shtegu i livadhit ku e priste Fani. E rroku për dore dhe u nisën me i zanë brigadistët që ishin nisë grupe-grupe kah stacioni.

– A më don?

– Po, Fani.

– Shum.

Ai luejti kokën, ndërsa ajo, mbasi e përqafoi, uli sytë përdhe e i dha një letër që e kishte shkruar para sa ditëve. Mandej këceu në shkallën e mbramë të vagonit, që rrëshqitte binarëve të largimit me një ushtimë neveritëse. Filloi diçka të sharrojë në te, të mbytet e të përmytet, të zhytet e të dali e të mos duket fare, reshtte diçka e paharrueshme në trunin e tij.

“Sa shpej po ikë jeta!” – mendoi. Gjithçka ishte si dje.

Bani disa hapa. Iu duk se përgjithmonë diçka shkëputej prej jetës së tij. Në dritaren e trenit ende dukej Fani tue luejtë dorën. Nji za e vidhte hapsija dhe terri i natës. Ai vraponte tue bërtitë, e zani i Fanit prap ndahej. Ai vraponte dhe, kur treni humbi në largësi, zgjati dorën kah shpraztija.

Frynte.

Ky ishte treni i fundit që ikte larg vetmisë së tij... Ma vonë do grimca të letrës që ishin shpërndarë nëpër peron, era i bajti. Ai ecte dikah, qeshte e qante, ecte vetëm, qeshte e qante. Vetëm.

Ku me dijtë se çka i kishte shkruar?

Kur ma nuk tregoi për at vajzën që e rradhite në familjen e Patës e Patashanit.

BURGU I HAPUR

Rilindja, Prishtinë, 1998

FOTOGRAFIA

Ma lëshoi në dorë aparatën fotografik. U rreshtuan para derës së shtëpisë. Tre fëmijët i vendosi në mes. Në anën e majtë qëndronte ai. Nga objektivi i aparatit renditja ishte pakëz e çuditshme. I ngjante gërmës V. Pse? Këtë nuk e bënte për atë që mendoja unë. Në të vërtetë, harmonia fillonte nga më i vogli, që gjendej në mes. Mesazhin e renditjes si ta pranoja. Gjakftohtë shikoja në syrin e objektivit. Çfarë fitore të braktisësh Atdheun, kisha menduar më vete. Dhe, kur përgatitesha të shtyp butonin, kisha veneruar edhe drynin në derën e shtëpisë. E shkrepja edhe disa herë nga kënde të tjera dhe pas çdo poze thoshte mos ma harro edhe derën, bile edhe atë drynin në të. Pastaj më kishte thënë se nuk di ku do të ndalet. Ndoshta, aty ku ndalet edhe autobusi. Me teshekoteshtë e përçolla në Stacionin e Lotëve, aty ku përkohësisht nuk ekziston “Rilindja”. Mezi e shikonim njëri-tjetrin. Të voglin e qafa më gjatë. Më bëhej se rreth qafe më ishte kacavarur një copë vdekje. Atë që i pëshpërita në vesh, i thashë, të mbesë fshehtësi në mes nesh. Ai luajti kokën dhe hyri në autobus krejt i humbur. Unë ngrita dorën. Ua ktheva shpinën me rrëmbim dhe ika. Ende vrapoj. Në bibliotekën time qëndron e varur fotografia e mikut, ku shihet edhe ai dryni në derë të shtëpisë. Rrenë është se ai buzëqesh. Vajin e tij e ndiej edhe në gjumë...

(Ulqianë, 1992)

NË FUND TË RRUGËS SË BREHTIT

CUNGNJERIU

Sapo dielli pikte tej Qafës së Prushit, e lija pas Gjirin e Jahocit. Rrëzë faqes së zdashur të Çabratit bëja udhë gati një gjysmë ore. Te kthesa e parë e Rripës, atje lart ia lëshoja sytë shkurrës së frikshme. Në mes të saj ngritej një cung i madh, hakaret. Askush nuk e mban mend sa vjeç ishte. Nëna më thoshte se ekzistonte aty shumë më heret se flitej në lagjen tonë. Sipas të gjitha gjasave cungu kishte qenë një dru i lartë dhe i bukur. Nën kurorën e tij ishin freskuar shumëkush. Edhe tani hija e tij bie në udhë, më e cunguar. Te shkurra e mistershme, në midis të faqes së zdashur të Çabratit, ku me perëndim të diellit thyheshin dritat e reflektuara nga valët e Erenikut, u ngjita një pasdite të vonë. Kur i afrohesha, ndieja praninë e mbretërisë së cungut, flladin e tij përzier me shkumbin e vjetëve dhe gjymtyrëve të vdekura.

Cungu ishte gati i derdhur, i pashpirt; ashtu siç tregonin në lagje. I ngjante një krijese pikëlluese; i burgosur në vetminë e merimangave, kërpudhave helmuese, myshkut. As në Makandon e Markesit nuk do gjeje një cung kaq të vetmuar. Nëpër trupin e tij të zhveshur, të nxirë futë nga shirat e erërat, lëviznin kushedi sa gjarpërinj. Ca prej tyre, atje në majë katullaqë bënin gjumë të

mirë; ca humbnin vrimave të thella, duke ndjekur ndonjë mi ose insekt, që guxonin t'u prishte qetësinë. Mbi të rrallë fluturonte ndonjë laraskë.

Qëndroja nja pesë metra larg. I bëra dikur nja dy rrahtë rreth tij dhe u lëshova faqes së Rripës pasi dëgjova fishkëllimën e një verdhushke. Shumë vjet më vonë në kujtesën time, në mënyrë të çuditshme, hetoja formësimin e asaj kreature trishtuese, e cila zgjonte në mua asociacione të llojllojshme deri te ajo nama e popullit, e cila i rrëshqiste nganjëherë edhe nënës: U bëfsh cung! Në fillim prania e tij ishte e zakonshme. Ato vija të rënda e gjymtyrë të vdekura, i shikoja me një dhimbsuri. Një natë, kur ndjeva peshën e tij, shqetësimi kishte lëshuar rrënjë në shpirtin tim. Cungu nuk ishte më vetëm *cung i vetmuar* në mes një shkurre, por pjesë e pandashme e ligjëritim tim. Ishte e pamundshme të lirohesh nga hija e tij.

Në Ulpianë, nga kati i katërt, derisa më rrëshqitnin sytë në terrin frikësues një natë vjeshte, diçka e zezë ngrihej para dritares sime. Dhe kur zu të shkundet si ai mani i nunit, buzëqesha. Ishte cungu. Pritja dënimin se kur do të më nxirrte edhe jashtë dhome. Unë ende nuk e kisha kryer poezinë për të. Vëreja se ishte nxirë edhe më shumë, me gjymtyrë gati të thyera, me nejtë frikshëm.

Dhe kur mendoja se isha liruar nga zymtësia e tij, pas shumë vjetësht në Frankfurt, në një kënd, ku, siç thoshte nëna, qosheve ruhen gjërat më të vlefshme, vizuelisht lexoja "Mbijetesën shqiptare", kapur nga Jetta Benzenberg.

Kisha lexuar e dëgjuar shumëçka për kampet e përqendrimit në Shqipëri, për atë majën e tmerrshme ideologjike, që kishte rrënuar edhe koka të kombit, por kurajoja ime kishte munguar. Ndaj diktaturës ishim treguar qyqarë. E donim Shqipërinë se te ajo na dukej e bukur edhe vdekja. Tani atë turp nacional e shihja varur në mur përmes fotografive të pastra, që lexoheshin si tekste lemeritëse. Jeta ishte zhveshur deri në asht. Ishin shpëluar krimi, mjerimi, injoranca, viktima dhe gogoli i zymtë i diktaturës. Fotografi e mesazhe ishin shkrirë në një

përmbajtje: *tragedi njerëzore*. Aty zbuloja edhe një plagë të re të Gjergj Elez Alisë. Dhe, nuk ishte e vërtetë se ai na i kishte vetëm nëntë plagë.

Ca drithma ma kishin përshkuar trupin. Në sfond portreti i shqiptarit në moshë të thyer: me ballë të gjerë e mollëza të dala e të rjepura, me duar të paluara mbi gjunj të cullakosur, me gishtërinj të shkurtuar e neje të ajura, që hynë edhe në një poezi timen. Tronditës ishte shikimi pikëllues - akuzues, që e kishte mbështjellë hija e rëndë e që e vijëzonte dhunën. Fatkeqësisht, para meje ishte njeriucung, i dalë nga dheu arbëror, që nuk dallonte fare nga cungu im atje në Çabrat, i cili më vizitonte shpesh.

Papritmas më kishte zgjuar një zonjë gjermane. Nëpër dhëmbë kishte sharë. Në syrin e saj të kaltërt kisha parë lotin. Qetas kishte hequr shallin nga qafa e vet e gjatë. Me kujdes e kishte mbuluar fotografinë dhe ishte tërhequr pas, duke mos i shkoqur sytë derisa ishte zhdukur. Fotografia fliste shumë. Nuk kishe të bësh me fantastikën, por me një realitet të hidhur që i afrohej fantastikës.

Ula dikur shikimin turpshëm. Lexova: Gjergji. Gjergj quhej cungu im. Në mbretërinë e cingut, më në fund e kisha zbuluar fyerjen njerëzore, por nuk di a kishte marrë fund udhëtimi. Cung u bëfsh more, mbasi nuk e vrave qenin...!

LIRIA ABSOLUTE

E nxora shaminë nga xhepi i majtë i vintjakës. Xhamin e megjulluar nga tymi i duhanit e hukata disa herë dhe e fshiva kujdesshëm. Nuk desha t'i bie në sy. Pamja u hap për mrekulli.

Katedralja shihej e pastër, me të gjitha nuancat. Pakëz e murrme, në anën veriore fshihte vitet. Miku, që rrinte karshi meje, përcillte çdo lëvizje timen, edhe shaminë si e palova dhe e vura prapë në xhepin e majtë të vintjakës.

- I shikoni vijat e fytyrës. Dukeni se keni ardhur nga lashtësia - tha.

- Përcjell fluturimin e zogut rreth Katedrales - iu përgjigja pa e shkoqur shikimin.

- Zogun? E jo Katedralen! - pyeti habitshëm.

- Ai ma kujton vendlindjen. Katedralja është diçka përrallore. Art më.

Ai ktheu shikimin nga Katedralja e lartë. Nëpër xhamin nga e kisha larguar megjullën e dendur të tymit pa vetëm bishtin e bardhë të zogut, i cili u struk në një vrimë, pranë Zotit.

- Aty e ka çerdhen - shtoi ëndrrueshëm disi - Bile dihet edhe numri i tij.

- Paska edhe numrin e vet?!

- Ta qëllosh mund t'i fitosh disa vjet burg.

Në gaz më lëvizi buza. Nuk e hetoi këtë miku. Buzëqeshja ime ishte më e hidhur se ç'paramendoja. Ligjin për mbrojtjen e shpesëve kur e zu ngoje, unë kisha qeshur tamam si një idiot. Për të foli edhe shumëçka. Gati kaloi nen për nen. Të zhdukësh një zog, tha, madje edhe ndonjë mi infektues, ekzekutimi bëhet tek pas shumë provave të tjera. Kjo është ajo liria absolute. E kërkuara.

- Te ne nuk ekziston ligj as për mbrojtjen e njeriut - ndërhyra.

- E pamundur! - tha sa gati syri nuk i piku në tavolinë. Për mbrojtjen e shpesëve nuk foli më. Vetëm shtoi - Të çuditshëm jeni ju ballkanasit. E hani vetveten. Si duket keni kohë përsëtepërmi.

- Madje shpërblehen ata që vrasin më shumë - Desha ta forcoj mendimin me ca shembuj, por ai me një neveri tha:

- As kafshë nuk qenkeni!

U nxi edhe më shumë se ç'tregonte lëkura e tij. Nga dridhjet brofi në këmbë. I ra sallës disa herë, i pavetëdijshëm gati. Lëvizjet e tij shkaktuan habi. Kamarieri pasi solli edhe kafetë e treta, me një fyt piu të veten dhe iku, duke më shikuar me një dhembshuri të çuditshme. Pak më vonë u ngrita edhe unë. Ai kishte harruar syzat që, siç thoshte, i kishte blerë në Tel-Aviv.

Kishte kaluar gati një javë që nuk isha kthyer në kafiterinë ku pija kafenë e mëngjesit dhe ku zbuloja nga diçka interesante në trupin e hedhur të Katedrales. Hapa derën. Nxitova tek dritarja, ku ulesha gati përherë. Sapo iu afrova tavolinës, dallova shpinën e mikut. Qëndronte me fytyrë nga Katedralja.

- Paskët vendosur të përcillni fluturimin e zogut - i thashë, duke zënë vend ballë tij.

- Plot graciozitet. Ka diçka magjike - u përgjegj pa i hequr sytë nga pikëvështimi.

- Duhet ta shikoni edhe ju këtë mrekulli - i thashë në gaz.

- Më keni thënë se i doni zogjtë, cicërimat e tyre - tha duke kthyer shikimin nga unë.

- Vaji i tyre më tmerron.

- Vaji? - tha - Vajtuakan zogjtë?

- Shumë, zotëri. Edhe në pikë nate të zgjon vaji i tyre.

- Nuk e kam ditur këtë - tha mendueshëm.

Se ç'ndodhte rreth Katedrales dhe me fluturimin e zogut, e kuptoja nga lëvizjet e mikut, i cili qëndronte ballë meje dhe kafenë

e pinte pak më ndryshe se herave të tjera. Nuk doja t'ia prish kënaqësinë. Ishte ajo zjarmia e tij e fshehtë, që i zbulohet nganjëherë nëpër fytyrën e zeshkët. Edhe kafënë tjetër kur e pimë, pashë se i zgurdulloi sytë e mëdhenj. Kërceu nga vendi. Mezi nxori fjalët:

- E kapën... E mbyllën në kafaz!

- Kë? - pyeta. Kisha harruar Katedralen dhe zogun.

- Mund të ketë ndonjë infektim - pëshpëriti, duke u ulur në karrige kur dy veta zbritnin ngadalë shkallëve të litarta me një kafaz në dorë. - Nuk do të lëvizë vendit derisa ta sjellin - shtoi, duke mos i shkoqur sytë nga trupi i hedhur i Katedrales.

- Ndoshta, e therin. Është majur në ajër të pastër - e ngacmova.

- Këtu nuk është Ballkan - tha me inat. Kishte shpërthyer.

- Ballkan, Ballkan... Po si e parafytyroni Ballkanin, zotëri? - e pyeta.

Dora i mbeti në ajër, e cila më bëhej se imitonte fluturimin e zogut. Nuk më intereson ajo shpellë e tmerrshme, mezi tha më vonë. Të dal tek arinjtë më mirë se të zbresë në ferr. Përmendi dikur Bosnjën, Kroacinë. Më tepër i përmendi për vete. Por një fjalë nuk e tha për Kosovën. Ia bëra me dije se në Kosovë ngrin më shumë se në Veri dhe se zogjtë vijnë më herët se në Bosnje.

Fjalët e mia nuk i bënin kurrfarë përshtypjeje as plagën time nuk e shihte. Ajo gati e kishte kapërbirë atë bashkë me Katedralen dhe zogun. Dhe, kur nuk kishte më vend për emra të tmerrshëm dhe kur kishte filluar terri të pikëlojë ulluqeve e çative të larta, vura re se fytyra e tij e zeshkët u çel prapë. Diçka kishte ndodhur rreth Katedrales. Me një gaz fëmije shtoi:

- E sheh ç'do të thotë fjala liri? E sollën zogun.

Nata kishte hyrë edhe në kafene e mbështillej rreth poçave elektrikë kur dola. Mbi librin e hapur ia lashë syzat. Më ngulfatte liria ime e përgjakur. Kushedi sa plagë kisha marrë.

- Do t'i ndërrojmë adresat - tha një ditë.

- Po qe se i kemi - i thashë.

- Unë jetoj aty-këtu - tha miku - Po ti?

- Në Sukë të Cermjanit, në Majë të Pashtrikut, tek Verrat e Llukës, në Cungaje të Drinisë, në Llapin e Therur, tek Varret e Gjata, ku bën ve Qyqja...

- Emra të çuditshëm! Ç'do të thonë? - pyeti, thuaj se përgatitej të kapte bishtin e bardhë të zogut atje lart në Katedrale.

- Shumë, zotëri... Më tepër se librat e trashë të metropoleve.

- Numri i postës? Vendi, si quhet? - pyeti më qetë.

- Ju thashë të gjitha, zotëri. Po qe se nuk më arrin posta jote, mund t'ia varni në krah zogut të Katedrales. Do të më gjejë diku. Besoj.

- Të çuditshëm jeni ju ballkanasit! - shtoi i humbur.

Nxori një kartëvizitë nga xhepi i brendshëm, pastaj një tjetër dhe shumë të tjera. Asnjëra nuk ishte e saktë. Para syve më vetëtoi Zefi i gjatë e i bukur nga Hora e Arbëreshëve. Më kishte përcjellë nga aty deri në hotelin "Central" të Palermos, ku nuk e kishte qitur hapin tej pragut. M'i kishte lëshuar në duar dy shishe wiski. Kishte buzëqeshur nga makina, duke shtuar vetëm: Nesër nuk di ku do të gjendem. Hora është një pikë ujë në këtë zjarmi.

Ndahesha edhe nga Zefi ynë.

Miku, që rrinte para meje, të cilin e kisha takuar rastësisht kur përcillja lojën magjepse të peshqve në një akuarium dhe me të cilin kisha shpikur shumë gota ballë Katedrales, sa desha t'i them se jam mërzhitur nga njerëzit e qytetërimet, kishte humbur në mjegull, e cila ishte zgjuar aty nga Rajna dhe e kishte kyçur qytetin në një kuti, të cilën nuk kisha fuqi ta hap. Pritnim rojtarin ta sjellë celësin...

(Këln, 1994)

ALBANI

Qartaqefas e piva kafënë. Nuk di kur do të kthehem në shtëpi. Dyer të panjohura m'u hapën pas ca ditësh. Në këtë kullë prej gurit do të banoni, më thanë. Pasi u rashë poshtë e lart kateve, u ndala në dhomën mbi bibliotekën e Belëve. Hapa dritaren në anën veriore. Përqendrova shikimin në një maje katedraleje. Venerova se mbi qytetin e madh ajo ngacmonte qiellin vazhdimisht.

Tek bëja gjumin e parë, ra telefoni: Burrat lidhen për Atdhe, kafshët për grazhd! E njoha zërin. Do të thotë, atdheun duhet dashur edhe kur nuk jep asgjë? Edhe atëhere, zotëri. Zëri kumbues u fik në anën tjetër. Lëshova dorëzën e telefonit dhe nuk më zu gjumi më.

Para dritares, në pjergullën e zgjatur telart murit dridhet një gjeth. Mund ta rrëzojë edhe puhiza. Ma kujtonte një tregim të Hivzi Sulejmanit. As përsëvdekuri nuk e lanë të qetë. Gjethi ende dridhet aty. Një zot e mbron, ndoshta. Nxjerr dorën jashtë. Ndiej fërkimin e lirisë.

Ditëve të para miku ma shpëloi një krah të qytetit. Tjetrin, tha, zbuloje vetë. Po deshe humb në turmë ose mbytu aty në lumë. Shoh se njerëzit u ngjajnë ngapak guaskave. Më të shurdhët janë. T'u nxjerrësh ndonjë fjalë, duhet thyer me çekiç ato. Nga mëngjesi në mbrëmje, në mes meje e dheut të Arbërit, diku aty nën dritën e fortë të neonit ose pranë grumbujve të hekurishteve, shtohen ato dhe ngulfasin. Evropa krijon membranën e vet mbrojtëse. Edhe lakuriqët ballkanas nuk e lanë të qetë. E shoh: e liruar nga ndjenja nacionale e sociale. Ndryshe kupton dhe e ndërton lirinë dhe shtetin. Nëpër gjësende lëndoj vetminë. Përpiqem të krijoj fytyrën e engjëllit tim.

Dhe në krye të rrugës nis bisedën e djeshme me mikun tim të ri.

- Alban, nga je?
- Nuk e di.
- Kë ke baba e nënë?
- As këtë nuk e di.
- Emrin kush ta vuri?
- Ai.
- Si ia thonë emrin?

Biseda prapë këputet. Çuditshëm shikohemi. Errësira e syve të tij më kapërbin të tërin. Fryma gati nuk e ka lëshuar. E kap për krah. Nga prehëri im habitshëm më shikon. I shpëlohen dhëmbët. Pakëz më vonë çilet.

- Nuk e njoh - përgjigjet preras.
- Ashtu!
- Nëna më thoshte se ka qenë tepër i bukur... Pakëz i ngjaj unë.

- Dhe?

- Një ditë kishte ikur ai. As nëna nuk e kishte ditur pse. Pas një kohe shkoi edhe ajo. Nuk di a janë takuar më... Unë rri te gjyshja.

Rruga e Hajnrih Belit mbaron në gungë. Nga aty derdhen rrugët e tjera. Marramendëse lëvizet. Në anën tjetër, afër një bange të gjelbër ndalen të gjithë autobusët urbanë. Edhe ai nr. 1 nga i cili miku im i vogël zbret çdo ditë në orë të caktuar. Nja dhjetë metra larg e pret një grua e shtyrë në moshë, ulur mu në atë bangë. Ajo është gjyshja e tij. Pasi takohen, qafohen. Dorë për dore nisen rrugës së ngushtë. Ajo bie përkaj një shtëpie të rrethuar me gjelbërim.

Takimi i parë me vogëlushin ndodhi krejt rastësisht. Në krye të rrugës kryesore gjendesha sapo zbrisnin fëmijët nga autobusi urban nr. 1. E kisha vënë hapin në shkallën e parë kur

dëgjova: Alban! Alban! Ktheva kokën nga zëri gati i shtjerrë. Pashë gruan e shtyrë në moshë afër bangës. E priste vogëlushin e veshur në blu, i cili u nda nga turma. Me çantë në shpinë e me një qese sportive kaloi zebrën. U puthën. Dorë për dore u nisën rrugicës që shpiente telart.

Autobusi nr. 1 u ndal një ditë para hundëve të mia. Zbriti vogëlushi, fytyra e të cilit më ishte vijëzuar në kujtesë. As vetë nuk e di, në gaz i thashë: Ku je, more Alban? Ktheu kokën ai. Më shikoi me një habi befasuese; Kush isha unë vallë! Përvolet buzët në dyshim. U zhduk pas drunjve, duke kthyer kokën disa herë pas autobusit, i cili rrëshqiste ngadalë. Pas tri ditësh pritja autobusin. Tek hyja, vogëlushi zbriste. Më shikoi fëmijërisht. Sytë i kishte të kaltër, plot dritë qiellore. Nuk e mbaj mend cili më parë buzëqeshi. Ky ishte takimi ynë i dytë.

Më vonë mësova se Albani kishte lindur nga një dashuri e rastësishme e dy bredhacakëve të takuar rastësisht aty. Babai i tij, të cilit nuk di pse nuk ia thotë emrin, një ditë me shi sapo kishte shkëlur rrëzë Katedrales, ishte bërë qull duke e shikuar atë nga poshtë-lart. Ishte sjellë disa herë rreth saj përderisa një dorë vashe kishte hapur çadrën. Ai fare nuk e kishte veneruar atë. Sytë i kishin mbetur në majë të asaj. I bëhej se ajo ishte nja tri herë më e lartë se xhamia e Sinan Pashës. As një muaj nuk kishte kaluar dhe prapë ishin takuar. Pranë Urës Lëvizëse shiste lule ajo. Nëse dëshiron të të shkojë puna mbarë, duhet përzierë gjakrat, i kishin thënë. Dhe ata kishin rënë në dashuri. Nuk mund të thuhet, pra, se Albani është kopil.

Një paradite sapo zbritja në stacionin tim, më doli përpara me biçikletë ai. Nuk më kishte harruar edhe pse nuk ishim parë me ditë.

- Ç'bën, Alban? - e pyeta në hap.

Rrudhi krahët. Nuk më kishte dëgjuar ndoshta.

- E di ç'do të thotë emri yt?

Lëvizi kokën. Mezi dikur shqiptoi: Jo.

- Mirë që nuk e di... E di ku gjendet Kosova?

Dy çuka iu thelluan në faqe.

- As këtë mirë që nuk e ditke.

Ika në shtëpi. Në krye të rrugës, nën kurorën e një pishë qëndronte ai. Nuk lëvizi vendit derisa mbylla portën e jashtme. Nga këndi i dritares pashë pastaj kur rreptas i grahu biçikletës.

Lexoja faqet e fundit të një libri. Dëgjova trokitje të lehtë në derën time. Hapa atë dhe brenda u rrokullis buzëqeshja e vogëlushit. Ishte koha kur ai kthehej nga shkolla. Zuri vend. I vura përpara një gotë lëng dhe copa çokollate. Ballë meje përbihej njëri nga tragjikët modernë të popullit tim që, në mënyrë të dhembshme, thurnin ose sajojnë *Librin e asimilimeve*. Gati një orë kishte kaluar kur më tha se ndodh ta kërkojë gjyshja edhe në polici. Mos u bë merak, i thashë. Të përcjell unë. M'i tregoi librat. Ishin emra autorët e tyre.

- Di kush është xhaxhi Naim? - e pyeta befas. Ngriti vetullat. Me fund zbrazti gotën. Prapë e grisi çokollatën me dhëmbë të imët. Fill e për pe zura t'i tregoj për çdo gjë, që kishte të bëjë edhe me atë që nuk dinte gjë. Dikur më pyeti: Ku gjendet Tomorri? Po pse pyet për Tomorrin, desha t'i them. Aty rrijnë përenditë tanë. Por këtë emër disa herë e pëshpëriti. Në mënyrë karakteristike e theksonte germën *m*. Më bëhet se këtë e bënte më tepër për vete, ose përpiqej të gëritte diç nga ndërvoja e tij. M'i nguli sytë dhe nuk pyeti më asgjë. Hapi çantën. Me kujdes i vuri librat. Por ç'libër t'i dhuroja unë? Ato mbi tavolinë ishin të rënda edhe për mua. U vinte era kazamate, lagështi. Pikonin gjak, ofshamë, vdekje. Megjithatë, vendosa t'ia fal ca. I shikoi me një buzëqeshje fëmijërore. Shpejt e shpejt i vuri në çantë edhe ato. Pak pa rënë muzgu e përçolla deri te shtëpia. Tërë rrugës nuk m'i hoq sytë. Në të ndarë m'i shkundi edhe një herë kaçurrelat. Gjyshja e shqetësuar zbriti shpejt shkallëve. Dyshueshëm e futi brenda. Në dritare lëvizte dorën ai.

Në fund të livadhit të Belëve këputja një mollë kur pashë mikun me Albanin nën sjetull. Ua bëra me dorë. Më kishin kërkuar gjatë.

- Atdheu e ka edhe një motër - pakëz në gaz e i dehur tha ai, që më kishte bezdisur rreth atdheut e grazhdit që nga nata e parë.

Albani nuk bënte vërë me gojë. Të tillë nuk e kisha parë. Nga maja e kokës deri në thembër e kishte mbështjellë një hije pikëlluese. Dikur m'u bë se plasi.

- I pe librat? - e pyeta ngadalë - Herën tjetër t'i sjell të xhaxhit Naim. Aty e ke edhe Tomorrin.

Ai fare nuk dëgjonte. Bënte ca lëvizje jo të zakonshme. Më vonë u bënë më të rënda ato. U shkëput nga dora e gadimsit dhe vrapoi livadhit. Gjeregjatë u shtri nën një mollë. Ulërinte gati. Në mes dhëmbëve më ishin ngrirë fjalët. Për herë të parë e dëgjova si qante ai.

- Ç'ke vogëlush? - e pyeta i trandur.

Flokët e verdhë ia përkëdhela, duke ia puthur. Ai grimconte gishtërinjtë. Nuk prante. Përyrrej. Në mes lëvizjeve të shpejta të duarve fshihte fytyrën. Më vonë drejtoi shikimin nga unë. Mezi u dëgjua:

- Nuk di të lexoj shqip. Unë nuk jam fajtor.

- Oh, zot!

Ula kokën i turpëruar më tepër nga vetja. Sytë e lagur nuk desha të m'i shihte. Më vinte inat të m'i shihte ai që qante për fatin e vet..

Shumë vjet më parë udhëtoja për në Paris. Diku mbi Alpet e Evropës stjuardesa kishte këshilluar: Ju lutemi, lidhuni! Nuk punon një motor. Për herë të parë e kisha uruar zotin, që ma mundësonte të bëja udhën bashkë me Lumin edhe në Hade. Kisha shpërthyer në gaz dhe i kisha tmerruar njerëzit, që fshiheshin nëpër karrige nga hija e vdekjes. Po Albani, ku shpie? *Librin e asimilimeve* e lexoja apo teksa kisha filluar ta shfletoja.

Në midis të livadhit, nën qiellin e zymtë, rashë në gjunj. Në mes duarve plot dhé futa kokën. Miku ishte larguar pa nxjerrë zë. Atdheu si duket iu kishte pëshurrur. Aty afër m'ï kishte lënë librat vogëlushi. Fërflizë shiu ishte derdhur mbi mua. Nuk është turp të qash për diçka që dhemb. Albani nuk ishte i vetmi, që ma shfletonte *Librin e asimilimeve* të popullit tim.

(Këln, 1994)

VDEKJA NE BOHEMI

Në krye të rrugës u shfaq qielli më i plotë, i cili u fsheh prapë pas drurëve të lartë, që nuk pranin së shushurituri e që rrugën e rrëpinjtë e të drejtë e përthekonin në të dyja anët. Qerrja e zezë ecte ngadalë. Mortshëm. Pas e ndiqnin dy njerëz të moshave e madhësive të përafërta. Njëri ishte për një kokë më i lartë ndoshta.

- Na la edhe ky - tha zgjatani.

- Pimë kafe dje - tha mendueshëm më i vjetri.

- Vdekja nuk pyet - shtoi i pari - Na gjen ku nuk jemi.

- Mjer nëna! Në dhe mbyll një lule djali - tha i dyti.

- Thonë e ka të verbërt - tha pakëz me ironi zgjatani.

- Bile edhe të shurdhët, kam dëgjuar - tha më i vjetri.
Hutueshëm.

- Më mirë. Nuk e sheh as nuk ia dëgjon gjamën - tha i pari

- Ç'gjamë i bëjmë!... U mbush Evropa me britma e varre tona - shtoi i dyti.

- Brenda një vjeti vetëm në Bohemi pesëdhjetë varre - tha i pari, duke theksuar fjalën varre.

Mbi kokën e drurëve u kacavar një re. Filloi të shqyhet pak më vonë. Qerrja e zezë monotonshëm dëgjohej asfaltit të lagur dhe hapat e kortezhit, që njëri-tjetrin ndiqnin herë pas herë.

- Ishte i vetëm? - pyeti zgjatani.

- Ashtu kallëzojnë... Të kishte pasur një vëlla a motër për ta qarë - tha më i vjetri me një melankoli.

- Ndonjë amanet, a ka lënë? - pyeti prapë i pari.

- Shumë... Por koha nuk është ende. - Fjalinë e dytë njeriu i shkurtër e tha më tepër për vete.

Pas gungës së dytë qerrja e zezë u ndal. Njeriu i veshur në të zeza zbriti nga qerrja. Shikoi në të dy anët e rrugës. Hipi prapë ku ishte më parë. Ndezi motorrin, duke luajtur kokën.

- Nuk bën të varroset këtu. Janë të vëndasve - tregoi i pari.

- As aty. Të jahudive, na qenkan - tha njeriu i shkurtër.

- Pak tokë ka për ne.

- Po atje? - pyeti më i vjetri.

- Ishte i shpatës. Nuk i rri mirë hëna, - tha zgjatani, pakëz në tallje.

- Po ku ta varrosim, pra? - pyeti prapë më i vjetri.

- Aty ku do të ndalet qerrja, - tha sërish i pari.

- Ka ca kohë që rrokulliset qerrja - tha mendueshëm i dyti.

- Trimi ka bërë rrugë më të gjatë - tha i pari me një klithmë, që nuk desha ta shënoj - Duhet t'ia gjejmë një vend ku nuk i kalben eshtrat, - e mbylli fjalinë me një patetikë rreth gjetjes së varrit.

- Si? - pyeti me një shqetësim të theksuar njeriu i shkurtër.

- Jemi në tokë të huaj, zotëri. Vështirë i pranon trupat tanë, - tha zgjatani me një zë krejt tjetër.

- Te kurdët, pra. Ose tek afrikanët - tha i dyti, më qetë.

- Do e shohim. Na duhet një makinë, ndoshta - tha mendueshëm i pari.

- E pastaj? - pyeti i dyti.

- E pastaj do t'ia hapim varrin e do ta përcjellim trimin.

- Këtë nuk e ka merituar - u dëgjua prapë i dyti.

- Kush thotë se e ka merituar - tha me zë zgjatani - Dy metra dhé nuk i dha toka nënë.

Zgjatani, që ecte në krahun e djathtë e që ishte bërë qull nga shiu, ktheu kokën nga i shkurti. Për herë të parë e pa se ai

ishite qel, me një sy të gastartë, i padhëmbë, gati i këputur. Ktheu shikimin prapë nga qerrja e zezë. Ngjitej gungës së pestë të rrugës së përmortshme. Qielli ishte ndarë përgjysmë. Aty ku takoheshin të dy gjysmat, pra atje në fund, shkrepse një dhëmb i verdhë. Shenjë, ndoshta, se e pranonte dheu të gjorin.

- The se dy metra tokë nuk i dha? - pyeti pikëllueshëm njeriu i shkurtër.

- Toka jonë është tokë gratçore. E kemi me kyt - tha zgjatani më i pikëllueshëm se njeriu i shkurtër.

- Do të na japë ajo, more. Edhe më shumë, - tha nevrëshëm i pari.

- Po ç'i dhamë ne të na japë ajo? - gati shpërtheu zgjatani. Kafshoi buzën e trashë i shkurti. Pastaj nxori një shami. E fshiu fytyrën e plakur para kohe. Në një kënd të shamisë pa dy pika gjak. E fshiu edhe buzën e poshtme, të cilën mjeku i kishte thënë të mos e prekte fare. Me një dridhmë futi shaminë duq në xhepin e majtë. Filloi ta ndjekë zgjatanin. Ai kishte zgurdulluar sytë. Përpjetëzës së fundit të rrugës së përmortshme ngjitej i mpirë. Në livadh, atje afër do shkurrave, një makinë hapte diç. Dhe kur e lanë rrugën e asfaltuar, zgjatani akull tha:

- Arritëm.

- Ku? - pyeti i shkurti.

- Aty nga nuk kthehet më, - foli zgjatani sa mezi e dëgjoi veten.

Qerrja e zezë u ndal para makinës së madhe. Njeriu i veshur në të zeza doli përjashta. Hapi derën e mbramë. Ndërkaq, njeriu i veshur në tesha të verdha, fiku makinën. Kërceu nga shkalla e dytë. Pa kurrfarë cermoniali nxorën nga qerrja e zezë arkën prej druri më të lirë e pa asnjë stolisje. E vendosën në bregun e dheut të shkrihtë. Njeriu i veshur në të zeza, që fraku nuk i rrinte aq mirë, pyeti në gjuhën e vet:

- A ka kush të thotë diç?

Zgjatani ktheu kokën në të majtë. Syri i gastartë i njeriut të shkurtër bënte dritë më shumë se kur e kishte veneruar për herë të parë aty diku në gungën e pestë të rrugës. Bëri tre hapa përpara. Mori qëndrim gatitu. Dikur rrëzoi shikimin mbi arkë. Vetëm tha:

- Lavdi, i gjori im! Të turpëroj dhe i huaj.

Pasi e palosën edhe lopatën e fundit, njeriu i shkurtër nxori nga xhepi i djathtë i mantelit një qese dhe. E hodhi përgjatë varrit. Tufën e luleve ia vendosi te koka, me mëngën e majtë të mantelit fshiu syrin tjetër të gjallë, që i kishte shpëtuar nga luftërat e fundit të Ballkanit. Zgjatani, pasi nënshkroi ca letra, u nis të dalë nga livadhi, ku nuk shihej asnjë gur varri... Dhe teposhtëzës ku morën udhën, dëgjuan prapë zhurmën e rëndë të makinës së madhe. Rrafshonte varrin e ri. Qerrja e zezë ishte zhdukur.

Njëri-tjetrin shikuan habitshëm. - Mezi foli zgjatani:

- Rrugëve vdekjen e bëjnë njerëzit pa atdhe. Kështu e ka. Namë është kjo apo...?

Në një bangë të vetmuar, nën hijen e një rrokaqielli, njeriu i shkurtër kishte futur kokën në mes gjunjve. Më vonë u rrokullis në çimenton avulluese, pranë një kore buke, që e kishin rrethuar mizat. Kishte tri buzë. Njëra futë. Një qerre ishte afruar. E kishte kyçur brenda. Dikah e shpiente. I zotit ishte edhe ai...

(Schwalenberg, 1993)

MIU RUS

Bertoldi ishte skuqur kur Hove i kishte treguar se ka goditur një mullacak sapo merrte turr të hynte në oborrin e Belëve. Kishte pyetur: Është e mundur? Nuk bën të çuditësh, kishte shtuar. Ka minj gjithkund. Disi ky dallonte nga të tjerët, ishte më agresiv. Megjithatë, ai nuk ishte pajtuar se kishte depërtuar nga fusha. Oborri është i rrethuar me mjeshtëri. Minjtë nuk mund t'u prishin qetësinë Belëve. Hove prapë kishte përsëritur mendimin e mëparshëm. Bile kishte shtuar se mullacakë të tillë nuk kishte parë as në Afrikë. Kishte filluar t'i flasë edhe për kërcimet e tij sa që e quajti një stilist të rrallë. Kur ishte përgatitur ta godasë, mullacaku gati nuk ia kishte nxjerrë sytë. Bertoldi ishte skuqur edhe më. Aty ku ka, ka edhe minj, por ky paska qenë, ruajna zot - kishte ndërhyrë krejt indeferent Poeti i Kampit Verior. Mund të ndodhë të mos jetë mi vendës.

Tevona Hove u kishte treguar vendin dhe viktimën. Mullacaku ishte hakaret; me një kokë tullace e ballë të shtypur, në mes gati i këputur se, siç duket, afrikani e kishte qëlluar rëndë. Edhe nga ngjyra dallonte nga minjtë e tjerë. Bertoldi kishte pështyrë: Unë i njoh minjtë e mi. Ky nuk është mi gjerman. Rreth origjinës së tij u kishte dalë punë pastaj. Ishte bërë piskamë e madhe: pse miu gjerman të dallojë nga minjtë e tjerë? Bertoldi kishte vazhduar të kundërshtojë me fakte të tjera: po të ishte mi gjerman, do të ishte më i moderuar dhe nuk do të binte aq lehtë në kurth të një afrikani.

Në momentin kur shpërndareshim secili me mendimin e vet, ishte apo nuk ishte, bile mi i kontinentit tonë, disa shenja vërtet nxirrnin punë në përcaktimin e origjinës së tij. U tubuam prapë. Dhe prapë nga fillimi nisi të na tregonte Hove atë që kishte ndodhur në fund të oborrit të Belëve. Me kujdes e përcillte

Bertoldi kallëzimin e tij mos po ndërronte ndonjë fjalë nga dëshmia e mëparshme dhe ta zinte në rrenë. Por Hove nuk gaboi as një çerek fjale. Poeti i Kampit Verior kishte rrokur një shtagë dhe mullacakun e kthente herë në një anë, herë në tjetrën. Në një moment kishte vërejtur se në bisht i kishte vetëtuar diç. Ndalen! kishte britur. Ky qenka më tepër se mi. Me gisht kishte bërë në drejtim të një rrethi vezullues aty ku ende rrithte gjak. E kishim shikuar dhe ishim pajtuar me Poetin e Kampit Verior se ky mund të ishte mi i ndonjë vendi totalitar, ku përdroreshin edhe këta të gjorë në komplete ndërshtetërore. I paska mashtruar edhe kordonët e hekurta policore të vendeve nëpër të cilat paska kaluar - kisha thënë. U kisha folur pastaj për minjtë e Shkurrës. Më kishin dëgjuar me vëmendje dhe kur kisha theksuar agresivitetin e tyre, kërcimet me një stil të veçantë; se ç janë në gjendje të bëjnë, iu kisha drejtuar Hoves: Ti nuk qenke vetëm mbret i xhunglës! Na paske shpëtuar nga ndonjë invazion i papritur planetar. Ky kishte buzëqeshur dhe Bertoldit iu kishte ndërruar pamja. Pas pak kohe kishte arritur një makinë e kaltër. Njëri nga ta kishte hequr vetëm atë unazën në bisht të miut. Ishin larguar tërë futë në fytyrë. Ndodhinë për mullacakun secili filloi ta tregojë në mënyrën e vet. Bile edhe Bertoldi mbasi kishte zbuluar sekretin se ai ishte mi rus. Mullacakë të tillë mund ta sulmojnë edhe Marsin, kishte thënë njëri tek lëshonim me rrëmbim roletat. Dëshironim të ndaheshim sa më parë nga ajo pamje gërditëse. Pasdite kishte rënë shi i rreptë. E kishte hedhur edhe pjesën tjetër të miut në kanalizimin e ujërave të zeza.

Mirëpo, aty në oborrin e Belëve na bëhej se ende kishte mbetur një vazhdë e zbehtë gjaku, e cila ndriste herë pas here kur rrezet thyheshin nga dritaret e shumta.

(Këln, 1994)

ÇELËSI I HUMBUR

Këmbëzbathur dilte. Nuk di nga cila poezi e poetëve tanë. Dyer, dritare e kapexhikë rrapëllonin pas tij. Vraponte Hove sapo rënia e fundit e telefonit nuk pushonte. Tri-katër shkallë i kapërcente menjëherë. Nga çimentoja e ftohtë e Belëve shputat e bardha i shkoqte rëndë. Dhe dallonin ato nga të tjerëve se ishin më të lehta mbasi vetëm ai vraponte dathur. Sipër tyre derdhej një ngjyrë bojëkafe e mbyllur. Kur hapin ngriste, ngjyra e bardhë binte në sy edhe në pikë të natës. Arrinte gati pa u shuar cingërrima e fundit. Merrte frymë thellë. Në anën tjetër kur dëgjonte zërin, zbardhte dhëmbët. Ngriste dorën në drejtim tonin: Afrika! Afrika!...

I përcillja lëvizjet e tij në mënyrë të posaçme. Shumë poezi të poetëve tanë më binin ndërmend, por nuk dija se në cilën e kisha takuar. Ulej në karrige. Zëri i largët kur humbte, lëshonte kufjen. U binte gjunjve me gishtërinj. Në fillim ngadalë, pastaj shpejtonte të rënat. Ngriste kokën. Prapë pëshpëriste: Afrika! Afrika... Nisej dikur në dhomën e vet. I bënte të njëjtat lëvizje, që i kishte bërë më parë. Fikte buzëqeshjen. Me dorën e djathtë i lëmonte flokët e shkurtra e katran. Nga tri-katër shkallë i kapërcente prapë. Tamam si një gazele e lastuar. Dhe, para se të mbyllte dyer, dritare e kapexhikë e të shtrihej diku në ndonjë poezi të poetëve tanë, këlthiste prapë: Afrika! Afrika!...

Kishte udhëtuar Hove me vjet nga fundi i Afrikës për në Evropë. Ai pushton edhe metropolet e Amerikës. Ndërsa për mua Hove ishte diçka tjetër, një fat i thyer, i cili kishte hyrë me rrapëllimë e shi edhe nëpër shumë poezi të miqve të mi - dyer, dritare e kapexhikë, duke i përplasur sa herë nxitonte të kapë zërin e largët të Afrikës.

Tek pinim kafe i thashë një ditë:

- Hove, di sa poezi i kanë shkruar shqiptarët për Afrikën?

Ai ngriti krahët. Habitshëm tha:

- Ashtu!

- Po - i thashë - shkruanim për Afrikën. Na dukej më afër se Parisi. Nuk besonim se do të binim më poshtë se ajo.

Si në një kuti duhani mbylli dhëmbët. Drita e syve të ndritshëm sa nuk iu fik. Dhe kishte ditë kur nuk mund e dalloja se kur vërtet buzëqeshte ai. Se, atë buzëqeshje, më bëhej, se e kisha parë diku tek kjasonte nga ndonjë çati Dukagjini apo fjalë e vjetër e gjuhës shqipe. Nga kujtesa përpiqesha ta shkund. Të pikojë ende ose të lirohem nga imazhi i ngrirë. Më kot! Mbi harkun e Belëve, aty tek dera kryesore, rrinte varur buzëqeshja e tij. Kishim vazhduar bisedën:

- Më ke habitur, të shkruhen aq shumë poezi tek ju e të mos dimë gjë për juve! Po, po... por ku gjendet kjo Dardania?

Mora nga rafti hartën, që ma kishte sjellë Bertoldi. E hapa ngadalë mbi tavolinën e gjerë të bibliotekës. Hove e pa se ajo ishte një hartë jo e zakonshme, prandaj u përqendrua duke përcjellë gishtin tim tregues si rrëshqiste nëpër të. Pak më vonë lëshoi një fishkëllime të çuditshme. Në notesin e vet kishte shënuar emra për të cilët thoshte se nuk i kishte dëgjuar kurrë më parë: Iliria, Dardania, Ulpiana, Albanopolis, Genususu, Arnisa, Avlona, Elima, Nissus e shumë të tjerë. I pëshpëriste ngadalë e rëndë edhe kur hartën e ktheva prapë në vendin e mëparshëm. “Po ku gjendet qyteti yt?” - pyeti pasi u ula në karrige. “Në Dardani - i thashë - Në fillim quhej Jak... Jakova”. “Jak! Jak!”, tha pakëz habitshëm. “Ashtu, disi - i thashë me një ton të theksuar. Ndoshta, edhe Isak...” “Bibla! Bibla! - shtoi me një gaz fëmijëror. “Pse jo. Vendi im është një bibël e vërtetë. Është krijuar nga gjaku dhe nga ai shpesh ka shpetuar.

Hapa pastaj një hartë të kohëve të fundit. Ia tregova emrin e vendinjes sime. Hove zgurdulloi sytë “Po këtë e pamë!”. E hap prapë hartën e mëparshme. “E pamë, e pamë, por emrat janë ndryshe”, i thashë. Ia kallëzova ëndrrën e Sebastianit nga Sorrania

për hartat e reja. “Zoti vetëm sipas hartave të vjetra i bekon njerëzit” - i thashë. Shëtiste Hove nga njëri në tjetrin skaj të tavolinës. Bënte krahasime në mes hartave: Det aty, det këtu; male aty, male këtu; lumenj aty, lumenj këtu, por emra të ndryshëm. “Oh zot!”, këlthiti dikur dhe mori një vrap deri në fund të livadhit. Pak më vonë u kthye, duke shtrënguar dhëmbët: “Po qenkeni popull i çuditshëm... Çudë si paskët mbetur gjallë! Edhe për ne paskët kënduar. Më afër se Parisin na paskët! Por, pse?”.

Vështirë i kapte ai ndodhitë në Evropë, lëre më ato në Gadishullin Ilirik, ku ende mbretëron koha e mjegullave. Ndeza një cigare. Pashë se ai ishte shqetësuar. E luta të kthehet prapë në ndonjë poezi të miqve të mi. Dua t’i kyç dyer, dritare e kapexhikë. Është kohë kur Evropa bën pazarin e vet. Ai brofi në këmbë. Dhe tek kur dëgjova rrapëllimën e dyerve, dritareve e kapexhikëve kuptova se ishte shtrirë diku në ndonjë poezi të miqve të mi, ose vraponte teposhtë Afrikës. Në të dalë pëshpërita: Cilin poet shqiptar e gjet shërri me këtë kokëfortë të Afrikës?...

Në bibliotekë ishte mbyllur ai. Shikonte një videokasetë. Sapo hyra, ma tregoi një kasollë prej kallami aty të vetmuar në mes zallit të nxehtë të shkretëtirës, që edhe ekranin e kishte errësuar. Pas pak doli nga aty një grup meshkujsh. Loznin. Në mes publikut, që u pa më vonë, dëgjohej një kumbim karakteristik xhungle. Ritmi bëhej më i shpejtë e më i rëndë. Dikur grupi i meshkujve ra në gjunj para zërit të fortë. Anash publiku u ngrit. I mbuloi ata me klithma. M’i kujtonin ca filma amerikanë për Afrikën. Hovës nuk i zihej vendi. Me shuplaka u binte gjunjëve. Në valle merrte pjesë edhe ai. Na bënte nganjëherë me dorë të përqëndroheshim më shumë: Afrika! Afrika!... Një qetësi e rëndë dikur pllakosi.

Nga kasollja, që shihej në sfond, u shfaq një plak me një verdhushkë rreth qafe. Me duar të çara e lëmonte vazhdimisht.

Mbi kokën e tij gjarpri nxirrte gjuhën e ai shëtiste nëpër publikë, ndërsa nga brendia e kasollës prej kallamit një tingëll trishtues përcillte lojën e tij me gjarprin. Syzgurdulluar, pa frymë. Hove i rrahte shuplakat me ritëm të ngadalësuar. Imitonte ritin e vdekjes. Dhe kur plaku me gjarprin rreth qafe nuk u pa më. Prapë në skenë u shfaq grupi i meshkujve. Çdo gjë ishte në trans. Patosit të Belëve i ra me shuplaka disa herë Hove: Magjia, magjia... Unë mendoja për miqtë dhe poezitë e tyre.

Dhe kur filmi përfundoi, ai nderoi një qiri dhe hapi një shami. Nga arka prej drurit nxori një dhëmb. Nuk di të cilës kafshë. Nga një brirë derdhi pakëz pluhur, që i vinte erë djegësime. Filloi të lutej në gjuhën e tij. Të dy shuplakat i vuri pastaj mbi shami dhe rrufeshëm i fërkoji faqet e bëra ujë. Disa herë i fërkoji. Dhe pamë kur fytyrën e tij e mbuloi një shkëlqimë drite: Unë nuk mundem pa Afrikën, tha sapo ngriti kokën. Gjërat e shpërndara nëpër shaminë e hapur para nesh i mblodhi. Një nga një i vendosi në arkë. Vaji i tij ma kujtonte Martin Camajn, të cilin kur e merrte malli për Temalin, zbriste në odën e mysafirëve aty në Lenngris, dy bojë njeri nëndhe. Nga një arkë e nxirrte tërë Atdheun. Rreth relikteve sillej, i fërkonte si gjymtyrë të shkëputura të Atdheut. Mbas çmallej, papë i kthente në arkë. Kyçte atë dhe te dera varte çelësin. Hove ishte një yrnek i krijuesit që vështirë pranonte shkëlqimin e metropoleve. Dhe, kur i flisja për Dardaninë, ngriste kokën nga qielli e pëshpëriste diç...

Sa ishim mësuar me të, na befasoji kur tha: “Do të ik në Afrikë”. M’u kishte drejtuar: “Nuk di pse, por shumë poetë nga Antologjia e poezisë suaj në anglishte i kam lexuar nga disa herë”. Dhe nuk pranoi se tash e tutje nuk dinte gjë për Dardaninë.

Pinim kafënë lamtumirëse: “Është interesant poetët e Dardanisë të mbanin një mbrëmje letrare në Keptaun?”. “Kemi rënë mjaft poshtë, Hove - iu gjegja - Nuk di a bën më poshtë”.

Të nesërmen bëri plaçkat gati. U përshendet me secilin nga ne dhe secilit na la nga një kujtim. Në tavolinën e madhe të

bibliotekës derdhi ca para metalike. Tha se ishin para të vendit të tij. Unë mora dy, vlera e të cilëve nuk ishte as sa një qindarkë e lekut. I thashë se në vendin tim kemi mungesë të drunjve. Ka më shumë cunga dhe paratë tona nuk i kemi prerë ende. Një dhjetëlekësh të Arbërisë ia dhashë mbasi Dardani ynë vononte.

Hove i kishte sytë të lagur. Sapo ngriti dorën, ne këlthitëm njëzërit: Afrika! Afrika... Ai qeshi apo... Nuk ia pashë më fytyrën.

E di se do të qortohem nga miqtë e mi pse atë nuk e thirra në kafe diku buzë Drinit nën hije të Pashtrikut. Por sapo desh t'i propozoja, dëgjova rrapëllimët e dyerve, të dritareve, të kapixhikëve. Ishte kyçur diku dhe çelësin e kishte hedhur në një lumë apo ia kishte varur në qafë ndonjë gjirafe, që nuk mund e arrija.

Rëra ishte tepër e nxehtë.

(Langenbroch, 1994)

TREGIMI KU FLITET PËR TË GJITHË NGAPAK DHE NJË MACE TË BARDHË

Nëpër dritare të mjegulluar pashë Selen tek zbriste shkallëve të Katedrales. Dhe kur përfundova atë, që më kishte ndodhur, ai tha në gaz: “Do të dëgjosh edhe më zi. Burrat janë tek Varret e Gjata!”.

Fjalën *burrat*, kur theksoi, më doli para burrëria, ajo e lavdishmja e kullave tona për të cilën krenoheshim para botës. Kishte peshë dhe zinte vend në krye të çdo fjalori tonë etik. Ajo fjalë tani vyshket, merr formën e një cingu të pikëlluar. Kam frikë se ajo do të mbesë vetëm një relik i kohëve të moçme të Shqiptarisë.

“Kryesore të ha e të dh... mirë”, kap veshi një bisedë në tymin e dendur të çajtoreve tona, që mbijnë si kërpudha Evropës. “Atdheu mund të mbesë edhe një herë në bixhoz”, i thotë tjetri tërë nerva. “Le të mbesë more, ia pret i pari. - Mund ta gjej ndonjë atdhe tjetër e një popull më trim... Ky imi më doli për hunde”. Ndez cigaren. Një pas një nxjerr shllungat e tymit. “Po fëmijët, bre?”, - pyet i dyti, duke u ngritur në këmbë. “Janë të gruas, ndërsa gota është imja”, i përgjigjet prapë i pari, të cilit mezi i shihet fytyra e vrazhdtë nga tymi. Sela fik cigaren e sapondezur. Ma bën me shenjë të ngrihemi. Mund të ndodhë diç e papritur. Aty i kishte lënë trimëria, do të thoshte Fishta.

M'u kujtua pastaj ajo barceleta për vëllezërit Cenin e Benin e Rrafshit: ishin prej një nëne e babai. Beni profesor, e Ceni? Cenit nuk i shkonte shkolla fare. Vjen ajo ditë kur secili niset udhës së vet. Ceni kishte ngulur atje në majë të Evropës, ndërsa Beni sapo shkilte shkallët e Universitetit. Por takoheshin shpesh. Kishin mbetur të vetmit nga një familje e madhe, që ishte shuar

papritur. Dhe Ceni kur kthehej, i thoshte Benit: “Hajt bre, vëlla, shtrembëroje kapuçin. Edhe kafshatën e fundit do e ndajmë bashkë”.

Dhe kishin ndodhur ngjarjet e vitit '81 pastaj ato të '89. Beni e Ceni jetonin ende si është më së miri. Kishin ngritur nga një shtëpi, që binin në sy nga fundi i qytetit. Por Ceni, kur na ishte bërë njëfarë bos, kishte harruar premtimin. Beni bridhte qyteteve me duar në xhepa e priste se kur do të duket Ceni. Ajo ditë disi ishte mbështjellë, apo këputur te vija e njëfarë Teodosi. Nuk kishte asnjë haber nga vëllai. Dhe lindi ajo barcoletë e zezë. Beni ngre telefonin: “Or vëlla, a e ke mbajtur fjalën?”. Në anën tjetër të telit zëri i vëllait iu kishte dukur më serioz, të mos them, zyrtar, gati-gati i huaj: “Tepër ka rënë marka”. Dhe shkloc telefoni. Një ditë tjetër: “Po vëlla, keq i kam punët!”. “Hajt bre dost, Kosova nuk na është bërë ende Bosnjë”. Në mënyrë të çuditshme ishte fikur zëri. Diçka kishte ndërruar apo Beni dyshonte: “A vërtet ka rënë marka? Po Kosova ende nuk na qenka bërë Bosnjë!”, pyeste dhe pas përgjigjes shtonte: “Ai edepsëzi më tha se një gomar parash ka harxhuar për ca ditë në Tunis. More, do e shohim”. Dhe një ditë prapë ngrit telefonin, pak më ndryshe: “Or vëlla, kam dëgjuar se vërtet heq të zitë e ullirit... Të pastë vëllai! Ti nis ca lekë? Mos shpëton nga mendtë e kresë...” Dhe me një murmurimë kishte mbyllur bisedën. Pas ca kohësh Benin e kishin parë te bregu i një lumi duke folur me gishtërinj. Ceni e kishte zënë veshin me ca miell të bluar keq.

Sela fiku makinën. Na ishte shfaqur një tokë e mrekullive. Te një liqe merrja frymë dhe hidhja gurë. Por asgjë nuk më kënaqte. Isha në tokë të huaj. Atë mjerimin tim me asgjë nuk mund ta peshoja: Fëmijët e zbathur me nga një copë bukë në dorë te pragu i derës. Ajo është bota ime. Aty fshihen edhe fjalët, edhe fatet, edhe përrallat e moçme. Kosova nuk ka të paguar. Hap shuplakën. Peshoj atë. Plumb. Dhe u marr erë fjalëve. Sela, që po ndiqte lëvizjet e mia, dikur shtoi: “Ç’u desh ta ngasim dajën Hitë? Ballkani do të ishte lule... Tani ia ngjesim Evropës zhugën.

U lajmë nevojtoret armiqve. Punë djalli bëjmë... “Dhe, derisa fliste ai, unë zihesha me babain tim kaçak me atë pushkën e gjatë, i cili bregut të Erenikut, atje tek Ura e Shenjtë, ngjitej Pashtrikut. Thoshte, shkon për të ndjekur allamanin, që ishte ngjuar aty në një shpellë. Unë isha fëmijë dhe nuk i dija dreqënitë e botës. Mezi kisha kaluar fruthin, kollën e keqe, linë; pastaj atë dimrin e katër që kishte marrë shumë jetë. Dhe, babai mendonte rrëzë një cingu, më në fund të na bënte shtëpi me oxhak. Unë nuk e kam parë pastaj si vdiq, por thonë sytë i kishin pasë mbetur hapur. Kishin ndodhur tevona të papritura: shkundullima e hasmit, helmimet, rrahjet, eksodet. Po a lëshohet Atdheu për një shuplakë? Nga një rezignatë e tmerrshme me shkëputi vala e liqenit dhe miku im veshur me rrip të zi, tamam si Al Paçino, ndezi makinën.

Në një metropol na kishte mbërritur një Micsokol. Të parën punë që kishte bërë, kishte nxjerrë një letër të bardhë, kishte bërë hesape deri në frangun e fundit. Sa kishte fituar e sa do t'i paguante fisnikes për bylyzykë ari. Dhe tregojnë se nuk ishte ndarë keq. Me tepsia ia kishin mbledhur bereqetin. Atij farë Micsokoli na i çon fjalë një ditë një sekretar i një sekretariati për azilantë. Dhe tërë kohën burri i botës nuk iu ishte shkoqur pasqyrës, duke e shikuar veten se ç'i mungon. Pas mesnate i kishte tubuar ata të Klubit e u thotë; “Unë, si bir i Skënderbeut, a bën të shkoj kështu?”. Të nesërmen na e kishin veshur e ngjeshur trimin nga majë e kokës deri te gishti i vogël. Por Micsokoli vërtet na kishte qëlluar pika e burrit. Po brekët? - Kishte shkrepur njëri, që ia kishte prurë shpirtin te hunda. Po atje nuk do t'i tregoni brekët, or Moisi! Ruajna zot, po qëlloi ndonjë hanëm aty”, kishte shtuar Micsokoli ynë pa fije turpi.

Gadimsi për dy-tre muaj ishte plakur për nja dhjetë vjet. Po nuk mund të mos e kallëzoj ëndrrën e tij. Një natë, thotë ai, gati më kishte rënë Ora e Bjeshkëve të Namuna mu tek dritarja. Por

ç'orë? E bardhë si bora. Ngrihem ngadalë dhe e hap. Po ç'bën more, na mërdhive, zgurdullohen grua e çikë. Flini! - u thashë me gjysmë zëri. Ka ardhur Ora e Bjeshtëve të Namuna. Dua ta fus në dhomë”. - Mos ke luajtur! Tha gruaja në vaj... E zbrazti edhe një birrë dhe mbylli sytë: A di çka, poet? në ëndërr shoh çdo natë se Kosova do të çlirohet. Dhe do të çlirohet. A e di pse? Të gjithë frikacakët kanë ikur nga atje... “Loti iu rrokullis faqes së rjepur, mbi buzën e çarë iu ndal e i piku mu në gotë.

Dhe zëri i tij ishte shuar mu kur nën dritaren time u thy një saksi nga një mace. Kishte rrëshqitur nga pjergulla ajo. Copat e saksisë i mblodha në mëngjes. Megjithatë, unë nuk besoj në fatin qorr edhe pse macja ishte e bardhë...

(Aachen, 1994)

NË FUND TË RRUGËS SË BREHTTT

Natë e ditë rri ndezur një llambë atje në fund të rrugës B. Brehti. Nuk mbahet mend se a është fikur ndonjëherë dhe kush e ndezi i pari. Drita e saj tregon fundin e të gjitha fundeve. Shpesh bëj ecejaken nën të. Në mes mureve të larta, që m'i kujtojnë muret e rrugicave të qyteteve bregdetare të Ilirisë, përbirohem kallj vetëm, dritë e llambës, duke më përcjellë si një sy i gjallë, të cilit sapo ia kthej shpinën, gjendem te shkallët. Aty zbres dhe humbi në një labirinth. Dikur ulem në karrigen time.

Pak kohë më vonë, si në ekran, më shfaqet përpara Malësia e Mbishkodrës: kanjonit të bredherakjeve të Cemiti filloj maratonën; pi ujë në Krua të Traboinit; dal në Majë të Deçiqit, trokas shtëpive të zbrazëta; ia qes tymin ndonjë vatre, shtrihem diku në hijen e një lisi gati të rrëzuar nga rrufeja; kap ndonjë tingull lahute, që m'u ngjan ciatjeve në pyll; zbres deri buzë liqenit; padashje i shkaktoj lëndime Rozafës së gurëzuar aty në fund të horizontit blu; laj sytë dhe sa përvjel pantallonat të kapërcej Ujin e Madh, vërej mikun si hedh ngjyrën në pëlhurën e varur. Ai dredh mustakun e djathtë e më thotë më vonë;

- Keni shëtitur mjaft... Ende nuk është kryer.

Prapë gjendem në krye të shkallëve. Nisem nga fundi i rrugës. Deri në fillim të saj më përcjell drita e llambës. Pasi të kam kaluar para shtëpisë së Moxartit dhe pasi të jem shkëputur nga fyti i thellë i rrugës dhe pasi të jem futur në zhurmën e tmerrshme të automjeteve të shumta, kthej kokën edhe një herë. Në fund të rrugës, atje, ku fillojnë shkallët, shihet kulmi i shtëpisë së mikut. Brenda tij frymon një copë e atdheut tim.

Augsburgu është qytet humbës. Ata që kanë pak kohë nuk ndalen. Mua më këput në gjunjë kur kërkoj shtëpinë e mikut dhe kur syri im nuk has llambën, e cila rri ndezur natë e ditë. Dhe,

lexues i dashur, po qe se të qet udha këndeje dhe sheh një llambë të përflakur edhe në pikë dite, dije se gjendesh në një rrugë më se të çuditshme. Mbaje mend atëherë llambën dhe nisu pa hamendje. Ecën rrugës hijerëndë, e cila frymon thuaj se është një qenie e gjallë. Në fund kur të arrish, do të mbesë pas teje drita e llambës dhe shkallëve bie. Në një derë po trokite, do ta hapë një njeri me një buzëqeshje karakteristike. Pak më vonë do të hetosh se e njeh tash e njëqind vjet. Në ndarje do t'u thotë ai:

- Keni shëtitur mjaft... Ende nuk është kryer.

Nga pëlhura largohet pasi e hedh ngjyrën e re, ose e fshin një të vjetër. Nuk ulet se gjërat dëshiron t'i kapë në lëvizje. Edhe kafënë e pi në këmbë. Se ekziston, e ndjen tek kur zjarri e djeg në mes gishtërinjve të verdhë. Pastaj ndez cigaren tjetër. Iu thotë kushedi për të satën herë: kanë zënë të zbehen kujtimet. Prandaj ankohet se ka net që nuk vë gjumë në sy. Nën dritare e trand tramvaji, i cili ia kujton gjarpërimet e Cemit. Të bindë dikur se ai tramvaj vërtet me atë rrapllimën trishtuese bën gati të njëjtat dredhake që i bën edhe Cemi. Merr frymë thellë, duke vënë gishtin te ngjyra e re: Vendlindjen dua ta mbyll. Shton më vonë. Dhe merr ngjyrën tjetër. Largohet prapa. Nga distanca lexon kombinimin e ngjyrave. Përjashta dëgjohet fishkëllima e tramvajit. Qet kokën në dritare. Buzëqesh. Ngul shikimin tek një lis gati i rrëzuar. Diçka nëpër atele thyhet. Kthej kokën dhe kërkoj mikun, i cili pas pak kohe më bëhet se zbret nga një mozaik, duke thënë:

- Kam shëtitur mjaft... Ende nuk e gjeta.

Rënien e qiellit e ndjejnë më parë kulmet e larta e të përhirta të Augsburgut se njerëzit. Pas shkrepitës dëgjon rrapllimën e shiut. Ulluqeve të panumërta derdhet me ushtrimë. Përskaj shtëpisë së Moxartit ik pas pak kohe. Reja e shiut, që kishte plasur para se të gjendesha në rrugë, ka ndodhur para njëqind vjetësh. Miku mbështjell shallin rreth qafes. Gati sa nuk e shkul mustakun e majtë. Me një lëvizje buze pëshpërit;

- Ndoshta, udhëtimin do ta përfundoj nesër...

- Dhe në krye të rrugës do të pijmë. Aty në “Dardani”, i them.

- Po ku tjetër... Në krye të rrugës shpie udha jonë.

Diç të re dëgjoj çdo ditë për qytetin ku humb nganjëherë... Është çudë sa shumë flitet e pëshpëritet. Si në përralla tregohen ndodhitë. Por mua, nuk di pse, më pëlqen të tregoj shpesh atë për Fyhrerin dhe Poetin, që ma tregoi një gjerman plak kur tramvaji më shpiente në periferi.

Moti, dikur moti, Fyhreri dhe Poeti kishin qenë të parët e qytetit, por kurrë nuk ishin takuar. Fyhreri, megjithatë, ishte njëfarë zoti i vogël. Shpesh urdhëronte të marrë udhë eskadrila luftarake nga aty dhe, thonin se vdekja nisej nga aeroporti i rrethuar mirë diku në veri të qytetit. Ndërkaq, Poeti kishte parandjerë të keqen; se ajo që ndodhte atje poshtë do ta shkretëronte një ditë edhe qytetin e tij, të cilin e donte fort; kështu zehër e bënin lajmet që vinin për çdo ditë. Dhe Evropën, kur e kishte shkretëruar skaj më skaj, Fyhreri kishte urdhëruar: Tani mund ta varni edhe një Poet. Dhe nuk kishin lënë vend pa e kërkuar. Por ai ishte mbyllur në fjalë, në dhembje, në këngë dhe një ditë, kur Fyhreri nuk ishte dëgjuar më, ishte parë ai në këmishë e brek. Ditë e natë i kishte rënë qytetit, duke kërkuar rrugën e vet. Ishte ndaluar në krye të gërmadhës një ditë. Vetëm kishte thënë: Në fund të kësaj rruge duhet të rrijë ndezur një llambë natë e ditë. Krimi është turpi i një populli. Dhe kur kishte gdhirë qyteti, kishin parë në fund të rrugës llambën, e cila nuk fiket ditë as natë. Atë e lë pas shpine kur zbres shkallëve për të vizituar mikun.

Kur tregoj këtë, paramendoje veten lexues i dashur, se gjendesh diku në Serbistan. Pas disa vjetësh, duke kaluar, bie fjala, nga Pallati Albania për në Tashmejdani, dëgjon: këndeje ka kaluar Vozhdi, por rruga mban emrin e filan poetit, i cili ia kishte bërë portretin më gërditës, që mund t’i bëhet një vrasësi. Duket diçka e pamundshme kjo. Por llamba e ndezur në fund të rrugës B.

Brehti paralajmëron të mundshmen: Krimi është turpi i një populli...

Pas sa ditësh do të dal në Mirditë, te Pali i Tanushëve. I kam premtuar mikut se do ta kap zogun, i cili i fluturoi nga pëlhura sapo qiti firmën në një skaj të saj.

(Augsburg, 1994)

NJERIU QË KRIJONTE EDHE RE

Martin Camajn e kishte pyetur ai i Kepit të Ilirisë së Epërme se kush ishte zotëria, që kishte zënë vend aty në midis salle dhe përcillte me vëmendje çdo fjalë. Në gaz kishte çelur gojën temalsi: I Tanushëve asht... Dhe kur kishte marrë fund mbrëmja, Martini krahapur ishte nisur në drejtim të zotërisë, që ishte ngritur duke duartrokitur. Pastaj ishim njoftuar. Zotëria fare qetë kishte shtuar: Unë jam Pali. Pali i Tanushëve. Martini kishte ndërhyrë me humorin therës verior: Pse nuk thue i shtëpisë së Dukagjinëve? Dhe fjala kishte rënë për Gjijn Tanushin, pastaj për Tanush Topinë e deri te më i riu në djep.

Zotëria i veshur me shije e që mbante në dorë të djathtë sheshirin e zi, m'u kishte drejtuar: Ke dalë poet ndonjëherë në Palabardh? Unë isha shtanguar kur dëgjova fjalën Palabardh, fshat ky që gjendet bri Gjakovës. Nuk di si m'u kishte ndezur llamba e kujtesës. Përpara më kishte dalë një Palabardh tjetër për të cilin ishte lidhur fort fati i një piktori me emër Lombarda.

Me vjet nuk kishte ditur kush se nga e kishte origjinën piktori plak, megjithëse ishte shkruar shumë, por gjithçka me hamendje. Tek kur i afrohej fundit të jetës, atij i kishte folur gjaku. Haptas kishte thënë nga është e kush është. Rebelimin e piktorit plak shtypi bulevardesk serb e kishte heshtur, qëndrimin e tij duke e shpallur shkallim se, ku mund të jetë piktor i madh e shqiptar!

Kur Pali i Tanushëve kishte pyetur prapë se a kisha qenë në Palabardh, shkurtimisht i kisha rrëfyer historinë e piktorit plak, i cili në pëlhura të tij vend dominant u kishte dhënë viseve shkëmbore: Oh, zot, sa të derdhur jemi, kishte këlthitur zotëria me sheshir të zi në dorën e djathtë. Dhe, pasi kishim ngritur edhe nga një gotë, kishim pyetur se ku do ta kalojmë natën. Ku tjetër,

në Kullë të Tanushëve. E kush do ta presë shiritin nga ju? Martini na kishte shikuar me rend. Buzëqeshja e tij me atë humorin e Mbishkodrës ishte ngrirë në mes tij e meje.

Asnjëri nga ne nuk kishte paramenduar se në mbarim të një vjeshte të vonë, diku në Bavari, do të zinin vend rreth oxhakut dhe dukagjinçe do ta zbardhim natën. Kishte ardhur dikur koha kur duhej ngjitur dhe emri. Nuk ka më mirë se në Dardani të humbasësh, kisha thënë. Pse këtë nishan të mos e ngjallim këtu edhe për shpirt të Shën Albanit, që bredh ende dherave gjermane? Tërë natën oxhaku kishte ndejur ndezur dhe ne kaçakçe rreth sofrave mbi qilima Peje kishim imituar e kujtuar edhe kohët, që nuk kthehen më; se ca ishin ngatërruar nëpër fjalët tona e ca i kërkonim.

Nuk kisha mundur të mos bëj edhe një sy gjumë në Dardani. Ballë oxhakut një verë, kur bëhej luftë në Ballkan, kisha fotografuar edhe Petritin e vogël aty. Më kishte besdisur pastaj për çdo detaj, që kishte parë, por unë vazhdimisht i kisha thënë: Po. Po. Po. Në mesditë, te Guri i Martinit kishim vënë një tufë lule. Nuk iknim vetëm ne. Ndërronte imazhi ngapak edhe rreth nesh...

I ardhmi nga larg ma lëshoi mbi tavolinë një letër. E njoha shkrimin. Më qortonte miku pse nuk isha parë moti në Dardani: Nuni nuk i han fjalët. Pak më poshtë shkruante edhe rreth Palabardhit. Pas do ditësh, në fund të një stacioni, zbrita nga treni. Në dorë të djathtë ai mbante sheshirin e zi dhe të majtën në zemër. Bri tij piktori i Meleshit lëkundej e qeshte me mustakë gjithnjë e më të holla, duke pvetë edhe për gurë të sokakut.

Tri ditë e tri net më folën për do fakte të reja rreth origjinës së Palabardhit e deri te rrënja e Tanushëve. I meleshit ç'kishte bërë t'ia ngjallte të parët. Kishin shkuar deri te Kristaq Rama. Kishin paguar figurinën e Tanush Topisë, pastaj u kishin rënë këmbët e zbrazur xhepa derisa i kishin gjetur vend aty buzë Ujit të Madh: Le ta rrahin edhe tash e tutje erëra e valë! Kishte shtuar Pali, i cili kishte filluar t'i përngjajë ngapak Kinta Kuntës: Të dijë çdo gjë për fisin e tij.

Tek zbritje nga Mirdita një natë, kishte hyrë në mesin e të rinjve, që i matnin gjokset me Ujin e Madh. Do ta qerasë atë që ma thotë se kush e ka thënë këtë: Kosova është gjaku im që nuk falet. I meleshit më tregonte se Pali nuk ishte ndarë aq mirë, por asgjë nuk iu kishte dhimbsur. U kishte thënë se atë, që e tha këtë, e kam mik. Ashtu! Kishte pëshpëritur njëri nga fituesit.

Nga dritarja jugore shihet më mirë udha e pafund. Të bëhet se ajo bie pingul mbi Ballkanin e errët. Dikur ai hap derën. As mirëmëngjes nuk thotë. Ndalet aty në midis të odës së burrave. Në dorë mban tabakanë shkodrane, filxhanin e kafesë. Pakëz në gaz, më vonë foli: I kni, vërtet? Edhe bujaria ka kufij, trim - i them. Po atje bën luftë! Neve kurrë nuk na ka munguar trimëria, por lojën na kanë luajtur të mëdhenjtë. Nuk na kanë lënë të zgataraqemi sa duhet. Nuk di pse i frikëson lashtësia jonë! Pi kafënë. Atje bëhet edhe plojë! Ç'burrë të mos e përjetoj edhe këtë. Zjarri duhet disiplinuar. Shikoj nëpër dritare. Do të thotë? Atje i kam varret e mia. Vetëm me tabut mund të më shkoqin nga aty... 'Ta kam lakmi, megjithatë. Kthehesh... Ka vjet që nuk kam qenë - tha me një zë, që nuk e kisha dëgjuar më parë. Aty asgjë nuk kishte patetik. E shikoja se ai digej në vete. Para meje flisje një grusht hi: Nëse del në Gjakovë, mos lë pa kthyer në kullën time. Pesë-gjashtë herë e kanë ngritur me gurë të Bjeshkëve të Namuna dhe disa luftra i ka mundur. Pastaj, pastaj kam një lutje: ma sjell pakëz dhé nëse kthen ndonjëherë. Nuk di si të shpetoj nga ëndrrat.

Me rrembim rroka plaçkat. Zbrita shkallëve thuaj se më ndiqte qoftëlargu. Ai nuk dinte të mbante vetëm sheshirin e zi në dorën e djathtë e tjetrën në zemër. Dinte të krijonte edhe re. Njëra u mbyll edhe në këtë tekst. E shikoni? Nuk më lë t'i bie në fund. Fjalët janë qullur. Duhet t'i shtrydh më parë e të vazhdoj aty ku mbeta. Aeroplani likpërmjet çante një mal hakaret të akullt në pikë të verës...

(Münben, 1994)

ZOGU I TEJDUKSHËM

MITI PËR DJALOSHIN QË NUK EKZISTON

Oh, zot! thyheshin dritare e dyer kur shkilte amerikani i përçudshëm në Gjakovë. Det Kaçi alarmonte forcat e rendit. Xhoni Uajsmiler kaq e kaq dëme i kishte sjellë kinemasë “Hysni Zajmi”. Bileta vështirë sigurohej. Stafit të kinemasë ia kisha fituar bastin. Tri-katër kërcime nga Ura e Shenjtë dhe sa gjendej në mes nesh Tarzani, akrobacionet e tij mund t’i përcillja nga rendi i dhjetë. Aq kushtonte çmenduria, e cila arrinte shkallën më të lartë. Se heroi nga xhungla ishte mbinjeriu ynë. Ai mund të zgjidhte edhe të pamundshmen. Amerikan më. Nga ne të rinjtë nuk guxonte askush të pajtohej me atë që fliste çarshia. Kryesore, xhungla trokiste edhe sokaqeve tona, bile rëndë.

Sy vezullues më përcillnin nga të dy anët e bregut. Në mes Urës së Shenjtë dhe Grykës së Drinit i ngjaja një dallëndysheje, e cila hulumtonte drejtpeshimin e vet. Por zhgënjimi ndodhi kur mësova se filmi “Tarzani” ishte një truk fantastik, i xhiruar diku në ndonjë kopsht zoologjik, ose në një kadë gjiganteske prej gome. Aty heroi ynë ishte vetëm një kukull në dorën e padukshme, që ne nuk e shihnim. Çfarë fuqie ishte ajo, or zot?

Ditën kur Tarzani na braktiste, qyteti hallakatej. Një fjalë nuk e thoshte kush. Det Kaçi dilte para kinemasë së vjetër me duar në xhepa. Pëshpëriste diç nëpër dhëmbë. Fjalët e tij kush nga ne i përcillte me fishkëllimë e kush me ndonjë guri në drejtim të xhamave të zeza. Prapë me ne kishin punë forcat e rendit. Me ndonjë plagë të re ngrysej qyteti.

Tek kisha hyrë në bylyk dhe në kujtesën time vendin e Tarzanit e kishte zënë një ëngjullore, Det Kaçi kishte zgjuar qytetin në këmbë. Ishte kthyer Tarzani në mes nesh pas disa vjetësh. Unë kisha zbardhur dhëmbët. Në sytë e mi kishte parë një dritë të çuditshme ëngjëllorja, për të cilën më foli shumë më vonë. Ai nuk ishte më heroi im. Shkaktar për këtë ishte aktori Bejker, ndoshta, i cili nuk mahnitte dhe na bëhej se ishte një antihero. Nuk kishin ndodhur më as thyerje dritarësh e dyerësh. Një ditë Tarzani kishte braktisur qytetin tonë pa bërë fije zhurme. Unë ndahesha definitivisht nga mosha e adoleshencës. Fytyrës i kisha rënë briskun e parë.

Tash unë isha ai djaloshi i sokaqeve të qytetit tim: Flokëverdhi. Binte në sy: zbathur e me një kanotiere detari. Në kaçurrelat e tij, tregonin, nuk kishte rrëshqitur kurrë krahri. Me një karafil të kuq, në skaj të buzëve, e hapte Çarshinë e Madhe dhe mbyllte atë të Voglën. Me poetin e Mëhallës së Hadumit pinin nga një kafe në kafenenë “Atdheu”. Aty ushtronin edhe leksionin e ri të patriotizmit. Zbriste tevona në Taphane. Te Kasaphana përcillte fundin e luftës së rosakëve, të shoqëruar nga britmat e sharjet e vizitorëve të shumtë, që me ferk i linin shtretërit e tinëz grave të përgjumura strukeshin në breg të Krenës për të parë se cili rosak do të fitojë. Ca ktheheshin të dëshpëruar. Edhe në luftën e shpesëve kishte hile. Flokëverdhi kalonte Urën e Taphanes. I lante sytë te Kroni i Panxhallës. Tregonin se aty një zemërplasar, në pikë të natës, dilte në këmishë e brek për të takuar Floçkën, që i kishte ikur nga shtrati. Bindte mëhallën se ajo kishte qenë e ëndërruara e tij. Sy e buzë të saj ishin përzierë me ujin e ftohtë, që rridhte me rrëmbim nga

solonjara e lartë. Një natë e kishin gjetur cipërdoncullak. Imitonte diç nën dritën e hënës dhe ushtimën e ujit. Për të nuk dihet më asgjë.

Sapo dilte dielli mbi Çabrat ose ngatërrohej nëpër degët e hardhive të dendura, Flokëverdhin e zinte mbrëmja në Fusha të Bajram Pashës. Iknin në breg të Erenikut me engjëlloren nën sqetull. Nuk ktheheshin derisa çmështilleshin nga nata e kaluar, që i kishte sosur. Loja fshehtas kishte zgjatur me vjet.

Në krye të Çarshisë së Madhe prapë ishte parë Flokëverdhi me një karafil në buzë. Ndoshta ishte gjetur rastësisht në kasabanë më të çuditshme të vilajetit. Pos origjinës, aty kishte dhe një guri, që mbante emrin e tij, diku atje mbi Urë të Shenjtë.

Përmallshëm, poshtë e lart, i kishte rënë qytetit. Nuk ekzistonte më romantika e dikurshme: Çarshia e Madhe, as e Vogla, as Taphanet, as Kroni i Panxhallës me solonjare, as Fushat e Bajram Pashës. Bile nuk dihej as varri i Bajram Daklanit e Kulla e Bajram Currit. Ekzistuaa djali, që i ditka të gjitha, thoshin. Por ai nuk dukej më; se nuk ekzistonte as xhiri i Jahocit, as i Shahës, as ura e Tabakëve. Asgjë nuk ekzistonte më. Katrahurë kishte ndodhur në kujtesën e njeriut. Një tmerr i paparë si në poezinë e një miku të tij.

Flokëverdhi ishte nisur drejt Urës së lartë një verë të vonë. Miti për djaloshin, që nuk ekzistonte, prapë kishte nisur të pëshpëritet në mes turmës së derdhur në të dy anët e Drinit: Oi nonooo, paska ardhë Taljani...

Pse ua kisha prishur imazhin për djaloshin që e kërkonin?

Isha ulur pranë Ujit të Madh, ballë urës përrallore, ku dhe babai im kishte vënë gurin. Dikush në rërë kishte shkruar emrin e heroit të fëmijërisë sime: Tarzani. Kisha buzëqeshur. Me një shkop fshiva vetëm germën z. Në vend të saj vura c. Vogëlushi, që më rrinte mbi kokë, zgurdullueshëm më kishte shikuar. Dikur

mori vrapin. E dëgjova kur me rrëmbim dilte nga hija ime. Nuk di as vetë: Urës së Shenjtë ia kisha kthyer shpinën apo ajo më refuzonte me atë madhësinë e saj. Më kishte rënë karafili i kuq nga skaji i buzëve, aty te këmbët. Isha plotësisht i humbur në mes turmës, që gumëzhinte tmerrshëm rreth meje. Oh, zot, fundi ishte?

Kishte ndodhur lufta pastaj. Njeriu nuk vlente as sa një mi. Varre masive. Pastrime etnike. Plaçkitje. Në forma më tragjike reprimohesh Toplica, Çamëria... Qindvjeçarët shtonin: E shikoni, nuk e kemi pasur lehtë as ne me ardhacakët. Mos e kanë rrënuar edhe Urën? Kisha pyetur. A ishte shfaqur ndonjë përendi i ri? Është koha e tyre. Ka diçka nga antikiteti. Sidomos ta kujton shfaqjen e fiseve sllave, rrënuesve të qytetërimeve të lashta...

FYTYRA E PËRHËNË

Në jetën time kishte hyrë edhe një Marie. Nuk mund të shpëtoja nga ato. Vërtiten rreth meje çuditshëm. E pabesueshme si hyri kjo dhe u mbështoll nëpër fjalët. Në një lartësi të madhe ajrore më shfercoi. Atje lart te Zoti. Nuk e kisha marrë me mend se kush më shfercon diku mbi botë. Diç e tillë ndodhka.

E lija fundin e Sicilisë. Qyteti Mazare del Vallo ishte pika e mbrëmë e dheut italian aty buzë Mesdheut, ku fliteshin të gjitha gjuhët e mundshme gjatë një takimi ndërkombëtar të poetëve. Secili kishte një sharm të posaçëm; se kishte sjellë aty një copë të atdheut të vet. Unë kisha varur këmishën e përgjakur të Kosovës në një degë ulliri.

Nga dritarja e hotelit kisha parë një mëngjes edhe aeroplanët amerikanë. Ngjiteshin a dilnin aty diku nga thellësia. Merrnin vrapin në drejtim të Afrikës. Goditnin caqet e Gadafit. Dhe prapë mbylleshin diku aty pas malit në thellësinë e kaltër. Pastaj dëgjoja radion. Pandërprerë lajmëronte se ç'ndodhte tej Ujit të Madh.

Hyja në javën e dytë kur humba nëpër fshatrat arbëreshe. Dëgjoja ndonjë kangjele, që vetëm veshi i zotit i kishte dëgjuar; këputja ndonjë portokall, ose mahnitesha para ndonjë kostumi fantastik. Gjunjazi disi kisha zbardhur një ditë në Bari, ku Uji i Madh vazhdimisht përplaste shqiptarë e liburna ilire. Kisha zënë vend në një tavernë. Pija kafënë e tretë. Më kishte rraskapitur udha e gjatë. U ngjaja pakëz atyre të legjendave. Kisha edhe pakëz pluhur e ndonjë lule në kaçurrela, që nuk e mbaja mend se kur i kisha krehur. Përpiquesha të zgjohesha. Të shkund atë lodhje. Vendi im ishte në anën tjetër të Ujit të Madh, i cili nuk pushonte

duke nxjerrë shqiptarë nga fundi i tij. Dikur kisha hedhur sytë përreth.

Karshi meje rrinin dy vasha, që pak kishin të ngjarë në ëngjuj. Pinin kafe dhe buzëqeshnin në mënyrë diskrete me lëvizjet e mia të përgjumura. Dhe nuk më kujtohet se si isha gjendur në tavolinën e tyre. Prania ime nuk i kishte shqetësuar fare. Përkundrazi buzëqeshjet e tyre ishin hapur edhe më. Më vonë u tregova nga vija e kush jam, si më kishte qitur udha andej e pse kisha humbur atë; sa ditë kisha bërë deri këtu e kur isha nisur. Më kishin dëgjuar me vëmendje. Pastaj më kishin treguar nga vinin e kush janë. Popullin tuaj e njoh mjaft mirë, u thashë. Shpesh vete atje. I zura pastaj ngoje ca miq të mi. Ato shikuan njëra-tjetrën me një ngritje vetullash. Nuk munda të mos u them se Ciril Zllobec ka përkthyer dy libra të mi.

Po atë e kam fqinj. pëshpëriti ajo që quhej Marie. Edhe më mirë, shtova. Ngrita me fund një raki rrushi. Pres tragetin, u thashë dikur, liburnën time. Pëshpërita më tepër për vete. Thanë se nuk kishin kohë më shumë as ato. Edhe dy orë fluturonte aeroplani. Duhej të ishin atje para udhëtarëve. Për ku? - pyeta. Do të zbresim në Shpuza më parë, pastaj vazhdojmë për në veri. Ashtu! - thashë. Do t'u shoqëroja, por... U shikuan ndërve. Ajo që quhej Marie, hapi gojën: Po si jo, poet. Do të shvercojmë. Në fytyrën picegjate, me një lëkurë gatë të tejdukshme, iu thelluan edhe më dy çukat, që i jepnin një bukuri antike.

Ndala taksinë e parë. Ikëm në drejtim të aeroporti, i cili gjendej në veri të qytetit. Binte shi, Maria ishte e mpirë disi. Kthesave mbështetej për krahun tim. Do të më shferconte një vashë veriu, mendoja. Qesharake. Kur ra Kruja, arbëreshët e mi kishin kaluar Ujin e Madh, kush me trapa e kush me kajkë. E mua më shferconte një vashë alpine. Do e shikoja tani udhën e arbëreshëve nga fluturimi i zogut. Nga aty do të vështroja mos kishte mbetur ende ndonjë trap a kajkë ilire pa dalë në bregun e huaj.

Në kthesën e fundit, Maria çuditshëm pyeti: Vini nga lashtësia? Dhe me gishtërinj të gjatë shkundi një trohë pluhur nga kaçurrelat e mia dhe vuri një lule mes dhëmbëve, pastaj e zhyti tërë shuplakën në flokët e mi. Ilir jam, i thashë në gaz, duke kapur duart e saj. Ky është deti im. Edhe qielli ku po fluturuaka aeroplani yt dhe ti me këto kostume blu. Ato qeshen.

Pas formaliteteve që i bënë, kaluan pikën kufitare në aeroport. Pas tyre edhe unë. Për pak minuta u zbraz holi. I ngjante një guaske të madhe, ku vazhdimisht frynte. Nuk dukeshin më ato. Fryma e aeroportit dikur më kishte mbështjellë nga koka në këmbë. Isha një trup që ngrija. Mund të ishte truk ky. Hera e parë që më mashtronte një femër. E ajo quhej Marie, në sytë e secilës kisha gjetur edhe një copë qielli timin. Polici italian përcillte lëvizjet e mia. Iu afrova xhamit. Në fund të pistës së lagur aeroplani i fundit kishte ndezur motorët. Nuk dukej askush. Mendoja si të arrij tragetin. Ndryshe do bridhja edhe një javë nëpër fshatrat arbëreshe. Shikoja orën dhe aeroplanin. Nuk dorëzohesha ende. Pas shpine dikur dëgjova do hapa. Ishte Maria. Më zuri për krahu. Vrapuam në drejtim të aeroplanit, sapo mbyllej hyrja e mbramë.

Ishte hera e parë që kaloja detin pa biletë. Nuk i besoja vetes. Aeroplani gjendej në lartësinë e vet. Atje poshtë shikoja detin si shkëlqente. Një pasqyrë e madhe, ku rrezet e diellit bëheshin thërmi. Fluturoja mbi atë diell, mbi ndonjë trap a kajkë ilire të harruar, e cila ende nuk kishte arritur të kalonte në breg për të sjellë lajmin fatkob të fiseve. M'u kishte kujtuar një telefonatë pastaj. E luta Marien të thërrasë në numrin, që ia shkrova në një cep pallome. Ajo buzëqeshi. Desh të thotë: Ju nga Iliria shumë kërkuekët. Iku duke pëshpëritur diç intime. Pas disa minutash u kthye.

Mezi e kishte bindur vëllamin se gjendesha diku mbi det. I kishte thënë ai se të nesërmen më priste me Zuvdinë në Tivar.

Edhe pakëz vëllami do të zbresë në aeroportin e qytetit tuaj, iu kishte gjegjur Maria. E pritni apo e mora në veri?! I ndërruam pastaj adresat. Pëshpëritëm diç që vetëm ne e dëgjonim. Dhe para se të na linte të qetë stjuardesa tjetër, kishte pyetur, duke u ngritur: Vërtet, jeni ilir? I kisha pohuar me kokë.

Para doganës më prisnin vëllami dhe Zuvdia. Për romanin “Viti i Gucisë” Kadare më kishte thënë: Fatkeqësisht që ky roman është shkruar në gjuhë tjetër... Nuk prish gjë, i kisha thënë. Guciani është më shqiptar se shumë të tjerë, që pëshurrin lart. Është nga ata të mëdhenjtë. Ishte strehuar në Guci kur kishte braktisur Kodralinë për shkak të Savë Batarës. Dikur e kishte kërkuar Yllin e Davidit, pastaj Sabetaj Cevin nga Izmiri aty në një teqe në Ulcinium.

Te ura mbi Cem ishte vrrarë Isa. Sa herë më qiste udha andejpari, e hidhja një lule për shpirtin e tij. Prapë e bëra këtë. Aventurën time të kaltër e më të çuditshme, që kisha përjetuar, u tregova në mbremje, e cila bëhej më interesante sa i afrohej fundit. Ju, zotërinj, qenkeni nga një familje e perëndive. Vetëm shqiptarët mund ta bëjnë këtë. Edhe qiellin do e pushtoni një ditë, kishte thyer heshtjen më i vjetri, pasi përfundoja tregimin për njërin nga Maritë.

Edhe pakëz kishte deri në Munhen. Dhjetë vjet kishte ndoshta. Para meje u shfaq një grua e pashme më kostume blu. E njoha tek kur tha: Mos i kërkonit qiejt e Ilirisë, zotëri? Pastaj më pyeti, a i kujtohem. Të gjitha më kujtohen Marie, i thashë. Edhe udhëtimi mbi Ujin e Madh. Edhe... edhe... Ajo vetëm lëvizi kokën. Dy çukat në fytyrën e saj picegjatë, me një lëkurë gati të tejdukshme, iu thelluan. Dhe m’u bë se buzën e poshtme ende e kishte të kafshuar. Pas dy-tri psherëtimave, pakëz e hutuar, tha se është nënë dhe ka dy fëmijë... Lexuesi i pasionuar në antikitet, në

mileniumin e ri do e lexojë këtë si një variant të mundshëm të Shën Mërisë.

Në një letër të bardhë tërhiqja ca vijëza nga të cilat përpiqesha të formoja një portret kur për herë të parë më vizitoi miku im, Gani Bobi. Ishte i plotë. I rruar. Me një gaz karakteristik. Nuk e kishte atë pamjen, që e kisha parë për herë të fundit në një spital diku në periferi të Tiranës. Dhe, sa nisa të bisedoja me të, ishte zhdukur qetë. Më kishte vizituar pastaj një poet. Edhe ai ishte i vdekur. Kështu me radhë. Më shumë ishin bërë në anën e teyme. E unë digjësja, sosësja për qejf të Kasapit. Në një kënd qielli pashë dikur si ngrihej një fytyrë e përhënë, mejti. E kujt ishte ajo?

Vërtet, e humba qetësinë? E kisha lënë një Marie të helenëve atje në Mazara del Vallo, një tjetër më kishte gjetur tek kapërceja Ujin e Madh me një kajkë ilire. Pastaj zunë të më shfaqen të vdekurit e mi, miqtë...

Zotëri, pimë kafe - më trandi zëri i Palit.

Gjendem në një rreth, ku duhet të çrrethohem vetë.

ZOGU I TEJDUKSHËM

Në besë më lajmëronte Dritëro Agolli se afër Maltës e kanë syrgjynosur piratët ulqinakë Servantesin e famshëm. Ia kishin vënë prangat tek çonte dashuri me një mullate. Spanja është alarmuar nga ky gjest i pahijshëm i shqiptarëve. Aty-këtu në Arbëri flitet se atë e kanë ngujuar diku në Kullën e Balshajve. Ruhet në fshehtësinë më të madhe nga fuqitë e mëdha. Pse? Askush nuk e di. Bile as Sanço Pança, i cili me një varkë bambusi arriti në vendin tonë pa Don Kishotin. Burri i botës nuk e sheh të arsyeshme të na thotë asnjë gjysmë fjale për babanë e trurit të kthjelltë njerëzor: A është e vërtetë se ai gjendet në duart e shqiptarëve? Devolliti kërkonte të dijë për fatin e mëtutjeshëm të Servantesit se shkruan një roman për burgimet e mëdha të tij në mes të shqiptarëve.

Tek pinim e hanim qefulla në një tavernë kallamishteje në derdhje të Bunës, fill e për pe i tregova poetit B. Në besë i thashë, në qytetin tuaj gjendet i ngujuar truri i kthjelltë njerëzor. Turp është të torturohet nga piratët ulqinakë. Ia bëra me dije se Agolli kërkon lirinë e tij të menjëhershëm dhe hyn dorëzan me krejt ç'ka. Poeti B. vetëm shtoi: Servantesin ende nuk e kanë liruara? Do e shohim.

Pas hulumtimeve disavjeçare e të hollësishme ishte paraqitur prapë poeti B. nga Cepi i Epërm i Ilirisë: Për Servantesin dihet më pak këndeje se në Arbëri. Hulumtimet, megjithatë, nuk do t'i ndërpresim. Është nder për Ulciniumin tonë përkundër protestave të shumta të Spanjës. Flitet për ca fosile të dyshimta. Mund të jenë edhe nga koha e atij të krisurit. Por këndeje pari kurrë nuk është luftuar me mullinj ere. Ashtu na thonë baballarët. Do e lajmërojmë devollitin bekri sapo të mësojmë diçka të re. Ca gjëra i biseduam me poetin skarpiot, të

cilin e kishte qitur udha këndeje Bune. Njërën nga porositë e mbështolli me gjeth ulliri dhe e përbiu, pastaj desh na rrënoi Kullën me bubullimë.

Devolliti nuk pran: A e gjetën Servantesin? Nuk më vete humori...

Me muzgun e parë zbrita nga Kulla e Balshajve. Desh u rrokullisa atje në hon nga trupat e cullakuar. Mezi u përbirova nëpër turmë. Tek një bango, nën kurorën e një rrapit zura vend, aty në mes dy makrorestoranteve, që nuk i kishin në mes tyre as njëqind metra. Por ishin larg njëri-tjetrit sa më bëhej nganjëherë se bangoja, ku vetmoja unë, i ngjante një planeti të humbur, që rastësisht ishte shkëputur nga sistemi i tij dhe dergjej aty para këmbëve të mia. Më vonë u shndërrua çdo gjë në zhurmë. Vizullonin vetëm lëkura dhe sytë e mi. Mos e takoja Servantesin në shoqëri me poetin B.

Në anën e majtë, ku ikte udha në Plazhin e Madh, aty tek Ura, siç njoftonte devolliti, piratët mund ta kenë futur Servantesin tebdil në qytet. Dhe, sipas tij, trurit të kthjellët njerëzor i kishin premtuar, se do ta lironin ditën kur të përfundojë kallëzimin për Don Kishotin. U bënë ca vjet e kallëzimi nuk përfundon. Gjë tjetër nuk dihej. Në fund të kësaj udhe gjendej njëri nga makrorestorantet, që më mbulonte me hije të drunjve të lartë. Pak më tutje ishte bangoja, ku hapja një zog të bardhë, të cilin ma dërgonin vashat e rëna nga Libohova e largët. Zogu nuk ishte i zakonshëm. Kishte diçka që u mungonte zogjve veriakë. Dhe tek më jipte ujë, në gaz më kishte thënë njëra: Zogu ishte rritur diku tej Ujit të Madh. Prandaj mundëson të shohësh krejt ç'ndodh në bregun tjetër. Është i tejdukshëm. Mund edhe të humbësh në brendinë e tij. Unë e kisha vënë mjekrën në mes dy shuplakave. E shikoja siluetën e vashës si largohej. Më kishte bezdisur me atë zog, i cili hapte krahët e më bënte hije kur dielli soste në kokë. Dhe, isha mësuar me të disi. Ditën kur ai nuk binte në shuplakën time, ndieja në vete vakuum të madh. Dhe, kur pritja fluturimin e tij, nga makrorestoranti tjetër, një zë më kishte qitur në kokërr të shpinës. Pa dashje zogu i tejdukshëm kishte vazhduar fluturimin.

Isha kthyer në anën e djathtë. Rruga shpiente në qytetin e lashtë. E shkilnin krajanët në këmishë e brekë, ashtu dathur me gra e fëmijë; ngujoheshin në Kullën e Balshajve sa herë i ndiqnin fusharakët ose kur barinj të ua hante ndonjë bajloz.

Në cepin e krahut më ishte shembur një copë muzg, sytë e të cilit nuk i kisha harruar. E kisha prekur me dorën e majtë: Fëmijëria ime me ibrik në dorë! Pastaj kisha humbur ngadalë në dredhë, që më kishte mbështjellë. Ndieja rrapëllimën e çepengave të Çarshisë së Madhe, atë atmosferë kasabeje me një fjalor të lodhur; këngët e vjetra që monotonshëm mbaronin diku pas mesnate, atëherë kur gratë shterpe dilnin në oborr dhe i shtrydhnin gjinj të dritë të hënës. Ndieja thyerje dyersh nga komitet e rraskapitur; ngulfatjen e hieroglifëve të fëmijërisë të derdhura sokaqeve të Gjakovës. Me skaj buze i kisha buzëqeshur asaj tufe muzgu, që ma kishte fërfëlluar nga xhepi i djathtë miku i fëmijërisë. Isha bërë pjesë e turmës. Ajo nuk ishte magji. Më vinte erë shkrumbi. Kallej diçka në mua. Nuk kishte të bëjë as me nostalgji. Në mes zogut të tejdukshëm, që krijonte perëndinë e re dhe copës së muzgut, që më kishte mbështjellë tmerrshëm, kishin kaluar vjet. Por një popull që nuk është në gjendje të vlerësojë, ai nuk është në gjendje të kontribuojë, as të mbrojë lirinë e vet.

Më vonë në qiellin qiçërr kisha veneruar një njollë: përgjakeshin zogu i tejdukshëm me atë copë muzg, që ishte ngritur çuditshëm nga krahu im. Çfarë do të jetë e ardhmja, cilës udhë të shkel? Turma e gjorë kishte mbetur me gisht në gojë, unë galuc në bangon time të vetmisë. Asgjë nuk ishte më këngë, vetëm zhurmë. Në mes dy makrorestoranteve zhvillohej garë e hatashme në mes të kaluarës e të ardhmes, që përgjakesha t'ia shoh fytyrën. Vizioni im ishte gozhduar diku në horizont.

Dikur lëviza vendit. Sthurje në të dy anët. Pak më parë isha ndarë nga fëmijëria, që nuk kisha arritur as të ngihem me ujë nga ibriku i saj. Tani, ku shkilja, në mjegull? Obobooo. Ç'm'u kishte kujtuar Servantesi. Kisha rënë në anën tjetër të bangos.

Nga dritat përreth dalloja natën Kullën e Balshajve. Trupin e saj të frikësuar si një hata, që kishte mbirë aty në qytetin e labirintheve. Miku im nga Arbëria më bezdiste se diku aty e kishin ngujuar trurin e kthjelltë njerëzor. Tërë Devollin e jap për Servantesin. Bini në gjurmë..!

Poeti B: Punë e kotë kjo!

Me Bindin në krah ishte larguar. Papritur më kishte rrjedhur një lot. Dikur gulshima më kishte mundur. Vajin ma kishin dëgjuar deri në Shkodër. Nga turma ishte ndarë një zonjë. Padiktueshëm m'u kishte afruar: Pse qani, zotëri? Kishte pyetur me një zë gjentil. Qaj, ashtu... Dua të qaj, zonjë. Punë për mua pse qaj. Pakëz arrogançe iu kisha përgjigjur. Dhe, pasi isha shfryrë mirë së qari, kisha zënë të qesh tamam si një i shkalluar. Nga turma ishte ndarë prapë zonja e mëparshme. Ishte afruar në majë të gishtërinjve, duke u luhatur: Zotëri, vërtet, pse qaje? Zërin e kishte më të hareshëm se herën e kaluar. Me sy pakëz më të ndritshëm e kisha shikuar, duke thënë pikëllueshëm: Qaja për të kaluarën time, zonjë. Ashtu! Me një ton krejt tjetër kishte folur ajo. Në vendin e mëparshëm ishte kthyer, duke shkelur rëndë. Pastaj ishte nisur në drejtim të Ujit të Madh, pas së cilës kisha vrapuar edhe unë.

Si do ta përfundojë Dritëro Agolli romanin për Servantesin, një zot e di. Spanjollit i krisur na nxori punë të madhe. Humbëm mjaft kohë pas tij. Do të ishte mirë Sanço Pançon ta mbajnë peng atje në Arbëri. Nëse është gjallë Servantesi, do të paraqitet vetë ai, mbasi heronjtë iu shkapërderdhën. Është koha t'i kërkojë, të peshojë besnikërinë e tyre.

Kulmet nuk dukeshin më nga Uji i Madh.

Mbaj mend një gjë: Hëna ishte pesëmbëdhjetëshe mbi Vendenis.

(Ulqin, 1994)

GAZI I KOMBIT

Teteku e kishte sajuar apo qitur në dritë një fjalë për çmimin “Nobël”. Në trupin e saj, hiç më pak as më shumë, nuk kishte se gjashtë shkronja. Përdorimi i saj bëhej me kohë. Befasueshëm. Gjuhëtarët ngulnin këmbë se nuk ishte ky ndonjëfarë zbulimi. Bile këtë biçim fjale e kishte përdorur më parë edhe një gjakovar. Megjithëse origjina e saj mund të hulumtohej edhe më herët; ndoshta nga koha e Buzukut. Nëpër trojet tona qarkullonin mjaft fjalë të tilla edhe atëherë. Thonë i kishte rrëshqitur nga goja edhe Kastriotit.

Mirëpo në momentin kur kthehej ose ringallej - e shëndetshme plot zehër, ishte më se një dush për gjuhësinë. Ishte folur e parashtruar se kjo fjalë gjendej jashtë përdorimit, bile nuk e shfrytëzonin as Qumilat kur kokën e bënin pazar. Ja, pra, ajo shpalojej. E paemër. Enigmatike. Në mes nesh frymon. Përplasat nëpër dhëmbë dhe na shpëton nganjëherë kur venerojmë ndonjë të shembur. Dërmohet dhe prapë në këmbë të qelqta shalakatet udhës. Dhe, nuk mund të mos e përmendësh autorin e saj, i cili e nxori nga harresa. Ai quhet Teteku.

Isha interesuar për historinë e saj. Me poetin B. ramë deri në Shas të Ulcinuimit. Hulumtonim nëpër arkive të tij se mos ka mbetur ndonjë gjurmë apo gjymtyrë e saj në ndonjë tra. Edhe fjalët harrohen. Ato nxirren nga përdorimi. Vdesin. Atëherë nis të vdesë edhe gjuha, populli. Ose ato gjymtohen e kërkohen shumë më vonë të bëhet shërimi i tyre. Mu për këtë shkuarja në Shas kishte një rëndësi të posaçme, se me nxerrjen në dritë të kësaj fjale, ne mund të shkaktanim hallakamë edhe në metropole. Përmes saj, po ashtu, mund të konstatojmë edhe ekzistimin e shtypshkronjës së parë shqiptare, ku ishin shtypur librat e baballarëve tanë. Nëse mundemi dhe na mban shëndeti, rrënimi i

supozimeve dashakeqe rreth varfërisë së gjuhës sonë deri te fjala që, rastësisht, e kishte sajuar apo rizbuluar Teteku, është krejt afër. Çarshia e Alesë së Shpëtimtarëve të Kombit pret këtë sihariq nga udhëtimi ynë në Shas. Bën përpjekje ta konservojë atë e të konkurrojë në metropole me një zbulim të rëndësishëm gjuhësor jo vetëm brenda shkencave shqiptare. Me këtë rast, ca thonin nuk bën të harrohet sajuesi e as shënuesi i saj. Fat do të është nëse nuk konstatohet se kjo fjalë, plot shëndet e zehër, nuk është e kohës së re. Po qe se kjo nuk ndodh, do të dëshmonim së pari, se gazi ynë dhe gjuha kanë origjinë nga kohët vërtet më të hershme se Buzuku; dhe së dyti, hapej udha për në Panteon.

Puna shkonte mbarë, derisa nuk u shfaq një i krisur e tha se kjo fjalë, megjithatë, ka të meta. Mendonte se ka humbur në vlerë për shkak të një germe, që në trupin e saj ishte montuar gabimisht, ose Teteku nuk kishte pasur kujdes tek e inkuadronte. Si e tillë vështirë të pranohet. Vlerë kapitale, ndoshta dhe autoriale, do të ishte po qe se në vend të **c**-së të vihej germa **s**. Staf i gjuhësor kategorisht kishte kundërshtuar këtë. Me ndërrimin apo zëvendësimin e germave humbaste theksimi, po ashtu vizuelisht nuk mund të kapej forma e përmbajtjes. Te rasti i parë gazin shkaktonte vetëm shqiptimi, pra të germës **c**, ruante fuqinë e demaskimit të shembjes, e cila ka zënë të shumëzohet kudo në çarshinë tonë.

U shënuan edhe ca vërejtje të tjera rreth kësaj fjale, të cilën e kishte sajuar apo nxjerrë në dritë Teteku derisa shkruante veprën e vet kapitale. Fjala ishte, megjithatë, reprezentative. Avancohte gjuhën e Buzukut. Bile ishte për një çik më afër çmimit “Nobel”. Si e tillë, çfarë na është e që duam ta lansojmë si të mbërrime tonë, nuk di a të konkurrohet derisa shkëlqimi i saj të mos rrezatojë edhe më larg. Planeti ynë mund të pësojë ndonjë havori nga grekët e sllavët e të mos e dëgjojë kush fjalën e rrallë, që dy-tri herë i kishte rrëshqitur nga goja edhe Kastriotit. Bile shoku Enver zgjohej me të.

Shkuarja në Shas të Ulciniumit lë mundësi të reja zbuluese. Teteku mirë kishte bërë që edhe një herë e aktualizoi këtë Çalë,

ose e kishte nxjerrë nga bagazhi ynë gjuhësor para se të fundosej në grykën e Otrantos. Lashtësia e saj po të vërtetohet, shumëçka ndërron rreth nesh; po ashtu dhe në vetë Evropën e fjetur, që nuk është hiq më e moçme se fjala e Tetekut. Në kavanoza të akullta, a mund të konservohet qytetërimi i ri pa drejtpeshimin e skajeve?

Besohet se hulumtimet në arkivat e 360 kishave të Shasit kishin shqetësuar tepër grekët e sllavët. Zbulimi i asaj fjale do të ndikonte në baraspeshë në Gadishullin Ilirik. Pra, me fjalën e Tetekut, dëshmohej se ne vërtet jemi rrënjë e lashtë dhe e fortë që vështirë shkulet, edhe pse tokën e kemi të brishtë. Ne ruajtëm shëndetin e gjuhës deri në ditën e sotme, për të cilën vazhdon interesimi i mendjeve të ndritura. Bile edhe Xhojsi i famshëm, tek shkruante *Zgjimin e Finigenit*, kishte shkundur shumë fjalë shqipe dhe kishte pyetur, siç thonë, edhe për këtë biçim fjale që, më në fund, Teteku e shpëtoi nga harresa e sigurt.

Mesazhi është se fjalët e gjuha të ruhen nga ndryshku, të mos harxhohen vend e pavend. Mund të kemi probleme më vonë rreth dëshmisë sonë se kush jemi. Pra, fjalën që e sajoi ose e zbuloi Teteku nuk ka nevojë publikisht ta shqiptojmë. Ndoshta mu këtu qëndron edhe fatkeqësia e saj. Apo nga teneqet nuk ka bukë. Ato, si nxehen ashtu dhe ftohen. Shpejt dalin nga loja.

Arriti Ivetëquajturi aty, Ivetëquajturi atje, Ivetëquajturi andejkëndej. Mbante një çantë me karamela. Nga skllota e tij nuk mund dolëm as kësaj vere. Megjithëse fytyrën ia pamë para se ta zbulonim të tërë. E la çantën aty dhe u ngul në kunj. Më vonë në fytyrën e tij gjuhëtari kishte veneruar i pari një hije të çuditshme nga paneli i padukshëm, që e kishte ndarë likpërmjet. Dhe, sapo fliste për dëshmi të reja rreth fjalës së Tetekut, iu duk interesant fytyra e atij, që kishte nguluar në kunj. Se montimi e çmontimi i fjalëve atje në Shas ishte tmerrues; kishte shkaktuar dyshime edhe në rikonstruimin e gjërave të tjera. Me dhembje, tha, se nuk di me një fjalë, që nuk ekziston më as në Fjalorin Kombëtar, të konkurrohet diku.

Dhe, tek përcillte demonstrimin e gjuhëtarit Ivetëquajturi ishte zgërdhirë; kishte shkaktuar një nervozë me fishkëllimen e tij dhe duke u shtrembëruar, sa nuk ishte rrëzuar. Nxori pastaj një kokërr fasule. E hodhi aty në mes. Dhe biseda u ndërpre. Para asaj kokrre gjuhëtari e ndjeu veten tepër të fyer. Në një farë mënyre, rrokullisja e saj e bëri atë kureshtar dhe shënoi diç në notesin e vet. Ishte një paralajmërim, ndoshta, se mund t'i zbulohej edhe përmbajtja e fjalës bezdisëse të Tetekut, që e kishte sajuar apo rikthyer në jetë tek shkruante veprën e tij, që ishte bërë histori.

Poeti *B* reagoi pa pardon. Gjesti Ivetëquajturit dhe sidomos i gjuhëtarit, që fjalën kishte vazhduar ta zhvlerësojë edhe më, nuk e pranoi. Me mirë t'i shkundim prapë arkivet e Shasit, tha. Montimi i fjalës mund të jetë i gabueshëm. Ka aty ndonjë defekt. Dhe atë nuk mund ta zbulojë një kokërr fasuleje.

Pas një jave u kthye ekspedita nga Shasi. Më i shqetësuar ishte poeti *B*. Nga hulumtimet rreth fjalës nuk ka shenjë thuaj se uji i ublave i ka fshirë, tha. Por ndodhi një e keqe tjetër. Dritëro Agollin e pamë në TV tek u bënte lutje rebelëve. Qante për atë grimë Shqipëri. Ç'do të thotë kjo, zoti e di. Liria na qenka vërtet një mut i madh.

Lajmi se devolliti di edhe të qajë, mori dheun e shqipeve. Nga fundi i sallës iu afrova grupit dramatik. Ishin tubuar gabimisht aty rreth një tryeze, ku debatohej mbi historinë e një fjale dhe se skeçi i Art Bostonit nga Kungëllia e Epërme ushtrohej në një bodrum. Paska qajtur Dritëro Agolli?, pyeta poetin *B*. Dhe, fort, tha ai. Kjo është ditë zije kur qan gazi i kombit.

Nga lart një kokërr fasule ra para nesh. Ivetëquajturi filloi t'i hedhë edhe shumë të tjera derisa i zbrazti xhepat. Nuk mundem më vetëm me këtë kalanicë, tha. Dhe prapë u luhat në kunj. Më ha palla që nuk mund e zbuluat ende fjalën e Tetekut.

Isha larguar pa thënë gjë. Në krye të udhës prapë telallxhiu. Kushedi çfarë haberi na thoshte. Hulumtimi i mëtutjeshëm i fjalës së sajuar apo të rizbuluar, ku u zëvendësua germa **c** me atë **s**, mbetet të debatohet në kohë më të qeta, se a ishte i qëlluar ky ndërrim.

FUNDI I MITT

Brenda një kohe të shkurtër tri herë dola tek varrezat. Kur e lamë edhe *B.* e zdirgjeshim, vërejtja një burrë të moshuar si i qitte hapat në drejtim timin. Në kthesën e parë më zuri për krahu. E kisha harruar gati pamjen e tij edhe pse një të keqe nuk ma kishte bërë. Zësjtjerrë më tha: Qenkit kthyer? Asgjë nuk humbet përgjithmonë. Ishim krejtë afër makinës kur fliste pa veneruar se ca fjalë mund t'i kapnin edhe të tjerët... Po qe se nuk të ka lënë guximi, ja nisul - shtoi në të ndarë. Në xhep dëgjova tingëllimën e çelësave. M'i lëshoi sapo u zhdukëm në turmë.

Dita e tretë. Çelësat pakëz të ndryshkur merrnin gjithfarë formash e ngjyrash mbi tavolinën e bardhë e të rrumbëllakët. Me një cinizëm të theksuar i vështroja herë pas here. I hidhja tevona në ndonjë kënd të bibliotekës. Por kurrë nuk i gjeja në vendin e mëparshëm. Dikush i merrte nga gozhda e lartë në mur ose i kërkonte nëpër kthinat e bibliotekës. Mund ta bënin këtë edhe fëmijët. Kureshtja nuk i linte të qetë.

Kisha dalë në ballkon. Do ta provoj veten. A më ka lënë guximi? Ka jeta edhe dhëmbë. Pëshpërita atë mbrëmje. U kacavarën ca pikla çatisë, pastaj nëpër qimet e gishtërinjve të mi dhe pikëluan atje poshtë. Mblodha grushtin. Kur dëgjova klithmat e fëmijëve, i rashë murit. Nata gati më kaloi duke i mbuluar ata.

Në majë të kodrës së fundit na çeli dita. Edhe pak fillonin serpentinat e papritura. Nën rrokullisjen e rrotave e të pagjumësisë, poshtë nën ne, shihej si zgjohej Uji i Madh, i frikshëm. Kaltërsia e tij u err më vonë. Gati tërë trupin e tij e kishte mbuluar hija e Malit. Ajo bile kishte arritur ta fusë nën sqetull edhe ishullin e zhveshur. Nuk shihej as xhadeja e fshehtë nënujore, e cila çuditërisht lidhte ishullin me qytetin e gurtë. Në të vërtetë, ajo shokë e bardhë, që përshkonte trupin e Ujit të Madh, i

ngjante një xhadeje turke kur e shikoje nga lart. Nga një mik imi kisha dëgjuar shumëçka për historinë e saj. Më thoshte se ajo ishte udha e fshehtë e kalorësve të erërave, të cilëve kur u kanosej ndonjë e ligë nga brendia, tërhiqeshin atypari dhe mbylleshin në ishull, ku nuk guxonte kush të zbriste. E, atë udhë e dinin vetëm kalorësit e erërave, që mund të mateshin me shpejtësinë e liburnave ilire. Dhe në atë kallëzim kishte diç timen. Tërë kohën kisha përshtypjen se ajo shokë e bardhë mbështillte edhe Malin e lartë e të vrenjtur nga i cili lëshoheshim me një shpejtësi marramendëse. E kisha hetuar këtë nga fytyrat e djersitura. Shpesh shkundnin buzëqeshjet e fikura. Udhëtimi mund të përfundonte në një kyçje guri ose atje poshtë të na mbështillte ajo shokë e çuditshme.

Ditët e para vrapuam buzë Ujit të Madh. E preknim me majë të gishtërinjve. I lagnim këmbët, duart, faqet dhe fshiheshim nën hijen e një rrap. Pastaj i shtrinim shuplakat gjërë e gjatë. Nën lëkurë ndjenim frymëmarrjen e dheut të kriposur. Na thithte edhe pikën e fundit të djersës. Nga dielli kur nuk filluam të iknim, rrinim më gjatë në ujë. Unë përpiquesha të gjeja atë xhadenë e humbur të kalorësve. Pas dy ditësh na u gurëzua shikimi në ca fytyra, që pikonin gjak diku në kujtesën tonë. I mblodha të vegjlit: Nga sot nuk jeni më fëmijë! - u thashë. Ata shikuan njëri-tjetrin dhe u paluan rreth nesh të mëdhenjve. Dhe sapo fillova t'i numëroja kokat e zeza, që shfaqeshin e zhdukeshin zallishtes së pafund me ca tesha karakteristike e thika të varura deri në gjunj, gruaja murmuroi. Shtrëngoi të voglin ngryk. Kisha harruar se gjendesha buzë Ujit të Madh dhe gjarpërinjve, që mbështilleshin rreth trupave të ullinjve.

As atë ditë nuk e gjeta udhën e fshehtë të kalorësve të erërave. Kishte rënë një terr i dendur mbi dhe.

Me ditë na kishte bezdisur emri Rafael. Unë kisha shumë miq me emër të tillë. Atje në Mbishkodër kisha takuar disa. Në

Ublat e Shasit njëri prej tyre kërkonte pasurinë e humbur të Buzukut. I kishin thënë se aty diku Buzuku kishte fshehur edhe një libër me do shkronja të çuditshme. Dhe, duke kërkuar atë, Rafaeli i gjerë nuk ishte parë më. Ca thoshin se ishte mbytur; ca tregonin se e ka braktisur vendin dhe një zot e di se ku ka shkuar. Nuk mund u pajtova më vonë me sufiksin, që i rrinte këtij emri si bisht i zhugaftë. Dyshoja në çdo gjë që na rrethonte në hapësirë, ku sosnim kohën që e kishim pakëz të tepërt. Pasi e zbuluam edhe kishën, që ngrihej aty në midis të qytetit të gurtë, ia bëra me dije gruas: leximi i fjalëve nëpër muret e saj përfundon në klithje. Kushedi se çfarë e zeze ka ndodhur këndeje pari me Rafaelët. Ato fjalë mund të jenë të viktimize ose të ndonjë Rafaeli, që kishte kaluar këndejpari se, fatkeqësisht, në këto anë kishte mbretëruar tehu i thikës. Sufiksi në emra të gjymtuar dëshmon për një hata të madhe.

Në Ublat e Shasit e kërkojnë edhe tani atëfarë Rafaeli, të cilin e takova kur ai gjurmonte edhe librin e trashë të Buzukut.

Një mëngjes tek zbritnim në zallishte vëreja se ishte prishur rendi. Në të dy anët e rrugicave pëshpëritej diç. Më të prishurit në fytyra ngritnin duart nga perëndon dielli. Nuk dinim se ç'kishte ndodhur tej kodrave të përhirta, ku shtrihej edhe pakëz Iliri, ku më bëhej se dëgjoja zërin e Dioklecianit; as pse qëndronte tërë ajo turmë me fytyra nga andej. Ishim krejt afër Ujit të Madh kur nëpër mure fillova të lexoj grafite të ndryshme. Vetë format e germave të shkruara me shpejtësi dëshmonin se diç derdhej para këmbëve tona. Si një duç cigareje pastaj u fik aty buzë ujit. Shqetësimi i mbrëmjes së kaluar u derdh me klithma e vetëtimë thikash, të cilat humbeshin zallishtës së pafund. Mezi kapja fjalët dhe formoja kuptimin, të zezën ashtu të gjymtuar: pe...inj...Pet...inje. I mblodha fëmijët rreth vetes. Prapë u thashë; Më nuk jeni fëmijë! Kërcënimi im kishte ton shqetësues. Nuk u dëgjuan më ato. Hyra në mes të turmës. Të bëhej se do ta rrënonin edhe kodrën, malin; edhe qiellin që kishte zënë të nxihet nga veriu. Dikur vonë u ktheva. Gjumi më kishte zënë të veshur.

Të nesërmen u lëshova ngadal shkallëve. U përbirova rrugicave. Ato i kishte pllakosur një qetësi vdektare. Se ç'kishte ndodhur mbrëmë pas kthimit tim, nuk dija gjë. Tërë natën turma e shturur kisha ulëruar: Do të bëhet gjaku deri në gju... Kush kishte ndezur ndonjë qiri para dere, kush kishte vënë thikën ndër dhëmbë. Ne jemi luanë. As zoti nuk ka ç'të na bëjë. Gëzohesha për të mitë, që nuk e kishin parë spektaklin e çmendurisë.

Rrugicave të ftohta, mendoja mos i kanë kaluar kodrat e përhirta atje larg, mos janë kapur për ndonjë bisht ylli apo ende vrapojnë pas qenit të coftë? Qetësia bëhej e padurueshme. Ju afrova një vitrine të derdhur. Një kasetofon qëndronte aty. E ndeza. Këngë e vjetër çetnike theu qetësinë rrëqethëse. Pak më tutje m'i kapi veshi lajmet e para nga një radio. E hapi me gjasë një dorë femre, që nuk ia pashë trupin, se kishte humbur në rërë. Do të thotë rrëmuja kishte marrë fund dhe të gjitha ato shqerrje. I rashë zallishtes. Hapa tendën krejt buzë Ujit të Madh. Ndoshta isha afër xhadesë së kalorësve të erërave. Këmbët m'i lagnin valët. Kotesha kur më zgjoi i vogli: Frikësohem nga kjo qetësi! Ia përkëdhela flokët e verdhë. I thashë se më duket e gjetëm atë xhadenë e vjetër. Përqendrova pastaj shikimin në një mur. Një plakë në të zeza i fshinte germat e fundit, si duket. Unë arrita të lexoj vetëm... kan... Të tjerat m'i tha djali, i cili buzëqeshi kur mbi grafitin e mëparshëm lexoi: Zoti na shpëtoftë!

Pasi i la fjalët aty në mur, zbriti plaka në të zeza, duke u luhatur. Ju afrova Ujit të Madh. Thërriste: Rafael! Mjaft xhezdisë nëpër Arbëri. I përvoli këmbëzat, kaloi në ishullin e zhveshur, duke fshehur pas xhadejen e vjetër. Brofa në këmbë. Në rërë vizatova udhën për në shtëpinë time, tej shtatë dritave.

Hera e parë ishte që shihja ëndërr syçelur. Diku pas meje, ku shtrihet edhe një pëllëmbë Iliri e ku më bëhej se dëgjohej

Diokleciani, kishte rënë qyteti H. Por, robëria ime vazhdon.
Duhet të ik, ndoshta, edhe unë në ishull. Xhadenë sapo ta gjej?

Zoti kishte fytyrën time.

DITARI I NJË SHKODRANI

Nuk di sa shkallë kishte. Por unë ngjitesha shkallëve të gurta atje lart, ku sos toka e fillon qielli blu; ngjitesha i ndjekur nga potera e drita të forta të detit, i cili thërmohej për rrëzë të kështjellës ilire. Nadje për nadje aty thonin se zbritnin perënditë dhe vazhdonin betejën me detin. Të tillë gati e kisha parandjerë në poezinë time: Me një arap të zi katran dhe me një breg të largët në horizontin e mjegulluar në drejtim të të cilit shket liburna ime.

Nga një *Ditar* me ditë nuk mund të ndahesha. Krajani një nadje kishte zbritur nga malet, të mbështjellur në një shami veku të punuar nga lini, ma kishte lëshuar atë para meje, në rërën e nxehtë. Përcillja lojën e pulëbardhave në thellësi, që humbeshin pastaj në avullin e rërës që ngritej pas shiut të natës. Mbi shkronjat e shkapërderdhura e fjalët e përgjakura kur kishte parë se syri më ishte zmadhuar, fët e fët ishte larguar në brek të gjata të lidhura për zog të këmbës. Kishte marrë udhën e hijes së vet duke ma lënë shkodranin anonim kushedi sa vjeç. Nën çatinë e një kasolle apo vetulle mali, kishte shënuar atë, që e kishte parë dritën në kohën tonë. Dhe, ja ngjitesha shkallëve të gurta me peshën e fjalëve gati të ngrëna nga tija.

Ajo që kishte ndodhur në ato male, që më rrethonin me një qetësi të frikshme, nuk mund të harrohet se reprizohet. Ishte holokausti i tmerrshëm shqiptar. Stiven Spielbergu paska qenë i pafat. Filmin e vet të ri për holokaustin hebraik, nuk di a do ta xhironte. Ngadalë e shfletoja siç shfletohen gjërat e çmuara. Për të shëtitur nëpër botë ende nuk e kisha arrnuar mirë Këmishën e Nënës. Ngapak i shaja edhe anamalasit. Plagët e malëve si nuk i kishin lidhur ende për fjalët e tyre. Gati të këputura fjalët nga udhëtimi i gjatë i shkodranit deri tek unë dhe, duke lexuar

shqetësimin e tyre, në të vërtetë unë rilexoja dhe protestoja në mënyrën time për tmerret njerëzore. Nuk ekziston kurrfarë dyshimi: Te një popull krimi nuk shfaqet, ai trashëgohet dhe haraqin e paguajnë brezat kur të triumfojë arsyeja një ditë.

Shkallëve të larta, duke marrë frymë thellë, mbyllja veshët nga një refren, që ishte shkëputur papandehur nga *Ditari*: Sot kanë ra gjithë ditën topa e pushkë. Kaq kishte shënuar shkodrani anonim për datën 18.12.1912. Por ditët e tjera kishin qenë edhe më të liga; kishin rrënuar e djegur fshatra e fshatra; fëmijë e gra kishin zbardhur majë hanxharëve e hunjve dhe varre të reja rreth shtëpive të përbuzura. Ishte derdhur breshër zjarri e ndonjë korb fluturon ende mbi Dardani. Ditari ishte akuzë.

Qielli hapej tmerrësisht mbi kokën time të rënduar e të bërë qull nga vapa. Në të dy krahët e mi si në një pe xhite pehateshin kohërat. Sa më shfaqej Martin Segoni me dëshmitë e para për Skënderbeun dhe Dardaninë e tij në teh shpate; sa numëroja mërrolat e Marin Beçikemit duke llafosur atje lart me zotërat e Ulk Iliricumit. Pakëz isha vonuar. Në një kohë tjetër frymoja. Vrapoja për ta zënë shkodrarin anonim në mbretërinë e përhënë të Ilirisë. Maramendthi tek kishte filluar. Dhe pas çdo shkalle më bëhej se humbja nga një qytet, fshat a betejë. Mbyllesha me shtatë dryna, këmbekrye në “Epitafin e Glavnicës”. Shkundja pluhurin nga teshat e fytyra e Gjergjit, Balshës, Topijave, Dukagjinasve, të tërë albanojve. Nga famë e përgjakshme droja dhe bëja një sy gjumë në hijen e një muri.

Dhe vëreja pastaj nga çatia e kërrusur: Ardhësit e rinj si bishta dhelpra që ngjitnin sufiksats e tyre karakteristikë nëpër gjymtyrët e mia. Shumë fise të Veriut dhe Balshajt i kishin shpallur për të vet. Nga gazi im sarkastik trembeshin sorrat. Riska e fundit e qiellit tim, që e kisha shpëtuar nga *Shkurra* më mbulonte pranë një cingu a vale. Kishte ndodhur pastaj Kongresi famkeq i Berlinit dhe Pismarku, siç thotë miku im i rrafshit, dhe Doclea ishte zdjergur më në Jug. Kishte rënë Shpuza, fshatra, ujëra, livadhe, male si kulla letra. Bregut të detit më kishin parë, duke kafshuar buzën, pastaj duke gjuajtur ariun. Ditari i

shkodranit anonim nuk ishte i rastit, siç nuk ishte i rastit as krajani trupmadh, që më kishte trembur para se të hyja në Ujin e Madh një nadjë plot temperaturë.

Shkilja shkallëve të larta, Emri i Balshajve më lidhte fort me një pjesë të gjallesës edhe pse vazhdimisht më thonin se ishte një enigmë e çuditshme në udhëtimin tim për atje lart, ku sosej dheu e fillonte qielli blu. Më duket sa nuk e kisha kaluar edhe shkallën e fundit, pashë në re kulmin e Kullës. Kaq shumë udhë kisha bërë sa gazin e gastartë të kryezotëve nuk e dëgjova.

Pasi ndezën një pishë u përbirova më vonë nëpër portën e lartë. Sërish shkallët. Ngjitje e re. Derisa ma treguan vendin. Lirova fjalët nga vetja ime për atë që ndodhte atje diku në Dardani. Nuk di a më besonin. Atë që thosha moti e kishin përjetuar. Asgjë nuk ishte e panjohur për ta. As krimi; thonjtë dhe lëkurën e së cilës e kishin vizatuar nëpër skajet e mureve. E pashë se nga rrëzë e Kështjellës deri te Kulla më kishte ndjekur fatumi.

Shumë vjet më vonë, ajo që kishte ndodhur, me siguri do e shënojë, ndonjë udhëtar i ri, të cilin do ta qesë udha shtigjeve të largëta të Arbërisë e diku aty tek *Bregu* do ta lidhë liburnën e vet.

Të mos e harrojë edhe perin e kuq rreth dore!

(Shas, 1994)

NË MBRETËRINË E KARKALECAVE

Ndizja llambën. Kërkoja ibrikun me ujë, të cilin nëna ma linte afër shtratit. Pak më vonë dhomën e pushtonin karkalecat. Siç duket, ata përbiroheshin nëpër të çarat e xhamit ose të plafonit. Asgjë nuk ndërmirra, as nuk më shkonte ndërmend fare të ndërroja diçka, bile as xhamin e pëlcitur. Shtëpia ishte në derdhje e sipër. Nga fundi i shtratit deri tek koka ndieja flatrat e insekteve neveritëse. Zhurma e tyre bëhej e padurueshme. Dikur e futja kokën nën jorgan. E fikja dritën me rrëmbim. Dhoma fillonte të zbrazej. Në gjumë prapë më vinte ndonjë gurgullimë gati e mbytur e Erenikut.

Në mëngjes vëreja: nata nuk kishte qenë aq e qetë. Nëpër mure kacavarej ende ndonjë krah karkaleci ose qartë shihej ndonjë vijëz gjaku. Pas shumë vjetesh kuptova se karkalecat lanë pas një shkretëtirë gërditëse. Nga gjurmët e harruara mund të lexohej tmerri i tyre, por edhe nga dridhjet e lisit që ishin shpeshtuar, nga degët e të cilit mezi shihja një riskë qielli. Gjethet e tij dallonin nga gjethet e drunjve të tjerë. Aty nuk u kishte hyrë ende tufa e karkalecave, se çdo gjë piquej si nën saç. Më vonë pashë se edhe druri im kishte nisur të thahej. Një ditë e shkulën me rrënjë si një cung hakaret dhe në midis të oborrit lanë një gropë të madhe disa bojë njeriu. Aty mbaronin të gjitha udhët. Edhe dhiaret.

Ajo që më mungonte kishte formën e klithjes, në majë gati të thikës. Gjysmën e udhës e kisha kaluar megjithëse besoja se ajo tek fillonte. Deri-diku kisha qetësinë absolute. Ishte hera e parë, ndoshta, që gjërat kisha filluar t'i shihja ashtu siç janë: pa kurrfarë zbukurimi. Fundi i shekullit afrohej, Ballkani përpilletet brenda hasmërive se është koha kur vihen gurët e rinj. Nëpër trojet arbërore shtohen kufijtë. E kur të kthehem, nuk di sa do t'i kaloj.

Ata vazhdimisht më ngulfatin. Ndonjë lajm përvidhet: Arbërorët dalin nga legjendat dhe po marrin Evropën në sy. As këtu smira nuk i lë të qetë. Ç'popull janë, more?! Do të ketë lajme taze me siguri. Al Paçino ose Rapsodi do të më zgjojnë me ferk. Arbëria nuk është pikë uji në det. Por ajo që më mungonte kishte majën e thikës. Do të shohim, gjak a ujë do të pikon nën strehë. Fjalët që më mundonin lidheshin një për mua. Çështje mbetej liria, ekzistenca ime në katarkën e derrave.

Nuk di a ka natë që zgjat më shumë se nata që pret të gdhijë. E kalova vijën e fundit me një vrap. Nxitoja të shihja atë që e takoja vetëm në ëndërr. Ia kisha harruar hijallin. Në krah të majtë, në krah të djathtë rrotullohesha. Dikur e kisha thyer pasqyrën dhe kisha dalë tinëz nga shtëpia. Më kishte marrë malli të ndërroj fjalë me ata që kisha bërë një gjysmë jete udhë. Takimi i parë: Dukeni mirë, zotëri! Keni qenë tek mjeku?, më thotë një mik fëmijërie. Do të shkoj, ndoshta, - përgjigjem në mënyrën e tij - Po ju zotëri, sa herët qenkeni zgjuar. Ai zgërdhiet. Kap maçokun për bishti dhe ikën. Unë hap derën e kafeterisë. Takimi i dytë: Deri në fund të sallës tavolinat. Aty-këtu ndonjë duq cigare dhe shishe e harruar "Skënderbeu". Kamarieri i zdash dhembët. Dua të zë vend diku në mes. Nuk bën, zotëri - thotë ai - tavolina është vetëm për pozitarët. Po aty? - ia bëj me dorë. Është e opozitarëve, zotëri. Bëjnë poterë po qe se mbesin pa të. Atje më tutje - vazhdon ai - Rrinë telallxhinjtë e tyre. Më tutje, aty tek ajo e qëndisime grumbullohen sharësit dhe të sharit. Ndërkaq krejt në fund rrinë hafijet e të gjitha partive. Nuk di kush kë spiunon, por hahen si qentë... Siç e shihni, zotëri, kafeneja jonë është ding. Na vjen keq që nuk ka vend të lirë...

Gjendem prapë në krye të sallës. Para meje tavolinat të zbrazëta dhe karriget, që lëvizin në mënyrë të çuditshme. Më bie ndërmend Mario Soresku dhe deklamimi i tij i hidhur para boshllëkut nacional. Por dallimi në mes karrigave shqiptare dhe

atyre rumune është se, pak më vonë, në këto tonat do të ulen gjithfarë copash mishi të të gjitha formave e peshave, nga fërkimi i të cilave mund të ndezësh edhe cigaren. Takimi i tretë: Ja kalemxhiu, zbret nga bina. Ndez cigaren në xixën e dy kofshave që sa përflaken! Me vonë: Do të thotë nuk paska vend. Ai prapë m'i tregon dhëmbët. Falemnderit!... Po kush sundon këtu?, e pyes pa të keq. Ende serbistani, zotëri - thotë disi turpshëm, duke i fshehur dhëmbët e verdhë. Ashtu! Te dera në flakën e një qiriu ndezi gazetën dhe ik.

Prapë rënia. Nuk ishte ky kërcim nga Ura e Shenjtë. E shihja pusin e errët, që hapej tmerrshëm. Dhe sapo i afrohesha, pashë se me të vërtetë isha i veshur në tesha të vdekjes. Këtë e hetova kur rrugën e trimave mezi e ndriçonte një poç elektriku, të cilin e kishte vënë dikush në një hu për të parë se ç'ndodhte në Kasaphane. Fatkeqësisht, poçi mezi bënte dritë. Ishte humbur gati në tufën e karkalecave, që thyenin heshtjen mortare, duke hëngër njëri-tjetrin. Tamam si... Rënia vazhdonte. Dhuna e poshtërimi nacional i afroheshin tetikut. Kushedi. Mashtrohem edhe këtë herë ndoshta.

VRASËSIT E PADUKSHËM

Kisha pesëmbëdhjetë vjet që nuk isha hedhur nga Ura e Shenjtë. Kur mora të ngjitem lart, se ç'e qiti plazhin në punë të trollit një poet nga Malësia. Kërkonte një fletë dhe një laps dhe u premtonte se do ta shkruante baladën më të çuditshme mu tek këmba e urës përrallore. Por kur dola nga uji, për një kohë ai nuk i kishte hequr sytë nga shkumba, që kishte mbetur pas kërcimit. Në një cep kishte shënuar vetëm: U turr nga vdekja, por as vdekja nuk e deshi... Në matinenë letrare, vargjet që i kishte shkruar me rastin e kërcimit nga ura, i kishte bartur thellë në një kohë, tek luftërat çlirimtare kundër osmanlinjve. Në imagjinatën e tij, megjithatë, kisha lënë një gërvishje të thellë. Ndërkaq, guximit tim ai i kishte dhënë përmasa historiko-kombëtare.

Duke shikuar atë, në kujtesë më shpaloseshin shumë ndodhi nga e kaluara. Historia kështu qenka shkruar, u thashë në shaka ca miqve të mi. Në momentin kur isha hedhur nga ura, Drinin e Bardhë poeti i Malësisë e kishte parë si një kuçedër, e cila gojëhapur priste viktimën, që binte me një shpejtësi të rrufeshme në mes grykës së thellë e të errët. Pas matinesë më ishte afruar ai: Ty vërtet nuk po të dashka as vdekja! Në suprinë të ujit kisha shikuar fytyrën time. Isha zhytur thellë në Dri pastaj. Një manjollë Çabrat duke i marrë erë, më kishin parë në bregun tjetër.

Kishte rënë në sy një makinë me regjistrim të NS. Ishte lëshuar nga hoteli. Tek dredhakja e parë kishte marrë udhën e lumit dhe ishte parkuar aty diku në një hije ferre. Tre veta kishin dalë: një plisbardh e dy kryeshtruar. Përreth kishin shikuar. Kishin fikur cigaret dhe kishin fshirë fytyrat me shamia. Në turmën gjysmë të lakuriquar ishin shkepur. Dikur ishin nisur në drejtim të një dore, që kishte mbetur e ngrirë në ajër. Ujit iu kishin afruar,

disa herë në brez duke u prekur. Vetëtimthi kishin kapërcyer nëpër gurë, njëri pas tjetrit.

Edhe ne ishim tre. Por mbetem dy. I treti kishte hetuar përthekimin në unazë nga hijet, që afroheshin me një lëvizje të çuditshme. Miku u kishte dalur para. Fjalë kishin ndërruar. Unë kisha qeshur. As vetë nuk e di pse. Ata ishin zbehur si fletë e duhanit. Pritnin përgjigjen, ndoshta; ose të bënin punën për çka i kishte qitur udha buzë lumit në pikë të diellit. Prapë ishin prekur në brez. Buzëqeshja ime ishte shtangur diku në një rremb. Ata bëheshin më të zbehtë se fleta e duhanit. Miku u kishte thënë: Ky nuk është ai, që e kërkoni dhe te ne rrallë del. Sy më sy ishim shikuar. Në syrin e plisbardhit kisha parë një pikëz gjaku, që mbuloi bezbën e zmadhuar më vonë. Dy të tjerët i kishin sytë të thatë, shkretëtirë. Miku kishte hyrë midis nesh: ky nuk është ai që kërkoni. Ata ishin ndalur dhe kishin shikuar njëri-tjetrin. Për herë të parë nuk i kishin çuar duart nga brezet. Plisbardhi i kishte rrudhur sytë fort dhe rrëmbimthi na e kishin kthyer shpinën. Nëpër të njëjtët gurë e kishin kapërcyer ujin e ftohtë. Kishin ndezur makinën me regjistrim të NS.

Më vonë mësova se një ditë gushti në Serbistan ishin tubuar ata dhe të nesërmen në mesditë ishin ngjitur në katin e nëntë; krejt të heshtur, pa fije gjaku në fytyrë. Aty u kishin treguar se ku gjendem. Pas dy ditësh kishin kaluar ujin e ftohtë tamam si në filmat e Gari Kuperit. Kur ishin bindur se ai që e kërkonin nuk isha unë, kishin ndezur makinën me regjistrim të NS. Tym e mjegull ishin bërë grykës.

Shpesh e kisha pyetur mikun: Për çka mund të të vrasë Llapi? Ai kishte qeshur pikëllueshëm dhe në tymin e cigares kishte kërkuar diç. Ishte nisur një mot edhe ky udhës së gjatë e të mundimshme nëpër të cilën u ktheva pak më parë për ta thyer drynin në derën e shtëpisë. Të mërkurat e mia pak dallojnë edhe pse ndodh të bjerë ndonjë e kremte rastësisht. Isha shtrirë në një kanape, kërkoja pakëz trimëri tek ndonjë këngë e Arif Vladit kur ra telefoni: A jeni mirë? Po fëmijët? Aliu? Prapë një zë tjetër: Mirë qenkeni? Edhe fëmijët? Edhe Aliu? Po mirë jemi edhe fëmijët,

edhe Aliu. Dhe u mbyll biseda. Dhe prapë telefoni. Në anën tjetër dënesje: Ju lutem, a bën t'ju thërrasim më vonë? Arif Vladi ishte nga fundi. Cingërrimat bëheshin më të rënda dhe zbrazej vaji. Gruaja mbyll telefonin gjithnjë e më e shqetësuar. Më drejtohet: Mos ke bërë diç? A bën gjë i vdekuri, i përgjigjem preraz dhe zëri i fortë i Arif Vladit sa nuk m'i ka përgjakur veshët.

Kur edhe ca telefonata na besdisën, i them: E shkyçim telefonin. Nesër e zbulojmë misterin. Por gratë janë shpirtra të çuditshëm. E ndjejnë të keqen. Nga gjysma e natës më trandi zëri i saj: Zgjohu, sonte të paskan vrarë! I përgjumur: Si? Më paskan vrarë? Bile edhe të vajtuekan, më tha dikush në tel. Nuk e ditkan: përditë më vrasin e zgjohem, i thashë pasi me solli kafënë. Thuaji ç'të duash. Ti sonte qenke i vrarë. A i dëgjon telefonatat? Vërtet kurrë nuk kishin rënë aq telefonata në shtëpinë tonë. E luta: E shkyçim telefonin!. Dhe kur i thosha këtë, cingërrima trishtuese më ngriti në këmbë: Shtëpia e Aliut? Po, i përgjigjem zërit të panjohur. Si jeni? Habitshëm pyet me një zë tjetër. Paj, si i vdekuri më... Tani hoqa edhe plumbin e dhjetë nga trupi, i them në tallje. Plumbin e dhjetë e hoqët? Sa i fortë qenkeni! Bile as lëkurën nuk ma kishte grithur, ia kthej. Në anën tjetër të telit humbet zëri.

Nuk do të na shqetësojnë më, e qetësoj gruan, Shtrihem. I njëjti zë më zgjon: Thatë se keni hequr plumbin e dhjetë dhe e ruani në pjatën e artë? Më paskët kuptuar gabimisht, zotëri, i përgjigjem butë. Sontë hoqa plumbin e dhjetëmiqtë dhe i mbaj në shuplakë. Në cingërrimën e tretë ngris receptorin: Ti në këmbë qenke?! Po ç'duhet të bëj, krejt akull ia kthej. Asgjë, thotë i largëti, Trupin e ke në xhami. Nëse e do, eja e merre! Deri aty paska arritur xhenazja ime? A ishte e bukur, ju lutem, e pyes pikëllueshëm. Tepër e shëmtuar, zotëri. Si duket edhe zoti ka çuar duart nga ti. Gruas i drejtohem: Vërtet më paskan vrarë. Do të shtrihem në dhomën tjetër. Kam të ftohtë. Dua t'i shkund edhe plumbat e tjerë nga trupi. Me sy të zgurdulluar më shikon ajo. Pritueshëm ngrit telefonin: Ia lidhëm edhe varrën e nëntë, e dëgjova kur iu përgjigj një telefonate. Mbylla sytë me një

buzëqeshje të hidhur. Por, telefonatat ishin shpeshtuar. Një rënë mezi e kapa. E njoha: Nekrologun për mua, ju lutem, lëreni për një vdekje më të madhe... Parasysh më kishte vetëtuar poeti i Malësisë, bregut të Drinit duke vrapuar me një fletë të bardhë. Tevona ishte shfaqur makina me regjistrim të NS dhe tre veta atje në fund të rrugës së shkretë; fytyra e parruar e mikut dhe varret e prindërve në breg të Erenikut. Po, kush ishte ai që më kishte qëlluar duke zbritur Velanisë? Nuk mund ia shihja fytyrën. Ishte yni apo i tyre.

Rashë në krah dhe mezi vëreja konturat e ditës. Kishte rënë një hije e frikshme. Së shpejti shtëpia u mbush me njerëz. Askush nuk nxirrte zë. Dikur thashë: Një Ali, megjithatë, qenka vvarë. Oh zot, deri kur do të na vrasin! Në krye të dhomës profesorin plak, me ag që ishte ulur aty dhe nuk bëzante, nxori një pako cigare. E përtypi si një kore buke. Nuk di se ç'do të ndodhë më vonë. Rrugët gumëzhijnë nga vrasësit e padukshëm. Vështirë e kam t'i bëj më leqë vdekjes. Vetëm të mos jetë turpi ynë...

LEMBA

Poetët shqiptarë kishin vendosur të ndërrojnë varkën, të provojnë fatin me Lembën, anije me rrema. Me Liburnën kishin pësuar komplete. Përgjatë zallishtave të Ilirisë ngjallnin mbretërinë dhe luteshin të ketë më pak mbytje, përmytje, përfytje.

Kishin ngritur gotat me fund dhe kishin thënë edhe fjalët, që thuhën para një udhëtimi të ri. Pikërisht në orën e caktuar ishin ndarë nga Taverna prej kallamishtje. Më vonë nuk dihej se kush bubullonte më shumë: ata, Taraboshi apo vazhdonin komplotet rreth tyre.

Njërit kohë i ishte dashur të notonte e të kërkonte Dritëro Agollin në hije të një rrapi buzë Bunës tek llafoste me mijëvjeçarë të Shasit e pinte raki nga një spec Zadrimeje, në formë të një amorfe. Dhe, kur e kishte lajmëruar se Lemba po nisej në udhëtim përgjatë zallishtave të Ilirisë, ai kishte ngritur vetëm dorën. (Nuk kishte dashur t'ua prishë qetësinë mijëvjeçarëve). Dhe kishte thënë: të niset varka me rrema rrufeshë. Do t'u arrij diku në Detin Jon. Të keni kujdes, komplotet lanë shkretëtirë... Dhe tinëz vetes kishte kënduar "Te Deumin" e dardanit.

Varka e re thonë noton Ujërave të Ilirisë. Besohet se do ta gjejnë kësaj here edhe Peshkun e Artë. Në Tavernën e Poetëve nuk valvit as Flamuri i Zi, se Vendenisi gjallëron në një guaskë aty në botën e tejme, të cilës i afrohem me gisht në buzë.

(Ulqin, 1997)

JARGAVANI I PËRGJAKUR

TRAGJIKA E NJË FJALE

Skaj Lëndinës së Lotëve, ndoshta, por nuk dihet te cila piramidë, ishin takuar befas dy veta pas shumë dekadash. Rreth njëri - tjetrit ishin sjellë frikshëm, nën vetulla duke u shikuar, pastaj ishin parë drejt në sy. Duke marrë frymë thellë, kishte pyetur i tejmi: Shqiptar? Shqiptar. Ishte gjegjur i këtejmi. Do të thotë, nuk qenkemi vetëm. Kishte thënë njëri.

Edhe pakëz ishin shikuar. Piramidës iu kishin sjellë edhe nja dy herë. Dikur kishin zënë vend rrëzë një lisi të çarë. Kishin ndërruar nga një cigare. Njëri fitilin prej duhanit kaçak, tjetri tarabosh. Kishin nisur t'i shpreshtojnë fjalët. Kishte pyetur i tejmi: Si i thoni bukës? Bukë. Iu kishte gjegjur i këtejmi. Po kripës? Kripë. Ujit? Ujë.

Dhe pas çdo pyetjeje e përgjegjeje, i këtejmi çudshëm kishte shpëluar dhëmbët, pakëz të nxirë nga nikotina e duhanit të sertë, të cilët ia kishte veneruar i tejmi sapo ia kishte hedhur fitilin. Më vonë iu kishte çaraveshur fytyra, iu kishin shpëluar tërë dhëmbët kur i tejmi kishte pyetur diç banale, që nuk i shkon logut të kuvendit. Si i thuani kësaj? Dhe kishte vënë dorën aty ku nuk e vë burri. Ishte matur e çmatur i këtejmi ç'përgjigjeje t'i jepte. Një tis

terri i kishte rënë syve. Mezi ishte dëgjuar: Zuzë. Zuzë, bythës? Po, Zuzë. Prapë disi ia kishte theksuar fjalën i këtejmi. Do të thotë, zuzë? Vërtet, zuzë! Bash zuzë! Zuzar, demeke. Nga Zuzaria. Ashtu! Vendi? I këtejmi kishte lëvizur dorën ç'i merrte syri.

Një gaz i madh ishte derdhur tevona luginës së thellë e ishte ngjitur kreshtave e prapë ishte rrokullisur tatëpjetë Grykës e ishte fundosur diku atje poshtë te një ujë i akullt. Kishin qeshur të dytë aq shumë, pa e ditur asnjëri se pse qeshnin. Më vonë si me shpatë ishte prerë gazi. Kishin pirë edhe nga një fitilaq. Kishte rënë një qetësi thuaj se asgjë nuk kishte ndodhur pak më parë. Prapë fjala zuzë ishte zënë ngoje dhe komentime gjithfarësh rreth saj. Mendueshëm kishte thënë njëri: Eh, nënën e nënës, na paskan vënë në mes gurin e vdekjes për një fjalë! Sy më sy rreptas ishin shikuar e besatuar pastaj.

Në këmbë kishin brofur tërë zjarr. I ishin sjellë edhe njëherë piramidës aty skaj Lëndinës së Lotëve ndoshta, ose te Kepi i Vashave. Ishin shikuar flakas në sy: Shqiptar qenke? Më duket se po. Kishte shtuar tjetri. Ishin përrulur nga guri i vdekjes. Krisma ishin dëgjuar e zjarri kishte rrahur shpate e lugina. Qetësia bërë fije fije. Nuk dihej nga cila anë dëgjoheshin ato: Shqipëri këndeje, Shqipëri andej e guri i vdekjes në mes tyre. Njëri aty kishte mbetur shakullë. Tjetri e kishte hedhur në shpinë. Ishin lëshuar nuk dihet nga, se në të dy anët toka e tyre. Nga larg ia kishin parë njërit këmishën e bardhë prej vekut si merrte ngjyrën e kuqe. Më vonë lulekuqin e këputnin apo ia zdishnin rrobat trimit. Pakkush e dinte.

Thonë i vdekuri kishte kaluar të gjallin nga guri i vdekjes e tëhu, që na kishin vënë në mes për shkak të një fjale, që nuk ma zë goja ta them...

MALËSORI DHE ATENAGORA

Saktësisht nuk dihet se kur ishte parë aty në Fanari të Stambollit i ardhmi nga Malësia e Gjakovës. Me ditë e kishte shikuar tempullin e lartë e të mistershëm. Para tij ngrihej ai si hije e trishtë. Pas një kohe kishte rënë në kontakt me një prift ortodoks shqiptar. Ai quhej Lefter Sava. Përmes tij malësori kishte hyrë në labirinthin e ortodoksizmit botëror.

Një mëngjesi jargavanësh, Hirësinë e kishte lajmëruar motra e parë për vizitorin e largët e të çudshëm. Patriku kishte urdhëruar: Le të hyjë! Pas motrës ishte nisur i ardhmi. Nuk dihet pas sa kthesave, por në fund të një salloni, ta quajmë kështu, qëndronte Hirësia. I kishte qitur edhe disa hapa e ishte ndaluar para tij malësori me dorë në zemër. Patriku i ortodoksizmit botëror e kishte pyetur se ç'hall e kishte qitur këndejpari dhe ç'kishte të re nga ai vend i largët, të cilin e shihte edhe në ëndërr, siç tha më vonë.

Malësori nuk kishte harruar asgjë se ç'e kishin porositur. Me rend ia kishte thënë të gjithat. At(h)ena(s)gore, Kryepari i ortodoksizmit botëror në Patrikanën e Stambollit, me vëmendje kishte përcjellë rrëfimin e të ardhmit, duke përsëritur shpesh ato fjalë, që i bënin përshtypje më shumë ose që i kujtonin diç nga kohët e hershme. Dikur i ardhmi nga Malësia e Gjakovës, i cili mund të ketë qenë nga Smolica apo Hasi, kishte marrë frymë thellë. Në sy e kishte shikuar Patrikun. Me gjysmë zëri kishte thënë: Hirësi i nderuar, Atdheun e kemi në rrezik. T'i lëmë unë xhaminë e Ju kishën. Ç'na duhen tempujt pa atdhe.

I ardhmi derisa i thoshte edhe fjalët e tjera, në sytë e At(h)ena(s)gores ishte shfaqur një re, që pushtonte me dritën e saj. Dhe pas fjalëve të dëgjua më vonë nga malësori, reja kishte zënë të shpërbëhet e të marrë forma piklash të shiut, që

rrokulliseshin monotonshëm e tretnin në mjekrën e bardhë e të dendur të Hirësisë. E kishte rrokur për duar të ftohta. Gati i lemeritur e kishte shikuar: Hirësi, ç'keni? Ishte dëgjuar malësori i humbur. I madhi kishte lëvizur vetëm kokën. E në kupën e thellë të sallonit ishin përplasur ca fjalë të pakapshme. Kryepari i ortodoksizmit botëror mezi kishte shqiptuar: Mik i nderuar, halli dhe fjalët tua, ma kujtojnë të ndritshmin Vaso Pashë Shkodranin.

At(h)ena(s)gora dhe malësori ishin qafuar shqiptarçe. E kishin kripur edhe nga një kafshatë. Hirësia e kishte përcjellë pastaj mikun e largët deri te pragu i derës kryesore. Respekt të tillë nuk i kishte bërë askujt më parë. Në analet sekrete personeli i Patrikanës së Stambollit e kishte shënuar këtë si gjest të dyshimtë të Patrikut...

Se a janë takuar më, nuk dihet. Në kthesën e parë i ardhmi kishte nxjerrë shaminë e punuar në vegje të Dukagjinit. Kishte fshirë sytë e qafën e trashë. E, këtë ma thoshte nipi i tij me të cilin ballë Xhamisë Blu të arkitekt Sinanit, pinim; çaj ai e unë dhallë. Pjesën tjetër të rrëfimit nuk mund ta them. Njeriu ka nevojë edhe për pakëz fshehtësi.

(Stamboll, 1998)

SHKAMI

Shkamaxhinjve të të gjitha Shqipërive që derdhën etninë

Ukë, tha, quhem. Ukë, a dëgjoni? Nga Drenica vij. U sjell këtë shkam të punuar nga druri i maleve të mia. E kam punuar për ju, trima. Nëpër plumba e prita kam kaluar me të në shpinë. Uluni cili të doni! Mendermethënë, aty ka vend vetëm për një bythë. Mjeshtria e urtia çok janë të Drenicës. U thashë, quhem Ukë. Këtë shkam e kam punuar nga druri i maleve të ujqërve. E shikoni? Tri këmbë i ka. Por vetëm një bythë mund të ulet aty. Unë ua solla këtë. Nëse e fyesi, kenë fyer gjakun e derdhur të ujqërve të mi; nëse e nderoni, paqi faqen e bardhë. Humbës nuk shkoni. Aty mund të ulet vetëm njëri nga ju! Po u pëlqen aq shumë, ua mbaroj secilit nga një. Në kohë ujqërish, nuk mund t'u shoh qyqe... Unë bëj dhe shkama, or të gëzuar. Pas kësaj katrahure, më dhemb zemra t'i dalë punë plumbit. Mbajeni mend, unë quhem Ukë. Por ju? Shkova të derdh të keqen atje ku mbrohet fytyra...

Njeriu i maleve të ujqërve kishte pleqëruar më urtë se bajraktarët e Vilajetit Hyxhymandalija. Për këtë dëshmon edhe një rebel. Fabrika e parë që ngritet pas çlirimit, kishte thënë ky, të jetë e karrigave. Më pakëz hasmëri do ketë. Varri ynë na bëhet shkami. Oh, Zot!

DAVIDI

I zgjedhuri i Zotit kishte edhe emrin mitik. Ishim njohur në Këln. Ai kishte studiuar në Zagreb. Për çudë, shumë miq të tij, ishin edhe të mitë. Pra, nuk e kishim të përbashkët vetëm thurjen e vetmisë. Kishim bërë ca javë e qindra kilometra bashkë. Në mbrëmjet letrare kishim folur përmes poezisë edhe për momentin politik të Evropës. Unë kisha probleme me hipokrizinë e të mëdhenjve. Në asht e ndieja ende thikën e tyre, e cila rrëshqet edhe më poshtë. Mikun e frikësonte paqja, lumturia. Nuk dinte si të veprojë me to!

Herë pas here bisedonim edhe për mbiekzistencën hebraike. Tërë atyre katrahurave si u kishte shpëtuar deri te formimi i Shtetit Izraelit. Kur ndërrojm fjalë rreth kësaj, qeshte çudshëm. Pastaj renditte shumë shembuj mjaft bindës. Theksonte posaçërisht mençurinë, guximin dhe solidaritetin brenda gjakut hebraik. Kishte raste kur reagoja. Këto virtyte nuk i mungonin as popullit tim. Por kur ndaleshim tek organizimi, aty frenoja. Nuk mund e dëshmoja një iniciativë ku kishim dalë faqebardhë. Në mosrealizimin tonë kishte dorë çatia, arroganca fisnore, bajraktarllëku. E, mu organizimi i fortë i kishte shpëtuar hebrenjtë. Ishte ajo fuqia që mbante gjallë virtytet, të cilat i theksonte me një qetësi dheu miku nga Tel-Avivi.

Unë isha pakëz folklorist. Nuk mund u shkëputja aq lehtë nga vetvetja. Rënditja triumf pas triumfi nga lashtësia e këndeje, por mungonte rezultati. Miku kishte të drejtë, pra, që ngulte këmbë në konkretin. E venerova këtë më vonë. Më kot trimëria kur mungon organizimi; kur nuk di ku hyn e del. Duhet të ekzistojë një farë maje për orientim. Pashë se nuk mund të krenohesha. Kryevete, në mënyrë farefisnore, nuk bëhet gjë. Këtu na zënë pritën edhe fqinjët tanë grabitës. Por bindi njerëzit e

shndërruar në karrige e që për ambiciet e tyre një popull e shpien në kasaphane. Më vinte inat: të jesh trim e humbës. Miku qetas vazhdonte bisedën. Isha bindur se na ka munguar mirëkuptimi i brendshëm dhe në momente kyçe na ka lënë takati.

Ktheheshim nga një mbrëmje letrare. Miku nga Tel-Avivi prapë ma kujtonte gjestin shqiptar, siç e quante ai: mbrojtjen e hebrenjve në kohën e nazizmit. Nuk mund e kuptonte se shqiptarët, popull i varfër e i pakrah, kishin mbrojtur hebrenjtë! Ç'fshehtësi kishte në këtë madhështi? Diç e tillë nuk kishte ndodhur askund në Ballkan, bile as te popujt civilizues, siç e quajnë veten këta të mëdhenjtë, që e mbajnë tani edhe kërbacën në dorë. Njihte disa familje që ishin kthyer në Izrael. Ato flisnin me admerim për fqinjët e tyre shqiptarë. Ca nga to bile ishin kthyer prapë në Shqipëri. Nuk kishin mundur të ngulnin në mesin e ri. E, këtu më thoshte, na shkoni ju shqiptarët. Keni diçka që nuk e kanë të tjerët: njerëzoren, miqësinë, respektin; besoni më shumë se të tjerët në vlerën dhe besnikërinë e njeriut. Pse e bëni këtë, mbetet enigmë? Ndoshta, për shkak se nuk dëshironi të jeni të vetmuar apo edhe për arsye të tjera psikotike. Pseudoshkenca serbe kot e ka, që propagon e bën çmos t'u paraqesë në një dritë tjetër, që më shumë është karakteristikë për ta. Kam lexuar elaboratet e tyre më se të marra. Jam turpëruar si njeri dhe kam truar shovinizmin se ku është në gjendje të shpie. Aty është dhe debakli serb. Besoj se nesër do të turpërohen nëse nuk është vonë. Ballkani është zorrë qorre. Evropa mund e operon këtë kur të dojë.

As tani nuk e di pse më kishte pyetur sa banorë ka Kosova. Me numrin e banorëve është manipuluar gjithmonë nga pushteti, i kisha thënë. Bëhej kjo thjesht për arsye politike. Fshihej realja. Përafërsisht, ne e dinim sa jemi. E dinin, po ashtu, dhe të tjerët se ish-bashkësinë e bënin vërtet dy popuj dhe ne. E, kur i kishim zënë ngoje partitë; numri i tyre e kishte tmerruar: Secila mëhallë e paska nga një parti! Kishte pëshpëritur çudshëm. Ju kishin dukur pakëz tepër. Në një kohë të ligë të veprojnë kaq shumë parti?! Pas një heshtjeje, më kishte pyetur se për kë veprojnë partitë. Unë

isha ngrirë. Për kë tjetër, pos për çështjen kombëtare. Kishte shtuar atëhere: Vetë numri i tyre bën të dyshosh. Vepruakan ato më tepër për interesa klanore, fisnore. Kisha kundërshtuar: Janë burra të mençur, patriotë të zot; betohen në tokë e në qiell. Kisha zënë ngoje një figurë të devotshme që, për çështje kombëtare, kishte shkrië tërë pasurinë. As këta të sotmit nuk besoj se i rrinë larg këtij kodi.

Miku nga Tel-Avivi kishte përcjellë deri në fund fjalët e mia. Me një brengë kishte shtuar pastaj: Aty ku derdhet fuqia, pak gjë bëhet për çështje kombëtare. Se, çdo gjë varet prej fuqisë - edhe organizimi, edhe triumfi, edhe ndërtimi i shtetit. Kishte murmuruar diç në gjuhën e vet. Vështirë ta bindja se si trimat e mi nuk ka; se ata shtohen dhe bëjnë punë, të gJORËT. I zgjedhuri i Zotit kishte mbyllur bisedën preras: Rezultati?

Nuk e mbaj mend si quheshin bajraktarët e tij në gjuhën e Talmudit. Në këtë zezonë e kujtova mikun tim nga Tel-Avivi, që mbante një emër mitik: David.

PASQYRA

Moti nuk ishte parë as dëgjuar. Kishte lakmuar të jetë dikushi më në fund. Vendos ta bëjë spirra-spirra atë. Aty ishte mbyllur dhe veten e kishte parë tepër të frikshëm. Derdhet pasqyra para tij dhe derdhet ai para thërmijave të saj. Vetën tevona e kishte kërkuar, por mungonte ajo. Gjymtyrët i ishin derdhur. Nuk mund e shihte veten aq të vogël. Nëpër thërmijat, që i kishte mbledhur, megjithatë, veten nuk e shihte tamam. Kishte veneruar atë hijen, që iu kishte dukur tepër gërditëse. Përfytyrimin i mungonte drita, tërësia.

Unë kisha qenë spektator rasti. Kisha shikuar këtë palaçiadë. Më vonë historianët këtë do ta quajnë me gjithfarë epitetesh, ndoshta edhe farsë shqiptare. Por detyra ime e parë ishte të krijoj Pasqyrën e re. Së pari figura nuk ka nevojë ta shohë veten aty; së dyti, përpjekjen për të kthyer qetësinë, nishanin, zgataraqjen time të lirë është punë e shenjtë. Njeriu ka nevojë të ngulë në dheun e vet më shumë se të rrijë varur në një karrige ajrore të dikujt. Dhe kur mendoja se i kisha kryer të gjitha, kisha kërkuar të nderuarin, që e kishte bërë spirra-spirra Pasqyrën.

Hafijet e hyqymetit kishin lajmëruar Kapon se ai që kërkohej, e kishin parë të varur majë një lisi në karadakllëk. Nuk i kishte frikësuar shumë luhataja e tij në ajër sa figura e tmerrshme e një ulkoje, që ishte kacavarur për atë trup të pashpirt nga i cili ëndërronte se do të lindte një trim më të çartur. E kishin shkoqur me rrëmbim. Kapoja me dorën e vet ia kishte prerë haletet e viktimit me një të rënë. Gruaja, që i ngjante ulkojës, ishte lëshuar karadakllëkut, duke këlthitur se do të lindë atë të vërtetin. Në vilajet dikujt iu kishte kujtuar Sefë Kosharja, por nuk ia kishte mbajtur ta thotë. Të varurin e kishin mbështjellë në një lëkurë gale dhe e kishin hedhur në hon. Flitet se Homeri plak ishte

përpjekur t'i gjejë vend në poemat e tij këtij trimi, që hiya ende i luhartet në degë. Nuk di më tutje se ç'është bërë me atë ulkojën: ka lindur apo jo. Rrëzë atij lisi një udhëtar kishte lënë një *Ditar*. Aty shkruante edhe këtë: azgan, po budalla. Unë iu tregova vetëm shkakun se në të dalë nga Pasqyra, ai e kishte bërë spirra-spirra atë. A do ta krijojë kush Pasqyren, ku shihesha tamam?

SHUMËSI I MEDIOKRIT

Nuk besoja se është në atë deregje: me tapi i cokatur. Shoq nuk ka, më thoshin. Për pesë para bën këtu e në Amerikë. More nuk kishte lënë kë pa e marrë nëpër gojë. E keqja ishte se punën e artit e shikonte në bazë të ngritjes së ngrehinës. I citonte katet si nocione rreth njëfarë “elitës”, që unë kisha çuar dorë kahmot. Dhe e dija se katet ishin dhe fatkeqësi njerëzore, që ky nuk e kuptonte. E kisha lënë të zbrazet, Njeriu ka nevojë të zbrazet kur ha shumë. Më kishte folur dikur për do koncepte e libra, që moti i kisha shqyer, ndoshta para se ky të ishte në embrion. E vëreja se gazi i tij ishte diçka tjetër. Megjithatë, ndieja dhembje. Nëse ndokush do ta tredhë Zotin, është ky - shqirrej sefatëhënia e çarshisë.

Pasi nuk kishte ku të hipë më, e kishte drejtuar gishtin. Nga ngrehina e tij më duket apo nga një karrige e Alesë së Shpëtimtarëve të Kombit. Marritë nuk mbahen mend. Pakëz besoj në ata që, bile, një morr nuk e kanë mbytur në Morrani. Ishte fundi i palaçiadës së çarshisë sonë. Nga të krekosurit e tij pashë se kishte nisur t’i shemben edhe katet, t’i preknin këmbët në tokë të zotit. Ashtu është, i them një ditë, por unë më mirë i kuptoj këta të tokës. Nuk mbaj mend se ç’keni shkruar? Kam dëshirë t’iu lexoj dhe, ju lutem, lajmërohuni kur gjeni yt gjenial ndërton një kasollë sa për t’u fshehur nga shiu! Nuk të kuptoj, kishte thënë. Nuk kishte më zjarrmi në fytyrë, as gishtat nuk i dridheshin. Një hije e zbehtë i kishte rënë nga koka në këmbë, që nuk dija në cilën pikturë të velanijasit tim e kisha parë. Ishte krejt në tokë, në mes “mjeranave” të mi. I mblodhi dikur fjalët dhe dhëmbët e shkapërderdhur nëpër Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit, i futi aty nga i kishin rënë, mbylli gojën dhe iku. Nuk kam dëguar më për të. Thonë se shkarravit diç. Por kam frikë se nuk do t’ia japin vizën të dalë as tej Lepasaviqit. Ç’na bëri more, kjo mace e zezë! Ika për në Romë. Të kthjellem pakëz nën qiellin e humbur të Dioklecianit tim të vdekur...

KOKËÇARJE ME NJË FJALI

Alo, bre... Dëgjoj mikun e shqetësuar në anën tjetër të botës. Gjysma tjetër e fjalisë sëç më rrëshqiti. Nuk mund e kapa. Nuk vonon. Prapë miku. Pakëz më i qartë: Alo, bre... E kap edhe gjysmën tjetër. Formoi tërësinë e fjalisë së parë. Nisi e qeshi. Kam përshtypjen se në anën tjetër vërtet është i shqetësuar miku. Mezi dëgjohet: Nuk bën të vdesësh, Alo. Shoh se kam problem me gjysmën e fjalisë së re. Diku më kujtohet udhëtimi im i largët. I them: Nuk do të shkoj pa ta kthyer emrin, mik i dashur. E di se vuan për emrin tënd të humbur, por unë nuk jam fajtor. Kërkoj atë të vërtetën dhe, para se të shkoj, do ta lë aty ku mund ta gjeshe. E di ti ku? Alo, bre, dëgjoj mikun në një gjendje të gurëzuar. Nuk bën të shkosh. Brengën mund ta zëvendësojmë me diç tjetër. Zoti i kërkuaka për drejt të mirët, të bukurit... Kush tallet me vdekjen? Kap qerëkun tjetër të fjalisë më të re të mikut. Më bëhej se, ajo ishte fjalia, që nuk e kishte kryer. Se unë kisha nxituar: Kënaqesh të kesh emrin Bajram? Të rri bukur. Kundërshton: ma kujton Bajramin e Taphaneve. Para kasaphanës dëshironte t'i mprehte thikat. Të tillët i duhen kohës, mik - i them. Dua një emër më fisnik. Frymëmarrja e tij ishte përplasur për muret e dhomës sime. Do të thotë, emër perëndish? Ngjashëm, disi. Dhe, më ik nga dhoma e teli me një fjali të plotë: Do të pimë nga një kafe? Gjithsesi. Fantastike është kjo: një i gjallë e një i vdekur tamam si në legjendat tona ulen aty skaj Alesë së Shpëtimtarëve të Kombit e llafosin edhe për fustana. Vetëm të mos u bie në vesh shkarravitësve se na vjedhin idenë. Shkuli telefonin. Kotem. Pas ca ditësh më falënderon për emrin e ri. E kishte gjetur aty ku ishim marrë vesh. Por unë ende nuk kisha udhëtuar. U gëzua: Për këtë sihariq nuk mjafton kafja. Dakord, mik i dashur. I bukur është emri i ri, por Alo, nuk bën të shkosh... Unë mbath këpucët. Dal në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit, t'i shoh si frymojnë të gjallët...

VENDLINDJA NË DY GOZHDA

Ndryshe e kisha parafytyruar Gucinë. E shihja të varur në dy gozhda në një mur të lartë. Më vinte inat: asgjë nuk kishte nga ëndrra ime. Po majë e Ali Pashë Gucisë, Jakup Ferrit qenkan përralla?!

Piktura e varur në dy gozhda zbulonte edhe revoltën time dhe imagjenatën e bujshme të krijuesit, i cili brenda një kuadri ishte përpjekur të ngrijë lavdinë e një pëllëmbë toke. Nga historia e gjeografia kombëtare Gucinë e kisha parë si një majë në mes majëve të dheut arbëror. Edhe pse kurrë udha nuk më kishte qitur andej, më bëhej se çdo gjë të saj e njihja: edhe grykat, edhe njerëzit, edhe kullat, edhe hijet. Pikturën e varur në dy gozhda, tani e shihja si një realitet, që shkakton tërmete? Aty-këtu mbi qilimin e gjelbër të rrafshnaltës së vetmuar e të zbrastë piktori kishte pikasur edhe ndonjë lis apo krah zog, që shënonin megjë are, apo i bënin hije ndonjë varri të harruar. Po ku janë majët, kullat? E pyeta pasi e kisha zbratur me fund gotën. Piktori vetëm lëvizi dorën nga piktura: Aty! Pëshpëriti diç, që vështirë e kuptoja. Fjalët e tij u ngjanin shumë pak fjalëve të gucianit nga Velanija, të cilin kur e rrok malli për vendlindjen, shtrin shuplakën mbi një tavolinë. Me një dridhjeje buze pëshpërit: Kaq ka mbetur lavdia! E sheh ky gisht? Vazhdon ai. E ka mbuluar Gërlën. Ai Dolin. Fundi i gishtit tregues ka mbuluar Limin, Vrujën, Ilinkën. Pak në të djathtë, nuk di a po i sheh? Rrjedh Bistrica, pastaj ai lumthi, i cili brenda dite del e shuhet nga një varr. Ndërkaq, nën pjesën e sipërme të shuplakës sime janë majet, kullat, grykat, të cilat ti po i kërkon nëpër fjalë e libra. Pak më tutje është ajo vija e zezë, e cila na ndan nga fluturimi i lirë i orlit. Dhe, kam vërejtur, miku im Velanija, s'e thotë një fjalë më tepër. Aty çdo gjë merr fund tek vija e zezë...

Shikoja pikturën e varur në dy gozhda dhe kujtoja poezinë “Vendet e shkombëtarizuara” të Kadaresë, fundin e çdo tragjedie: *Ku janë baladat, eposi, kujtesa e kombit?* Piktura më kishte nxjerrë jashtë vetes. Atdheun e përcaktuaka dhe gjuha. Lëkura ime, bën për një daulle?

JARGAVANI I PËRGJAKUR

Kërshëria tregonte diçka tjetër: fshehtësinë e gjakut. Nën qiellin blu të Stambollit buzëqeshje e duartrokitje i kuptoja si shkundullimë shpirtërore, të zbulimit të vetvetes - se kërkonin atë që u mungonte.

Ndoshta ishte hera e tretë që kremtoja Dy Korrikun jashtë Atdheut. Tek përcillja një valle lashtësie jataganësh, qiellin e mbrëmjes së vonë e kishin përzhitur fishekzaret, të cilat nuk i lënte të fikeshin mbasi zjarr u jepte një xixëllonjë e padukshme. Kisha lëvizur vendit. Valltarët i afroheshin fundit me një ritëm të shpejtë, final. Në stadiumin e madh kumbonte fjala Kosovë. Mesazhin e kisha të qartë edhe pse nuk dija një fjalë nga gjuha e Nazim Hikmetit.

Gojë më gojë ishte endur Kosova. Diç e shenjtë. E madhërishme. Me nishane e varre... E kisha mbështjellë dikur në një shami Hasi dhe e kisha futur në gj. Fishekzaret sajnin figura nga më abstraktet në qiellin blu, ku lexoheshin edhe si hieroglifë të fatit tim. Pastaj xixëllonja e padukshme kishte kaluar Grykën e Bosforit, duke bartur zjarrin me vete dhe kishte rënë një fashë zgurdulluese.

Ç'koincidence! Ditët Poetike të Ballkanit mbaheshin edhe në kuadër të vetë simbolikës së lules së jargavanit. E, kjo më kishte kthyer në fëmijërinë time, aty te dritarja e shtëpisë sime, e cila fshihej nga një trup luleje, që me erën e vet mbushte oborrin e dilte edhe tej. Në mes degëve të dendura strukësia shpesh kur bëja ndonjë faj. Ato formonin një kurorë të kaltër. Nëna frikësonte t'i shkundë. Unë mbështillesha rreth drurit të lules derisa nënës i kalonte hidhërimi. Nën dritën e fishekzarave më shfaqej lulja e fëmijërisë. Në majë të gishtërinjve isha ngritur. Nuk mund e arrija dot. Stambollin nisa ta dua edhe për shkak të saj.

Isha endur nëpër turmë. Kisha vërejtur pastaj se në dorë mbaja një jargavan. Fatkeqësisht, ky ishte i përgjakur. Në një dritare të kaltër të qytetit një vashë kishte mbyllur sytë. Me siguri ishte e gjakut tim...

(Stamboll, 1998)

POETI NGA DIASPORA

As vetë nuk e dinte si ishte përbiruar deri aty. Poshtë e lart i kishte rënë mëmdhethit. Çmallur bile edhe me... si kanë zakon të thonë ata të diasporës. Pakkush kishte besuar. Vërtet ai kishte ardhur pas disa vjetësh jo siç thoshte: pas vdekjes. Kishte zënë vend në një kafiteri. Ka mundur kjo të jetë në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit ose te Pleçnarët e Kombit. Me gjasë, e fundit. Kishte pyetur: Ku është Mirko Gashi, Anton Pashku, Azem Shkreli? Më ka marrë malli t'i shoh. Bashkëbiseduesi habitshëm e kishte shikuar, me një lëvizje dore në ajër dhe pasi e kishte zbrazur edhe një gotë, i kishte thënë: E ngremë edhe nga një për shpirtërat e tyre! Poeti nuk e kishte kapur mirë reagimin e tij. Kishte vazhduar të përmendë edhe ca të tjerë. Edhe një gotë kishte ngritur ai krejt i ndezur në fytyrë dhe iu kishte drejtuar të ardhmit: Këta që i përmendët mund të kenë jetuar në mileniumin e kaluar. Pikëllueshëm kishte shtuar Poeti: Para ca kohësh kam pirë me ta. E pamundur kaq shpejt të kenë shkuar! Bashkëbiseduesi kishte murmuruar më tepër për vete: Mund të jetë, zotëri. Por kjo ka qenë moti ndoshta.

Poeti kishte vënë ca gjëra përsëri në çantë. Mezi e kishte gjetur derën. Një fjalë nuk e kishte thënë më. Ishte bindur se nuk kishte aterruar aty ku duhej. Bënte vapë. Nëpër malin e gjallë kishte kërkuar një hije, ku t'i varte ato pakëz gjëra, që i kishte sjellë nga Evropa. Më vonë zjarri ia kishte djegur edhe malin. E pashë një ditë në TV pranë zotërisë nga Amerika. Marshonte kushedi se ku. Unë kërkoja fjalë për Sinfoninë Shqiptare. Të them atë, që kishte harruar në të nëntën pa e thënë austriaku. Edhe në ëndrrën time marshon ai. Thonë se përgatitet për ripushtimin e Trojës...

Buzë Ujit të Madh Homerit ishte endur dhe kishte dëshmuar se njëri nga fëmijët e Zeuzit është edhe Dardani.

KLITHMA NË ËNDËRR

Bindi ishte i pari. Gjendesha diku në Cepin Verior të Ilirisë, të cilës nuk ia shihja fytyrën tamam nga bardhësia e pafund verbuese. Nuk di edhe sa kohë më ndante nga Uji i Madh, ushtima e të cilit dëgjohej kudo rreth meje. Bardhësia më kishte pushtuar. Ndjeja dhëmbin e saj edhe në asht. Tinëzisht më kafshonte si kafshë e uritur. Në ballë të rrëpirës hija ime m'i ngjante një cungu, i cili rrokulliset herë pas here nga lëvizje të panjohura. Bindi ishte një kokë mbi fatin. As ai nuk mund bëri gjë.

Ushtima e Ujit të Madh rritej, bëhej e padurueshme. Unë ndërroja hapa dhe nga cilado anë që kthehesha hijen time nuk mund e kaloja. Pas një copë udhe e pashë se edhe ajo ishte tkurrur, ishte shndërruar gati në një pikë të zezë. Nga larg i ngjante një pulle, që përthekon diç dhe e cila priste një dorë magjike ta hapë ose ta fshijë përgjithmonë; hapësira të dukej krejt e bardhë, fund e krye.

Bindi kishte zgjuar erërat në thellësi. Valët gati sa nuk më morën me vete. Përgjatë trupit e fjalëve e ëndrrave ndjeja ajrin e ftohtë, që më mbështillet çuditshëm. Kishte kaluar atëherë e Bukura e Dheut dhe Bindi, që ishte një kokë mbi fatin. Ja kishte hedhur mollën nga dega më e lartë. Qoftëlargu i kishte bërëtitur të Bukurës: Hedh atë mollë! Por ajo ia kishte kthyer të zotit. Bindi e kishte futur në këmishën e lirit dhe kishte përcjellë të Bukurën e Dheut, duke u ngjitur Malit të Mjegullës.

Te Kroi i Traboinit ishin përzierë fjalët me fishkëllimë erërash sa vështirë i dalloja të mijat. Kisha përvjelur pantallona e këmishë pas shumë vjetesh dhe kisha zbritur aty ku kishte pirë ujë Deda. Në rrasën e lëmurë pasqyrë, m'u aty ku thyhej uji me rrëmbim, kisha zbuluar konturat e një trupi, që nuk më kujtohej

se në cilin log e kisha parë. Nuk kisha arritur etjen ta shuaj. Kisha pëshpëritur emra e emra. Dikur si kokrra rëre i kisha flakur nga goja plot gjak. Kisha lënë kushedi sa bjeshkë e konaqe e ulërimë e vjet pas. Tek Ura, aty ku kishte rënë Isa, nuk kisha zemër t'ia shkel hijen. Kisha lakuar udhën dhe isha nisur shtegut të ri pas Bindit, i cili nxitonte nga Uji i Madh.

Ulciniumin më në fund e kisha shkelë. Isha ngjitur në një kep, ku valët e kishin përplasur liburnën time. Kisha lëshuar zë. Po Uji i Madh ishte në mes meje e fisit. Kisha këlthitur edhe në ëndërr, e cila ishte çarë dhe kishte fluturuar një zog qiellit. Atëherë isha mbështetur për një trup ulliri me këmbë në Ujin e Madh, i cili ishte bërë katran. As jehonën e fjalëve të mia nuk e dëgjoja më. Në ca fluska ishin shndërruar ato, që më kishin mbuluar të tërin aty të shtrirë gjerë e gjatë në rërën përvluese kur i zoti i lidhte erërat një nga një për degët e shkapërderdhura të Dheut të Ilirisë. Orën e blerë në Pazarin e Vjetër të Shkodrës, e kishte shikuar Bindi pastaj. Duhet kaluar Ujin e Madh! Ose, lëkurë për daulle dreqi. E shikoni? Lëkurë nuk kemi as për një daulle!

NËPËR ËNDËRR

BURGU I HAPUR

Po ku burgu i hapur në fund të shekullit XX?

Rendi i gjatë para xhenetit, po lëkura tepër e lirë. Deputeti gjumash duartroket vetëm atëherë kur serbezlëku paguan gjumin. Paguaji, baco, nëse nuk dëshiron të shikosh filma në color, thotë përqyrrani i Shkulës.

Burgu i hapur, projekti më gjenial i mendjes së errësuar, zhveshje e njeriut nga virtyti, shndërrimi i tij i ngadaltë në një fosile (para) historike. Ja, i gjori harron kahet e vjetët. Kycja e vetvetes vazhdon në mënyrë më perfide. Sillesh brenda hapësirës, ku thonë se ka liri me bollëk, por nuk ia gjen nishanin as në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit. Po qe se lëviz vendit, ndjen rreth vetes të rënat dhe gërrhamët e deputetit gjumash. Ta hajë dreqi, edhe këtij duhet duartrokitur për patriotizëm!

Gjithçka e hapur: edhe fyerja, edhe tortura, edhe hafijllëku...

Në fund të shekullit XX, si burgu i hapur?

Përpjekje të kota për ta zgjuar deputetin e fjetur dhe për të shkukur farën e dreqit, që dikush na e hodhi në oborrin therrak

derisa kënga jonë mbushej me gërrhamë. Me vjet të bindin se asgjë nuk të mungon; se liria jote ka masën e trupit tënd dhe më shumë nuk mund të të jepet sesa zë një sarkofag i gjetur rastësisht në Kameleoni.

Po lëvizjet? Ato janë për të ruajtur kondicionin e kaçakut. Këtë e kupton kur ballafaqohesh me murin e padukshëm, kur nis e përgjakesh nga koka te këmbët; kur e kupton se je i mashtruar, të bindësh pastaj se vërtet je i burgosur; të mungon liria se asgjë nuk ke bërë për të, por tërë jetën e ke imituar se je i lirë dhe ke dëgjuar gërrhamët e deputetit gjumash. Në dritaren gjysmë të thyer vë saksinë. Nuk di kur çel as kur venitet se, burgu i hapur nuk ngopet.

Në fund të shekullit XX, pse hyri në këtë tekst edhe burgu i hapur?

Babai thoshte burrëria në ditë të vështira, por burrëria tek Varret e Gjata. Kalon pranë xhenazeve dhe të shurdhojnë me refrenin banal: Sistemi ynë është më i përsosur. Deri në një t'i mësojnë urtitë nëse nuk dëshiron të ndjeshë kafshimin në lëkurë. Orientimi: Maja e Kakudrës. E burgu i hapur vazhdimisht gëlltit. Lëviz, marramenthi. Brenda tij e bën vdekjen, frymon: A më dëgjoni ju atje, oreee? Ta bën dikush me dorë se çdo gjë paguhet. Kondicioni ende nuk të ka lëshuar. Kapërcen edhe Malin. Të ndjekë drita e kuqe, e cila buron nga brendia jote. Mbështillesh në të dhe fare nuk shihesh në burgun e hapur. Tebdil, thonë, na u bë. Djersitesh se don të ekzistosh. Nuk harron se mjeshtri është të jetosh në pisllek. Pas një ëndrre të keqe, të zgjojnë britmat. Vetëdija nuk të lë të qetë: Ke qenë dikur gur Kulle! Të shkundullon. Jashtë lëkure e prek veten: Je një copë mish. Bindesh se nuk jeton vetëm për vete. Në një pus aty hedh kovën: Ujë, ujë, ujë... Në dritare të thyer ujit lulen në saksi. Të kujtohet Nëna. Vrapon, as vetë nuk e di nga. Merr goditje të re. Nën kupolën e shurdhët dëgjohet ajo. Boshllëku yt të tmerron. Bindesh më në fund se me vjet eksperimentohet me ty në

laboratorin më të çuditshëm të projektuesve të burgut të hapur. Nga bindjet, nuk di të kujat, se ti je i lirë dhe mund të jesh i lirë, vepron kundër lirisë dhe vetvetes tënde, që zgataraqet deri tek tehu i thikës së Trimtucit. Një ushtri gati për ta bartur kokën rrugëve të kasabave.

Më vonë kupton se nuk ngrihet dorë aq lehtë, se liri ka me bollëk (ashtu thonë) dhe atë duhet gjetur në burgun e hapur: Ku ke parë, more bacë, ta shesësh lëkurën aq lirë! Lëkura jote qenka më e trashë se e buajve të Drinisë. Lëre pash zotin, nuk mund e gjete ende lulen e xhenetit. Në shtrat prej puplave të quranave bën një sy gjumë pranë të dashurës, e cila të viziton vetëm në ëndërr. Ia sheh sytë. Të shndritshëm. Dikur i lotojnë. Qan edhe ti. Rrugët e kasabave vërshohen nga Uji i Madh.

Po ku burgu i hapur në fund të shekullit XX?

Nuk mund të mos pajtohesh se jeta jote nuk u ngjan pakëz përrallave. Do zëra të largët të trandin. Të merr malli ta dëgjosh prapë ndonjë përrallë, që nuk mbaron kurrë. Ulesh pranë vatrës. Shpërpush hirin. Ai ende flet. Para teje hapet. Konturat e humbjeve. Të vjen inat ajo që ka ndodhur. Nuk i buzëqesh as kutisë magjike, që e shtrëngon në kraharor. Vetëm ndjen se diç të djegë. Sheh duart, mish i gjallë. Kullojnë. E hap. Aty në fund të saj zogu. Brenda atij zogu dëshiron ta kërkosht margaritarin. Nëna të fliste për të pranë vatrës. Të kujtohet brisku në xhepin e vogël. E nxjerr. Në mënyrë solemne e hap zogun. Ai nuk bëzan. E kërkon margaritarin, i cili fillon t'i lëbyrë sytë me dritë. E mbështjellë me shaminë e Nënës. Zogun e qep. E mbyll prapë në kutinë magjike, të cilën pastaj e vë në krye të oxhakut. Ndalesh para pasqyrës. Vëren: Balli të lulon. Ta hajë dreqi, më paskan qëlluar.

Sheh se kalon nëpër rrathët e një përralle, që janë rrathë edhe të një ferri njerëzor. Brengosesh pse projektuesit e burgut të hapur materializojnë çdogjë tënden: edhe vuajtjen. Përreth teje kënaqësi shtazarake e butakëve, që dridhen kur Trimtuci duket

atje në fund. Në skaj të shtratit shtrihesh me vesh të mbyllur. E dashura e paska harruar syrin e gastartë! E mbyll në shuplakë të përgjakur. Nuk lejon ta therin. Fatkeqësi është të besosh se të gjithë të ngajjnë ngapak; se edhe njolla në këmishën e bardhë të Trimtucit është e rastësishme. Ta hajë dreqi edhe këtë. Këlthet në burgun e hapur, i cili i ngjan fytit të hatashëm e të errët të një peshkaqeni të nxjerrë në ranishtën e Ujit të Madh.

Ora paska kaluar pa i dëgjuar tiktaket e fundit. Më në fund zbulon, as në burgun e hapur nuk je vetëm. Këtë ta thonë denoncuesit. Aty shtohen edhe projektuesit famëkeq, të cilët i la durimi. Nuk patën fat të shohin aktin e fundit të Vdekjes sate solemne në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit. I kishte tradhtuar mjeshtria, që u shndërrua në një pikë të zezë. Ajo gërryen edhe burgun, edhe plehun. Projektuesit e fatit tënd dalëngadalë humbin në atë pikë që zmadhohet vazhdimisht. Ka filluar t'i vjen çdo gjëje era mut. Edhe saksisë në dritare të thyer me një lule të vyshkur, e cila nuk kundërmoi asnjëherë. Pa britma, pa përgjakje, pa reprezalje nuk të kalon dita. Dikur të plasë gazi sapo ta zë veshi bisedën jashtë mureve të padukshme: Deri kur Kosova të merret me Serbinë? Serbia a do të lirohet nga Kosova? A do të ketë ndërhyrje të forcave të NATO-s? Serbia mbetet problem i brendshëm i Kosovës. Serbia krahinë e Vilajetit të Kosovës. Pashallëk. Votohet për Karasinan Pashën...

Në dritare një zog i zi. E tremb me një pordhë ariu. Nga kapixhiku i një përralle hyn e dashura me sy të shkruar, ku vështirë i dallohen lotët. T'i lidhë plagët. Të nëntat. Dikur nga shuplaka të rrokulliste margaritari, të cilin e zë ajo pak pa hyrë në një vrimë miu. E heq nga qafa shaminë. E mbështjell. Del vrap, zbathur në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit. Ju kumton lirinë robërve.

Në istikame të Kameleonisë ndërrohen vetëm flamujt.

Ti nuk je më. Dikush tjetër. Nuk të dhimbset asgjë se mbylle burgun. Dhe fillon koha e përrallave: Paguaji, baco, nëse nuk dëshiron të shikosh filma në color. Gjumashit i del gjumi cipërdoncullak në dyqanin e antikitetit dhe...

Aty-këtu ndonjë e dhirë mini dhe lëkura e gjarprit e varur diku në hyrje të Alesë së Shpëtimtarëve të Kombit. Të na ruajë Zoti nga syri i lig, që shëtit dherave të Arbërisë...

(1994)

RRËNIMI I TEMPULLIT

Të gjallët dilyn e hynin në tempullin, i cili gjendej karshi kodrës së zhveshur deri në rrënjë. As për një centimetër nuk dallonin njëri nga tjetri. Kodër e tempull kishin një shtat. Sa herë dilja në majë, mund të kaloja me një hap në tepën e qelafit të kodrinës. Ky mashtrim optik kishte zgjatur disa vjet. Sapo u shfaqën minjtë dhe nisën të shumohen në akuariumin tonë, siç e quanim edhe ndryshe tempullin, u pa se nuk ishte fundi larg. M'i ngjante Kullës së Pizës, përditë e më shumë, Kodra ishte larguar kushedi sa hapa. Gati e kishte kapërcyer edhe Llapin. Brenda hapësirës lëvizte çdo gjë në mënyrë të çrregullt. Ishte prishur harmonia. Kollitja e rëndë e ashensorit bëhej e padurueshme.

Kur kumtuan se duhet braktisur tempullin, se ç'më rroki një gjumë; dëshiroja të kaloja edhe sa kohë. Kisha zënë vend në një kënd. Por syri i Kronistit më përcillte gjithkund dhe hallakamë shkonte në tempull. Askush nuk dinte se ç'ndodhte. Dhe nuk di cila ditë ishte kur u gjeta ballë ashensorit. Për drej, saherë e shikoja atë, ma kujtonte një tregim të Dino Buxatit. Kisha pritur gjatë dhe tërë kohën miku më kishte folur për ca libra të vjetër, ku bëhej fjalë se minjtë i tremb tingulli i kavallit. Nga një arkë nxori atë. Më tha se e kishte dhuratë nga një bari Sharri. Prapë e vuri në vendin e mëparshëm, ku shpesh gishtërinjtë e Kronistit përziheshin. Thonin nëse djallit i shpëton, atij nuk i huq. Kishte nuhatje të tmerrshme. E zinte edhe mizën në fluturim.

- A di çka, nun? - foli më plaku - Tempujve dy gjëra u kanosen: minjtë dhe kronistët - kishte pushuar pakëz, me gishtin e verdhë, duke shkundur shpuzën e cigares në shuplakën e dorës së majtë. - Minjtë na i hanë fjalët, librat, ëndrrat... Kronistët na mbulojnë me pluhurin e fjalëve, të librave, të ëndrrave...

Dhe ishte zhdukur sa çel e mbyll sytë. Kalli qëndroja përballë ashensorit. Në mes tij e meje lëvizte hija e Dino Buxatit, buzëqeshja e tij sarkastike. Dhe disa herë ishte hapur e mbyllur dhe prapë ishte hapur e mbyllur. Ciatjet kishin mbushur tempullin. Më vonë ishin rrëknyer me një ushtimë të fortë atje poshtë. Shkallëve isha lëshuar. Me ata pak të gjallë që kishin mbetur, nuk di se ç'kishte ndodhur më tutje. Tempulli kontrollohej plotësisht nga minjtë.

Kisha harruar edhe më të dashurit kur më doli para Neli. Në buzëqeshjen e tij ishte zgjatur hija e mejtit. Dikur më tha se kavalli i kishte mbetur në tempull. E shikova me një gaz të hidhur:

- Nuk do të bënte punë. Minjtë janë shumë...

Ai lëvizi kokën në dyshim. Hija e tempullit ishte bërë cubel. Gati nuk ishte shembur. Fundi apo fillimi ishte i kronistëve të marrë? E venerova këtë tek kur syri ma kapi ashensorin e tmerrshëm, i cili kishte dalë si bole e tharë e dashit. Qëndronte varur për një re të zezë, jashtë fuqisë sime.

ÇANTA MAGJIKE

Çdo gjë ka mundur të ketë përfundim më fatlum. Miku im nuk është çfarëdo. Ma kanë thënë këtë shumëkush. Brendejashtë. Bile edhe Leci e Cima, që vështirë japin mendime për njerëz të formatit të tillë. U bënë ca vjet e nuk kam pirë kafe me të. Kur kalon ndonjë “Benz” pranë meje, e di se i kujt është; sidomos kur shoh një dorë si lëviz në dritare. Ajo është dora e mikut tim. Nuk kalon pa më përshëndetur kur më sheh si nxitoj në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit. E lëviz atë derisa nuk shihemi, ose derisa dora i lëpohet për xhamin e zi të veturës.

Disi dora e tij ma kujton atë të një perëndie. Ishte nga Qyqekulla, bari i keq. Nuk e kishte hetuar dot si i derdhej Grigja. Por ajo që më gëzon, miku im nuk ka të përbashkët asgjë me të. I Qyqekullës u shfaqej njerëzve hijallë edhe pas shumë vjetësh. Kishte shkuar aq larg sa kush e shihte në ëndërr, nuk e kishte të gjatë. Leximi i shuplakës së tij të harruar në xhamin e dritares ishte bezdisëse. Tregojnë se ai farë perëndie i vizitonte bashkëqytetarët edhe në gjumë. E kishte dënuar rëndë një çift të ri sapo kishte dëgjuar se ç’pëshpëritnin në shtrat tek bënin atë punën: I dashur, populli nuk rritet pa ujë, i kishte thënë ajo. Do rritet, do rritet, shpirt - iu kishte gjegjur ky mbi një yll të gjallë. Dhe trupat ishin ndezur flakë për herë të fundit. Me vjet pret një Nënë aty tek Uji i Madh mos po i nxjerrë ata ndonjë valë e harlisur...

Fat është se te ne ka ujë me bollëk. Vërshon pa pushuar. Çudë, populli nuk shtohet. Pse? E di më mirë miku im, ndoshta, i cili hyn në kasabanë tonë çdo mëngjes me “Benzin” kur unë nxitoj të dal në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit për të dëshmuar se nuk është e vërtetë se ne shqiptarët kemi origjinën nga lepuri. Kur e dëgjoji këtë Lecit desh i ra pika: Qy, qy - bërtiti - A po dëgjoni? More, më mirë nga lepuri se nga majmuni. Do rrënonim

çdo gjë. Cima nuk ishte dakord. Me ditë zgjati debati rreth zbulimit më të ri të zonjës nga Evropa.

E kisha harxhuar edhe dardanin e fundit e Leci e Cima sapo ishin kthyer nga jashtë. Ma zunë pritën në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit: E dimë pse ka ardhur mustaqeziu nga Serbistani... Ç'ka po flet, bre? Ai na i ka sjellë çelësat. Po ashtu, e dimë pse ai miku yt e ka marrë kësaj here çantën më të madhe... Do të kemi zifafet.

Nuk dija cilin ta dëgjoja më parë. Kur e zbraza edhe gotën e fundit, u thashë: Le të mbesë në mes nesh. E di pse miku im këtë herë e ka marrë çantën më të madhe; po ashtu e di se ku i ka lanë çelësat mustaqeziu. Por kam frikë të tregoj se na zbulon armiku... Ishalla nuk na dëgjon ai me emër gjysmë jude e gjysmë sllav, tha Leci syçatalluar dhe pa e kryer mendimin ndërhyri Cima: Po kush rren, bre? Qumili - i thashë, papritur e kujtuar.

Prapë zunë vend në krye të Alesë së Shpëtimtarëve të Kombit. Pritnin se kur do të hapet çanta e madhe e mikut tim për të parë se a është e vërtetë ajo, që flitet nëpër kancelaritë e Evropës. E, ajo nuk është vetëm çantë. Ka diçka të veçantë. Dritat e saj farfuritëse moti ua kanë marrë sytë tërë një populli të rraskapitur, i cili çdo ditë pret e përcjell një "Benz" si hyn e del në kasabanë tonë plot mend e shend...

Pak më parë mora një letër. Zonja nga Evropa aty shkruante edhe këtë: Nuk kam besuar se jeni popull ujk. E tmerruat edhe zotërinë nga Amerika. Buzëqesha me lot në sy. Kisha humbur në mes varreve të panumërta aty në fushën e mëllenjave, ku nuk dihet - ngryset apo agon...

NËPËR ËNDËRR

Njerëzit kishin humbur edhe saktësinë e kohës.

Edhe pak kisha deri të Shtëpia e Zotit. Dy orë i ka - na thanë atje në rrëzë. Ikte ora e katërt e Abazalia nuk shihet. Në jetën time kurrë nuk kisha sharë më shumë se atë ditë. Isha tamam një karrocier. E, ngjiteshim të shihnim Shtëpinë e Zotit. Gjarpëronim lugjeve të panumërta si komitët pa kapuçë. Gazika e vjetër kineze tërfaste si një kafshë e këputur. Na shtrëngonin përreth bjeshkë të zhveshura pa asnjë hije, te qelavta, gungore me një ngjyrë të rëndë guri, e cila ndërronte nuancat pas çdo kthese. Kisha të drejtë që shaja: dora e njeriut nuk kishte ndërtuar asgjë. Vetëm bunkerë të panumërt lëviznin si sy të gjallë.

Gazika e vjetër kineze mezi përbirohej xhadës së baba sulltanit. Nja tridhjetë km deri në shokë të Malit i bëmë hiq më pak se katër orë. Njerëzit kishin harruar edhe kahjet se çdo lidhje me Zotin kishin ndërprerë dhe nuk di a e kishin parë bile në ëndërr. Shkilmim të njëjtën udhë, që kishin bërë Naimi, Noli e burra të tjerë. Por asnjëri nuk kishte arritur në Majë. I kishte lënë fuqia apo iu kishin frikësuar lartësisë? Nuk ia kishim parë fytyrën Zotit as kishim pirë ujë në kroin e tij.

Abazalia ishte endur kodrave, duke biseduar me shpesë e rrufe, herë-herë kryemëkrye i kishte tubuar majët dhe u kishte pëshpëritur diç. Supozohej se Hirësia ishte ankuar dhe kishte qitur menç ata, që kishin kënduar për të. Pak realitet, pak frymë, pak bekim kishte nëpër fjalët e tyre.

Ecnim disi si nëpër ëndërr. Filozofi kishte rënë në mendime: Diktaturat gjithkund janë të ngjashme - thoshte. Së pari i ngrisin tempujt vetes e pastaj mendojnë për milet. Poeti i përflakur bënte me dorë: ja deri këtu ka arritur Naimi, ndërkaq atje Noli. Biseda e tij ishte pakëz e përçartë. Me atë psehun e tij,

siç dukej, merrej filozofi. Unë isha ndarë. Më tërhiqte një forcë e padukshme. Mali nuk më dukej as një pëllëmbë më i lartë se Ura e Shenjtë.

Dikur ishte shpëluar Tomorri. Së pari ia pamë flokun e thinjur, pastaj filloi t'i nxirrte edhe gjymtyrët e tjera. Një pas një i pushtonim kodrat. Ciatje e shpesëve na përcillte. U shfaq më vonë një shqipe e mbërthyer në ajër. Lëvizte çudshëm. Nuk mund i shkoqem më sytë nga ajo. Me krahët e mëdhenj na kishte mbuluar tërë kohën. Kishte gati një orë, që e kishim lënë gazikën e vjetër kineze me zorrë të nxjerra aty të një bërryl i Malit.

Tek një pishë nuk e pashë më Zogun e Kombit. Mbi trupin tim të dërrmuar ishte shembur një shqiponjë tjetër. Nuk ishte as sirenë, as floçkë. Ishte diç e gjallë prej gjakut e mishit. Me flokë të gjata më kishte mbuluar mua Konstantinin, që kisha braktisur varrin tim të gjallë. Dikur më zgjoi zëri i Poetit. Ishte bërë rrëmujë në shtypin e majtë pse nuk e kishim marrë edhe Dritëro Agollin. Udhëtimin do ta bënte më të lehtë dhe më antik. Ç'kishim faj? Logjika shqiptare nuk ishte liruuar ende nga paragjykimet partiake. Ne ishim ngjitur atje pa parti për ta takuar Zotin tonë, të cilit nuk ia kishin ndërtuar një dhiare bile!

Parafytyroja Avenynë e pestë në Nju-Jork, sheshet e Parisit, të Vjenës, të Bonit, të Pekinit, të Moskës; Omoninë e Sintagmën e Athinës. Ku mund të inkuadronim sheshin e Zotit tonë? Çështje u bë më vonë: Tynzot mos e kishte harruar gjuhën shqipe?

Nga një ndërtesë e ulët pamë një re të bardhë, e cila u ngrit telartë. Veneruam pastaj se dikush dilte nga ajo. Për pak kohë u shurdhua Maja: Abazalia ishte ulur në një shkëmb guri. Kishte tretur shikimin kushedi ku; kërkonte ndoshta Zogun e Kombit. Ne ishim ngritur pa frymë, kush vrap e ca në bërryla. Kishte vrapuar edhe ajo vasha me flokë të gjata, e cila nuk ishte as sirenë, as floçkë. Ma kishte zgjatur dorën. Rrokadylas ishim shembur para këmbëve të Zotit.

Ishte hera e parë që takoja Zotin tim. Shumë më i ri ishte se zotërat e tjerë, që murmuronin rreth nesh. Nuk e kishte lënë as

fuqia. Një gjysmë shekulli e kishin mbërthyer atje lart. Një dhiare nuk ia kishin çelur. Më vonë vërejtja se kishte nisur t'i rrudhë sytë. E luta vashën të m'i kthejë syzat, ta shpejtojmë Hirësinë nga verbimi. E mora për dore atë dhe u nisëm në tempullin nga kishte dalë pakëz më parë ajo re e bardhë.

Para muzgut u lëshova tatëpjetë Malit. Në bërrylin, ku gërrhatte gazika e vjetër kineze më arritën edhe të tjerët. Prapë ishte dukur Zogu i Kombit mbi ne nga i cili nuk mund u shkëputëm më. Më kanë treguar pastaj se gazikën e vjetër kineze e kishin gjetur të varur për një tra të Demir Zykos tek këndonte ky Urën e Qabesë. Vasha e bukur e kishte nemur se nuk mund na arriti në shkretëtirën e ëndrrës...

Njerëzit kanë problem më shumë me kohën se me zotrat.

(Uji i Zi, 1994)

BUKURIA ME SYZA

Nuk ia pashë më sytë. I kishte fshehur pas syzave. Ç'e kishte shtyrë të veprojë kështu, nuk e di kush. Nganjëherë mendoj se ka dëshirë të lozë symbylltas dhe të kapë në terr ndonjë flutur. Pra, nuk besoj se ajo është miope. Kishte vënë distancë në mes vetes e botës. Guxo e ma prek majën e thonit. As është e vërtetë se dëshiron të ruajë paqjen. Shihet se është idhnake. E mbyt në vete revoltën e pathënë. E hetoj këtë kur nis të flasë, duhesh t'ia nxjerrësh fjalët me danë.

Në fillim ia pata lakmi. Më vonë nisa të ndiej ftohtësi. Megjithëse nuk bija në kurthin e saj. Krijova edhe unë distancën time. Nga larg e lexonim njëri-tjetrin tani. Më mirë ishte kështu ndoshta, se nuk ia shihja më sytë. Dikur çova dorë edhe nga gjysmëbuzëqeshja e saj. Por, si më shikonte përmes syzave ajo? Ndoshta si re, që mbulon malin e që duhet shpërbërë për ta vazhduar udhën krejtësisht kalli. Kryesore, ajo i kishte fshehur sytë. Gjelbërimi i tyre sa vinte e terrohej edhe më. Brenda syzave çonte jetën e vet, e cila kishte batica e zbatica të papritura. Edhe kur rraploja derën, nuk mund e hetoja dridhmën te ajo. Kisha përshtypjen se nuk i interesonte fare se ç'ndodhte përjashta. Leximi i syzave të saj ishte shndërruar në lexim hieroglifësh. Nga aty kontrollonte me siguri edhe planetin e panjohur rreth vetes.

Ndodhka njerëzit të mbyllen në fortifikata të padukshme, mesjetare; të bombardojnë nga aty, të kallin datën për kurrgjë send. Tej xhamit shihja edhe shtresimin e akullnajes nëpër fjalë, tëhujësimin në mes botëve, që duken e nuk shihen si sytë e saj. Por ajo?

Në majë të hundës së drejtë, pakëz picigjate, i rrëshqitnin nganjëherë syzat. Ato m'i kujtonin dyert e rënda të Kështjellës, të cilat hapeshin e mbylleshin monotonshëm derisa kthehej i Madhi.

Por kjo vazhdon t'i fshehë sytë. Rreth gjësendeve vetminë e derdhur fillova ta zbuloj përmes prekjeve tamam si ai poeti i verbër nga kohët antike. Kryesore, ajo i kishte vënë syzat dhe nuk kisha më ku ta shihja veten. Krejt tjetër ishim tani. Hapemi e mbyllemi secili me çelësin e vet të panjohur. Unë këndeje dritës, ajo andej hijes sime.

Ajo është pjesa tjetër e planetit tim të braktisur. Unë jam vetëm mbledhës i gjërave të rralla, sajues i mozaikut, ku hijon edhe ajo gjysmëbuzëqeshja dhe çerpiku i saj krah dallëndyshe, që nganjëherë nuk mund e hetoj fare pas xhamit të errët. Shoh se pa syza ajo nuk mund ta paramendojë edhe pjesën tjetër të udhëtimit në ishullin e vetmisë. Diku aty krijon edhe imazhin e vet pikëllues, se nuk ka kush t'ia thyejë dritaret e mbyllura. Tek shikoja atë, isha zhytur në vetminë e saj, të cilën e lexoja edhe si frikë apo zhgënjim; si ndonjë thyerje të tmerrshme në të; ndoshta edhe si kokëfortësi të heqë dorë nga gjithçka; të mbetet brenda vetes, e akullt... Bukuria paska diçka edhe të gjarprit!

Pse i vuri syzat? Alegori tmerruese: bukuria me syza. Duhesh bredhur jashtë vetes; të ngjitesh Malit të Shenjtë; t'u biesh të gjitha këmbanave; të giesh Ujkun e ta vrasësh; ta sjellësh Floçkën... Syzat nuk i heq as tani. Unë harrova si dukem. Hijet dendësohen përreth e lisat shpërngulen në bebëza të saj të zgjeruara, aty pas xhamit të errët. Nuk dëshiron ta sheh edhe anën tjetër të planetit, që përditë humb udhën rreth saj, as të kalojë kohën tjetër në një amforë.

Rri pip në këmbë para bukurisë. A do t'i heqë syzat, t'ia shoh sytë e gjallë?

GUASKA

Dikur ishte shfaqur Shkretëtira dhe kisha dëgjuar vajin e Burrit të Dheut. Kisha përvjelë pantallonat dhe isha nisur pas zërit të fyellit. Uji i Madh kishte nxjerrë një guaskë nga fundi i mistershëm. Fillova ta hap. E pamundur. Guaskë pas guaske hapja duke zbuluar fatkeqësitë e dherave të Arbërisë...

(Vlorë, 1992)

SHËNIM

Këto tregime mund të lexohen edhe si shkrime diskursive.
Janë shkruar kur më ka mundur zjarri...

Ulpianë, gusht 1998

A u t o r i

HARAKIRI

(ESE, SHËNIME NGA ESNAFI DHE NJË MINIROMAN)

Rilindja, Prishtinë, 1999

JU FALËNDEROJ PËR DURIMIN AKADEMIK

Fjalët

Ne poetët jemi soj pakëz i çuditshëm, përçues e transmetues të mëdhenj të fateve njerëzore. Nga fjala duam të krijojmë mrekullira, të pamundshmen. Kur e them këtë, kam parasysh krijuesit e mirëfilltë, që shkruajnë *poezinë e pastër* e që nuk janë të paktë në letrat shqipe. Borhesi thoshte se përmes dy-tri simboleve mund të shprehet një histori e tërë njerëzore. Ndërkaq, plakushi ynë tekanjosh, bard i poezisë sonë moderne, Lasgush Poradeci, e përsëriste vazhdimisht se katër vargje vlejnë më shumë se katër romane. Të dy poetët e nderuar kërkonin: koncizitet, pastërti, mjeshtëri...

Pra, asgjë më shumë se fjalët nuk u nxjerrin probleme krijuesve. Janë të tmerrshme. Ata që nuk dinë të mjeshtërojnë me to, do ta humbasin betejën herëdokur; se fjalët kanë diçka magjike: janë të gjalla, lëvizëse, të pakapshme - nga filli i fjalisë deri tek arkitektura e një ngrehine poetike. Unë frikësohem kur ato bëhen kallaballëk, të zhurmshme. Nuk mund t'i inkuadrosh as në një fjalor xhungle, që shpesh kam qejf ta përdor kur thumboj shkaktarët e së keqes rreth nesh e në ne. Brenda fjalëve ndodh një havari; nuk bëjnë as për pozë, as për marketing. Mu për këtë nuk dua t'ju besdis se fjalët e kanë edhe kohën e vet kur thuhet ato. Neve ora gati na ka pushuar. Derdhet shqetësimi në ne dhe e ndjej: *si të ekzistojmë* në këtë katrahurë, kur bëjmë përpjekje t'i shpëtojmë edhe fjalët, që ka filluar t'u vijë era gjak, mortje. Për shkak të gjallimit tonë u politizuam, hoqëm dorë disi nga qetësia kabinetike.

Shekullin XX e mbyllim me një imazh mjaft trishtues. Në kujtesën tonë pakëz gjëra ruajnë freskinë. Dhe, bindem se nga fati tragjik krijuesi i mirëfilltë nuk mund të shkëputet, tradhton veprën dhe

idealin e tij. A bën të jesh spektator në një teatër absurd, ku çdo gjë jotja rrënohet? Dhuna pasionante shqetësoi edhe kokat më të ditura të kontinentit. Ti kujtojmë vetëm ca filozofë francezë, angazhimin e tyre njerëzor e intelektual.

Liria ime

T'i kthehem rastit për çka gjendemi nën këtë çati shqiptare. E pranoj se kurrë nuk më ka shkuar mendja se do të shkel në një kryeinstitucion kombëtar në një kohë të pakohë, të zymtë për qenien kombëtare, kur në tetik është gjithçka: edhe guximi, edhe dinjiteti, edhe morali, edhe kujtesa. Kohë më të liga nuk mban mend rodi ynë. Është kohë kur vazhdimisht duhet gërvishtur ndërgegjen se ç'bëj për fatin e një kolektivi njerëzor?

Edhe më parë kam theksuar se tani për tani, mua konkretisht më mungon hapësira jetësore – kulturore, historike; më mungon Itaka ime; qetësia, vizioni mos mbetem mal me mjegull. Më se esenciale shtrohen probleme të gjallimit, të refuzimit të dhunës, por edhe të arsyes si kolektiv: *a bëhet udhëtimi vetëm?*

Liria ime nuk është vetëm imja. U heq dyshimin se nuk tentoj të identifikohem me *popull, atdhe*; dy nocione të shenjta këto për secilin nga ne. Në shpinë nuk mund t'i bart, as kam guxim të vë monopolin mbi to: se unë jam populli apo atdheu... Si çdo krijues e intelektual yni përpiqem këto dy nocione të ruajnë kuptimin e parë, drejtpeshimin nacional; të mëkëmben vazhdimisht me gjak të ri, siç do të thoshte një poet yni. Nuk bëhet fjalë vetëm për ekzistencën e individit, zotërinj.

Në një kohë turravrap mortjeje, nuk di a mund të vihet monopoli mbi gjërat që secilit i takojnë e duhet të mbrohen. Mozaiku ynë kombëtar është aq i gjerë sa secili mund të vërë gurin e vet, shenjë. Fatkeqësisht, hapësira jonë është plot gërçe, nervoze; vazhdimisht tkurret si diçka e pazot. Komunikimi normal brendashqiptar thuajse është i pamundshëm, shurdhues; nënçmues se ka hile e refuzime kategorike. Gjallojmë në një hapësirë të shthurur e

që merr konturat e një apartheidi klasik: se u mësuam me dhunë, pa të nuk na shkon as biseda tek pimë kafe apo...

Megjithatë, nuk pranoj fatalitetin. Se nuk humbet çdo gjë kur një kolektiv njerëzor e ka fiksuar shkaktarin e së keqes. Shpesh më bien në mend ca mesazhe brilante nga tradita jonë. Ato duhet kujtuar e riaktivizuar vazhdimisht. Të bëhet kjo për shkak të guximit, kompaktësisë dhe qëndrimit tonë ndaj çështjes kombëtare. Në këtë shkapërderdhje të mbrosh gjuhën, shkollën, historinë; të çmosh e të respektosh gjenin krijues e librin tënd; të shënosh atë që është jotja, më së pakti ka të bëjë me nacionalizëm. Lëkura jonë e di çfarë është ai. As atdhetari nuk është të jetosh e të duash në mënyrën tënde, është dhunti; diçka njerëzore, madhështore që na takon e largon nga violence.

Nuk na është i panjohur as opcioni demokratik. E shoh si vazhdimësi të mendimit tonë demokratik, nisur shumë më herët ecejakeve të Kombit. Po ashtu, ky nocion nuk do të thotë se përfundoi; se nuk mund të korrigjohet-plotësohet me ide e forma. Bunkerizmi ishte i tmerrshëm për qenien tonë, shkatërrues, linç i vetvetes. E vetmja rrugë që na shpie te zgjidhja e çështjes sonë kombëtare mbeten proceset e reja shoqërore, demokratizimi ynë jo në baza farefisnore apo të bajraqeve, por si kulturë e komb i organizuar. Aty e shoh edhe mposhtjen e dhunës.

Kundër harresës

Ky tempull kombëtar, institucion jashtëpartiak, mund të ketë ndikim e të kontribuojë edhe më rreth shumë problemeve tona të pazgjidhura. Dua ta shoh edhe tani e tutje si përkrahës të pakompromis të proceseve ekzistenciale-demokratike mu për shkak të autoritetit që ka. Në të kundërtën, *dita* vazhdon të na kushtojë disa jetë: vritemi si qen pse duam të jemi ata që kërkojmë të jemi. Realitet ynë na u bë absurdi. Edhe për arsye të tjera, integrimi ynë në proceset e reja të Evropës është i domosdoshëm. Së pari, nuk mund të copëzohemi as të ballkanizohemi më. Dhe së dyti, nëse ekziston një

çelës për zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare, atëherë duhet ta shurdhojmë Evropën. Ajo e mban...

Në mbyllje të kësaj paraqitjeje, ku pakëz kokëfortë e arrogant isha ndoshta, apeloj në ndërgjegjen tonë: asgjë të mos na gëlltisë harresa. Vetëdijësimi ynë për atë pakëz gjë që arritëm ta shpëtojmë, mund të bëjë edhe çudira të tjera. Mund të kem qenë patetik, por të kërkosh të jetosh si kulturë e komb, nuk ka asgjë me patetikën.

Ju falënderoj për durimin akademik!

(Prishtinë, 6 shkurt '97)

(Fjala e mbajtur me rastin e shpalljes së anëtarëve të rinj të ASHLAK)

BIZONI I PLAGOSUR

DEMOKRACIA NË MËNYRË BALLKANASE

1.

Me gjasë në Monparnas të Parisit, shkrimtari i shquar Miguel Asturias kishte pyetur kolegun e tij, ambasadorin shqiptar: *A ka mjegull në Shqipëri?* Zotëria nga Tirana preras iu kishte përgjegjur: *Ka. Bile shumë.* Kaq mjafton te për shkrimtarin nga Kolumbia e largët të konstatojë se aty ku ka mjegull, ka edhe legjenda. Ky detaj e kishte intriguar një shkrimtar tjetër të shquar, Ismail Kadarenë, të elaborojë fenomenin e legjendave e të nisë librin e eseve “*Legjenda e legjendave*” mu nga ajo bisedë e rastësishme e dy ambasadorëve diku në Paris.

A ka vërtet mjegull në Shqipëri, gjegjësisht në Ballkan?

Në momentin e pikërishtëm në Shqipëri konfrontohen palët rreth konceptit të *demokracisë* - në mes dorës së fortë, pas së cilës nuk dihet se kush fshihet dhe të atyre me orientim properëndimorë. Pozita, si duket, kishte hapur portat më shumë se duhet dhe kishte qitur mendsh se edhe proceset e demokracisë duhet lëvizur - korrigjuar. Dhe, në mënyrën e vet, kishte bërë ndërtimin e shtetit, kuptohet se seleksionimi ishte më tepër negativ. Në këtë hallkë opozita u përqendrua dhe nisi marshimin e vet.

Mirëpo kjo që ndodhi në Shqipëri është çështje e brendshme e shqiptarëve. Kërkohej shtigje për ardhmërinë. Propaganda e fqinjëve vrapoi të alarmojë se, më në fund, nuk ekziston më *toleranca* në mes besimeve të shqiptarët dhe se konfrontohen Veriu violent dhe Jugu i rebeluar. Dhe se krejt kjo bëhej për shkak të *Zotit* dhe *Karriges*. Në një shkrim të hershëm kam theksuar, nëse Evropa duhet të mësojë diç nga shqiptarët, atëherë tolerancën e tyre fetare duhet vënë si lektyrë shkollore. Gabuan, pra, fqinjët e të tjerët se shqiptarët mu në respektimin e njëri-tjetrit janë më të fortë. E kanë të qartë se të tri besimet ndodhen aksidentalisht në hapësirën iliro-shqiptare. Për ta ekziston një Zot tjetër, pakëz më i lartë.

2.

Ptolemeu i famshëm kishte dëshmuar se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve. Nga një frustrim ballkanas, nga janë e kur kanë ardhur, shqiptarët nuk vuajtën asnjëherë, as nuk e ndjejnë veten inferior ndaj të tjerëve, konkretisht ndaj fqinjëve, që u derdhën nga Karpatet në hapësirën shqiptare, duke rrënuar çdo gjë që gjetën aty. Së pari, shqiptarët nuk e bartin *fajin* e serbëve apo të grekëve, që bënë gjenocid të paparë mbi të tjerët e sidomos ndaj shqiptarëve. Bosnja asgjë nuk është ndaj asaj që kishte ndodhur në Toplicë, në rrethinë të Nishit e në Çamëri në vitet 1878 e deri më 1945. Fqinjët tanë veriorë kishin proklamuar para botës se bënë luftë kundër forcave turke: në të vërtetë, ata digjinin, vritnin e shkatërronin çdo gjë të autoktonëve. Dhe së dyti, ardhacakët nuk mund të jenë autoktonë. Për rastin e parë kanë shkruar edhe vetë serbët, krimi që kishte ndodhur atje ishte ngritur deri në kult serb; për rastin e dytë dëshmojnë edhe shkencëtarët e huaj. Dhe, nëse krimi tregon shkallën e primitivizmit, atëherë ndiej dhembje për kryerësit e tij, të cilët nuk e kuptuan asnjëherë se kanë të drejtë të jetojnë edhe të tjerët. Pra, të tillët më shumë mbështeten në instinkt se në arsye.

Ne shqiptarët bëmë ca luftëra të përbashkëta kur iu kanos e liga Ballkanit. Por kur pushuan ato, për shkak të hegjemonisë, serbët cenuan vazhdimisht hapësirën shqiptare. Miku i madh i poetit anglez,

Bajronit, Ali Pashë Tepelena, feudali më i fortë shqiptar në shek. XIX me seli në Janinë (ky qytet gjendet tani në Greqi) në vitin 1804 kishte përkrahur forcat serbe kundër Turqisë, i kishte ndihmuar edhe për arsye se atyre u printe një i konvertuar yni i quajtur Karagjorgje. Në vitin 1821, po ky prijës kishte kontribuar për pavarësinë e Greqisë. Shumë luftëtarë shqiptarë, populli e historia greke i pranoi edhe si heronj të vet. Të kujtojmë familjet e mëdha - Boçarët, Merkuri, Shpata; ose fiset e përbashkëta shqiptaro-malazeze dëshmojnë se dhuna kishte qenë e rëndë ndaj shqiptarëve, konvertimi i tyre ishte bërë me teh thike. Për këtë vlen të shikohet vepra e prof. Zekeria Canës “*Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar*”, (botim i Institutit Albanologjik, 1997).

3.

Ajo që ndodh pikërisht në Shqipëri besohet se bëhet edhe me bekimin e ndonjë fuqie të madhe. Nuk ka nevojë të elaborohet ky turp, se është mjaft transparent. Fat është se në këtë kaos ballkanik u arrit baraspesha e popujve, me gjithë barbarinë ndaj autoktonëve. Po ashtu, nuk mund të fshihet e vërteta kush është ardhacak, kush i trilluar e kush autokton. Edhe grekët e sotëm mendohet se shumë pak t’i kujtojnë helenët e antikitetit. Ndodhën aty përzierje të mëdha popujsh. Viteve të fundit Ballkani ishte një teatër i absurdit. Do të kalojë kohë e nga kujtesa vështirë do të hiqen të bëmat nga Bosnja, Kroacia, Kosova, Jogurtrevolucioni serb, para së gjithash, solli popullin e varfër serb para humnerës. E zbuloi paranojën, patologjinë, varfërinë shpirtërore e civilizuese të tij. E dhembshme është kur ca krijues e intelektualë me orientim properëndimorë pësuan thyerje të mëdha mu në rrafshin etik.

Shqiptarët mbetën tolerantë jo pse nuk dinë të vrasin, por në etikën e tyre vrasja nuk simbolizon trimërinë. Mu për këtë ngjarjet më të reja në Serbi, shumëkush i përkrahu. Ekzistoi një proverb tek ne se kur digjet shtëpia e fqinjit, prite zjarrin edhe në tëndën. Demonstrimet e opozitës serbe (1996) u mbyllën me ca lëshime të pozitës, që nesër krejt lehtë mund t’i sanojë për shkak se opozita nuk u deklarua ende

për shumë çështje. Vërtet, ajo e hoq yllin pesërrembësh, simbolin komunist në Beograd, por nuk di a hoq diç nga hegjemonizmi e mitomania nga koka. Opozita serbe, po ashtu, a është në gjendje të pranojë se Kosova është tokë e okupuar nga viti 1913, siç ndodhi me Toplicën në vitin 1878. Djep i serbizmit nuk mund të jetë toka e huaj nëse aty ndodhi *Beteja e Kosovës* (1389), ku morën pjesë edhe popujt e tjerë; pra edhe shqiptarët. Këtë nuk e dëshmojnë vetëm dokumentet autentike të osmanlinjve, por edhe veprat madhore të Jozef von Hamerit, Jeriçekut etj.

Me rëndësi të dorës së parë është se shqiptarët kurrë nuk vuajtën nga mitomania, as nuk u mbështetën në të, sepse nuk kanë nevojë të dëshmojnë autoktoninë mbasi dihet dhe pranohet kjo tezë edhe nga shkencëtarët seriozë evropianë. Në momentin e pikërishtëm, ata absolutisht dominojnë në hapësirën “kontestuese”. Se janë properëndimorë, dëshmon një fakt relevant: alfabeti i shqiptarëve që e mbeti ai latin. Në vitin 1913, atë vit, kur Serbia aneksoi Kosovën, shkencëtari i shquar hungarez Nopçe thoshte: “se kusarët e egër (kështu na quanin fqinjët) derdhën gjakun për vite të tëra, që me alfabetin latin të ndahen nga kultura turke dhe të bashkohen me kulturën evropiane...” e fqinjët nuk e bënë këtë përcaktim as sot.

4.

Mjerisht atë që trillonte pseudoshkenca e fqinjëve vazhdon të ngjallet me moton se sllavët shpëtojnë Evropën nga islamizmi, i cili mund të depërtojë përmes shqiptarëve. Ngjashëm ishte vepruar edhe me gjenocidin ndaj hebrejve, duke e fshehur atë ç’kishte bërë Milan Stojadinoviq e që me pedantëri e elaboron këtë tragjedi njerëzore dr. Dilip Koen në librin *Lufta e fshehtë e Serbisë*. Mirëpo, kur një nobelist e shkrimtar i nderuar, siç është Ivo Andriq, shkruan elaborate kundër të tjerëve e posaçërisht rreth shpërbërjes së Shqipërisë, nuk mund të pritët një fat më i mirë nga Qosiqi e ndonjë mediokër. Pra, nuk është për t’u çuditur se pas ndonjë havarie shqiptarët të shpallen edhe si krijesa jashtëplanetare, që nuk kanë ekzistuar kurrë në këtë hapësirë.

Mendja e “shëndoshë” fisnore ç’nuk mund të bëjë. Neofashizmi nuk është pjellë e lirisë.

5.

Nën maskën e demokracisë është dëshmuar shpesh se fshihet edhe dhuna. Na tërheq vëmendjen për këtë jo vetëm Çomski. Pakkush beson se vendet e ashtuquajtura demokratike si Serbia, Mali i Zi, Maqedonia dhe Greqia lirohen nga dhuna e nuk do të ushqejnë mjediset e tyre, se shqiptarët janë element destabilizues dhe duhet t’u merret e drejta për të ekzistuar. Nëse as kjo nuk realizohet, të trillohet ndonjë ekzod ala kurdçe. Dhe nga ata që shpëtojnë të krijohet një material i përdorshëm për nevoja të jashtëzakonshme e jashtënjerezore. Është çudi, në fund të shekullit XX kur Evropa bën përpjekje për një bashkim, fiset ballkanike frikësohen nga shkollimi e vetëdijësimi i njëri-tjetrit. Dhe mu ky frikësim vë në dyshim proceset demokratike në vendet e lartpërmendura. Rrugëve të Shkupit e qyteteve të tjera dëgjon klithjet: *Dboma gazji për shqiptarët*. Hiq më pak raciste se ato kur dëgjoreshin dikur rrugëve të Serbisë: *Vdekje shqiptarëve...*

Njëri nga mësuesit shpirtëror të nacionalizmit serb, Vasa Çubriloviq, që kishte arritur të ketë postin e ministrit edhe në kohën e Titos, thoshte edhe këtë: “Në kohën kur Gjermania mund të dëbojë dhjetëra-mijëra çifutë dhe Rusia mund të zhvendosë miliona njerëz prej një ane të kontinentit në tjetrën, zhvendosja e disa mijëra shqiptarëve nuk do të nxiste luftën botërore”. Kësi egërsie ne kishim përjetuar: Toplica ishte zbrazur e therur deri në pulë. Çamëria ishte bërë hi. Shtrohet pyetja: A duhet të gjitha fatkeqësitë të fillojnë e të mbarojnë me shqiptarët?

Nocionin *demokraci*, fatkeqësisht, fqinjët tanë e kuptuan *liri* brenda fisit të vet dhe *dhunë* ndaj të tjerëve. Flertimi i Evropës dhe SHBA-së mund të sjellë zhgënjimin. Nuk bësoj se do t’i tolerojnë këta antireklamues të mëdhenj të demokracisë çfarë synohet nën një kulm të përbashkët të Evropës. Unë parandiej marshimin e nazidemokracisë.

Akademiku i shquar i Universitetit të Oksfordit, Mark Almond, në esenë: *Kosova: Miti në shërbim të agresionit serb* ku elaborohet zanafilla e nacionalizmit serb, dëshmon se në Betejën e Kosovës (1389) morën pjesë edhe shqiptarët dhe konkludon: Car Llazari mund të mos jetë sundimtari i fundit serb që ra në Kosovë. Fitorja në një betejë të dytë të Kosovës mund të dalë po aq iluzore si ajo më 1389.

Zjarri duket në Ballkan. Bëhet trishtues, i padurueshëm. Evropa duhet të veprojë, të mos e gjejë në gaf “loja” e demokracisë së fiseve ballkanike. Syri nuk e kap krejt ç’duhet parë. Mimikëria është e tmerrshme. I ngjan varrit më tepër.

E varre ka mjaft Ballkani.

(Kumtesë nga TAKIMET NDËRKOMBËTARE TË PEN-it të mbajtura në Bled nga 21-25 maj 1997)

RIDËNIMI

Shqipëria prapë u dënua. A do të ndëshkohen edhe shqiptarët? Ai që mban anën e të fyerve dhe është në gjendje të vdesë për ideal, ka të drejtë edhe të shajë. Krijuesit e njëmendtë janë më afër së vërtetës. E tjetër gjë është, a u fal kush sharjet dhe sa pajtohemi me ta. Ne u sakatosëm, duke përzënë xhindet jashtë vetes e shtëpisë. Katarza nuk pran kurrë tek ne, si duket. Apo një popull antik nuk mund të ekzistojë edhe pa një pikë gjak. A e keni vërejtur, as shtëpinë nuk mund e ndërtojmë pa therur bile një pulë në themele...

Koka e Ali Pashë Tepelenës

Kur përmend kokën e pashait të sertë, të kujtohet romani *Pashallëqet e Mëdha* i Kadaresë, ose zë ngadalë e në vaj këndon *Mora udhën për në Janinë*, e cila bashkë me atë për *Urën e Qabesë* bëjnë kulmin e tragjikës sonë. Por ajo kokë e prerë disi përditë më shikon nga një kënd i dhomës sime, që me plot drithmë e vara aty një ditë.

Tabloja është punuar nga Skënder Kamberi, piktor vlonjat, i cili nuk mban mend as vetë sa ekspozita ka pasur. Dy herë i rashë në konak, në mbarim të viteve shtatëdhjetë dhe në fillim të nëntëdhjetave. Herën e parë e vizitova edhe atelenë e tij, aty ku dielli mesdhetar të sosë nga të gjitha anët, edhe në hijen e palmave, Dhe ku nuk di deti apo njeriu është më i thellë, apo humbesh në Ujin e Madh, duke i kërkuar kuajt e bardhë të ngjuar diku në vargjet e Fatos Arapit.

Përpiqesha të shpalos mesazhet nga vizatimet e tablotë e shumta, që formonin një mozaik domethënës mbi identitetin tonë kulturo-kombëtar. Dikur kisha pikasur njërën, ku nuk jepej vetëm fati tragjik i Ali Pashë Tepelenës, me një sensibilitet shqetësues. Koka e tij e prerë në prehrin e një labi, i cili tymoste ndoshta cigaren e fundit me

një pikëllim humbësi. Piktori kishte lexuar vrojtimin tim. M'u kishte afruar në gaz: Koka e Luanit të Janinës më mirë të gjendet në Kosovë se të bëjë një udhë të gjatë e të monotonshme deri në Stamboll.

Pas një jave tabloja trishtuese qëndronte e varur në dhomën time. Edhe tani kur zgjohem, shpesh më rrëshqasin sytë në të: ç'tmerr kishte përjetuar Ali Pashë Tepelena kur i kishte rrëshqitur shpata mbi qafë? Në kohën e tij Mesdheun e mbretëronin shtatë pashallarë shqiptarë (Sabri Godo: *Ali Pashë Tepelena*). E tani duan të na nxjerrin edhe nga Vlora!

Vendi i shqipeve shpërngulet në Evropë

Herën e dytë me Skënderin kishim zbratur ca gota raki Skrapari. Vendi i shqipeve, më në fund, nuk ishte bisht i Evropës. Po ashtu, më kishte folur për një poezi timen, dedikuar atij e që nuk e konsideroja aq të rëndë, por ai gati ia kishte parë sherrin. Sigurimcave nuk iu kishte pëlqyer. Pakëz i tmerrshëm ju kishte dukur imazhi i fundit të Mesdheut. E kishin pyetur një ditë piktorin: Po ç'desh të thotë ai miku yt me atë poezi? Do ta pyes kur ta takoj, iu kishte përgjigjur ky.

Në të dy anët e murit tragjik dyshimi i ngjante një verdhushke dhe vështirë mund të peshohej se ku ishte më i rëndë, megjithëse në të dy anët rrokulliseshin edhe koka.

Në fillim të viteve tetëdhjeta promovohet kompleti i veprave të Kadaresë në Prishtinë. Një prezentim aq dinjitoz nuk ia kishte bërë ende Shqipëria. Me Kadarenë ishim takuar shpesh. Një ditë rastësisht ra fjala për Skënder Kamberin dhe kokën e Ali Pashë Tepelenës. Po si more, koka e Aliut paska arritur në Kosovë? Dhe me humorin e tij karakteristik kishte shtuar: Do të rrinte bukur ajo edhe në murin tim. Kishte të drejtë miku i urtë. Kishte shkruar poezi e romanin e famshëm *Pashallëqet e Mëdha* për Ali Pashanë, koka e të cilit kishte udhëtuar nga Janina në Stamboll, duke tmerruar trojet shqiptare nëpër të cilat kalonte. Ndërsa unë ende nuk e kisha shkruar një fjalë për pashanë e sertë. Por Vlorën shkrimtari i nderuar e kishte një vrap e

unë duhej të kapërceja ca kufij, edhe pse Shqipëria kishte nisur të shpërngulet në Evropë. Parandjeja se mbyllja ime tek fillonte. Kosova kishte filluar të shndërrohej në nishana.

Pajtoni, syri sekret

Tek shfletoja ditarin e burgut të Fatos Lubonjës *Në vitin e shtatëmbëdhjetë* (Prusti do ta quante ditari i kohës së humbur) dhe kërkoja lidhjet me romanin e tij më të ri *Ridënimi*, me të cilin e pagëzova edhe këtë tekst, unë në të vërtetë hapja laboratorin orvelian nga shpërlarja e trurit deri te kastrimi i njeriut. Aty ideologjia ishte shndërruar në diçka monstruoze. I kapshëm më bëhej edhe kaosi i sotëm shqiptar, ku të çmendur janë vetëm të urtët se budallenjtë e shpërbënë Shqipërinë. Prapë isha ndalur te faqet e para të romanit, te biseda mes autorit dhe Spartakut (me siguri Ngjela) rreth tablosë *Demonstrata e Bukës* të Skënder Kamberit, për të cilën dëgjoja për herë të parë, as nuk dija se kur ishte punuar e çfarë mesazhi fshihej aty, që e kishte bezdisur një të rebeluar.

Një pajton diku midis tablosë dhe një sy në një çarje perdeje iu kishte ngulitur në kujtesë Fatosit. Me atë detaj ishte marrë kushedi sa kohë. Më vonë piktori syrin në atë çarje e kishte vendosur në një kënd pak më të fshehtë të tablosë, të venerohet më pak. I rebeluari mendonte se talboja nuk kishte fuqinë e mëparshme. Ndiente dhembje për bartjen e detajit. Dikur piktori kishte pranuar frikën. Mesazhi kishte dëshiruar të mbetej pakëz i kamufluar.

Simbolika e pajtonit recipientit të vëmendshëm ia kujtonte gazën e sigurimit, i cili bezdiste në hapësirën shqiptare. Insistimi i Fatosit, shpirtrebelues, është i qartë: gjërat duhen thënë me kurajo, pa dorëza. Po, a mund t'i shpëtohej ndëshkimit?

Në të vërtetë, gjesti i piktorit thoshte më shumë për lirinë krijuese në Shqipëri. Ndoshta, thoshte më shumë se syri në të çaren e perdes. Të thuhej diçka e zezë kërkohej mençuri dhe një gjuhë pakëz e mjegulluar. Arti piktorial i Skenderit fliste tepër dhe ndonjë hije e hedhur në tablo nuk ishte vetëm kamuflim. Derdhja e ngjyrave linte të

kuptonim se jeta në bunkerizëm nuk ishte aq e bardhë, siç propagandohej nga politika e ditës dhe servilët kujdestarë.

Iu kishte kujtuar Fatosit në Spaç diku ose në ndonjë kazamat “antik” të diktaturës tabloja *Demonstrata e bukës*; se hija e tmerrshme e pajtonit rrugicave të Shqipërisë dhe ai syri në perden e shqyer ishte bërë realitet i rëndë, nga i cili as sot shqiptarët vështirë të lirohen. Po ashtu, gjesti i piktorit fliste edhe për censurën, që ishte shndërruar në një autocensurë tmerri.

Mirëpo krijuesit e njëmendtë gjenin mënyrën për të artikuluar pezmin e tyre. Kurajoja qytetare ende përbirohej nëpër plasaritjet e ndrydhjet e vazhdueshme të fjalës. Problemet shtroheshin në mënyrë të urtë, që më vështirë mund të depëronte syri sekret nëpër të çarat edhe të shoqërisë. Miku ynë i përbashkët kishte “dëmtuar” tablonë ndoshta, por mu nga aty fillonte revolta e tij kundër së shëmtuarës, diktaturës.

Në ca lokalitete të Jugut ndodhi rebelimi. Shqipëria dridhet para fatit ogurzi. E shohin këtë ca nga rrafshi i pakënaqësisë. Eksplozimi social u bë marshim politik. Rrënues. A thua mos duam të lirohemi nga gjithçka jona? Rebelimi i kaloi edhe ca kufij të pakënaqësisë. Këtë hallakatje brenda kombit duhet parë ndoshta edhe nga lirimi i atij syri në çarjen e perdes, të cilën e kishte paralajmëruar shumë vite më parë piktori dhe që ngulte këmbë Fatos Lubonja, atij detaji të mos i ndërrohej vendi. Si duket, ne shqiptarët u lodhëm njëri me tjetrin. Provojmë tani trimërinë se kush e bëri Shqipërinë e kush do ta rrënojë më parë. Por ajo vazhdon të na rëndojë mbi supet tona, edhe pse merret nëpër këmbë.

Varur aty në murin e dhomës sime, nga prehri i labit, m’u bë se koka e Ali Pashë Tepelenës kishte rrëshqitur vendit në tablo si ai pajtoni me atë syrin sekret në perden e shqyer në *Demonstratën e bukës*, për të cilën Fatos Lubonja përsiatte edhe në “antikitetin” e diktaturës. Më shpesh zura të ndalem para saj. Si duket ende nuk e kisha lexuar deri në fund. Leximi i fatalitetit kombëtar kërkonte një përqëndrim më të madh, ndoshta dhe një kohë më fatlume. Dhe në zonat gri të kujtesës përpiqesha ta zbuloj befasinë...

Mirëpo koka e Ali Pashë Tepelenës gjendej aty në prehrin e labit të pikëlluar, cigarja e të cilit ishte në të sosur. Dhe vazhdova leximin e romanit *Ridënimi*. Para meje jeta shpalosej nga brenda. Leximi ishte krejt tjetërfare. Më shqetësues. Më i rëndë. Ishte një zhgënjim ndaj asaj së jashtmes, për të cilën servilët kujdestarë kishin thurur himne deri te krijimi i kultit. Diktatura kishte poshtëruar shqiptarin, e kishte shndërruar në një vidë. Nuk dihej nga cila dorë kurdisej. Vazhdimisht pikonte gjak. Ne shqiptarët nuk mund të jetojmë bile edhe pa një pikë gjak. A ju kujtohet temeli i shtëpisë?

Maska nuk është mjet mbrojtës. Shqipëria nuk mund të çojë jetë vazhdimisht pas maskës. Ajo duhet të shihet e plotë, nëse nuk duam të jetojmë në iluzione. Fatos Lubonja ndodh të shkruajë edhe vazhdimin e *Ridënimit*. Shqipëria u dënua prapë. Ajo nuk bën të mbesë ishull në oqeanin e madh njerëzor.

(1997)

REFUZIMI I BIZARES

Imazhi blu

Të hysh në një ngrehinë imagjinative nuk lipset artileri e rëndë, bagazh termash nga falori e mbamendja. Gjurmohen pikëmbështetjet në tekst, ose mjafton një detaj të gjeshë e të njihesh me rendin e panjohur. Poeti amerikan, Xhon Bishop, insistonte në vetëm një detaj, që mund të mundësojë shpalosjen. Megjithëse shkruhet poezi shumë, ajo mbetet e pakapur. Nga se mësova se më tepër duhet shqyer e djegur se sa të botosh, kuptova se poezia është enigmë e madhe e shpirtit, e mendimit, e fantazisë, e figuracionit. Leximi i saj varet nga shumë faktorë. Recipienti duhet të shkelë në të si në një tokë të pazbuluar. Krahasim pakëz trivial, trupin e saj, atë arkitekturë që pret të shpalohej, e shoh si të një vashe; duhet hapur atë siç hapet një guaskë misterioze, me plot dro se a do të depërtosh dhe a do të përjetosh të bukurën.

Poezia mbetet nga artet më të komplikuar. Recipienti nazeli hamendet edhe kur ajo është një fjalë e vetme e vendosur diku aty në hapësirë, ose kur nga ajo fillon loja e varianteve në tekst e nuk di cilës t'i qaset. Vladimir Hlebnikov kishte qitur në hall esnafin krijues rus me lojën e fjalëve. Nga një fjalë e mbi një fjalë ngriste sistemin e vet poetik, me idetë e mesazhet përpiquej të krijonte të pamundshmen. Nga një fanatizëm i tillë vuajnë Lasgushi e ca poetë tanë.

Në fillim të viteve të shtatëdhjeta përgatitja librin e parë të Fatos Arapit. Isha ballafaquar me imazhin blu. Arapi ishte më i sigurt aty, me një sensibilitet të një liriku të hollë. Poezitë për detin i kisha quajtur vinjetë, kroki. Mirëpo ujin e madh ndryshe e kisha paramenduar: si frikë-ushtimë, si forcë-hata, si mbyetje-përmbytje, si gllabërim-rrënim. E, në fundin e atij misteri shpesh më shfaqej ai Arapi i Zi, rrënuesi-

pushtuesi; me një sy si katallani i Homerit ndoshta. Për këtë, fatkeqësisht, pak më parë na bindi disi fundosja e liburnës sonë në Grykë të Otrantos (1997). Imazhit blu i mungonte diçka, megjithatë. Nuk mund të humbësh në të, të ndjeshë rrëmbimin jo vetëm kreativ. Imazhi tek hapej para ujit të madh, misterit.

Dhe në mbyllje të viteve të përmendura në revistën *“Koha”* (1979) të Podgoricës kisha lexuar poezitë e para të Basri Çapriqit. Nga atëherë iu desh të kalojë një rrugë të mundimshe deri te *“Frutat bizare”* (1996), libër i katërt, që e bëri poetin individualitet të fuqishëm në letrat shqipe. Vepra e tij ka edhe një rëndësi të veçantë. Vjen nga zonat e rrezikuara të qenies sonë. Mu për këtë e elaboroj edhe si klithmë të të shkelurve, të të ndjekurve, të fyerve e të traumatikëve të Cepit verior të Ilirisë.

Tërësia e derdhur

Drita verbuese e ublave, rrënimi i murit të ndonjë kështjelle ilire, apo fundosja e ndonjë liburne diku në botën e algjeve, mosha e ullinjve më e vjetër se fisi, vetmia e tmerrshme nën diellin përcëllues në një natyre shkëmbore, jo aq fatlume, në imazhin blu piku ndjenja e mërzisë, e braktisjes, e tragjikes. *“Ulli me dy mjë unaza”* (1983) nuk është libër rasti. As i një fillestari. Artikulimi fundekrye është imagjinativ me një figuracion tipik mesdhjetar. Fjalëve e figurave u vjen era det, kripë, hala, ulli, po dhe të shkrumbit të mallit për shpërbërje të mëdha. E, një poezi e tillë kërkon lexim më të vëmendshëm. Edhe për arsyen, që e theksova më parë. Është një copë e tërësisë së derdhur.

Pikë shënuese në krijimtarinë e Çapriqit është libri i tretë *“Ma qet gjubën”* (1989). Të njëjtat rekuizita gati disponon, por larushia e përmbajtjeve zbret thellë në lashtësi. Shpalos edhe anën e errët. Ndeshim gazin e zi, ironinë - se në gjërat rreth nesh insistohet ndërrimi ose korrigjimi. Historinë nuk e lexon vetëm brenda kornizave.

“*Frutat bizare*”, libri më i ri, është konceptual. Çapriqin e shohim në dritë të re. Një ligjërimit bashkëkohor. Ka një sintaksë të re. Poezia e këtij libri duhet kundruar nga rrafshi meditativ. Figuracioni është gati i reduktuar. Nëpër shtresime vështirë lëvizet nga dendësia e pusitë e poetit që kurdis qoftë përmes revoltës, ironisë; qoftë përmes rrymimit të brendshëm. Përmes një ligjërimit të tillë me plot gërçe poeti vë kontakt me jashtësinë, duke refuzuar bizaren.

Çapriqi na tërheq vëmendjen se udhëtimin imagjinariv, qoftë individual apo kolektiv, e përcjell “një rrezik permanent”. Se, nuk mungon vetëm guximi për të shpëtuar diç, ndoshta të pamundshmen. Të ekzistosh nuk mjafton vetëm të dallos nga kafsha. Kështu, poeti ngre çështjen e lirisë, konceptin e saj; se ajo është bazë për të gjallëruar si qenie me arsye. E bën këtë me një cinizëm, do të thosha, rrënues. Puritanët nuk di sa mund të pajtohen se “*liria është një mut i madh*” (poezia *Liria*, faqe 28). Pse?

Keqpërdorimi i lirisë

Në mes mungesës e keqpërdorimit të saj lëviz koncepti se ç’mund të jetë liri. Ka aty zbrastësi, që duhet mbushur me ide e përmbajtje. Dhe, nëse nuk di ta përdorësh, mund të keqpërdoret ajo; do të thotë sikur të mos e ke fare. Pra, a mjafton vetëm guximi njerëzor? Keqpërdorimi i lirisë sjell të zezat: rënien sociale, prishjen e kodit etik, fukarallëkun, rebelimin, anarkinë. Momenti i pikërishtëm në Shqipëri ilustron edhe shumëçka tjetër. Luhatja e vendit në zgrip është ngecje e vetëdijes; se liria mund të jetë edhe “*një faj i rëndë*” (poezia *Liria*, faqe 28), për ata që e humbin ose nuk mund e fitojnë më. Pas të gjitha persiatjeve e ke të qartë se mungesa e lirisë është shkaktare e fatkeqësive si në rrafshin social, ekzistencial ashtu dhe politik-kombëtar. Shpërbërjet e sistemeve janë të mundshme atëherë. Sintagma *Dheut At* (poezia *Muri Gjigand*, faqe 11), përdorim ky i çrëndomtë, do ta interpretonte linguistika bashkëkohore, në poezi Çapriqi e bën me qëllim të forcojë ironinë, pezmin ndaj tkurrjes së vazhdueshme të hapësirës jetësore-kulturore-historike. Pra, ndryshe

nga ca poetë, që këtë sintagmë e përdorin në funksion të atdhedashurisë.

Alber Kamy jo vetëm në veprën “*Njeriu i revoltuar*” vinte në spikamë se revolta e vë njeriun në veprim. Kuptohet, brenda kufijve të lirisë. Se anarkia pengon edhe triumfin e mundshëm të pakënaqësisë. Nga ky pikëshikim e zë edhe ligjërimin e Çapriqit për lirinë, koncepti i së cilës refuzon bizaren; se liria mund të jetë edhe fatkeqësi. Pra, në mes lirisë e rrënimin ndrit arsyeja.

Po ashtu, në “*Frutat bizare*” shtresohen edhe probleme të tjera për të bërë më bindës konstatimin rreth konceptit për lirinë, të cilën kur nuk di ta përdorësh, defekti qëndron te individi, kolektivi. Diktatura e tëhuajsoi njeriun, e shndërroi në kurrgjë; e zhvlerësoi, e gërditi nga vetvetja e rrethi. Kufizimi i saj e solli në situatë të palakmuar, poshtëruese. Përmes një lavireje e dy ministrave, njëri i ushqimeve dhe tjetri i industrisë së rëndë, poeti vuri përballë raportet njerëzore dhe nxori kontradikta të theksuara në mes sistemeve. I ashtuqajtur njeri i ri i diktaturës bëhet figurë tragjike në një mjedis, ku morali shndërrohet në monedhë (poezia *Vasha nga lindja prostitutë në Romë*, faqe 37). Zhgënjimi i njeriut të diktaturës deshmon se shturja ose mbyllja hermetike është katastrofale. Duhesh të pajtohesh edhe me turpin, krimin, vandalizmin.

Shfaqja e qyqes

Çështja e hapësirës është kategori më vete. Çapriqi e thekson atë si diç tragjike. Se, ajo nuk është problem vetëm i individit. Tkurrja shpie te mbyllja. Poetin grek Konstandin Kavafis e shqetësonin muret. Ndajnë ato jo vetëm popuj, por edhe qytetërimë. Recipienti-interpretuesi nuk di në ç’kategori i vë shumëzimet e kufijve në trojet tona? Në funksion të vetëmbrojtjes është kështjella, kulla, por copëzimi i shpirtit, i kulturës, i hapësirës? Me një luciditet Çapriqi shtron këtë problem më se ekzistencial jo vetëm për individin. “*Kokën në Jakobi*” thotë poeti (poezia *Muret e Skotlandës*, faqe 22). Po ky Jakobi mund të jetë secili nga ne. Nga kufizimi i lirisë nuk pritet as dallimi

mes bishës dhe njeriut. Tragjikën e mbyll poeti me shfaqjen e qyqes. E, ne shqiptarët e dimë mirë se ç'simbolizon ky zog.

Në çarshinë tonë letrare bëhen të zhurmshme fjalë-bubullimat, të papeshat, retorika e sforcime të ndryshme odash, bejtet, çrregullimi i kriterëve, shija e bastarduar deri te iracionalja. Ndaj një dukurie anakronike, çmendurie poeti distancohet: “Ushton zë epik i poetëve nxitojnë fëmijët të ikën” (poezia *Dritaren lëre hapur*, faqe 18). Çështja e vlerës mundëson ecejaket, po dhe ideologjinë e re të *Nikeve*, siç e paralajmëroi një i talentuar yni i një vokacioni tjetër. Çapriqi këtë vetëm e gërvish.

Një ditë do të shkruajnë poezi të gjithë, thoshte Tadeush Rozheviç. Do të merremi, pra, me kategorinë e të bukurës. Mendonte ashtu poeti polak, ironinë e të cilit e kap se do të vargnohet më shumë dhe në një kaos të madh, nuk do të mungojë vlera megjithatë.

“*Frutat bizare*” është libër i një shqetësimi të ri. Ngreh e përmbyes çështje. Po ashtu, karakteristikë e librave të mirë është se kur hapen, mund të hysh nga secila portë. Mua më intereso i fenomeni i lirisë, koncepti i saj, mbasi më mungon. Shoh pra se më tmerron *Fuga e vdekjes* e Paul Celanit me atë vargun famoz: *Pi qumësht të zj...*

Librin e mbyll Çapriqi me një varg sinjifikativ, do të thoja ngushëllues: *vë dialog me zotrat antikë* (poezia *E zbrazët, më në fund*, faqe 61). Është më mirë ndoshta të bisedohet me të vdekurit; të iket nga kjo anarki njerëzore, ku çohet dorë edhe nga liria e atdheu...

(1997)

BIZONI I PLAGOSUR

Pakëz edhe jasht çatisë

Çështja kombëtare është më komplekse sesa mendohet. Urtakët duhet të jenë pakëz më esull. Di se akcili popull nga dy gjëra nuk mund të çojë dorë: liria dhe atdheu.

Mirëpo, edhe kur na vrasin e na fyejnë, në mes nesh ka hile. 1) Duam të tregohemi ata që nuk jemi dhe 2) Mendojmë se dielli sillet vetëm rreth nesh... Fërkime të tilla nuk shpiejnë përpara. Fatkeqësisht, këso marrëzish ka edhe në disiplina të tjera, bile edhe në atë të krijimtarisë, ku krijuesit duhet të qetësojnë shpirtin. Për pesë para bëhet edhe gjeniu. Nuk pranojmë as pikat orientuese. Çdo gjë e shohim nga çatia, mëhalla, klani apo fisi. Na mungon guximi intelektual e qytetar. Është e qartë se nuk mund të peshohet asgjë me kandar të judos, por nuk bën të lozim me dinjitetin. Të dalim pakëz edhe jashtë çatisë, se edhe ajo është jona. Ky egocentrizëm mund të ilustruhet me dhjetëra shembuj. Unë jam gjakovar, por mos e dhashtë zoti çdo gjë të fillojë e të mbarojë në Gjakovë; trupi e shpirti im do të më braktisin. Bëhet luftë për shtrirje pra. Nahijçe e me inat nuk mund t'u qasemi vlerave. Atëherë ne kemi dhunuar të vërtetën, kemi zvogëluar vetveten dhe kemi treguar primitivizmin tonë malok. Peshimi i gjërave, sipas tekeve e mëhallëve, bën copëzimin tonë të mëtutjeshëm, që më së pakti na konvenon në momentin e pikërishtëm, kur rrënimi ynë bëhet nga të gjitha anët. Në mileniumin e ri të hyjmë të emancipuar kombëtarisht dhe intelektualisht.

Ata që nuk e shohin veten në asnjë pasqyrë, thonë se bartin rrezikun. Kjo është edhe njëra nga fytyrat e shëmtuara të bajraktarizmit, që njeriu i mençur nuk e pranon. Për dreq, të tillët shtohen, për të zezën e vetvetes më tepër.

Njeriu nuk bën t'i gjunjëzohet fatit

Përmes formave raciste nuk mund të zgjidhen marrëdhëniet ndërnjerëzore dhe ato etnike. Ndoshta jam frikacak, por nuk mund t'ia shkel kujt hijen, as nuk lejoj kush të nëpërkëmbë dinjtetin tim njerëzor. Mund të gjenden udhë për mposhtjen e urrejtjes dhe të smirës, sall veprimi duhet të jetë i dyanshëm. Konkretisht, fëmijën tim nuk mund e shoh rrugëve e shesheve, duke britur parulla raciste si: *Mos u jepni as lapsin*, apo *Shqiptarët janë popull pa kulturë*, siç çirret shpesh kreu nationalist serb, bile edhe injoranca akademike e Papoviqëve, prototip ky tipik i azganllëkut serb. Kjo është fatkeqësi, para së gjithash, e vetë këtij populli. Marshimet çmendurake, para së gjithash, nuk kanë shtigje të gjata. Kujtoni se deri ku e shihnin Serbinë. Bile edhe zotin e kishin shpallur serb!...

Fati i ballkanasve është fati i përbashkët. Të mbështetet aty te mirëkuptimi e respektimi i ndërsjellë në mes popujve dhe kulturave. Për mua, nuk ka popull të madh apo të vogël, të ndotur apo të pastër, ka koka që na hasmërojnë. Dhe, kur t'i heshtim pasionet, nuk do të flitet për ballkanasit si për do fise afrikane, se na paskan jetuar.

Njeriu nuk bën t'i gjunjëzohet fatit. Duhet të jetë zot i tij.

Rezervati në kohë betoni

Nga antologjia personale e Rexhep Ferrit *Ndoshta ishte dashuri*, Rilindja (gazeta) 1998, jo për shkak të vlerave, veçoj poezinë dedikuar poetit Alen Boske. Ka një titull pakëz provokativ *Më erdhi të bëhem trim*. E kur? Në kohë të pakohë. Arsyeja tjetër, ne shqiptarët vështirë i zbulojmë e i ruajmë miqtë. Poeti francez ishte ndër miqtë tanë të rrallë. Në poezinë e cituar gjendet, po ashtu, edhe vargu: *vizatoja vizonin e plagosur*. Kafshë kjo nga rezervati, paska humbur udhën e mbyllur në një varg të poetit tonë. E, këtë e bëj jo pse kam simpati për inkët, por pse e ndiej veten se gjendem në rezervat. Dua ta përjetoj pra edhe ftohtësinë e tij.

Arsyeja se nuk mund të shkëputem nga koha e rreziqeve kur qytetërimi i egër bën trysni ndaj qytetërimeve autoktone e më të lashta, është se do ta tradhtoja kredon krijuese. Sintagma e zënë ngojë thotë shumë. Poeti na ofroi këtë edhe pse ka për vokacion të parë artin piktoral dhe dëshmoi për lidhjet e forta në mes arteve jo vetëm përmes elementeve figurative. Në letrat shqipe krijuesi biling nuk është rastësi.

Në tekstin *Poeti dhe përhapësi i kulturave*, botuar më 28 mars në “Bujku”, faqe 10, akademik Rexhep Ismajli, duke folur për veprën e meritat e poetit francez Alen Boske, kishte kujtuar edhe një moment domethënës nga një udhëtim i poetit, që kishte bërë para dyzet vjetësh deri aty në Ras. Atë vit miku im, Rexhep Ferri, ma kishte sjellë librin e parë të poezive të Boskesë në botim të “Nolitit” të Beogradit. Ky bashkë me Vasil Popeskun (Vasko Popën) kishte zbritur deri në Ras, ku përfundonte zgataraja e Mbretërisë së Nemanjiqëve. Më tutje, sipas nikoçirit, fillonin ata të Karl Majit, vrasësit (!). Më kishte folur për këtë edhe Popa, tek udhëtonim në një mbrëmje letrare në Subotićë. Dhe është interesant se të dy variantet e kallëzimit puçen. Ekzistonte trysnia serbe edhe atëherë ndaj shqiptarëve.

Mirëpo ky bizoni i plagosur i Ferrit mos e prishi imazhin e atij udhëtimi të parisienit në bisht të Evropës? Bizoni tek inkët simbolizon fuqinë e dheut, krenarinë. Në poezinë e poetit tonë ai është i plagosur. Hija e tij tmerron edhe ata, që poetit nga Parisi i kishin folur se më tutje nuk bën, jetojnë ata që vrasin. Në një farë mënyre, ata kishin dëshmuar përçarjet e dy popujve, që shpiejnë te shkëputja e domosdoshme mbasi asgjë nuk kanë të përbashkët.

Kisha përshtypjen se Vasko Popa, përkthyes e mik i Boskesë, nuk ishte gjetur mirë, megjithëse kishte pasur dorë në tensionimin e nacionalizmit serb; se tërë ajo që kishte ndodhur në Fushë-Kosovë, e kishte parë nga çatia serbe. Mbi atë rrenë ishte shtrirë më vonë si hije e rëndë poezia e Kadaresë, *Mundja e ballkanasve*, dhe vargu: *Bashkë me ditën, ballkanasit, u thyen. Medet*. Ishte pëshpëritur se Kadareja i kishte dhënë nacionalizmi serb një dush të akullt sa i përket Mitit të Kosovës.

Mund të dukem naiv, ndoshta, por më mirë të mos kishte ndodhur *Beteja e Kosovës* (1389), bile hasmëri do të kishte më pak dhe tapitë do t'i takonin realitetit të sotmërisë, të “fyerëve”. Pas disa vjetësh Vasko Popa kishte shkruar një poezi për një bashkëqytetar të tij të ri me origjinë nga trevat shqiptare. Poezia quhet *Shtëpia*. Përmes tij vinte në peshojë dinjitetin njerëzor, shqetësimin në relacion kurbet-vendlindje. Këtë ma kishte lexuar në dorëshkrim një herë tjetër, nuk di as vetë pse. (Në shqip përkthimi më i mirë i kësaj poezie është ai i Shaip Beqirit). Në të vërtetë, Agimi, emri i djaloshit në poezinë e Popës, simbolizon për mua një bizon që, rastësisht, kishte hyrë edhe në poezinë e Ferrit, sall i plagosur. Plaga e tij kishte tmerruar ata të Rasis, që nuk e kishin lejuar Boskenë të zbriste poshtë në Dardani. Kjo kishte zgjuar kërkshërinë te ky se ç'ekzistonte tej. Tevona u kishte folur miqve për këtë udhëtim të papërfunduar. Interesimi i tij prej intelektual kishte shpalosur me kohë atë mrekulli, që krijohej tej atij kufiri të anktshëm, ku, sipas nikoqirit, fillonin ata të Karl Majit, vrasësit.

Urrejta në bisht të Evropës, megjithatë, nuk mposhtet lehtë. Bizoni në poezinë e mikut mori plagë, por nuk ra. As në kohë të liga nuk humbet shpresa. Dhe tek lexoj poezinë *Më erdhi të bëhem trim*, në të vërtetë, unë përjetoj edhe artin piktorial të Ferrit. Përvidhet aty përmes fjalëve e figurave. Në këtë simbiozë të çuditshme, thënë përmes artikulimit e brushës, vëren se ky me sens kurdis para teje një befasi e që të bëhet se ti, në të njëjtën kohë, lexon poezinë por dhe shikon aty në mur ndonjë piktorë që, rastësisht, është shndërruar në fjalë dhe nuk të kujtohet as koha se kur ka ndodhur kjo. Poetët që kanë vokacion dhe piktorën dallohen me perceptimin. Edhe fjalën, edhe shqetësimin, edhe mesazhin e thonë nga një pozicion tjetër, me drojë se fjala megjithatë nuk është ngjyrë. Vargu i tyre ka pakëz drithmë, lirizëm. Por bizoni i plagosur dëshmon tragjikën e një populli, i cili vazhdon të gjallërojë në një rezervat të kohës së betonit.

Në stilin e Markezit

Diku në një vend neutral, pas një debati të gjatë për çështjen e Kosovës, dy intelektualë bisedonin sa kishin qenë të sinqertë në paraqitjet e tyre. Zotëria nga Beogradi, njihet për radikalizmin e tij të theksuar dhe nuk zbret nga toplista kundër zgjidhjes së Njës së Kosovës, i kishte thënë në besë zotërisë nga Prishtina: Kosova është e humbur për Serbinë, por nuk ka kush t'ju lajmërojë. Biseda ishte mbyllur tamam në stilin e Markezit.

REVOLTA E NJË BREZI

Oazat në shkretëtira shpirtërore

Buzë një liqeni diku në Evropë tek më fliste një shqiptare e shqetësuar për “parajsën” e premtuar, në kujtesë kisha shkruar poezinë edhe për vajin e shumë të tjerave. Poeti, ballë meje, vazhdonte të më bindë se njerëzit tanë në diasporë më së shumti “*vuajnë nga tensioni i lartë*”. Me rend kisha sharë parti e organe deri te guximi ynë intelektual, si lejuam një Kosovë të vogël të rropatet në mëshirën e fatit. Vërtet, këtë e kisha parandjerë në një tekst pakëz më herët: a zgjohet Kosova në ekzil? Shtrohet pyetja: Po shpirtërisht, ku shpirtërohet ajo me njeriun tonë?

Nëse keni shikuar nga dritarja e aeroplanit kur mbështillet nga retë e dendura, atëherë nuk e shoh të arsyeshme të shtoj se ç’kini parë. Shtrirja e diasporës ka zënë t’i ngjajë një shkretëtire aty-këtu me ndonjë oazë kulture, ku shpirti gjen pakëz prehje. Zatën, kjo është një farë grithje në ndërgjegjen tonë.

Më pak se jetë

Sebeb i këtij teksti është edhe libri i Bujar Salihut “*Më pak se jetë*” (1997) botuar nga “Rilindja”. Dua të vë në spikamë me këtë rast edhe një të vërtetë: a është shkruar ndonjëherë poezi më shumë se në momentin e pikërishtëm dhe pse ndodh ky fenomen? Kemi zjarmi, si duket për së tepërmi dhe duam të dëshmojmë para së ardhmes se kaq mund bëjmë; gjuhën tonë nuk e lëmë të vyshket, bile as në metropole. Është e tmerrshme të harrohen të bëmat, prandaj shënohen qoftë edhe në një copë lëkure.

Në Shtëpinë botuese “Rilindja” nuk më ka penguar kurrë dorëshkrim a libër i ndonjë autori. Me kolegët e mi, ca nuk gjenden më mes nesh, përpiqeshim nga asgjëja të krijonim diç, apo siç thonë në qytetin tim, t’i krijonim gjërat edhe nga mella. Edhe pse shpesh mund të pësonim, dyert ishin të hapura edhe për vlera që mezi shiheshin në horizont. Qëllimi ishte fisnik. Kombëtar.

T’i kthehemi pyetjes: është e vërtetë se kurrë nuk është shkruar poezi më shumë se viteve të fundit. Për vlerën e tyre do flitet më vonë. Por dhembjen, dhunën, tragjikën, fatin tonë ogurzi dikush duhet t’i shënojë. Nëse ne nuk e bëjmë këtë, ose nëse pranojmë, si thonë, me gjëra transparente krijuesit nuk bën të merren, atëherë nuk di se kush do ta bëjë punën tonë. E njeriu ynë ka nevojë të lirohet nga zjarmia e të deklarohet para vetes e botës se ekziston... Një klithmë, një shqerrje sarkastike sado e pavlerë në të parë ka peshën e vet në një kohë kur çdo gjë jona na është në tetik. Nuk më çudit, pra, pse shkruhet; pse atje shtohen publikime e botime të ndryshme. Në një farë mënyre dëshmohet se Kosova vazhdon të zgjohet në ekzil e t’i bëhet krah i fortë çështjes kombëtare. Por, organizimi duhet të ketë forma kurajuese.

Përmbledhja e poezive “*Më pak se jetë*” është njëri nga shumë librat e shkruar në kurbet. Vetë titulli flet shumë, dëshmon për shumëçka. Artikulimi i tij ka shenja të një sensibiliteti tjetërfare, urban. Edhe pse e preokupojnë temat shqiptare; tragjedia e njeriut tonë në një mjedis urban, ku ka rend e ligjet e veta, nuk i shikon në atë stilin folklorik, anakronik, banal: *Ku po shkon, more djem...* Një shqiptim të tillë dikush mund ta lavdëronte. Salihu kurbetin e jep përmes nuancave, e shpalos; nxjerr zjarrin, kullon plagën e quajtur, si të duash, *Kurbet* apo *Kosovë*; e shtrydh, ia nxjerr atë vrerin, që na shqetëson e na shtyn të veprojmë. Poezia e tij rri afër brezit të *Rrethit letrar të Prishtinës*: Rahman Paçarizi, Xhavit Beqiri, Beqë Cufa, Sali Beqiri, Lulëzim Tafa, Kujtim M. Shala etj. të cilët artikulimin e shohin si shpërthim ekzistencial, të jetohet për inat të fatit ogurzi. Nuk është pra fjala se një popull po shndërrohet në poet, por ky bën rezistencë edhe në këtë mënyrë.

Bujar Salihu më parë ka botuar përmbledhjen “Në *xjpat e vetmisë*” (1994), Me librin e dytë bën një kërcim të dukshëm kualitativ si në rrafshin gjuhësor ashtu dhe në përmbajtësor, figurativo-imagjinitiv, ku e nxjerr në një dritë të re. Ndaj dramës jo vetëm kombëtare, ka një vrojtım mjaft bashkëkohor. Pak simbole hasim, se poezia e tij lexohet si një metaforë, ka shtresime, është ekuivoke. Se, mendimin e poetit duhet përcjellë nga vargu i parë ose poezia e parë, që të vjelësh mesazhin bile edhe të librit me një titull rrëqethës *Më pak se jetë*. Do të thotë se brenda tekstit të tij ka rrënime të mbështjella, të shumtën e rasteve me një gaz ironik. Në këtë kuadër vlen të kundrohet ballafaqimi i poetit me mjedisin urban të metropolit, me teket e një rendi që nuk kanë asgjë të përbashkët me një tradicionalizëm. Mund të jetë kjo dhe braktisje nga stereotipet e demoduara; pra tentim për një qasje vërtet të mirëfilltë bashkëkohore ndaj gjërave.

Kosova plagë brezash

Gjuha është pikëmbështetje kryesore e binasë më se të çuditshme që quhet *krijim letrar*. Në ca poezi të Bujar Salihut hetohet shkathësia për të krijuar poezi lëvizjesh të çuditshme brenda tekstit e njësisë ciklike. Të kujtojmë poezitë *Ndodh* dhe *Rrotullimi*, dy më karakteristike. Poeti tekstin e liron nga ngarkesa të ndryshme emocionale dhe na ofron një poezi të kulluar. Në të dy poezitë e përmendura, si dhe në *Kapelat e eksodit*, mbështetet i tërë libri. Nga këto pika përcjell jo vetëm tragjikën e marramendthin e apatridëve, por edhe dramën në Kosovë me tërë revoltën e një brezi, që nuk e pranon nënshtrimin. Artikulimi i tij mund të jetë dhe i një brezi që vjen *se të jetosh do të thotë të vepros*. Ky është dhe njëri nga mësimet e para të qytetërimit evropian.

Ashtu, siç thoshte nobelisti Seferis se kudo e bart Greqinë. Ky i ri, si të gjithë të tjerët, me vete e bart *plagën* Kosovë, që duhet të pushojë njëherë së kulluari; nga ajo të çelë *lulja* që, ndoshta, e kërkojmë me shekuj. E, libra të tillë të autorëve, që përkohësisht jetojnë në kurbet, siç thotë një mik imi, të inkurajojnë se Kosova nuk

është më vetëm plagë e çështje e atyre të brendshmëve. Ajo lidh breza e krijues, pa marrë parasysh se ku gjallojnë e veprojnë. Me guxim e dinjitet kur thuhet gjërat, nuk ka vend atëherë as për frikën. Vetëdijesimi ynë vazhdon dhe na kujton atë thënien e mendimtarit tonë të mirënjohur Branko Merxhani: Ai që e ndien veten “Shqiptar” është patjetër Shqiptar... Librin e Bujarit e lë ta vazhdoj një rast tjetër.

Cinizmi

Në mbyllje të këtij teksti nuk mund të mos e përmend një poezi të Isuf Sherifit. Derdh aty mllëfin ndaj servilëve e pakurrizorëve, që kombin mund ta qesin në bixhoz për ndonjë lëvërdi bizare. Poezia e tij titullohet *Pjata*, botuar në një gazetë majtiste dhe cinizmi: *E lëpin qeni/ Edhe njeriu e lëpin/ Kush më shumë se tjetri/ Pjatën e lëpin...* Ka edhe shumë krijues, që për rebelimin e tyre dhe ndërrimin e situatës tonë momentale, meritojnë një vëmendje të posaçme. Pakëz e dhimbshme vetëm ballafaqohemi me një të vërtetë: para nesh shpaloset një tjetër Kosovë, ajo e ekzilit, e cila bën çmos të mposhtë pisllekun e kohës morbide, që është ndoshta më shumë se vdekje.

(1997)

HARMONIA NGA KAOSI

Mbi krijuesin

Se krijuesi është në kërkim të sublimes dhe tërë jetën shkruan një libër të vetëm, na bind edhe antologjia personale poetike e Shaip Beqirit: *Rekuiem për veten*. Përse antologji? Unë konsideroj antologji personale çdo përzgjedhje të konceptuar me kritere. “Buzuku” bëri punë të mençur që na ofroi një vepër të tillë për dy arsye: e para, poezia e Shaip Beqirit kapet në një sfond krejt tjetër, me një koncept të ri dhe spektër të gjerë interesimesh; e dyta, pse *Në pyllin e pashkelur të ëndrrës*, siç thotë autori në poezinë *Argusi*, udhëtimi do të jetë i rëndë dhe befasues.

Kreativiteti është edhe punë e ndërgjegjes. A e pranon krijuesi formën e parë si akt të kryer, apo shqetësimi krijues nuk e lë të qetë në synimin për një realizim e koncept më të përsosur jo vetëm të poezive e cikleve brenda librit, varet edhe nga interesimi i autorit, si e kupton ai idealin e vet krijues. Vepra pra vazhdon të krijohet e nuancohet edhe atëherë kur ne mendojmë se ajo ka përfunduar. Shpirtërisht ajo jeton me krijuesin e vet, i cili kërkon maksimumin e vetvetes dhe të tekstit të vet, synon më qeniesoren.

Në letrat shqipe ka kohë që Shaip Beqiri është i pranishëm me një artikulum të veçantë. E them këtë sepse ky poet është dëshmuar me vlera, duke ofruar një poezi që shumë pak fërkon me atë dërrmuesen, që shkruhet në hapësirën tonë gjuhësore.

Rekuiem për veten është sajuar nga dy librat e tij të mëparshëm: *Fontana e etjeve* (1976) dhe *Flatrat e gjymta* (1983), të dytë botuar te “Rilindja”, si dhe poezi nga dorëshkrimi i librit më të ri *Eklipsi i gjakut*. Kështu recipientit-interpretuesit i ofrohet një lexim i ri i poezisë së

Beqirit, një vrojtim i tij interesant mbi problemet e kategoritë: jetë-art, të paralajmëruara që në fillim të krijimtarisë së këtij poeti.

Dy lexime të një poezie

Unë këtë libër tash e lexoj në dy mënyra. Në leximin e parë, më del personaliteti i autorit, përplasjet dhe përpëlitjet e tij: *Në pyllin e dendur të hijeve*, siç thotë ai në poezinë *Akvariumi*, me kërkimin intensiv të paqes shpirtërore, të vlerave njerëzore dhe të shenjave të identitetit kombëtar në një kaos, ku duhet të veprosh patjetër nëse dëshiron të ekzistosh, apo: *Të ndrydbësh plagën tënde / Që po na i lulëzon kremtet...* (*Unaza e gjakut*). Sidoqoftë, thyerjet dhe bezdisjet brenda e rreth vetes, të cilat poeti i ngre si çështje para recipientit-interpretuesit, nuk janë thjesht konstatime. Shtrimi i klithmë-dilemës: *Ab koha është të vdesim moj? Ende pa jetuar (Ritmi e asgjë)* është filozofi e rebelimit që paralajmëron se asgjë s'mund të ketë vulën personale në mposhtjen e ogurit të zi e as nuk mund të elaborohet në kuadër të personales, edhe pse ligjërimi i tij në të parë na bëhet se është një monolog iracional.

Edhe në librat e botuar më parë, ku sipas autorit është bërë ndonjë ndryshim i vogël, shqetësimi i kahershëm krijues i këtij poeti ishte gjithnjë evident, kurse tash bëhet më dinamik, qoftë kur jepet përmes mesazheve apo kërkimit të shtegdaljeve nga *Pylli i pashkeluri ëndrrës*. Kjo dëshmon faktin që ceka në fillim se krijuesi i njëmendtë kurrë nuk kënaqet me formën e parë, sepse duke shkuar gjithnjë kah përsosja e saj, heton se diçka i mungon. Mu për këtë teksti letrar ndan fatin e krijuesit. Është i lëvizshëm. I shpirtshëm. E mbyll leximin e parë me një konstatim sarkastik të vetë poetit mbi bëmat në një kohë që do ta quaja të vetëdijësisimit tonë ndaj të papriturave dhe proceseve të reja njerëzore, të cilën ai me saktësi poetike e cinizëm e emërton: *Kur po vdiste arti i të lehurit (I zoti i qenit)*.

Krijoje gjuhën tënde

Leximin e dytë e shoh në rrafshin e aktit krijues, të punës sizifiane në ngritjen e arkitekturës shpirtërore-imaginative; pra ka të bëjë me vlerat, me artin. Antologjinë personale Beqiri e mbështet në pikat, që janë edhe referuese: Prologu, Intermexo, Epilogu, të lidhura me emërtimin e idealit vetjak estetik: *Lasgushiana*. Po të elaborohen me kujdes këto tri pikëmbështetëse, vëren se poeti shtron edhe problemin e gjeniut tonë krijues, individualitetin e tij të formatit të një Lasgush Poradeci, prania e të cilit hetohet dendur jo vetëm në leksikun, por edhe në elementet përcjellëse të aktit krijues të Beqirit, i cili përqafton, selit dhe mbron një ligjërim poetik shqip lasgushian. I udhëhequr nga ky mësues i tij i madh shpirtëror dhe i mbështetur në njohjen e poezisë moderne, ky ngre para së gjithash çështjen e gjuhës poetike, variantet e mundshme të fjalës, magjinë mahnitëse dhe provon mundësitë që ofron ajo kur mjeshtri i saj di t'ia gjejë vendin aty ku duhet në tekst.

Në fund të librit poeti ka vendosur tekstin *Dhiata ime për Poetin e ri*, ku, ndër të tjera, ai porosit krijuesin: *Krijoje gjuhën tënde*. Përkrah këshillën e dikurshme të Danilo Kishit të drejtuar shkrimtarëve të rinj (1984). Poezia pra është diçka fisnike, krijohet nga një gjuhë e veçantë, e cila rrezaton në hapësirën tonë. Pikërisht nga këtu ndoshta do të mund të hapej edhe kjo antologji personale e Shqip Beqirit, e cila ngërthen edhe vlerat e një relikti gjuhësor.

(1998)

ÇKA MË TUTJE?

Vlera kërcënon vetëm mediokrin

Libri i mirë nuk e gëzon vetëm autorin, as nuk ka nevojë për reklamë. Vokacioni im, po ashtu, është diç tjetër. Por gjërat që më pëlqejnë, dëshiroj nga këndi im t'i interpretoj dhe të jem sa më korrekt. Artin nuk e kuptoj garë. Shkruaj, pra, për vepra që më nxisin të mendoj dhe kur ndiej nevojë të them diç mbi atë që më ofron kënaqësinë time personale. Nuk do të thotë se ç'më pëlqen mua, t'i duartrokasë edhe pazari.

Poezitë e Sabit Gecajt kam pasur rastin t'i lexoj para një dekade dhe kam dëshiruar emrin e tij ta has sa më shpesh. Pranoj se mua nuk më pengon paraqitja e akcilit krijues. Vetëm mediokri mund ta ndiejë veten të rrezikuar. Në një maramendth kombëtar-njerëzor, poezia e këtij poeti disi të trimëron dhe të jepë shpresë se arma e vetme në këtë moment dramatik për qenien tonë mbetet edhe fjala, vepra e dinjiteti ynë kombëtar.

Në botim të "Rilindjes", doli libri i parë i poezive të Sabit Gecajt me një titull simbolik, domethënës: "*Hijet e shiut*" (1998). Poezia e këtij libri ma forcon mendimin tim të hershëm për këtë poet, i cili edhe me heshtje rrëmben, rrënon dhe refuzon të keqen njerëzore. Se një krijues ka potencial dhe di ç'kërkon, mjafton një varg a poezi të tij ta peshosh. Sabit Gecaj ka librin, ku shtrohen çështje ekzistenciale për njeriun tonë në kohën e betonit dhe të armës kur fillon edhe tëhuajësimi i tij, bredhjet me duar në xhepa poshtelart Evropës. I përbuzur, i ndjekur dhe i akuzuar se Evropës ia prish dhe rehatinë me fishkëllimën e një melodie nga vendlindja. *Shpirti vuan shqip*, thotë Gecaj në poezinë, *Mbrëmja dhe unë* (fq. 83). Reagimi i tij nuk duhet të kuptohet si patetikë, por si dëshmi e një kohe të ligë që na nëpërkëmbë.

Gjuha e vetmisë

Qeniesore është për krijuesin se ç'kërkon nga teksti i vet. Sabit Gecaj di pse shkruan, artikulimi i tij lë përshtypjen e një mjeshtri të rryer. Poezia e tij nganjëherë na është edhe një dush i ftohtë për atë, që përdhunon lirinë dhe identitetin e njeriut. *Kjo është koha sot / Jetoj si di vetë / Rrojmë a nuk rrojmë deri te e nesërnya.* /Mbyll hamletçe poezinë “Koha”, fq. 71. Në këtë poezi ajo që përvëlon është *malli* për rrënjën e fisit se: *Mbetesh t'i atje ku jemi ne* (poezia *Kosovë*, fq. 10.). I shkëputur nga trangu, megjithatë Gecaj nuk e pranon humbjen, atë nuk e pranuan as baballarët tanë në një kohë më të rëndë ndoshta. Ajo e bekuara (lexo: Kosova) mbetet atje ku i kemi gëzimet dhe varret. Këtë përcëllim, që shkallëzohet, Gecaj e veneron nga katet e kohës së betonit, ku njeriu është më se i tëhuajësuar, bile dhe të harrojë se ç'është: *Pa nacionalitet / banues i këtij treni urban / Që me vetveten beshtë shqipt* (Poezia *Miku im nga treni* fq. 22). Do të thotë se kurbetçarin pas do ta ndjekë vazhdimisht ndjenja e tragjikës, mu për këtë ai detyrohet të mësojë edhe gjuhën e vetmisë, bile sa për të bashkëbiseduar me vetveten.

Poezia e Gecajt edhe kur na bëhet se ka shenja të kozmopolitizmit, pasojë kjo ndoshta e një mjedisi e urbanizimi të theksuar, në tekstin e vet inkuadron diç nga përkatësia e tij. Kështu, komunikimi i tij me vetveten dhe botën përmes gjuhës së vetmisë, ka edhe shenjen shqiptare. Kjo kurbetçarini e ngushëllon dhe i jep kurajo për një marshim të ri e më fatlum. Se, Evropa ka zënë të bëhet më e vogël për ne. Kur e them këtë, kam parasysh pjesën dërmuese të poezive të këtij poeti, ku dëgjohet kumti i atij gazi të hidhur: *Mjerimi, urbanizëm i përkryer* këlthet me dëshpërim në poezinë *Urbanizmi* fq. 28. Apo: *U çorrën maskat e kuajve* (*Narvisët*, faqe 55), ose padëgjueshmërinë e një rebeli të heshtur e përplas me sarkazëm ndaj gjithë asaj që ndodh në Kosovë: *E di se bëni jetë me qenin* (poezia *Ditëmbërnya*, fq. 59).

A do të shfaqet e nesërmja e jonë?

Ky libër dallon edhe për gjuhën e pastër figurative, posaçërisht për koncizitetin e të shprehurit poetik. Pak gjë mund të heqësh nga trupi i hedhur i poezisë, ose të mos pajtohesh me atë që poeti e ngrit si problem. Disi na ofron krejt ç'posedon mbasi *e vrazhë çdo ditë nga pak* (Poezia *Internista*, fq. 9). Ky është, ndoshta, dhe shkaku i tensionimit dramatik në qëndrimin e tij si njeri e poet. E, këtë e thotë me një sintaksë të rëndë që në distancë kohore, në mes të krijuesit dhe objektit, përflaken dhe: *Nuk dëbet fituesi* si konstaton dhe akuzon poeti në *Ndajnatë* fq. 66. I bindur se popullit të tij i është imponuar fataliteti, copëzimi e rrënimi i tij, sheh se ai bëhet *pjesë e botës së marrë* (*Shqiptarët*, fq. 78.).

Fat është se ky poet ka për yrnek poezinë eliptike me një kundrim vetanak, duke pasur qëndrimin ndaj eksplodimit individual e njerëzor. Leximi i këtij libri mesazhesh e deri të kompozitat e leksiku i pasur, na bëhet se revolta e tij prej intelektualit vepron edhe në formësimin dhe avansimin e përmbajtjeve tekstore. Librat e mirë lëvizin gjërat dhe shndërrohen në ortiqe. Me *Hijet e shiut* Sabit Gecaj na shtyn të mendojmë: çka më tutje, nëse nuk shfaqet e nesërmja e jonë?

(1998)

A DUHET SHKRUAR LIBRI I RI I DHIMBJES?

Shkapërderdhja e gjuhës

Poezinë *Të Guri i Prevezës* e kisha mbyllur me një klithmë tragjike: *Mjери u....* e kisha përdorur trajtën e vjetër të përemrit vetor *unë*, që ishte shfaqur që moti te zoti Buzuk. Por nuk besoja se gjatë tërë udhëtimit, nga Janina në Korint apo, siç thoshte M. Kuteli, nëpër Ilirinë e Poshtme, do të më bezdisë ajo *u*, siç më kishte ndodhur më parë në disa fshatra arbëreshe në Kalabri. Trajta e vjetër e përemrit vetor me atë theksin hundor, më shtynte të besoj se etnia vërtet dikur kishte ekzistuar dhe kishte pasur një shtrirje të madhe, por në shpërbërjen e saj ishim fajtorë mu ne, ndoshta. Kjo trajtë ngërthente një bukuri dhe dëshmonte lashtësinë e thellë të shqipes, ndoshta dhe *Tej Iliadës*, siç do të thoshte poeti Xhevahir Spahiu.

Tkurrja e përemrit vetor deri te një zanore e vetme me atë theksin hundor mund të lexohej, para së gjithash, edhe si tragjikë e vetë gjuhës, e cila, kur nuk kultivohet, derdhet deri te format më të pabesueshme. Konkretisht, përemëri vetor *unë* nga trupi kishte humbur gjatë udhëtimit deri në kohën tonë dy shkronja. Ato, ndoshta, nuk ndikonin aq shumë në formësimin e përmbajtjes, por linin shteg se pas një kohe zanorja *u* me theksin hundor mund të zhduket. Ishte e pranishme, pra, vdekja e ngadalshme, derdhja e shkronjave, e fjalëve dhe e vetë gjuhës. Me këtë mbyllej fati i dhembshëm i një populli të lashtë në një udhëtim mjaft traumatik. Shpërbëheshin lokalitete, toponime, sisteme, të bëme, kujtime. Bile edhe një udhëtim çfarë ishte ky mjaft tronditës, që e bëja në vitin 1988 nëpër trojet e shkombëtarizuara, siç do të thoshte Kadare, do të tregoj vetëm si një udhëtim i një bredhacaku, që kishte dalë t'i gjejë shqiptarët ku janë e ku nuk janë.

Dhe, nuk ishte hera e parë që humbja udhën, duke i kërkuar fshatrat arbëreshe. Tek udhëtoja në Mazara Del Vallo në Trapani për pak e kisha lënë edhe kokën. Ç'm'u kishte shfaqur një Mari, e cila më kishte mahnitur. Por nga të gjitha sjelljet e fjalët e saj më ishte ngulitur në kujtesë ajo // hundore. E kujtesa është e tmerrshme, nuk të lë rehat derisa të harxhohet.

Zonat gri

Vitet e tetëdhjeta mbylleshin me shkatërrimin e ish-Jugosllavisë dhe me rrëshqitjen e Kosovës tehut të humnerës. Shqipëria, bënte sehirë me atë ç'ndodhte tej murit, megjithëse trandjet kishin filluar edhe atje. Shembja e binasë së diktaturës shqiptare në fillim të viteve të nëntëdhjeta paralajmëronte tërmetet shqiptare. Përgjatë sheshit "Skënderbe" ishte tërhequr zvarrë shtatorja e Enver Hoxhës nga piedestali deri te Universiteti, ku bënë grevë studentët. Pastaj ishin rrënuar edhe shumë monumente ose ishin sakatosur.

Në një farë mënyre, ndodhte diç me përmasa të mëdha shkatërruese. Ne shqiptarët, fatkeqësisht, mendojmë se çdo gjë duhet të fillojë nga fillimi. Kjo më kishte qitur në hall se ç'duhet bërë më tutje. A duhet gjërat të lexohen ndryshe, apo përsëri të shkruhet libri i ri; të shkundet kujtesa, realiteti. Më e dhimbshme gjatë stuhisë është shkatërrimi i vlerave. Këtë e kisha veneruar edhe në Dodonë, Janinë, Artë, Prevezë e në shumë lokalitete ilire, përgjatë detit Jon. Ndodhi kjo edhe në ditët e sotme, kur më së shumti sulmohet kujtesa.

Rreth zhdukjes së vlerave, posaçërisht të gjuhës, kam lexuar edhe libra. Por nuk më hiqet nga kujtesa një e bëmë e një miku tim. Tek bënte një udhëtim në Hilandar, ku nuk dihej a ekzistonte më *Pyrgu i Kastriotëve, kishte vetmuar një të urtë* si vraponte Malit të Shenjtë dhe zbriste atje poshtë te Uji i Madh. Rrinte gjatë aty dhe pëshpëriste diç më tepër për vete. Dikur mbyllej në një të çarë shkëmbi. Nuk shihej derisa në kujtesën e tij të ndodhte diç. Atëherë e hidhte veladonin krahëve dhe lëshohej atje poshtë. Mikut tim kjo i kishte bërë përshtypje. Një ditë e kishte shoqëruar pakëz si tinëz. Kur ai i

ishite afruar ujit, kishte filluar të pëshpëritet. Miku im mezi kishte kapur fjalët *krip ujë*. I ngazëllyer se, më në fund, edhe në Malin e Shenjtë kishte takuar një njeri të gjakut të vet, i afrohet, por ai kishte hedhur veladonin krahëve, kishte ikur vrap në të çarën e vet në shkëmb. Më vonë më kishte treguar se prapë kishte shkuar atje, por kurrë më nuk e kishte takuar atë hije të çuditshme as në atë çarje shkëmbi.

Dhoma suedeze dhe kënga Jon

Brenda një dhome të bardhë suedeze në Stokholm qëndroja i shtrirë. Ballë meje, në ekranin e TV-së ndodhte invadim i madh i shqiptarëve në dherat italiane. Shqiptarët kishin shpërthyer, më në fund, kafazin e diktaturës. Gjithçka kishte një lëvizje marramendëse. Uji i Madh nuk u binte as deri te gjuri. Por nuk dihet sa arritën të gjallë në bregun tjetër. Dhe dy suedezet, të cilat kujdeseshin për kurimin tim e që mëngjes për mëngjes më shpienin në një sallë, ku asnjë minutë nuk rrija i varur për këmbësh, pastaj më shtrinin në një tavolinë dhe fillonte masazhi, kishin veneruar se ajo që ndodhte në ekranin TV me refugjatët shqiptarë ndikonte edhe në lëvizjet e mia. Në të vërtetë, kisha harruar dhembjet, se fati im qëndronte në duart e atyre dy suedezeve që kishin harruar buzët e tyre atë ditë kur më përcollën. Nuk di, a do ta takoj ndonjërin. Por udhëtimi ishte i gjatë e i mërzitshëm. Nga veriu në jug qiellin e Evropës e kisha shikuar në kokërr të shpinës. Dhe, për herë të parë, kisha dëgjuar këngën *Jon*. Nuk dija asgjë kush është Ardit Gjebrea, as nuk më shkonte mendja se diku, rrëzë Dajut, me Xhevahir Spahiun do të kalonim një natë të gjatë mbi tekstin e këngës *Eja*, e cila e lansoi në orbit të këngës së Mesdheut.

Dhe tek e dëgjoja këngën *Jon* përgjatë Evropës, m'u kishte kujtuar Deti Jon, Guri te Preveza, pastaj ai përemri vector *u* me atë theksin hundor, zënia me një arvanitas, kur më kishte thënë se a dëshiron të shohësh Itakën, unë kisha shtuar, nuk di a do ta gjej aty Penelopën.

Lutja jonë

Në mes dy pikave isha paraqitur. Arditi më kishte përcjellë me vëmendje. Pakëz i shqetësuar: Ah, kjo Shqipëria xhuxhe! Miku im, Ilir Shaqiri, kishte komponuar një këngë vërtet të bukur mbi këto vargje, por ia kishin refuzuar me motivacion se Shqipëria, siç thonin, nuk është xhuxhe. Dhembje kjo, por unë që kisha mbetur jashtë kufijve të saj, nuk më dukej më e madhe. E shihja pakëz më ndryshe. Dikur Arditi kishte kënduar edhe këngën *Jon*. Pastaj ishte lutur në skenë, të mos përsëritet më ajo tragjedi. Shqipëria të mos bëhet më xhuxhe. Ishim lutur të gjithë aty në midis të Brukselit, në një sallë, ku nuk kishe ku e hidhe gjilpërën. Por Zoti nuk na kishte dëgjuar. Uji i Madh prapë na kishte mbyllur në gjirin e vet, se shqiptarin vdekja e gjen ku nuk është. *Mjeri u* e kisha mbyllur poezinë *Te Guri i Prevezës*, një baladë që nuk dëshiroj të përsëritet më për viset e shkombëtarizuara.

A duhet shkruar libri i ri i dhimbjes?

KARAMBOLLI SHQIPTAR

BABILONIA SHQIPTARE

Kur bajraktarët shohin ëndërr të keqe

Shqipëria është rrënuar shpesh deri në temel, por është ngjallur si feniks për inat të vetë ne shqiptarëve. Mbetëm dashnorë të egjër në dashurinë e respektin e saj. Asnjëherë nuk mësuam, as ditëm ta duam e mbrojmë, bile as në momente kur ajo kërkon dorën tonë. Pas çdo rrënimi ajo u xhuxhëzua; ose të përdor nocionin domethënës të mikut rebel, Maks Velos, *Shqipëria u qeth* si dele vit për vit, ose kur panë bajraktarët ndonjë ëndërr të keqe.

Në mënyrë thuaja të pavetëdijsëm në këtë sjellje kemi dorë dhe ne krijuesit. Shpesh frikacakët i ngritëm në piedestalin e heronjve, krijuam kulte nga ta, diçka me përmasa mitologjike. Pakëz herë ishim kritikë se me atdhedashurinë mashtronim brezat e ardhshme. Dhe tashti kur shikon masmediat botërore, nis e gërditësh, të vjen të çosh dorë. Ku është Shqipëria, ajo e këngëve tona, e përrallave, e hyjnive? Në cilin planet shpërngulet? Ku banojnë? Nuk shihet as në bisht të Evropës! Në hartat e të mëdhenjve mbetet një zonë humanitare, ku ushqehet e mbahet gjallë nga marsovcat.

Shqiptarët kalojnë detin me gjysmë dërrase

Patër Anton Harapi, njëri ndër kokat e ndritura të kombit, në shënimet e veta për të bëmat e shkatërrimet e vazhdueshme të Shqipërisë, thoshte edhe këtë: *Ngatërrohemi shoq me shoq dhe vetë krijojmë Babyloninë shqiptare, pa qenë të zotët t'i gjejmë fijen lamshit...* E kishte veneruar tragjikën dhe ishte turpëruar se trimëria shqiptare derdhej më shumë mbi kokën shqiptare, në rrënimin e asgjësimit të vetvetes, se atje ku duhej shkrepse rrallë.

Vetëdija kritike të pjesa dërrmuese mungoi. Dhe nuk pat efekt as atëherë kur Faik Konica, Fishta, Noli e shumë të tjerë patën guxim intelektual të thumbojnë “burrërinë” tonë, injorancën farefisnore, fodullëkun, bajraktarllëkun që shpënin në derdhje. Mbetëm popull sojlinj, me diplomë.

Në një kohë makabre, a mund të bëhet sehir, të rrihet duarkryq? Shqiptarët e kalojnë detin me gjysmë dërrase, shqiptarët ndërrojnë identitetin për një cigare; për një grusht parash armikut ia shesin tankun, armën, nderin... Nga qytetërimet mësojmë atë më të keqen që bota i ka hedhur në plehurina. Dhe para një kopeje të shtthurur, a mund të rrihet duarkryq? U prish rendi ynë shtëpiak, kombëtar, etnia. Bukuria vuri syzat. Nuk ia sheh më kush sytë ç'shkëndijnë e ç'thonë. Micsokolat skajohen, thyejnë qafën me ndonjë makinë apo rrospi të bodrumeve të Evropës. Dhe rodi ynë rrëshqet, se nuk duam atdhe, siç thoshte Noli.

Njerëzit e akullt

Dhe vazhdoj leximin e shënimeve të Patër Anton Harapit, nga të cilat nuk mund të mos e veçoj një sekvencë për njerëzit e akullt, indeferentë: *Në Luftën e Waterloos i qe paraqitur Napoleonit - thotë shkodrani i urtë - një kryetar komunije i cili, tue deklaruar vehten asnjans, mendoi të justifikohet. Vranje - tha Napoleoni - venje në plumb menjëherë, pse armikut qi të*

del përball i goftë falë, por ky që rrin i mëshëfun n'apathin e vet, ky asht ma i rrezikshëm, pse jo vetëm anmik, por spekulator i dobët.

Ky urtak nuk është i vetëm. Na tërhoqën vërejtjen edhe shumë të tjerë se kur rrënohet shtëpia nuk rrihet duarkryq. Për hir të çështjes kombëtare Atë Gjergj Fishta, poet ortekian sensibil, kishte sakrifikuar disi idealin e vet krijues (satirën, lirikën), pra talentin e kishte vënë thjesht në zgjimin kombëtar. Ia kishte hyrë të shkruajë epin kombëtar me rekuizita e qasje tjetërfare për arsye që dihen: masës ende të pavetëdijësueshme e të pashkolluar t'ua kujtojë të kaluarën e tyre të lavdishme, siç ishte *Lidhja e Prizrenit* (1878) dhe si duhet mbrojtur hisen tënde. Sipas gjeniut, krijuesi në momente të caktuara duhet të sakrifikojë edhe rehatinë e vet. *Labuta e Malcis* (1905-1937) mbetet vepër madhore e zgjimit tonë kombëtar, por jo vepra më cilësore artistike e Fishtës. Ekzistojnë momente, pra, kur krijuesi çon dorë edhe nga ideali i tij krijues për shkak të çështjes kombëtare. Poeti hungarez Petëfi thoshte: *për atdhe jap edhe dashurinë*. Në mes njeriut dhe kafshës nuk qëndron dallimi vetëm te grazhdi.

Në mes atdheut dhe ikjes

Në kohën e marshimit të egër hitlerian, zoti Breht kishte ngritur zërin kundër marshimit të popullit të vet që Evropën e kishte hedhur në majë thike. Ishte fort i bindur poeti se ata nuk luftonin për çështjen e tyre kombëtare, por për çështjen e armikut. Të njohura janë poezitë nga *Abetarja gjermane*, që mbajnë ndezur vetëdijen mbi fatin njerëzor. Por, ne ç'bëjmë? Hamendemi në mes atdheut dhe ikjes: ku ta qesim hapin, ku të fshihemi e ç'të bëjmë! Për çështje kombëtare ai që nuk bën diçka, nuk mund ta paramendoj si e përjeton kënaqësinë, bile edhe kur bukuria fsheh sytë e përлотur.

Apo fillon kohë e treshjeve, se qyryk na doli fara.

SHQIPËRIA FOTOGRAFI E DHEMBSHME E ILIRISË

Se Iliria ishte shkatërruar kështu apo ashtu; se në rrënimin e saj kishin marrë pjesë faktorë të jashtëm romakë apo fise sllave; se këtë e kishin bërë për këtë e atë qëllim, nuk mund të merren më si supozime serioze. Rrënimin e Ilirisë e përjetuam edhe në kohën tonë, kur Shqipëria u rrotullua mbarë e mbrapsht. Pra, pasqyra më e mirë e rrënimin të Ilirisë është vetë shkatërrimi i Shqipërisë, e cila nuk mund të shkoqet nga viti zero derisa të shndërrohet në një njollë të tmerrshme, që dikushi me një gomë ta fshijë si një gabim që e paska krijuar i madhi. Ai i madhi nuk mund të jetë shqiptar. Shqiptarët ai mund t'i ketë rrogtarë në rrënimin e vetvetes.

Iliria, pra, është rrënuar nga brenda, atë e ka shtyrë edhe faktori i jashtëm, ashtu siç ndodh sot me Shqipërinë, me vetëshkatërrimin tonë kombëtar, me vandalizmin e paparë që do të hyjë me siguri edhe në Librin e Ginisit.

Shqipëria në bixhoz

A rrënohen institucionet e kulturës? A fshihet kujtesa e kombit? Kush dëshiron shqiptarët si komb e shtet t'i nxjerrë në margjina? Dhe, a i kujtohet kujt nga ne se deri ku shtriheshim e ç'humbëm deri tash? Nuk ka nevojë, ndoshta, të komentohet se kush ka dorë në gjithë këtë çmenduri tonë. Por si të dilet nga ky kaos, anarki kombëtare? Kombit e shtetit tonë si t'i kthehet kredibiliteti i humbur para të tjerëve. Është e tmerrshme t'u zgjasim dorën edhe armiqtë tanë të përbetuar, është e tmerrshme të vëmë çdo gjë tonën në bixhoz për kurr gjë send.

Nëse e ardhmja e Shqipërisë po u varka nga heqja e një njeriut, le të shkojë. Por a duhet me ndërrimet e brendshme shqiptare vazhdimisht Shqipëria të gjendet në vitin zero?

Ne jemi yrnek popull, që nuk mësuam gjë asnjëherë nga historia! Por disa gjëra nuk bën t'i harrojmë. Ato duhet të përsëriten më shpesh, si poezitë e bardit tonë, Naim Frashërit. Në fillim të shekullit që po e lamë, ministri i Punëve të Jashtme i Rusisë Cariste kishte deklaruar: Në shekullin XXI shqiptarët do t'i hedhim në det. As katër vjet nuk na ndajnë nga apokalipsa që e kishte paralajmëruar mendermethani nga shkurra e ftohtë. Kur ai e thoshte këtë, një burrë tjetër, presidenti i SHBA, zoti Uilson, Shqipërinë e kishte mbrojtur të mos bëhet më xhuxhe; pra, ishte kundër shpërbërjes së Shqipërisë.

I përmenda këta dy shembuj t'ua kujtoj micsokolave tanë se në çfarë ujërash noton anija jonë, por dhe nipave të zotit Uilson që punë serioze nuk më duket nëse demokracinë e brishtë shqiptare lejojnë ta rrënojnë mafia apo ndonjë forcë tjetër e pidentifikuar.

Është e qartë se SHBA-ja dhe Evropa janë lodhur nga Tugimani, Milosheviqi, Izetbegoviqi, prandaj kërkon të shkojë edhe presidenti i Shqipërisë. Por kam frikë se me shkuarjen e tij mos shkon edhe Shqipëria. Brenda e jashtë saj ndodhi tradhti e madhe. Mos po e përjetojmë edhe njëherë derdhjen e Ilirisë. E atëherë, kë e kush të fajësojë?

Injoranca shpie në kasaphane

Demokracia shqiptare kuptohet se nuk bën më të jetë e brishtë, gjithkush ta rrënojë. Në të duhet të korrigojohet shumëçka. Dhe, atë duhet ta bëjmë ne vetë shqiptarët në mënyrë të civilizuar - pa derdhje gjaku; tok nën flamur ashtu si në vitin 1912. Nëse ka nevojë, t'u kallëzojmë të tjerëve se dimë edhe të vdesim për *atme e fê...*

Asgjë nuk paska sharë Konica, Fishta, Noli e kokat e tjera të revoltuara të Kombi. Ndoshta kohë e tyre tek troket. Kushedi.

Shqipëria nuk bën të jetë kohë e shkuar! *Rroftë Shqipëria edhe pa mua*, thoshte Patër Anton Harapi. Por burrat, si duket, kanë vdekur. Ne përmorravemi, duke i shitur mend njëri-tjetrit. E nuk kemi ideal as organizim kombëtar. Deri kur kështu, zotërinj?...

Flitet se Lamerika bëhet Lamers. Kuptohet, injoranca të le pa atdhe, shpie në kasaphane...

(1997)

JU LUTEM, PAKËZ DASHURI, DINJITET...

Realiteti i hidhur shqiptar nuk bie nga masmediat botërore. Çmenduria jonë na shpie buzë humnerës. Kaq e paska trimëria jonë! Me ditë turpërohem nga vetja. Asgjë nuk bëmë në qetësimin e shpirttrave e kokave të ndezura atje në Shqipëri. Pak fjalë të miqve të mi arrijnë. Pak dëgjohemi. Nëpër fise e çatia janë tërhequr; nëpër mëhallë e shpella mbyllur. Të tillë qenkemi para apokalipsës sonë. Truri ynë mos pushoi, apo romantizmi ynë i rremë na u shndërrua në zhgënjim gjithëkombëtar?

A u besohet mesazheve?

Ngritet dorë edhe nga vendi. Ka vdekur kurajoja intelektuale e dinjitetit kombëtar! E shohin Shqipërinë si një cukël të hedhur ndanë udhëve, qyqe. E përplasim kush më parë të çohet. E fyejnë. E derdh rrugaçësia si një gotë ujë. A mund të besohet në idealin; në mesazhet e miqve të mi në poezi, romane, libra e shkrime të tjera? Nuk prononcohen as kur pajtimi kombëtar u lëshon thirrje se vendi është në rrezik. Mos o zot, burrëria të jetë veshur në dimi grash!

Sipas gazetës italiane “Corriere Della Sera” forca të errëta të Verio-Epirit hynë e dalin në Shqipëri. Avokati Lykourezous, i njohur për shovinizmin e tij ndaj nesh, merr në mbrojtje, si thonë rebelët e jugut. Kjo do të thotë mjaft. Në tragjedinë tonë kanë dorë edhe të tjerët.

Dhe, tek përcjell apokalipsën shqiptare në TV, dhoma ime “pushtohet” nga britmat e lutjet e fëmijëve, nënave, të plagosurve. Përmes valëve të Radio Tiranës në Kosovën e përgjakur arrijnë këlhithjet e fundit për shpëtimin e Shqipërisë dhe dinjitetit kombëtar.

Qanin ata apo unë? Po lutjet e tyre kush t'i dëgjojë, kur çdo gjë rrënohet pa mëshirë. Çfarë demoni na tërheq në vetzhdukje?

Nuk jam njeri emocional, as përkrah këtë apo atë parti. Jam në anën e Shqipërisë së fyer, të rrënuar; jam në anën e miqve të mi të përgjakur nga kapuçonët e mafia e paidentifikuar. Rreth realitetit shqiptar kam një vetëdije kritike; më dhimbsen bredhjet se vazhdimisht u vonuam. Nuk mbroj, pra, as Berishën, i cili nuk e kuptoi përgjegjësinë historike. Ai është president i Shqipërisë, jo i partisë që e solli në fron. Populizmi e retorika e ndezur e tij thelloi konfliktin në mes partive, popullit, krahinave. Humbi shansin të mbesë figurë dinjitoze si president i parë i shtetit demokratik në historinë moderne shqiptare. Në rënien e tij nuk ndikuan vetëm rrymimet brendashqiptare.

Kisha një parandjenjë të çuditshme tek shkruaja tekstet e librit *"Tkurrja e Atdheut"*. Hapësira kulturore-jetësore-historike vazhdimisht tkurrej. E ndieja se po bëhemi më të vegjël, xhuxhimaxhuxhë; se rrënohej dinjiteti ynë kombëtar, toleranca, dashuria, mirëkuptimi, besimi brenda nesh. Grykësia, pakënaqësia, kurbeti na nxorën jashtë vetes, ashtu siç nuk e kishim ëndërruar. Filloi shturja, armikun duke kërkuar te njëri-tjetri, fajet për ngecje duke ia lënë njëra-tjetrës partitë, duke u larguar nga Evropa me sjellje vandale. Dhe, rënia jonë vazhdon. Ky është triumfi i atyre, që duan të na shohin pikë e pesë, xhuxhimaxhuxhë...

Vetëshkatërrimi ëndërr e bukur për të tjerët

As Serafimi i Athinës, as Pavli i Beogradit nuk ka parë ëndërr më të bukur se shkatërrimin e vetë Shqipërisë. Nga një katrahurë e tillë frikësoheshin edhe kokat e mençme të kombit tonë. Keqdashësit kërkonin pikën tonë më të dobët, të na nxjerrin edhe jashtë interesimeve të të mëdhenjve, hilja e të cilëve shpesh nuk mungoi rreth zgjidhjes së çështjes shqiptare në Ballkan.

Ndaj shtrohet një pyetje qeniesore: A dimë edhe ne diç të ndërtojme; a mund t'i gëzojmë fëmijët tanë? Për një çast, a bën të

ndahemi nga fataliteti ynë, t'i bashkohemi historisë më të re të njerëzimit dhe me çmendinë tonë të mos i argëtojmë të tjerët?

Me ditë nuk pran barbaria jonë. Është bërë hit i primitivizmit të një populli antik në masmediat botërore. Në këtë fundshekulli, lutem për pakëz dinjitet e dashuri për vendin tonë të copëzuar, të përgjakur... Kam frikë se në shekullin e ri trokasim si fis. Faik Konica me kohë ishte lutur: Shpëtoje zot Shqipërinë nga shqiptarët! Truri ynë, mos pushoi?

(1997)

A ËSHTË PROFESION VRASJA?

Bajram magjupi i taphanës së qytetit tim

Sa herë lexoj një poezi të Karl Sandbergut mbi *xhelatin*, më kujtohet njëfarë Bajram Magjupi i Taphaneve të Gjakovës. Ai ishte *kasap* me nam. Dhe sa herë kaloja atypari, e shihja Bajramin të përgjakur deri te qimja e flokut. Para derës mprehte thikat dhe në fytyrën e tij i derdhej një hije e rëndë mortjeje. Mendoja me ditë: Ky Bajrami, sa kafshë ka therur athua?

Duke lexuar poezinë mbi *xhelatin* isha mahnitur me Karl Sandbergun si i portretonte vrasësin në mes familjes së tij, duke përshkruar nga duart e ndjeshme deri te futja e kafshatës në gojën me ca dhëmbë të rënë. E kisha parafytyruar pastaj përkëdheljen e tij ndaj gruas në shtrat dhe fëmijëve rreth tryezës së ngrënies. Dhe çdo lëvizje e bënte thuaja se asgjë nuk kishte ndodhur pak më parë edhe pse, ndoshta, e kishte dërguar ndonjë bashkëqytetar të vetin në botën tjetër.

Dhe nuk di, poeti punën e xhelatit e konsideronte profesion apo te ai dëshironte të zbulojë edhe diçka njerëzore. Qëndrimi i tij disi më shqetësonte. Por sa herë i kthehem kësaj poezie, nuk mund të mos e kujtoj Bajram Magjupin e Taphaneve të qytetit tim. Dhe, nëse puna e tyre *të therrësh e të vrasësh* qenka profesion, atëhere çfarë profesioni njeriu duhet të refuzojë? Vërtet, njerëzit më të qetë na qenkan vrasësit!

Kisha shkruar një poezi me titull *Gjaku i zi*. Më kishte mbetur në kujtesë një detaj makabër nga fëmijëria. Aty në breg të Erenikut zbritnin fshatarët dhe ua prenin veshët deleve. Thonin se i lironin nga gjaku i zi. Nuk m'u kishte hequr sysh ky detaj, që më i tmerrshëm bëhej kur në imazh shihja edhe fytyrën trashalluke të Bajram Magjupit

dhe xhelatit, që hante bukë me fëmijët e vet pa kurrfarë vrasjeje ndërgjegjeje.

Shpesh ia kisha shtruar pyetjen vetes: Po çfarë na qenka ky gjaku i zi? A vetëm *kasapi* mund të na shpëtojë?

Këto ditë m'u kujtuan valët e Erenikut, pastaj kolona e fshatarëve të shqetësuar, që binin aty dhe u prenin veshët deleve. Nga goja më gojë kalonte sintagma: *gjaku i zi*. Isha fëmijë atëherë. Më vonë mësova se edhe njerëzit i zë gjaku. Kjo ndodh më shpesh kur nuk kanë ç'bëjnë dhe kur çohen pesh në kokë të vet. Duke parë sekvenca llahtarie nga masmediat botërore, të cilat shqiptarinë e qitën në kokërr të shpinës dhe duke dëgjuar se Shqipëria shpërngulet në një planet të humbur, pëshpërita më tepër për vete: Mos duhet të lirohemi nga gjaku i zi?

Diçka kjo e dhembshme. Absurde.

Kapuçonët, emër i tmerrshëm

Lajme të zeza arrijnë nga Arbëria e derdhur në hundebuzë: Kaq e kaq të vrarë në filan qytetin, fshatin; kaq e kaq fëmijë të djegur nga baruti e breshëria; kaq e kaq murana e nishana, që vështrë mund t'i zinte ndonjë poezi e Vaso Pashë Shkodranit. Shqiptarët më nuk i shpëton as flamuri i bardhë! Në fund të detit fundoset liburna jonë luftarake, që nuk kishte mundur ta godasë as Cezari. Më kujtohet "Titaniku", por për shqiptarët kush nuk e çan kokën. Thonë se u prishin zotërinjve të Evropës imazhin mbi lumturinë në kurrizin e varfënjakëve. Nuk i ha palla kujt, le të mbyten sa më shumë. Para syve të Evropës vepron hapur mafia, se burrëria vdiq tek mungoi ligji, shteti. Kanë marrë ikën "trimat" e Arbërisë, kur Kosova ngul në rrafshinën e vet e Evropa përgatitet të mbyllë pazarin pas invadimit në dherat e shqipeve.

Në pikë të ditës, në midis të Tiranës, poetin e mikun tim, Xhevahir Spahiun, e kishin përgjakur kapuçonët. E numri i të rrahurve shtohet. Ndër të parët ishte Edi Rama. Siç vërehet,

kapuçonët bëhen emër i tmerrshëm. E paskan rrahur poetin. Paska shkruar ca poezi për Vlorën. Unë nuk di për cilën Vlorë; ndoshta atë të Isës, të Qemalit, të Marigonës... Nuk është keq të shkruhet për Vlorën. Krijuesin duhet pranuar bashkë me revoltën dhe po qe se nuk na pëlqen. Xhevahiri është poet i shqetësimeve. E ka tmerruar rrënimi i Shqipërisë. Paska shkruar ca poezi për qytetin e flamurit t'ua kujtojë atyre se ku vënë. Thonë më bukur se aty kund nuk "këndojnë" armët. Prishin qetësi, përgjakin njerëz e ullinj. Arbëria shpërngulet në mënyrë të çuditshme. Patriotizmi i devotshëm nuk e bën një pup. Nuk iket më as në Greqi. Ata e shndërruan Arbërinë në tokë të shkretë, e cila përditë zbardh më e zymtë. Në mënyrë spektakulare bëhet vetasgjësimi i një populli antik.

Vendi i qyqeve

Tek shkruaja poezinë *Gjaku i zj*, përjetoja memecllëkun e tokës, të kohës; ndieja rrëqethje e mallkim. Në hapësirën, që tkurrej vazhdimisht, më kishte mbuluar një dritë e rëndë. Mos duhej ta zgjatja veshin edhe unë. Mezi e kisha parë Majën e Pashtrikut. Në qiellin e shtatë ngjitej. M'u kishin parafytyruar delet, fshatarët, thikat në duart trashalluke të Bajram Magjupit, Ereniku që ndërronte fytyrën... Isha fëmijë. Dhe nuk besoja se do të përjetoja kataklizmën e një ëndrre!

Vendi i shqipeve na shndërrohet në të qyqeve, për shkak të logjikës së fisit, fukarallëkut, diktaturës... Vërtet, profesion na qenka vrasja!

Pa arbër nuk i duhet kujt Arbëria. Ajme për ne.

(1997)

DIKUSH KISHTE LUAJTUR ME NJË POPULL

I.

Në Alenë e Shpëtimtarëve të Kombit një mik, i cili shpesh del në Francë, më thotë se atje vështirë gjen ndonjë shesh apo institucion, që mban emrin e Napoleonit, edhe pse ai e kishte bërë Francën. Pse? Sepse ishte diktator. Më ishte shfaqur parasysh fytyra e diktatorit francez në interpretim të Charl Boajesë në një film, ashtu topolak e i shpejtë. Por, ja, askund nuk kishte mundur të ngulë; asnjë shesh apo institucion nuk ia kishte hapur dyert. E kishte larguar fama e tij shkatërruese.

Kafenë nuk e piva. Gjendesha diku në mjedis të Ballkanit, ku nga diktatorthit me germë të vogël deri te diktatorët me germë të madhe, nuk ka apo nuk ka pasur shesh, qytet e institucione që nuk kanë ngulur. Tani ata më dukeshin gogolë kur miku vazhdonte për Napoleonin. Dhe dallimin në mes Francës e Ballkanit nuk e shihja vetëm te funksionimi i *ligjit* mbi të drejtën njerëzore e shoqërore.

Në krijimtari e arte të tjera kishte ndodhur diçka tjetër. Gati çdo hap i Napoleon Bonapartës ishte shënuar; pra, nga shkëlqimi e perëndimi i famës së tij. Dhe gjendesha një verë krejt afër kështjellës në *Ishull*, ku kishte mbyllur jetën. Por askush, thuaja se për inat, nuk ma kishte treguar se ku gjendej ajo. Isha ndarë i lagur. Ballkanas më, nuk më dëlnin diktatorët e mi. Tendoja t'i shoh edhe të tjerët ç'pamjen kishin?

II.

Ai simbolizonte Shqipërinë. Do të gënjeja po të thosha se nuk e kam dashur. Secili e kemi respektuar në mënyrë të vet. Nuk dinim asgjë se ç'ndodhte tej *Murit*; asnjë haber nuk kishim për kazamate e kampe internimi, ku ishin vrarë e zhdukur, siç thonë, gati aq shqiptarë

sa kishin rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në fytyrën e tij nuk kishte parë kush hijen e djallit. Sa herë përcillte ndonjë shok në botën e teje, në gju ulte ndonjë fëmijë dhe këngtari popullor ia qiste këngën e re. Për hir të së vërtetës, kulti i tij kishte bërë që kush të mos guxojë t'i prekë gurin për pesëdhjetë vjet. Ndoshta mu për këtë truri ishte shpërlarë bukur mirë dhe pakkush dinte se ku bie Çamëria apo Kosova. Nuk mund të harroj pyetjen e gruas së një miku të njohur. Po kur shkoni në Zagreb, Sarajevë apo Lubjanë, udhëtoni me pasaportë? Unë isha shtangur. Kisha shtuar vetëm: nuk di a do ta arrij atë ditë... Miku e kishte shikuar me ironi gruan. Shpesh më kujtohet ky detaj, që do të thotë shumë. Familja ku isha unë, ishte ndër më të njohurat edhe jashtë. Merreni me mend tani ata, që nuk kishin pasur asgjë... Sidoqoftë, unë kisha qenë në mes profetëve. Kishte edhe të tillë që kishin kaluar nëpër kazamatet e Spaçit, Burrelit...

Në vitin 1993 Visar Zhiti më tregonte si kishte shëtitur një poezi ime nëpër duart e të burgosurve, që e *krijon Antologjinë e burgut* nga poezitë e shkrimet, që u “shpëtonin” gazetave të atëhershme moniste. E imja, si duket, ishte përvjedhur në “Drita”. Pastaj ishim ngjitur Sharrit, Malit të borërave, për ta kërkuar shtëpinë e Vojsavës, nënës së Skënderbeut, aty në Gradec. Në mbrëmje ma kishte lexuar një poezi për të. Po këtë vit, në lokalet e një institucioni të njohur të Tiranës, kisha takuar një këngëtar ndër më të njohurit, i cili sapo ishte kthyer nga Suedia, ku kishte qenë një kohë në ekzil. Dhe, poeti me të cilin ishim ngjitur në Majë të Tomorit, atë e kishte ngacmuar dhe ai ia kishte thënë këngës së njohur: *Mprehu shpatën...* Miku vështirë e pati ta qetësonte. Unë më vete kisha shtuar: për kë kishte mprehur shpatën, vallë?

Vërtet nganjëherë xhaxhi e ngriste zërin, kombëtarja e tij të dëgjohej e të shtrihej si magji edhe tej gurit. Por a mjaftonte vetëm një kollitje? Nuk dua t'u hyj në hak luftëtarëve që bënë luftën për ideal, bile as të tjerëve, që e shtrembëruan pakëz. Por akcili udhëheqës që nguli *Majë* shtetit shqiptar, ne të këndejmurit e respektuam thjesht për shkak të Shqipërisë. Mjerisht askush apo pakkush na bëri me dije se shpesh në krye ndodhi dhe fatkeqësia jonë. Ashtu në mjegull disi

krijua mbi mbi diç që nuk paska qenë ashtu siç e kemi parafytyruar. Kush është fajtor për këtë?

Ndjej dhembje që dashuria ime paska qenë e mbështjellë edhe me një gajtan fatkeqësie... Si duket, ne nuk mund të jetojmë pa dikë mbi kokë. Fatkeqësia na u bë sporti ynë më i dashur, fatkeqësisht.

III.

Krijuesin e mirëfilltë dy gjëra e stolisin: talenti dhe guximi. Nëse këto të dyja shkojnë krahas njëra-tjetrës, mund të ndodhin çudi. Të tillë kam lexuar shumë, ku falë guximit të tyre kanë shënuar edhe momente historike, që ndoshta më vonë i ka nxjerrë historia margjinave. Megjithatë, krijuesit nuk kanë lejuar të kalkuloohen me dinjitetin e bindjet e tyre. Kjo do të thotë mjaft për karakterin e tyre.

Poetin e kritikun *Agim Vinca* nuk e njoh nga sot. Në tre-katër libra të tij gjendet emri im si redaktor. Rreth çështjeve të ndryshme kemi pasur edhe fërkime. Guximin te ky e kam parë edhe si krenari kombëtare, pa marrë parasysh pajtohesh apo jo me atë që e thotë. Mu për këtë e ka pasur të ndezur dritën jeshile. Mendoj se mozaiku ynë shpirtëror nuk bën të ketë vetëm një ngjyrë. Atëherë nuk do të ishte interesant.

Në vitin 1991, pikërisht më 21 shkurt, me rënien e Monumentit të Enver Hoxhës, ra edhe diktatura pesëdhjetëvjeçare shqiptare, ndër më të egrat në Evropën e Lindjes. E kishin rrënuar dhe tërhequr zvarur Sheshit të Skënderbeut deri te Universiteti i Tiranës. Çfarë simbolike! Atë rrënim e kisha parë shpesh edhe në ekran. Mendoj se në atë faqe të re të historisë kryesori kishte qenë vetë *Ramiz Alia*. Nuk kishte lejuar të derdhet gjaku dhe pushtetin e kishte dorëzuar si i ka hije një burrë shteti. Ishte befasuese kjo. Ndodhte në një vend totalitar, ku më parë vdekjen e mendonte njeriu se një gjë të tillë. Por, kur dashka populli, ndodhka edhe e pabesueshmja.

Agim Vinca e kishte kapur një moment historik, që nuk besoj se do të përsëritet në dheun e shqipeve. Poezinë *Rënia e Enver Hoxhës*, kontestuar në momentin kur ishte shkruar dhe botuar e që tani gjendet edhe në librin *Kohë e keqe për lirikën*, (1998). Unë e lexoja

ndryshe nga reaguesit. Ajo nuk madhëron kë, është revoltë që lexohet edhe si zhgënjim. Poeti nuk është në anë të diktaturës. Përmes figurës së Hoxhës ai lirohet nga miti, që deri dje kishim besuar se ishte realitet, i pamposhtur. Në të vërtetë, Vinca shfaqti mendimin e vet si poet e intelektual për diçka që perëndonte aty nën muret e larta të Universitetit të Tiranës e mbyllej turpshëm një epokë mbi mitin e Enverit, siç do të pohojë më vonë vetë poeti. Në tri poezitë pasuese mbi këtë figurë e sidomos në *Paradoksin*, ai i drejtohet Homerit dhe përmes tij kërkon të vërtetën:

Ta shoh

Në y

Verbimin tim...

Me këtë dhe mund të mbyllet revolta shqetësuese e Vincës. Dikush vërtet kishte luajtur me një popull. Çdo gjë tjetër është e qartë. Nuk di a do koment?

(1998)

FRIKA NGA REALITETI

1.

Duke mbrojtur qenien tënde, nuk dëmton të tjerët. Përkundrazi, i liron ata nga më e keqja. Nëse dëshmojmë se vrasjet, torturat, ndjekjet, aparteidi u bënë realitet i mjedisit tonë, ne nuk kemi akuzuar kë; kemi bërë punën tonë qytetare. Ata që kanë shkaktuar plagë në ne, punë e ndërgjegjies së tyre është. Në hapësirën tonë asgjë nuk është transparente, as vdekja që duhet shpëlar edhe më dhe të mos turpërohem. Ndoshta ndryshe mendojnë ata që u mungon guximi se ballafaqimi me realitetin nuk është aq i këndshëm. Por frika nga e vërteta legjitimon dhunën. Mediokri ynë, që mund të jetë edhe një snob krijuesi, më tepër pranon të merret me gjëra triviale, të përqyrravet para këmbëve të ndonjë femre ose në fjalorin e tij fjalë të parë ta ketë *seksin* sesa të protestojë ndaj realitetit.

Të shkruhet për të sotmen mendohet se është një humbje kohe, ngecje pas evropianizmit shpirtëror. Të sotmen duhet lënë të vjetërohet pakëz dhe për kohë më të qeta; kur të flitet, atëherë për të si për borën e parvjetme; ose si diç që ka ndodhur moti, në kohë mitike. Fatkeqësisht, ne nuk jemi atëherë, as kurrë nuk do të dimë se si do të interpretohet koha jonë: vrasjet, torturat, varret masive, ndjekjet, pastrimet etnike të fikësuara, ndoshta, edhe nga syri i kamerës së Hazir Rekës, Sali Cacit apo të Iliaz Bylykbashit, ndonjë ngjyrë të rëndë e karakteristike të hedhur në panotë e Muslim Mulliqit apo poezinë rastësisht të shkruar kur para hundës na shembet vdekja e një njeriu apo e një kulture.

Heqja dorë e krijuesit nga sotmëria shpie tek pranimi i heshtur i asaj që ndodh mes nesh. Pra, legjitimohet çdo gjë se nuk është alarmuar e keqja. E kjo është rrjedhojë e bindjeve të disave, se transparente është të merresh me të përditshmen! Unë mendoj se mungon jo vetëm guximi intelektual, por edhe paaftësia për t'u gjetur

në një kaos të paparë shoqëror-njerëzor. Prandaj alarmimi ynë është i shurdhër. E, kur vritet një njeri a ndodh një poshtërsi në qytetin tënd, Brehti thoshte se duhet alarmuar; duhet çuar në këmbë një qeveri nëse ka nevojë. E ne nuk mund e ngrisim një plesht. Liria totale është liri e të gjithëve, pa marrë parasysh kufijtë e gjuhët. Po ikja nga tragjika jonë do të thotë se ne pajtohemi me fatin dhe me shumëçka nga kodi etikomoral. Vetëdijësimi ynë: harrojmë se vrasja e një njeriu është vrasje e një pjese të qenies sonë; se dhuna është hija që mbulon kë më pak e kë më shumë. Apo: le të vriten shqiptarët sa më shumë; le të ndodhë Gostivari, Bit-Pazari; le të rrënohen e plaçkiten muzeume e arkiva; le të rrënohet çdo shenjë e identitetit dhe të një kulture; more rrafsh me tokë të bëhen se ka mjaft shqiptarë...

2.

Mirëpo edhe historia plakët, harrohen gjërat. Një ditë kujt nuk i kujtohet se diç makabre paska ndodhur këndej pari. Këtë moskujdes tonin e preku në një bisedë pak më parë edhe Ismail Kadare. Vërtet, a na kujtohet Paraqini se ç'ndodhi me fëmijët tanë? Po helmimi? Fëmijët e vrarë e shumëçka tjetër bizare? Memorocidi bën punën e vet. Botën e pikëllon më tepër, bie fjala, vdekja e një princeshe (respekt ndaj bukurisë e mirësisë së saj, por të kishte njohur ndonjë Mic Sokol nga Aleja e Shpëtimtarëve të Kombit, me siguri do të jetonte edhe njëqind vjet) se zhdukja e mijëra fëmijëve nëpër bodrume e kazamate mesjetare. Dhe bindesh se bota është një ndërtim më se i çuditshëm. Shikon profitin e vet më parë. Megjithatë, sotmëria nuk bën të na bëhet obsesion ynë, por nuk bën të pajtohemi me traumat e saj; të lirohemi nga ajo, duke mos harruar të bëmat nëpër të cilat përbirohemi. Sy më sy me realitetin duhet parë. Atë duhet ndërruar në të mirë të momentit njerëzor. Mu për këtë ajo që ndodh brenda nesh duhet alarmuar zëshëm, siç thoshte Brehti.

3.

Si kaq shpejt e harruam një zuzar të Anamoravës, i cili me zuzën e vet bëri derdhjen e një shteti. Ai zuzar u bë njëri nga

segmentet e projektit të një perandorie të rreme. U shkruan libra, u xhiruan filma të të gjitha metrazheve; e nxorën surratin e tij edhe në pano; bile e pranuan për krisht të ri në mesin e të marrëve anamoravësin e ngulur në hu. Shumica e atyre që e kishin vënë në lojë fatin e një kodoshi e dinin se përmes tij luanin me fatin e popujve të tjerë, por nuk besonin se luanin më tepër me fatin e vet.

4.

Gjatë revolucionit spanjoll flitet se nuk kishte mbetur krijues, që nuk i ishte kundërvënë Frankos. Dhe shumë nga ata kishin mbetur hendeqeve, duke mbrojtur dinjitetin spanjoll po dhe lirinë që vinte nga një vetëdijësim i tyre i lartë. Dhe, ata që kishin pasur fat të shpëtonin nga kasaphanja e Frankos, ishin marrë një kohë të gjatë me të vdekurit. Nga mozaiku i përgjakur spanjoll Pikaso kishte punuar kryeveprën e vet, *Geranikën*, ku ishte vijëzuar tmerri dhe madhështia e shpirtit spanjoll para së cilës përulen breza krijësish.

Në kaosin nëpër të cilin përbirohemi, pajtohem se vështirë mund të kapet qeniesorja. Por a duhet të qitet në harresë se nuk kemi jetuar në një kohë makabre. Nëse nuk dimë të gjendemi, nuk është turp të mësohet nga të tjerët, bile edhe nga armiku. Viteve të fundit krijuesit e Amerikës Latine janë mysafirë tanë të shpeshtë. Nuk na u kujtua ndonjëherë t'i shtronim vetes pyetjen: pse gjithë ato vrasje e puçe në veprat e tyre? Apo përmes librit anketë, beseler i vitit, Markezi senzibilizoi opinionin botëror për atë që ndodh në Amerikën Latine. T'i shfletojmë më shpesh dhe tekstet e rok muzikës, ose poezinë e bitnikëve, anarkistëve të rendit, të kujtojmë atë thënien e Llorens Ferlinghehtit: *Mos e pritni revolucionin se ai do të ndodhë pa ju*. Dhe do të bindemi se në to ka më shumë përditshmëri të zymtë e plot dhunë e gjak se në tërë poezinë shqiptare nga koha e Shën Albanit e deri te vaji i fëmijës sonë të fundit.

5.

Nuk rrëmbej bajrakun e asnjë prijsi, ideologu apo qoftë larg patrioti. Them se koha jonë kaq tragjike nuk mund të reprizohet më,

as nuk bën të nxirret margjinave, historinë të na e shkruajnë të tjerët si duan ata. Apeloj, po ashtu, kundër harresës dhe ndjenjës së frikës për të thënë atë që na e kthen vlerën njerëzore; se të merresh me përditshmërinë është diç transparente dhe duhet ajo të zërë vend më shumë në librat tanë.

Askush nga ne, besoj nuk jeton në ndonjë kohë tjetër apo planet të panjohur. Ndaj kaosit, ku notojmë pa dashjen tonë, nuk bën të qëndrojmë indiferentë. Një turp të tillë, nëse pranojmë, publikisht të deklarojemi atëherë se gjithë kjo që ndodh me ne është pjellë e fantastëve; se në mjedisin tonë liri kurrë më shumë nuk ka pasur; se ato vrasje, rrahje, tortura i kemi parë vetëm në ëndërr.

6.

Dhuna serbe bën luftë me të gjitha format për mposhtjen e trurit tonë, se esnafi prodhues mund të korruptohet nëse nuk është bërë kjo. Pakëz humor i zi, por një kikirixhi heq më rëndë se një çetë krijuesish. Pra, vështirë të peshojë liria jonë më rëndë se ç'bëmë për të.

Viktimën, megjithatë, duhet kujtuar nëse nuk mund e mbajmë gjallë, se më tutje “ajo që mbetet e krijojnë poetët”, kështu thoshte Martin Hajdegeri.

(1997)

NË KËRKIM TË SË VËRTETËS

Fenomeni shqiptar

Nuk na pëlqen, por popujt e vegjël shpesh romantizmi nacional i ka sjellë buzë greminës. T’i shfletojmë ca vepra nga historia e artet e të bindemi se deri ku ka shkuar, bie fjala, populli serb. Ndaj historisë shumë pak ishim kritikë edhe ne. Duke u fshehur pas do ngjyrave të ndezura; harruam se duhet vepruar, korrigjuar, bile dhe flakur patosin.

Me shembjen e diktaturës, ne mbetëm gati ata që ishim. Vështirë ndërruam diçka në sjelljet e mënyrën e të menduarit. U ndodhëm para të papriturave. Pakëz gjë mësuam se nuk shkohet me të vjetrën. Filluam të lansojmë diçka, që mund të krahasohet me irealen. Vepruam kështu më tepër për qëllime vetjake, se na pëlqen të dukemi aty ku nuk e kemi vendin.

Para hundës na mbiu, ta quajmë kushtimisht, *letërsia e kazamateve*. Për Arshi Pipën (*Libri i burgut*, 1944 - 1957) e ca të tjerë dinim. Por nuk dinim për një armatë “disidentësh”; se pas rrënimit të diktaturës kush nuk mbet pa e shpallur veten për të rebeluar, bile edhe të deklarohet se kaq net na kishte qenë i ngjuar dhe me tel në nevojtoje kishte shkruar edhe ndonjë varg. Trokitëm në dyer të historisë jo aq dinjitozë. Ndoshta, ishte ky rast fatlum për marshim: një populizëm i marrë, pa taban.

Sapo e ndien veten mirë në tokë, tejmurasit nga bisedat e ndryshme edhe numri i titujve, të shkruara në kazamate famëkeqe e kampe internimi, u vërejt se aty kishte megjithatë një fije dyshimi, një parregullsi e qartësi, se dikush bënte çmos të duket në krye. Përmes sjelljeve, bisedave e grykësisë u veçuan ca këndeje e andej Murit. E, proceset demokratike tek ngulnin në hapësirën tonë. Kapllan Resuli nxitoi i pari të deklarojë se gjatë burgut kishte shkruar hiç më pak se

dyqind mijë faqe tekst! Një deklaram i tillë dëm i solli më shumë autorit, vuri në dyshim edhe një numër të veprave të shkruara në kazamate. Diktatura shqiptare ishte shpallur ndër më të egrat dhe, si ndodhi burgjet shqiptare të na shfaqeshin në do farë “strehimore” krijuesish? Pakkund në Evropën Lindore kishte ndodhur një fenomen i tillë.

Sinqeriteti krijues

Në të vërtetë, nxitimet marramendëse përpiqeshin të dëshmonin se edhe brenda kazamateve truri ynë paska qenë aktiv, bile ai kishte përgatitur edhe revolucionin demokratik që ndodhi. Deklarimet pa kurrfarë kontrolli, zbusin disi vlerësimet mbi diktaturën shqiptare, e cila nuk kishte pasur yrnëk, as nuk mund të krahasohet me asnjë tjetër. Unë nuk kam pasur rast të shoh ndonjërin nga këto kazamate. Kam lexuar e dëgjuar nga miqtë; po ashtu, përmes ekranit e filmave dokumentarë i kam parë ato si duken. Pas shumë mëdyshjeve kam konstatuar se shqiptarët nuk kishin bërë as dinin gjë tjetër vetëm të shkatërronin vetveten; se nga lëndimet e ndërsjella vështirë të lirohemi nga gjaku i zi. Ka shembuj morbidë. Ç’u deshën gjithë ato kazamate në Shqipëri?. Dhe, kur pyetjes i bashkangjiten fakte e dëshmi, se numri i viktimave kishte qenë mjaft i madh, nuk mund të përjashtosh as mundësinë se me ne vërtet paska luajtur dikush, ashtu si kasapi me qengjin.

Nuk hedh baltë mbi ata, që vërtet kontribuan në rrënimin e së keqes. Por në një vend totalitar, siç ishte Shqipëria, paska pasur edhe të guximshëm e qenka shkruar shumë! Nga historia e diktaturës ka shembuj jo të paktë, që nuk mund të mos i shtrosh pyetje, bile vetes. Pikë së pari, çfarë diktature na paska qenë ajo kur të dënuarit me mijëra faqe paskan shkruar (përjashtoj rastin e Resulit). Dhe, së dyti, nëse gjithë ato faqe qenkan shkruar, atëherë nuk paska munguar liria, bile i paskemi rënë në qafë stafit të diktaturës. Ekziston mundësia se tërë kohën paskemi luajtur me vetveten symbylltazi. Por tërë ato viktima kush i shkaktoi?

Nuk janë të gjithë Kallusha

Nuk them se nuk është shkruar, nuk është vepruar dhe se truri ynë ka fjetur. Me siguri është shkruar ndonjë poezi, poemë; është bërë ndonjë skicë tregimi, novele apo romani. Por deklaratimet e shpeshta se janë shkruar kaq e kaq faqe vënë në dyshim dhe rënien e diktaturës, apo diktatura qenka diçka e shpifur, duhet ruajtur nga skajshmëritë. Mu për këtë Kallusha nuk janë të gjithë. Në një mes heterogjen, ku nuk di kush çka është, nën dritën e ndonjë fitilaçi me frikë është shkruar me tel nevojtoze ndoshta ndonjë varg, faqe ditari apo grafit në ndonjë skaj muri, që nesër a pasnesër ta nxjerrë nga aty pasi ta ketë mësuar përmendsh. Të guximshmëve ua heq kapelën. Paskan ditur t'ia heqin maskat diktaturës.

Mirëpo ca të ashtuquajtur disidentë lënë përshtypjen se burgjet e diktaturës paskan qenë “Mekë” për krijimtari; se në to paska ndodhur një fenomen; qenkan shpifje vrasjet e zhdukjet e qindra intelektualëve; do të thotë se ne pa dashje afirmojmë absurdin mbi lirinë e tepërt; se aty qenka krijuar një letërsi e madhe, me vlera të pakontestueshme e që në letrat shqipe troket me zhurmë si *letërsi e kaqzamateve*. Këtu qëndron moskuptimi në mes diktaturës dhe procesit të krijimit. 1) Në asnjë burg, bile as në vendet më përparimtare nuk kam dëgjuar se lejohet krijimtaria imagjinate, e posaçërisht në vendet totalitare, siç ishte Shqipëria. 2) Dikush po qe se është marrë me krijimtari, u është mundësuar vetëm atyre që merren me përpilimin e fjalorëve të ndryshëm apo të ndonjë teksti nga shkencat ekzakto. 3) Shpirti ynë rebelues nuk ka pasur hapësirë të madhe për manovrim, se vigjilenca e syrit të padukshëm ishte në shkallën më të lartë. Pra, i përqendruar në individë të rrezikshëm, që shpesh ranë viktime nga vetë rrethi. 4) Nuk di a ka ekzistuar kund në Evropë si në burgjet shqiptare për njëfarë *grykimi* preventiv ndaj të pamposhturve, që shpesh i ka vënë edhe para togut pushkatues... Ekzistojnë, pra, shkaqe të llojllojshme, që lexuesin e rëndomtë e vënë në një situatë jo fort të lakmueshme: kujt t'i besohet, krijuesit apo përlivanllëqeve të diktaturës.

Letërsia e kazamateve, faqe e re në letrat shqipe, ku shpirti ynë i revoltuar, i pakënaqur, veptoi dhe nuk u dorëzua para mjeshtërive të dhunës, “begatoi” elaboratet e absurdit njerëzor. Dhe nuk pësoi vetëm njeriu. Në një *Ditar* tregohet se në njërin nga burgjet famëkëqinj, dyshimi i gardianëve kishte rënë edhe në një qen leckaman, i cili kishte vizituar shpesh të burgosurit brenda telave gjemborë. Staf i burgut vendos ta “arrestojë” të gjorin dhe pas debateve, i jepet dënimi kapital. Kishin dyshuar se përmes qenit të burgosurit bënin propagandë të tmerrshme edhe jashtë. E, para një vigjilence të tillë të mjeshtërive të dhunës, nuk mund të mos dyshosh pakëz në sinqeritetin krijues të disave, që paskan shkruar me qindra mijëra faqe. Do të ishte në rregull po të ishin peshuar këto pas një distance kohore.

Dritëro Agolli, në mes shumë rasteve të rebelimit intelektual, ma kishte veçuar rastin e Kasëm Trebeshinës, *Promemorien* e tij, dërguar në të njëjtën kohë Enver Hoxhës dhe Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, pra më 5 tetor 1955. Guximi intelektual i Trebeshinës kishte lëkundur çarshinë shqiptare. Në Shqipëri të tillët njiheshin në gishta. Është interesant të ceket se ky krijues, sa di unë, në asnjë libër të vetin nuk e ka vënë as emrin e ndonjë burgu, ku kishte kaluar një kohë. Diktaturën ai e njuh mirë, se gjatë Golgotës Shqiptare i kishte përjetuar të gjitha hidhësitë e saj, por nuk pranoi vetes t’i shtojë namnin dhe lexuesit hutinë. Legjitimoi lirinë krijuese e qytetare, që nuk ekzistoi gjatë 50 vjeteve. Kodi i tij moral flaku mistifikimin.

Nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë kaluan edhe krijues shqiptarë, por vështirë shkruan ndonjë varg, skicuan ndonjë tregim, novelë e, ruajna zot, ndonjë roman. Unë ende nuk kam lexuar diç të tillë nga autorët kosovarë. Këtë kurajo nuk e kam hasur as te letërsitë e ish-bashkësisë. E, kjo do të thotë shumë. Sepse, *fjala* në çdo burg të akcilit vend konsiderohet tepër e rrezikshme. Në Goli-Otok, Idrizovë, Lepoglavë i dënuari mund të bënte vetëm një gjë: të lexonte e të mësonte ndonjë gjuhë të huaj; të merrej, ndoshta, në përpilimin dhe të ndonjë fjalori...

Fenomeni që ndodhi në Shqipëri, konkretisht në fushën e krijimtarisë, nuk besoj të ketë ndodhur kund tjetër. Para lexuesit të

painformuar kjo merr përmasa fantastike si faqe e re në letrat shqipe, e lindur mu në kazamatet më të egra të Evropës, nëse u besohet bile pakicës së krijuesve, atyre që edhe tinëz vetvetes shënuan diçka mbi diktaturën.

Vërtet, a jemi kritikë në rishkrimin e historisë, sa ka të vërtetë në guximin tonë intelektual e njerëzor, apo të vërtetën nuk guxojmë ta shikojmë në bebëz të syrit. Prandaj, vështirë lirohemi nga mistifikimet e llojllojshme. Këtë problem e kanë prekur edhe të tjerët. E vura prapë në spikamë. Të jemi më kritikë ndaj vetes që të mos na nëpërkëmbin të tjerët se nuk dihet si do të mbyllet fundi.

(1998)

TEZË PA MBËSHTETJE

Pa të keq, me miq mund të zihesh ndonjëherë për çështje parimore. Fërkimi nuk do të thotë mosrespektim i personalitetit me të cilin vazhdon udhëtimin. Kur është i sinqert, më së paku cënon ndokë.

Mbi tavolinën time me ditë qëndron një libër botuar diku në Cepin verior të Ilirisë dhe me ditë kam menduar rreth tezës së ngritur mbi shovinizmin tonë krijues nga Kadareja. Ç'e shtyri të thotë diç të tillë kur krijuesit e Shqipërisë së Jashtme nuk mund të paramendojnë një "luks" të tillë? Edhe pse i botuar, teksti i të nderuarit në një libër të përgatitur me shije e për qëllime jo vetëm letrare, prapëseprapë nuk besoj se ashtu mendon shkrimtari ynë. Ndoshta pse jam mësuar me kodin e tij etik. Ajo që lexoj, është befasuese. Përmes fjalëve të tij dikush dëshiron t'i qërojë hesapet me krijuesit e këndejmurit. Ose fjalët e një personaliteti që, ndoshta, menduaka ashtu, t'i nxjerrë në një kontekst tjetër; konstatimi i tij të shtrihet si hije mbi përpjekjet tona mbinjerëzore, qofshin ato dhe vetëm në rrafshin imagjinativ.

Kurrkush nuk mund t'ia mohojë atë se ç'bën shkrimtari ynë për çështjen tonë kombëtare. Për mua, nuk ka shoq në letrat shqipe. Me dinjitet e kurajo intelektuale ngre zërin gjithkund. Guximin e tij qytetar nuk e dëshmon vetëm vepra e tij. Kadareja disi na u shndërrua në shkollëshkrimi, kod. Vërtet, ç'u desh tani të ngrisë papritur një tezë jashtë kodeksit të tij?

Mos do të thotë kjo se gjenive nganjëherë u shpëtuaka kontrolli mbi fjalët, mbasi nga ato kërkojnë më shumë se, ndoshta, që ofrojnë në një moment të caktuar. Apo pse duan të flasin pa pardon, ose pse loja me fjalët shndërrohet nganjëherë në një torturë të tmerrshme, kështu që ndodh të na befasojnë edhe me të papritura. Kështu e kuptoj edhe tezën e ngritur nga ky personalitet se krijuesit në Kosovë na qenkan të ngarkuar me shovinizëm!

Pakëz i rëndë ky formulim! Këtë ia bëra të ditur edhe të nderuarit. Fjala e rëndë mund të thuhet kurdo. Kohë për të ka më shumë se për të urtën. Por teza e ngritur, vërtet a ekziston, a ka mbështetje?

Në aparthejdin evropian, a mund të ketë krijues shovenë?

Branka Bogovac, korrespondente e përhershme serbe nga Parisi, e njohur për bisedat me intelektualë e shkrimtarë të shquar botërorë, shkrimet e së cilës lexohen, komentohen e citohen shpesh, pak më parë në Podgoricë botoi librin e dytë *Razgovori u Parizu (Bisedat në Paris)*. Aty ka vënë edhe një bisedë-tekst interesant, me shkrimtarin tonë të nderuar Ismail Kadare. Fletushka e Beogradit *Republika*, nr. 175 - 176, data 1-30 nëntor 1997, nga libri i përmendur sjell fragmente mendimesh të Joneskos, Emil Sioran, M. Bitor, U. Ekos, M. V. Loses e ca shkrimtarëve të tjerë me titull të përbashkët *Književnici opolitički*. Pra botohet edhe fragmenti nga Kadareja - për fatin e Shqipërisë dhe për momentin tonë të pikërishtëm kombëtar.

Prezentimi i tij nuk është kontestues. Por në tekstin e tij ngritet një çështje, që ka të bëjë me ne krijuesit e Kosovës dhe nuk di sa mund të jetë e pranueshme. Me këtë personalitet të letrave shqipe, druaj se prapë manipulohet si në vitin 1988, kur albanofobi Miodrag Bulatoviç, në emër të Kadaresë dhe të Agollit, në "Duga" pat shpifur e fyer rëndë shkollën shqipe dhe përpjekjet tona për mëvetësimin e Kosovës. Më vonë nga vetë Kadareja shpifjet u demantuan në letraren *Drita* të Tiranës. Fat të njëjtë mund të ketë edhe kjo bisedë, sepse kur bëhet fjalë për shqiptarët, mjetet e informimit serb nuk kursejnë asgjë, lansojnë të pavërteta të llojllojshme për të rrënuar edhe paqjen tonë shpirtërore dhe për të futur huti jo vetëm brenda nesh. Është e dhembshme kjo, mbasi dihet qëndrimi i Kadaresë për çështjen e Kosovës. Nëse ka ndërruar diç atëherë i nderuari u ka hyrë në hak krijuesve të Kosovës, me konstatimin se na qenkan të ngarkuar me shovinizëm!

Në të vërtetë, Kadareja në tekstin e vet u bën thirrje të gjithë krijuesve ballkanas në ndërgjegjësimin e tyre krijues, në mirëkuptimin e respektimin e ndërsjellë në mes popujve dhe kulturave, pra dhe në mes serbëve e shqiptarëve. Këtë gjest e kurajo intelektuale duhet përkrahur. Por nuk di sa është i qëlluar mendimi se krijusit kosovarë na qenkan të ngarkuar me shovinizëm e për të cilën të keqe na e paska tërhequr vërejtjen disa herë. Unë nuk di ku dhe kur?

Në mes viktimës dhe xhelatit

Mirëpo shtrohet një pyetje elementare: një popull i shkelur, i fyer, i rraskapitur, i copëtuar e i rrethuar me mure të dukshme e të padukshme, me telashe ekzistenciale, humbës i vazhdueshëm i hapësirës së vet kulturo-historike, a ka kohë edhe për një “luks” tjetër, shovinizmin, shfaqjen dhe mbështetjen e tij? Revolta jonë krijuese nuk bën të shikohet nga rrafshi i së keqes, të identifikohet me shovinizëm, apo përmes pajtimit të mundshëm në mes viktimës dhe xhelatit të na mbijë njëfarë internacionalizmi artificial. Këtë ndjenjë ogurzezë privilegj e kanë popujt e kulturat që mohojnë ekzistencën e identitetin e të tjerëve, siç vepron konkretisht shovinizmi i egër ortodoks serbogrek me sotmërinë shqiptare. Teza e ngritur çorienton, sepse në një tekst të vetin të hershëm Kadareja thekson se shqiptarët nuk krijuan biblioteka të urrejtjes siç krijuan serbët ndaj fqinjve të vet. Po ashtu nuk besoj se këtë tezë e ngriti për ndonjë qëllim që mund ta dijë vetëm ai. Lë mundësinë se këtë e bëri për shkak të mirëkuptimit ndërballkanik, ndoshta; të njëfarë baraspeshe në mes viktimës dhe xhelatit. Megjithatë, kjo është tepër e ndjeshme! Për fat, diç ogurzezë nuk ekziston në krijimtarinë letrare, që krijohet këndejmurit. Bile nga ky prizëm nuk e shoh as veprën e Fishtës, Konicës, Koliqit, Mid'hat Frashërit, Skiroit apo të ndonjë tjetri. Brenda kornizave të shovinizmit nuk mund të shikohet vetëmbrojtja. Klithma për të gjallëruar me çdo kusht është forca e fundit e njeriut apo e një kulture të nëpërkëmbur. Të ishte ashtu siç shkruhet në tekstin e të nderuarit, të keqes nuk do t'i frikësoheshim më: tkurrjes sonë të vazhdueshme, ndoshta më të

keqes, zhdukjes. Por, o Zot, a duhet pranuar diç që nuk ekziston? Një konstatim të tillë nuk e kam hasur në asnjë tekst apo libër të Kadaresë. Kjo më bën të dyshoj edhe më tepër në sinqeritetin e bashkëbisedueses.

Kadareja është vlerë kombëtare (D. Agolli). Reagimin tim ndaj një teze dyshuese nuk e bëra për marketing apo të hedh diç të pahijshme në figurën e tij. Ndjeja dhembje për atë që më së pakti mund të jetë mendim i tij. Por rreth nesh ngritën aq shumë gracka sa çudë si mund të ekzistojmë. Posaçërisht nuk prajnë fabrikimet më të ndryshme të masmediave të fqinjve që bile na shikojnë edhe përmes grykës së armës.

Nëse kam gabuar, kërkoj falje. Por rebelimi im më bën të mos pajtohem me mendimin se krijuesit e Kosovës na qenkan të ngarkuar me shovinizëm. Këtë na e “*zbuloi*” gazetarja Branka Bogovac përmes tekstit të shkrimtarit tonë që, për fat, e konteston vetë Evropa politike e këtyre ditëve. Më në fund, u bind se në trupin e saj na ekzistuaa aparthejdi i quajtur *Kosovë*. Duartrokitje, ju lutem, për këtë zbulim të vonuar të të urtëve evropianë!

Gjenive, megjithatë, u falet se nuk është lehtë të kesh kontrollin mbi çdo fjalë a mendim...

KARAMBOLLI SHQIPTAR

Dreqi i kuq

Mund të gaboj, por në një poezi Fishta e kishte parandjerë shfaqjen e një rendi të ri në hapësirën gjithëshqiptare, që nuk do të përkohë me asnjë tjetër të tej Ujit të Madh. Mua kjo ma forcon bindjen se poetët janë racë e çuditshme; parandjejnë të pamundshmen derisa dikush bën gjumë të rahatshëm. Qoftë përmes një trazimi shpirtëror apo një udhëtimi imagjnativ, ai kishte hetuar konturat e sistemit që më vonë do të quhet koha e komunizmit. Në poezinë *Dredha e djallit* (1908) Fishta paralajmëronte edhe diç më të rëndë, rrezikun nga fqinjët: bullgari në Manastir, greku në Janinë, serbi në Prizren dhe malaziasi në Shkodër... Nga shqetësimi i tij njerëzor e intelektual nuk ndodhi vetëm Shkodra. Imazhi i poetit: *shka lan këta katër ujq thonë do të del një dreq i kuq edhe krejt do të shkretojë...*

Parandjenja e Fishtës u bë realitet në dekadën e katërt të shekullit që po lëmë, ku fatkeqësisht u gjetëm edhe ne. Ç'ndodhi më vonë, e dimë të gjithë. Ishim dëshmitarë për gjysmë shekulli. Ëndrrën e rilindësve se etniteti shqiptar i takon qytetërimit perëndimor e kishim tradhtuar.

Një mbrëmje dhjetori, tek shikoja *Sallën e kaltër* në Volks Hausen, aty midis të Cyrihut, ku “hazreti” Lenin kishte tubuar bashkëmendimtarë e mbajtur predikimin e parë (1917) për një sistem të ri që vinte e ku askush nuk do të ishte i diskriminuar, më ishte shfaqur pas disa vjetësh ajo hije e dreqit të kuq nga poezia e Fishtës. E shihja se ende nuk ishin liruar, ose vetëm shtiremi se jemi liruar. Me ca nuanca e retushime vështirë po shkëputemi nga një ideologji. Kryesore ne si kulturë e komb, nuk u bëmë tamam asnjëherë. Dhe nuk di kur do të bindemi se ne nuk jemi filli, as do të jemi fundi i asaj

që quhet shqiptari. Fat që me ne nuk fillon as mbyllet ndërtimi i qenies sonë kombëtare. Iluzionistët mund ta vazhdojnë thurjen e rrejtit të merimangës.

Intelektuali qëndron mbi të keqen

Intelektuali ynë është specifik: 1) Mendon, pra, se çdo gjë shqiptare nis nga ai; 2) Nuk mund të durojë praninë apo vërejtjen e tjetrit se është egocentrik. 3) Dëshiron të shihet edhe aty ku nuk e ka vendin. 4) Reagon kur kalon furtuna, 5) Krekosen nëpër përvjetorë të rastit që nuk e kanë peshën e masakrave të Drenicës, Tivarit, Livoçit, Ferizajt e ca lokalitete të tjera, ku fill pas së ashtuquajtures LNC, ishin masakruar me mijëra njerëz, 6) Intelektualin tonë, kur e lë takati, me mënyra të tjera kërkon “triumfin” e vet, duke kërkuar morrin në Morrani dhe në kohën e rënieve të të gjitha institucioneve përpiqet të instalojë intrigën etj. Në të vërtetë, të tillët nuk mund të quhen intelektualë; ata aktrojnë intelektualin, pakënaqësinë. Do të thosha, pavetëdijshtëm shndërrohen në njerëz të përdorshëm, instrumentalizohen më tepër në dëm të vetes. E, këtë fenomen tonin mjeshtrit e dhunës e përcjellin me kërshtëri, sepse çdo rrëshqitje e përçarje jona forcon projektet e tyre makabre. Arsyet: 1) Brenda nesh të krijohen probleme e të harrohet dhuna, 2) Të merremi me vetveten e jo me çështje fundamentale të ekzistencës sonë. 3) Edhe atë grimë forcë, që kemi, ta harxhojmë në diç triviale.

Probleme, ja, prapë na nxjerr Tito, kur bota komunikon përmes internetit. Kthehet ai mes nesh edhe për së vdekuri. Na bën zullum. - Se kush i paska përkthyer, lekturuar e bërë korrekturat e veprave të tij; se kush ia paska kushtuar ndonjë vjershë a libër. Po në këtë moment, a loz rol kjo? Unë nuk e fsheh, as më kërset ta fsheh, se para katërdhjetë vjetësh e kam vargnuar shkarazi një për të. Rreth kësaj kam shkruar më parë kur bënin hyxhym xhema të ynë “intelektual” ta shpallnin edhe si kriminel Hivzi Sulejmanin. E kam një mik, po ashtu që shpesh zihet rreth kësaj vjershe, por asnjëherë nuk ia kam parë për të keq; se nuk çohet dorë nga mikun. Një ditë një bashkëmendimtar i tij m’i ofroi

ca poezi të mikut: mbi Titon e Revolucionin e Tetorit. Mund t'iu them vetëm këtë, ato ishin të datës më të re dhe asgjë nuk ishte imja; ku dilte miku, gati Evropën e kishte bërë Rusi, kufijtë e saj cullakoheshin deri në brigje të Rajnës. Për pak të na shtijë në luftime edhe me gjermanë... Mikut nuk ia përmend, sepse nuk është njerëzore as burrërore të merresh me huqe të njerëzve. Intelektuali duhet të qëndrojë mbi të keqen dhe njeriun ta shpëtojë nga ndonjë traumë e re.

Dhe vijmë te sinqeriteti: nga një sistem që ka ekzistuar jo vetëm për ne, duam ta zhbëjmë një pjesë të historisë se ne nuk kemi jetuar kurrë në atë bashkësi popujsh. Vetëm, a mendojmë ndonjëherë se po të kishte ndodhur kjo që po përjetojmë tani, në vitet e gjashtëdhjeta a do të mund të ishim këta që jemi; të kishim tërë këtë potencial njerëzor e intelektual? Më duket se ne nuk pikëm nga qielli, as dolëm nga shpellat, ku duan të na mbyllin tani. Njeriu ynë flet nganjëherë aq sa di dhe nuk ia shoh për të madhe mbasi njeriun duhet pranuar ashtu siç është; vështirë ndërrohet diç në të. Megjithatë, duhet kujtuar: po ky Kiro Gligorovi, a nuk ishte titist i madh? Ja, e bëri shtetin. E njëjta gjë thuhet edhe për Tugimanin, Kuçanin. Pse titistët tanë nuk e bënë këtë? Nuk dua t'i akuzoj se nuk dëshiruan apo nuk ishin trima. Përgjigjen e kësaj pyetje duhet ta kërkojmë kur të lirohemi edhe nga frustrimet e komplekset. Për mua është inkurajues reagimi i Luftëtarëve të Kosovës jo vetëm ndaj gjestit naiv të Kiro, por edhe për qëndrimin e tyre burrëror ndaj proceseve të reja dhe UÇK-së. Ky nuk është konformizëm, vetëm nuk mund e shoh veten në nivelin e pubertetlinjve. Do zoti e fiton e drejta legjitime e popullit se udhën nuk e bëj as për një çerek të çerekut të karrigës.

Minimizimi shpie te zhdukja

Nuk është çudi që krijuesi ynë të nxirret në ilegalitet dhe libri të konsiderohet mall kontrabande, mbasi nuk paska të drejtë ta shesë vetë autori ose përmes ndonjë miku. Unë kam parë me dhjetëra raste në Evropë ku autorët shumë të njohur vetë e shesin librin. Zhan Pol Sarti, nobelist, në moshë të shtyrë, rrugëve të Parisit, që e botonte dhe

askush nuk ia shihte për të madhe. Ai ofronte diç që kishte. Ku të kemi sa më shumë libra dhe lexues?

Nga dëshira të dukemi të mëdhenj në çarshi, ne kemi filluar të minimizojmë çdo gjë tonën; të dukemi sa më të vegjël. Diç e tillë kurrkund në botë nuk ndodh si në trevat shqiptare në të dy anët e murit. Ndërrohen sistemet, por nuk hidhen krijuesit e asnjë profili. Ç'do të ndodhte, sa herë të ndërroheshin qeveritë, të ndërroheshin edhe krijuesit? Ne kurrë nuk do të kishim gjë. Inkuizicion kulturor nuk bën të ketë as të ndodhë kur kërkojmë të jemi të hapur dhe me qasje të re; kur e luftojmë dogmatizmin e forma të tjera të çoroditura përmes formave të reja. Në fëmijëri shpesh ndalesha para një kulle dhe vëreja aty se secili guri e kishte vendin e vet. Po t'ia hiqje një, droja se prishej harmonia.

Ne mendojmë se dhuna është e këtyre ditëve; se brezat e mëparshëm fare nuk kanë përjetuar dhunën. Unë nuk jam skizofren, as nuk dua kujt t'ia zë vendin, por si nuk na kujtohet *Abmet Kosbutani* i Ramiz Kelmendit, fytyra markante e aktorit të ndërë Abdurrahman Shala në filmin *Era dhe Lisi*, poezitë *Nata kriminale* dhe *Kënga e lugatit të ri* të Besim Bokshit, kurorat sonetike të përkryera të Enver Gjerqekut për Skënderbeun, Lasgushin e toponominë tonë që zhduken, prozën e Hivzi Sulejmanit, Demaçit e të tjerëve?

Në një moment të rëndë intelektualit duhet të ketë edhe rolin e iluministit. Me këtë rast dua t'ju kujtoj sjelljet e bardit tonë Esat Mekuli derisa ishte kryeredaktor i *Jetës së re*. Ai jo vetëm na këshillonte e përkrahte, por na mbronte dhe në momente vendimtare. Nga kujtimet e tij të botuara në librin *Shpërtriat e lënduar* (1997) të A. Zogajt, në faqen 39, thotë edhe këtë: “Ne ishim një brez i iluzioneve... Ndaj jam me rini dhe gjithsesi duhet bërë ndryshime. Më kujtohet rasti i Ali Podrimjes, kur synonin për ta larguar nga Gjinnazi i Gjakovës. Kishte shkruar poemën për vitin 1941. Shkova te D. Mugosha të cilit i thashë se është turp kjo që bëhet me një të ri të talentuar. Aso kohe Fahredin Gunga nuk kishte mundësi jetese e as kushte për krijimtari. Shkova te një udhëheqës. Kërkova t'i jepet bursa. Fahredini vazhdoi shkrimet... “Shumë vite më vonë bardi ma kishte dedikuar edhe një poezi, të cilën e kishte vënë në një libër të tij. Ishte diç prekëse për mua se këtë e

bënte njeriu e krijuesi, të cilin nga fëmijëria kisha përcjellë shqetësimin e pleqërinë e tij.

Ne duhet të ndërrojmë diçka në sjelljet tona. Në të kundërtën ndokush do të kënaqet me karambollin shqiptar dhe pas përplasjeve tona të vazhdueshme, secili do të rrëshqasë aty ku nuk ka kthim. Një poezi e mbyll: *Koha është të dubemi...*

(1998)

BAJRAKTARËT DHE QENTË

Ankthi i ballkanasve

Politika është art që të mashtron. Nuk them se e kuptoj lojën e saj, as nuk më shkon mendja të argëtohem me të. Vokacioni im është diçka tjetër, pra nuk më lejon. Brenda mundësive të mia, dëshiroj t'i ndihmoj akcilit njeri. Nuk mund ta ushtroj *dhunën* ndaj tjetrit. Ndoshta është ky gabim, por ç'të bëj. Nuk është mirë të përzihesh në zanatin e primitivëve. *Dhuna* nuk nderon askënd e më së paku atë që e shkakton. Mirëpo a bën të mbetet liria "Vetëm në librat shkollorë?" - pyet poeti roker, Jim Morrison. Një pyetjeje të tillë nuk duhet t'i përgjigjen vetëm ballkanasit. Evropa rropatet të shuajë hasmëritë mes popujve e shteteve dhe liria të dalë nga librat e të bëhet realitet i të gjithëve. Kësaj iniciative a bën t'i bashkohen edhe ballkanasit dhe të mos frikësohen më nga pavarësia e akcilit popull, apo duhet ta modifikojnë edhe më *dhunën*? De fakto formimi i shteteve nacionale vonon në rajonin tonë dhe askush nuk pranon të bëjë koncesione me trojet e veta. Me përfundimin e kolonializmit në rajonin tonë, liria më nuk do të mbyllet në libra. Tek atëherë fillon bashkëpunimi e respekti mes shteteve e popujve të liruar nga ankthi se dikush u rri mbi kokë dhe u kërcënon lirinë e sovranitetin.

Pavarësia e Kosovës nuk frikëson njeriun e urtë, i tmerron "disejnerët e krimit", siç do të thoshte një poet tjetër roker, Roger Waters, ata që nuk mund të heqin dorë nga hegjemonizmi e nacionalizmi i verbër: të rrënojnë çdo gjë që nuk është e gjakut tim. Pavarësia mund të frikësojë edhe ndonjë profiter shqiptar, që në kaosin kombëtar e rajonal sheh ngritjen e vet.

Ballkani, a mund të vazhdojë me derdhje gjaku, që shpie te një katastrofë mbyllëse? Përcjell edhe mjetet e informimit të fqinjëve dhe

nga shumë tekste kam bindjen se edhe *vrasësit* janë lodhur; se *kobë e çizmës* ikën dhe ballkanasit duan të ndërtojnë secili shtëpinë në mënyrë të vet. Kjo është inkurajuese se popujt tentojnë të krijojnë mozaikun e tyre shpirtëror, atë të entiteteve. Qeniesore është se Ballkani nuk pranon të mbesë bisht Evrope, fuqi e primitivëve. Po qe se ndodh diç tjetër, humbës jemi të gjithë se askush nuk pranon mileniumin e dytë ta mbyllë si vasal. Ballkanasit do të harxhonin edhe atë pak fuqi që iu ka mbetur për të ekzistuar.

Pranimi i sovranitetit dhe ekzistencës mes ballkanasve është fitore për të gjithë, se pavarësia e akcilit popull shpie te pavarësia e të gjithëve dhe shpëtimi nga ankthi makbetian. Me pushimin e smirës dhe zjarrit popujt do të vlerësoheshin e respektoheshin përmes kulturës dhe vlerave të tjera nacionale. Pakëz kjo utopi në momentin e pikërishtëm, por njeriun duhet ta gëzojë liria e tjetrit, ndryshe përfundon çdo gjë në humnerë.

Shkaktari i të gjitha këtyre hasmërive qëndron te krijimi i vonshëm i shteteve nacionale, që ca duan të shtrihen në dëm të tjerëve. Nëse ballkanasit lirohen nga kjo fantazmë, askush më nuk do të frikësohet nga pavarësia e tjetrit dhe liria do të bëhet realitet. Besoj se edhe populli serb nuk do të veçohet nga civilizmi i ri. Nëse nacionalizmi ekstrem serb u beson më shumë armëve se dinjitetit njerëzor, atëherë çmenduria do të mbyllet me katastrofë për ata që rrudhin gishtin të parët.

Kjo nuk është mençuri. Rrënimi i palëve nuk do të kishte fund. Një aventurë të tillë nuk ua dëshiroj askujt e më së paku fqinjve, nuk dua t'i shoh ata si armiq, dhunues të lirisë sime...

Bajraktarët dhe qentë

Kallëzojnë në qytetin tim se pasi ishin vrarë e prerë ndër veti bajraktarët, i kishin çuar fjalë njëri-tjetrit se mund të takoheshin në ndonjë nahi neutrale. Asnjëri nuk kishte kundërshtuar. I kishin mbledhur të vrarët e i kishin varur armët thuajse asgjë nuk kishte ndodhur mes tarafeve. U kishin hipur kuajve më të mirë e kishin rënë

në atë farë nahie neutrale, kallëzojnë pastaj se ata kishin bërë pallën e sefasë, kishin pirë e hëngër desh të pjekur rreth hellit të zjarrit, që shihej kushedi se ku. Ngapak dhe kishin kurvnuar e lidhur miqësi.

Mirëpo, kur u ishin sosur të gjitha me shishe e tepsi, ia kishin filluar do bisedave fort të prera e morbide rreth plojes, që kishte ndodhur pak më parë mes tarafeve. Kishte pyetur dikur i pari: po sa qen t'u vranë? Më pak se ke shkrepur plumba. Iu kishte gjegjur tjetri rreth zjarrit. Po ty? - kishte pyetur të parin i dyti. Aq sa ty. Iu kishte gjegjur i pari me kokë të ulur. Me ferk ishin ngritur e përçafuar dhe secili kishte rënë në bajrak të vet. Prapë ishte dëgjuar pushka dhe gjëma derisa kishte ndodhur një sebeb tjetër qejfi. E kështu me radhë ishin pakësuar tarafe e “qen”.

Para një kallëzimi të tillë morbid, i cili mund të kallëzohet në varianta e me ditë, njeriu normal shtanget dhe nuk mund të rrijë pa sharë. Në këtë hasmëri të tarafeve, kallëzojnë më vonë, dorë kishte pasur hasmi, që me mjeshtëri ua kishte përzier punët. Bajraktarët *Atdheun* e shihnin aty nën çati dhe e konsideronin të madh sa, bie fjala, livadhi i Hasanit, ose nuk e shikonin kurrëgjë më të lartë se Suka e Cërmjanit. Shtrinin shuplakën pastaj e mendonin se e tij është deri aty ku bie kokrra e plumbit. Se kush ishin ata “qen” për bajraktarët, nuk mund ta them se fyhem si njeri e krijues. E vërteta qëndron se në të dy anët ishin vranë shqiptarët e gjorë, që kishin përcjellë bajraktarët edhe atje ku ata bënin qejf në oda të fshehta. As vetë nuk di pse hapa këtë plagë, që aty-këtu ende mund të kullojë. Sall kam të drejtë të frikësohem në momentin e pikërishtëm, mos po e pranojmë lojën e bajraktarëve. E kjo më tmerron kur në bazë të nahive e krahinave duam t'i ngremë edhe partitë. Ndonjë recidiv i së kaluarës së largët, për të cilën më kallëzonin shpesh të urtit e mëhallës, po të qesë kokë do të ishte turp edhe për elitën intelektuale. Një gjysmë karrige nuk mund t'ia zërë vendin çështjes kombëtare. E asaj pakkush ia ka parë hajrin. Unë frikësohem se mos *krahinazobemi*, *lagjizobemi*, *çatizobemi* e po harrojmë diç më të shenjtë...

Kryeministri që ka probleme me gjeografinë e atdheut

Në vitin 1972 për herë të parë shkëlja në Dheun e Shqipeve me një grup shkrimtarësh. Kremtohej njëri nga përvjetorët e poetit kombëtar, Naim Frashëri. Shqipërinë krejt ndryshe e kisha përfytyruar dhe nuk mund të pajtohesha me atë që shihja. Kisha takuar, mes tjerësh, edhe Lasgush Poradecin, Nonda Bulkën dhe Skënder Luarasin. Për mua këta ishin tre pleqtë më të urtë e më simpatikë, që kam takuar ndonjëherë. Dhe tek pinim kafe kishte hyrë me hez në hotel një tokmak i pushtetit e me një nënçmim iu kishte drejtuar Poetit të Nositit: Si i ke punët me Gjeografinë e Atdheut? Poeti kishte ngritur edhe një ngërç e kishte shtuar: Dhimbshëm... Me Gani Bobin mësuam më vonë se vërtet Poetit ia kishin zili pse e dinte Gjeografinë e Atdheut dhe, sipas Skënder Luarasit, ne ishim ndër të parët që i kishim dhënë notë kaluese në këtë lëndë, ku Nëna Parti mendonte se Lasgushi gabonte. Me tre pleqtë më të urtë e më simpatikë ishim ndarë me një përqaftim vëllazëror, duke dëshiruar të gjithë të “gabojmë” si Poeti i Nositit. Nuk i takova më kurrë. Njëri zuri pritë buzë Liqenit të Ohsisë, (Ahritës) atje në Poradec, dy të tjerët kallëzojnë se bartin diku Tomorrit mbi supe dhe ishin shndërruar në një grusht dhe...

Kisha menduar gjatë rreth problemit të *Gjeografisë së Atdheut* dhe për notën e dobët të Lasgushit nga Nëna Parti. Njeriu zgataraqet aq sa i ka falur zoti vend. E, këmbë e krah kishin mbetur megjithatë jashtë. Nëse ballkanasit do t'i bëjë diç varr, atëherë janë mu ata gurët e ftohtë të kufijve, që ngriten si murana qytetërimesh. Truri i njeriut krijoi shumë budallallëqe. Më i rëndi është *kufiri*, kufizimi i lirisë. Ka ndonjë të hekurosur që nuk pajtohet me këtë marri time, por ai guri i kufirit është simboli më tragjik, pjellë e egoizmave nacionale, që nuk pranojnë lirinë si të drejtë njerëzore.

Përmes TV Shqiptar, Majë Sharrit e pashë zotin Fatos Nano. Më gëzoi se një kryeministër shqiptar, më në fund, ishte ngjitur maje Malit të Borërave. Po të bënte gabime si Poeti i Nositit në lëndën e gjeografisë, do të bindesha se vërtet ka devijuar udhën e Partisë. Në

këtë çështje ishte esëll. Pashë se udha e tij nuk shpie atje ku dëshiroja unë. Tevona m'u kujtuan tre pleqtë e urtë, që i kisha parë një pranverë të largët në një hotel të Tiranës, pastaj ai tokmaku i qeverisë, që ishte tallur në mënyrë të pakriptë me Poetin e Nositit e që "gabimit" të Poetit me Gani Bobin i kishim dhënë notë kaluese. Dhe, duke dëgjuar Kryeministrin, u binda për të satën herë se nuk është fajtor vetëm Nëna Parti, por dhe guximi intelektual e qytetar. Nuk ka më Lasgusha në Shqipëri. Ç'ri uroj Nanos pos notë të dobët në lëndën e gjeografisë. Në xhuxhllëkun e Atdheut të dukesh i madh është maskarallëk...

Pse? E të tjerët vdesin për aq vend sa u ka falur zoti. Dinjiteti është lëndë mësimi ndër të parat. Edhe aty, ku fulçinjtë i kanë plot qytetërim...

(1998)

RËNIA E FANTASTËVE

Zotëria nga një metropol evropian, pasi kishte dëgjuar me vëmendje për të bëmat e përgjakura në Ballkan, kishte pyetur: këta serbët, dinë gjë tjetër pos të vrasin e të rrënojnë kultura? Dhe, si intelektualët e krijësit serbë lejuakan një barbari të tillë mbi të tjerët? Vritkan edhe lexuesit e tyre joserbë?! Morbiditet të tillë nuk kam hasur kund!

Rrëfimi i poetit nga Sarajeva, Izet Sarajliq forconte edhe më mendimin mbi mjerimin intelektual e njerëzor të azganëve nga vendi “ku rrejnë të gjithë” (A. Tijaniq). Rreth tryezës ishin skuqur fjalët. Më bëhej se nga turpi pikonin aty në liqe. Zotëria nga një metropol evropian ishte larguar, duke sharë në gjuhën e vet. Për shumëkë mesazhi ishte i qartë; morbiditeti është karakteristikë e popujve, që u mungon kurajoja intelektuale e njerëzore për t’iu kundërvënë edhe historisë nëse kërkohet.

2.

Nuk ka mjedis që nuk ka krijësit e vet halabakë. Vetëm nga agresiviteti ata mund të dallojnë. Turravrapit për të hipur në panteon me shpirtin e “blerë” bëhet njësoj si këtu e në Afrikë. Për mosrealizimin e ëndrrave të tyre shpesh fajtor është rrethi, ose kastat e ndryshme. Bile u sulen edhe mësuesve të tyre shpirtërorë, që u kanë zgjatur dorën ndonjëherë ose i kanë udhëzuar. Pakënaqësia nuk është vetëm revoltë. Ilustron nganjëherë edhe karakterin e impotencën krijëse. Krijësi i njëmendtë di kur duhet reagu. Halabakët vazhdimisht zënë prita. Rrënimi i institucioneve dhe gjendja e rëndë sociale bëri që edhe mjedisi ynë të gumëzhijë nga turravrapet e këtyre “blerësve” të shpirtit, që shpesh me donkishotizëm mbyllin edhe shtegun e mundshëm.

Halabakët, që i zinte ngojë Izet Sarajliq, kishin edhe një veti: dinin edhe *zejen e vrasjes*. Si duket, u pëlqente më tepër drita e gjakut. Sidoqoftë, paraqitja e tyre kudoqoftë ngërthen dhe *gjakun e zi*. *Patriotizmi*, megjithatë, nuk pranon hakmarrjen si mjet rrënues të çdo gjëje që nuk është imja. Kemi të bëjmë me krim atëherë. Me Hagën. Patriotizmi fisnikohet përmes formave më njerëzore, duke krijuar vetëdijen e lartë se shenja ime nuk bën të dëmtojë Familjen e Madhe Njerëzore. Fatkeqësisht serbët patriotizmin vazhdojnë ta mbajnë gjallë përmes hakmarrjes dhe “shitjes”, së mjegullirave mitike, mbasi vazhdimisht janë humbës.

3.

Me Izetin njiheshim moti. Seç fliste çarshia për të, më së pakti më interesonte. Unë peshoja fjalën e tij, sinjeritetin dhe kurajon prej krijusit. Nuk mund të harroj gjestin e tij ndaj personalitetit të Kadaresë. Në hapësirën e ish-bashkësisë shkrimtarit tonë i kishin vënë embargo. Kjo për Izetin nuk vlente. Pasi kishte lexuar *Gjeneralin e ushtrisë së vdekur*, kishte shkruar një poezi për të në shenjë admirimi. Në të vërtetë, e njihja këtë poet dhe qëndrimin e tij konstruktiv ndaj vlerave tona në përgjithësi, të cilave kurrë nuk ua vuri gurin në mes. Në shumë manifestime e mbrëmje letrare kishim qenë bashkë. Bile nganjëherë u vënim kushte organizatorëve. Kjo nuk do të thotë se edhe pajtoheshim. Herën e fundit në Teshanj (1990) prapë kishte rënë fjala për do miq të tij që, siç thoshte MB, nuk bënin të gjithë sa një shkrimtar. Për qëllime nacionaliste të gjorët vësheshin në lojë.

Në Takimet Ndërkombëtare të PEN-it në Bled (1997) u takuam prapë, pas shtatë vjetësh. Izeti nuk ishte më ai i vjetri. Nëpër fjalët e gjestet e tij kishte më tepër radikalizëm. Lirizmi i tij ishte i mbështjellë me një membranë dhembjeje për njeriun. Miqtë e tij të dikurshëm nuk ekzistonin më. Për çudi, pajtohej tani edhe me qëndrimin e MB, se ajo kope nuk bënte sa një shkrimtar. Dikur më kishte kërkuar falje rreth cakërrimit të fjalëve për diç, që nuk dëshironte ta kujtojë më. Nga kujtesa e tij shtërgata e luftës kishte fshirë shumëçka. Por, nuk mund të besonte ende se njeriu qenka kaq i

mjerë. Kush nuk kishte pyetur, gjallë a vdekur është. Nga miqtë e tij të dikurshëm vetëm njëri e kishte vizituar. Kjo kishte ndodhur në ëndërr. Çështje më keq, ai kishte qenë një poet i vdekur serb. Zhgënjimi mbyllet në mallkim të fatit njerëzor.

Krijuesi i njëmendtë nuk mund të jetë vasal, as të pranojë rolin e vrasësit. Krijuesi qëndron mbi çdo monark e bajraktar. Rruga e tij shpie te liria e akcilit njeri e popull. Edhe në mbrojtjen e identitetit, ai duhet t'i përmbahet kodit të vet. Me serbët ndodhi diç tjetër. Ndoshta më mirë është t'i kërkosh ata në këngët për Kraleviq Markon. Populli e atdheu halabakçe nuk duhet. Shikojeni sa qesharakë duken Vuk Drashkoviç, Shesheli dhe kapot e tjerë të nacionalizmit serb kur zënë e flasin për të drejtën historike serbe mbi Kosovën dhe Spartën Serbe (Malin e Zi). Në të vërtetë, ata nuk dinë as ta mbrojnë mendimin e tyre. Çdo shqerrje e tyre është neveritëse edhe për vetë serbët e mençur. Zotëria nga një metropol evropian, pyetjen që kishte shtruar se a dinë gjë tjetër serbët pos të vrasin e të rrënojnë, e kishte parë këtë çmenduri nga rrafshi njerëzor, ku të gjithë duhet të jemi të barabartë para Zotit e Djallit.

4.

Shkrimi *Letër nënës*, botuar në “Glas” dhe në gazetat tona pastaj, është një shkrim rrëqethës, vaj i një të riu në mbrojtjen e hegjemonizmit serb në një tokë të huaj; me ato projekte e elaborate etnocidiale. Aty çdo fjalë zbulon më të keqen. Pak para se të vritej, e kishte shkruar letrën se nuk kishte mundur tërë atë tmerr ndaj shqiptarëve ta marrë me vete. Parandjenjë e çuditshme! Nëna e tij arriti ta publikojë këtë. Dhe komenti i z. Mihaillo Radojçiqit, botuar në “*Naša borba*” (6-7 qershor 1998), e lexoj si akuzë të rëndë ndaj momentit politik serb e posaçërisht ndaj të ashtuquajturës “elitë” intelektuale, fantastëve, që popullin e vet e futën në një udhë qorre. Radojçiq thotë se ushtari i vrarë quhej Tasiq. Të njëjtin emër mban edhe kryeprogonisti i romaneve të “babait” të kombit (mendohet për z. Qosiq). Dhe komentatori me një sarkazëm konstaton: Të gjithë heshtin, edhe poetët, piktorët e lahutarët... edhe gjuretiqët, edhe

beçkoviqët e milosheviqët. Duan ta shpëtojnë të gjithë zuzën e kombit për fytyrë... Cinizmi i komentatorit: Shokë shkrimtarë, ajo rini nuk vritet për ju, por vritet nga ju. Letrës së ushtarit të gjorë Radojçiq i jep një vend meritore në vlerat shpirtërore të popullit serb, e ngre bile më lart se shumë vepra të pjesës dërmuese të shkrimtarisë serbe. Unë këtë gjest e kuptoj se halabaçke nuk shkohet më dhe qëndrimi dinjitoz i Radojçiqit ma kujtoi të gjorin MB i cili e kishte zënë ngoje kopenë e ashtuquajtur krijuese e që nuk bënin sa një shkrimtar. Do të thosha, as sa një zhilet. Shkas u bë *Letra* të rikujtoja edhe mendimin konstruktiv, që e dëgjova vitin e kaluar në Takimet Ndërkombëtare të PEN-it në Bled. Zotëria nga një metropol evropian kishte bërë atë pyetjen domethënëse: Dinë serbët diç tjetër pos të vrasin e të rrënojnë? Borhesi thoshte se dhunën e ushtrojnë qyqarët.

Izet Sarajliq ka dy plagë në trup dhe ende kërkon një degë më të lartë për ta varur nxënësin e vet, Karaxhiqin, të cilin e kishte bërë këmbë e duar. Nuk kishte besuar se atë më shumë do ta joshte zanati i vrasësit se trupi ëndërrues i poezisë.

Në një shkrim të hershëm kam thënë se shovinizmi është fatkeqësi. Ata që kalojnë nëpër purgatorin e tij, nuk dalin tamam...

(13.6.1998)

A I GËZOHEMI FATKEQËSISË?

1.

Dy miqve të mi poetë tiranas ua shtrova një pyetje të përbashkët: A dimë ne të ndërtojmë diçka apo jemi mjeshtër të shkatërrimit të vetvetes? Nuk kam marrë përgjigje, as nuk di kur do t'i shoh. Por heshtja e tyre thotë shumë. Ishte mesi i majit dhe Shqipëria kishte humbur në tymnajë. Në të gjitha hartat figuronte si një zonë e errët e universit.

Në kopshtin përrallor të një banje shëruese të Badenit, pija kafënë dhe përpiqesha të zgjidh enigmën nëpër cilën derë kishte hyrë e dalë aty bardi ynë, Naim Frashëri. Pakëz isha nevrikosur kur një austriake gjentile, e mbështjellë në një dritë të çuditshme, pëshpëriti se i vinte keq se për një person të tillë nuk kishte dëgjuar kurrë. Pakëz më vonë pyeti: në cilën kohë ka jetuar? Me një gaz më se të hidhur iu kisha përgjigjur: nuk është i *Kobës së nikëve*. E kisha kujtuar edhe një mik roker, i cili nuk ka shkrim që nuk më bind se edhe te ne troket *ideologjia e nikëve*. Unë nuk ia prish. Vërtet diçka duhet ndërruar.

2.

Kur lindi Gonxhe Bojaxhiu (1910), kushërira e kompozitorit të ndjerë, Lorenc Antonit, mes nesh nuk kishte asnjë gardh; ende gërshërët e të mëdhenjve nuk kishin rrëshqitur mirë nëpër lëkurën tonë. Fund e krye ishte Shqipëri. Tani kur shpirti i saj vajti te engjëjt, nuk ekziston më as Vilajet i Kosovës me Scupin tonë. Është çudi, të dy mileniumet e kohëve moderne hapen e mbyllen me triumfin e shpirtit tonë. Por trupi humbet para sysh!

Në fillim të mileniumit të parë Kisha Gjermane kishte shpallur për të shenjtë Shën Albanin nga Iliria, i cili me gjysmë opinge ishte ngjitur lart Evropës së ftohtë për të përhapur krishtërimin. Atëherë

ishte fillimi i kohëve moderne. Për humanizmin tonë pak dihej dhe ku gjendej ajo farë Ilirie. Por shpirti ynë nuk prajti. Mirësia jonë vazhdoi të përbirohet, të degëzohet edhe në anë të tjera të globit të shqetësuar tokësor.

Nga viti 1928 Nënë Tereza disi ia përcaktoi vetes udhën: *dëshpërimi* është *shpresë*; nuk bën të frikësohemi se ai kthehet në triumf. Paqje e çuditshme me filozofinë e ekzistencialistëve. Sidoqoftë, mileniumi i dytë modern tek mbyllet prapë me një shenjtorë të gjakut tonë. Pra, pse të mërzhitem kur shpirti ynë hapet mbi njerëzimin që humbet vazhdimisht në egon e turpëruar? Megjithatë, duhet të potencohet, si Shën Albani, ashtu dhe Nënë Tereza nuk e patën pas *Grigjën*. Por prania e tyre ishte me Grigjën, rrezatonte larg. Dhe nuk mund të pajtohem se nuk bënë asgjë për vendin e tyre. Mjetet e informimit të shkurrës nuk patën pakëz kurajo të shënojnë shkuarjen e një hyjnie, siç nuk u pajtuan as ca të hallakatur tanët. Ajo bëri aq sa ia mundësuam edhe ne.

Pakëz erë hipokrizie vjen, por Shqipëria xhuxhe e 28 mijë km², më në fund e pranoi madhësinë e bijës së vet edhe pse për 50 vjet ia kishte kyçur derën. Nuk dua të akuzoj askënd e më së paku klasën e re politike, e cila entuziazmon me guximin e vet dhe e kuptoi si triumf të vetëdijes sonë, se *kombi e shteti* nuk ndërtohen vetëm përmes viktimizimit, por edhe nga ajo se ç'i ofron njerëzimit. Dhe nga të gjitha ato fjalë e urime, që u thanë nga 7 - 77 vjeç e nga të gjitha fiset e bajraçet, vështirë që njeriu ynë mund t'i pranojë më urdhërat e gardhiqet. Një vdekje e solli një popull para një akti vendimtar se dëshpërimin duhet shndërruar në fitore.

Mbi librin *Lule për Nënë* të Dom Lush Gjergjit, me mikun e poetin e ndjerë Fahredin Gunga, disa net kishim ndenjur pa gjumë, duke zbuluar madhësinë e Nënë Terezës nëpër shkrimet që i kishte tubuar, po ashtu, miku ynë Dom Lush Gjergji. Dhe, kur *librit* i kishim dhënë formën e mesazhit, pra kur i kishim rënë në fund, nuk do ta qes mendsh kurrë, na kishte dehur një fuqi e padukshme. Nënë Tereza qëndronte para nesh ashtu siç dëshironim: një Nënë e Madhe. Dhashtë zoti, shenjtorja jonë të na ofrojë qetësinë kombëtare.

3.

Robert Goro, gazetar i BBC nga dheu i helenëve, raporton shpesh edhe për çështjen tonë kombëtare, përmasat e së cilës sa shtohen edhe nën Pindin e lashtë. Për të painformuarit apo për të vonuarit, ato që i thotë Goro, duken pakëz qesharake, ngushëllim përralla për fëmijë, siç do të thoshte Ezra Paund. Por ato të dhëna mua ma ka ëndja t'i shoh në një dritë tjetër, sepse janë tepër domethënëse për momentin e tanishëm shqiptar. Faji është i shkencës shqiptare, mijëra të dhëna që nuk ia përplasi para derës Evropës së bombarduar aq shumë nga propaganda e pseudoshkencëtarëve sllavë e grekomëdhenj. Të tanët nuk e bënë, ndoshta, se nuk ditën të gjenden mes llavës, ose frika e shpirtit primitiv iu bë dikujt se është megalomani të dëshmosh se kush je e deri ku shtrihen. Robert Gora iu bashkua atyre, që nuk pranojnë të heshtin të vërtetën, se nuk është turp të shpartallohen falsifikimet e të tjerëve që edhe na fyejnë.

Arvanitasit (arbëreshët) e shpërndarë dhe të zënë rrënjë edhe nëpër ishuj të vdekur dhe *Skëpëtarët* të ngulur me kohë në viset e Trakisë, kontribuan në formimin e Greqisë së re. Nga grekët e urtë kjo farë nuk u fshih. Siç e dëshmon edhe një herë Goro, arvanitasit i falën Greqisë së re 15 kryeministra e mjaft ministra e deputetë. Në flotën e detarisë greke, thoshte Çabej, deri vonë përdorej shqipja. Njëri ndër presidentët e parë të Greqisë, Pavlo Kundrioti (1929), kishte deklaruar: “Ne arvanitasit e çliruar Greqinë nga turqit. Ne arvanitasit e krijuam Greqinë”. Me këtë nuk dua të them se Greqisë duhet t’ia hapim dyert tona, por duhet t’ia kujtojmë shpesh se ne atë e bëmë shtet.

Brenda çatisë sonë ç’ndodh? E dhembshme është se fatkeqësinë nuk mund e derdhëm. Diçka që ngritëm me mijëra vjet, saora e rrënuam, ashtu si në legjendën e Urës së Shejtë ose të Rozafatit: *më shumë prish se ndërto!* Për demonin e shpirtit tonë nuk dëshmon vetëm anarkia e disa muajve në Shqipëri, ku duket, para së gjithash, mungon ideali, vetëdija kolektive, kombëtarja. Më me qejf rrogëtarojmë e na madhërojnë të tjerët, që na lëshojnë një pëllëmbë vend nën diell.

4.

Shfaqja e shenjtërve të formatit të Shën Albanit dhe të Nënë Terezës janë raste të rralla edhe te popujt e mëdhenj. Paraqiten një herë në dy mijë vjet, ndoshta, ose kur njerëzimi katandiset. Prania e tyre rrit më parë famën e përkatësisë së gjakut që i takojnë. Tjetër gjë që ne nuk dimë të vlerësojmë momentin kur shfaqen ata, t'i pranojmë e madhërojmë siç e meritojnë. Të tjerët, kam përshtypjen, nga kurrgjësendi krijojnë idhuj.

Shpesh i shtroj vetes pyetjen: a e merituar vërtet Nënë Terezën? Ne që asgjashojmë vetveten në mënyrën më barbare, ne që dimë vetëm të shkatërrojmë e asgjë të ndërtojmë, bile për hir të fëmijëve, brezave! Në këtë kontekst shoh anomalinë: mos i gëzohemi fatkeqësisë?

Përgjigje nuk mora nga miqtë e mi poetë tiranas, as kur qetësia e turpshme u kthye në vendin e shqipeve të bardha.

(1997)

LIRIZMI I PËRGJAKUR

KOHË FISESH

Rrethi i fundit i maratonës

Prapë çarshia serbe ngrit çështjen e etnogjenezës shqiptare. Do të thotë fillon rrethi i fundit i maratonës së nacionalizmit serb, i cili nuk mund të lirohet nga ideologjia e tij hegjemoniste, të kuptojë se secili popull ka të drejtë të jetojë në mënyrë të vet. Zëra mortorë dëgjohen prapë nga Francuska 7, akademikë e pendrexxhinj të dështuar në Bosnjë e Kroaci. Turpin e tyre nacional përpiqen ta fshehin përmes ushtrimit të dhunës mbi popullin e pambrojtur shqiptar. Kjo është veti e paburrërisë. Aq larg shkojnë sa nuk u besojnë as baballarëve të nacionalizmit të tyre të egër, që ishin më koshientë se nipat.

Që në vitin 1922 Jovan Cvijiqi ishte deklaruar për origjinën ilire të shqiptarëve. Në vitin 1881 po këtë e kisht thënë edhe Garashanini. Më meritori nga ilirologjia, dr. Aleksandër Stipçeviqi, pak më parë deklaroi - megjithatë gëzon fakti se në mesin e serbëve të urtë ka që përkrahin origjinën ilire të shqiptarëve. E përmend Slobodan

Jovanoviçin me paraqitjen e tij në vitin 1987. Do të thotë se vazhdojnë të merren me origjinën tonë.

Mirëpo, si t'i bindësh kokat e "nxehta" të Mihajlo Markoviçit e të stafit të nacionalizmit serb, që mbi etnogjenezën tonë vazhdojnë të qirren e të derdhin vrer, ekzistimin tonë ta shikojnë në kuadër të politikës së ditës. Për shkak të Serbisë së Madhe, intelektualë e akademikë serbë bishtojnë të vërtetën e shkencës së tyre dhe çojnë dorë, bile edhe nga baballarët e nacionalizmit serb.

Tek lexoj shkrimet e M. Markoviçit e stafit të tij nuk mund të mos e kujtoj kohën e perënduar të Titos. Paraqitjen e tyre, në ca tryeza filozofësh e intelektualësh, e kishte konsideruar të dëmshëm për ish-bashkësinë. Ca më të guximshmit, paraqitjen e Markoviçit e të tjerëve e kishin përkrahur si qasje e re properëndimore. Në të vërtetë, në hapësirën e ish-Jugosllavisë kishte nisur të ngrejë kokë nacionalizmi serb, i cili më vonë popullin e vet do ta shpjerë në një kasaphanë të rëndë. E, kjo nuk është vetëm çështje serbe në mbyllje të shekullit njëzet.

Shumëkush nga ne pas një kohe ndoshta nuk do të jemi, por numri i mundshëm i kandidatëve për në Hagë sa vjen e rritet. Ky nuk është patriotizëm, por fatkeqësi e një primitivizmi mesjetar, që kërkon triumfin e marrë në fatkeqësinë e të tjerëve.

Rrethi ynë i maratonës nuk do të mbyllet as me vrapimin e fundit të nacionalizmit serb, megjithëse këndeje e andej Murit - pavarësia e Kosovës ka zënë ca t'i frikësojë. Pavarësinë unë e konsideroj, para së gjithash, liri edhe për vetë serbët, kthim të besimit në mes të ballkanasve.

Gara në vetëzhdukje

Në Shqipëri bëhen gara se kush më shumë do ta lëndojë vendin. Kjo çmenduri nuk ka të ndalur. Por çudit gjakftohtësia e tërë atij potenciali intelektualësh, nuk ka kush guxim të ngrejë zërin kundër vandalizmit të pashembullt në historinë më të re të njerëzimit. Nga

Jugu në Veri dhe nga Veriu në Jug derdhet Shqipëria si një vend i shkretë. Nga verbimi partiak, klanor, farefisnor, intelektual gjendet në një situatë të palakmueshme para çështjeve të tjera madhore si: në ndërtimin e mëkëmbjen e etnisë, kthimit të dinjitetit njerëzor e kombëtar, paqes në familje e në vend.

Le përshtypjen se intelektual i ynë luan rolin e asnjësit. Brenda vetes merret me do gjëra të imëta, shkakton problem për kurrëgjësand, që t'ia tërheq vëmendjen masës dhe disi të harrohen probleme shumë më të rëndësishme. Kultivimi i trimërisë brenda vetes nuk ka asgjë të përbashkët me etikën e intelektualit: ai është veti e mediokrit, që u rri gjërave në pritë për të treguar “kujdestarinë” e vet të përhershme kinse mbi të keqen.

Dhe me ditë nuk dëgjon gjë të hajrit, pos sharje rrugaqësie e etiketime bodrumesh. Në mënyrë të pavetëdijshme ia hapim udhën dhunës të depërtojë edhe më në qenien tonë të shprishur. Nëse ca nga institucionet tona të çfarëdo profili qenkan pengesë e ecjeve tona, atëherë haptas t'u bashkohemi “të pakënaqurve” dhe t'i shuajmë ato bile për shkak të forcimit kombëtar, sepse nga përbindshit, mendermethënë, nuk mund as të... Po që se dikush vërtet menduaka se me rrënimin e tyre fitohet liria, t'i rrënojmë sa më parë. Por udha në fitore, mjerisht, nuk shpie përmes shkatërrimit të vetvetes.

Ranë me qindra objekte nga Veriu në Jug - me rëndësi të dorës së parë për etnogjenezën tonë; vazhdojnë të rrënohen edhe ato pakëz që kanë mbetur, e intelektual i ynë përmorravet, zë në thua në vetvete. Po ky është një harakiri - individuale kolektiv. Një rrëshqitje jona ua bën të mundshme të tjerëve të luajnë si të duan e kur të duan me etninë tonë e askush të mos turpërohet për atë që bën ndaj nesh. Te ne historia asgjë nuk korrigjoi, për ne nuk vlejnë as mesazhet e rilindësve dhe të burrave të devotshëm, ne duam të jemi ata që nuk mund të jemi. Këtu qëndron problemi i fatkeqësisë dhe vogëlsisë sonë.

Mbi çdo gjë tonën të shenjtë shfaqet hija e karriges. A e keni vërejtur, shumëkë as në ëndërr nuk e le të qetë ajo. Dhe kur atë e lëviz

ndonjë dorë e padukshme, ndodhin gjëra të çuditshme në kodeksin tonë: më nuk jemi ata që ishim.

Bira e mbramë e kavallit

Rreth Shoqatës së Shkrimtarëve më kanë pyetur tre-katër gazetarë të tri-katër gazetave. Bile njëri më ka bezdisur disa herë: a do të japësh dorëheqje? Nuk doja t'i fyeja, mbasi për dorëheqje kam menduar shumë më herët, jo për shkak të problemeve që shtruan kolegët. Në këtë kaos tonin kombëtar Shoqata është birë e mbramë e kavallit, mu për këtë nuk jam trim të merrem me të. Qëndrimi im aty apo jo, nuk do të thotë *liri* nga dhuna serbe; po ashtu, aq shumë kemi probleme sa çdo dorëheqje nga ajo nuk do të shkaktonte asnjë tërmetth, sepse ka probleme të tjera më qeniesore se ndërrimi i stafit udhëheqës brenda këtij institucioni tonë. Kjo nuk do të thotë se ata duhet të jenë të përhershëm. Ndërrimi duhet të ndodhë edhe për arsye të tjera.

Mbasi e zura Shoqatën ngoje, dua të them se Ajo nuk e bën shkrimtar askë e më së paku mediokrin, siç nuk do të thotë gjë as botimi i një libri, dy apo dhjetë e të jesh anëtar i Shoqatës. Nëse jap dorëheqje nga Ajo, do ta bëj pse në gjirin e vet ka pranuar vlera të paverifikuara. Ndoshta, është menduar, bile në këtë institucion me numër t'ua shkojmë Serbisë dhe Albanisë bashkë. Në këtë zezonë unë vërtet nuk jam trim. E di se do t'i zhgënjeja mediokrët me frigacakllëkun tim të jepja dorëheqje. Fatmirësisht, Shoqata është organizatë vullnetare, hyn e del e del e hyn. Më lart i thashë të gjitha. Nuk dua të pranoj, megjithatë, se ka shqiptarë të këqinj...

Hajla

Më ka pasë premtuar Azem Shkreli se do të ngjitemi në Hajlë. Ta shohim Kosovën si në shuplakë dore. Për këtë e kishim njoftuar edhe Gurakuqin. Ai kishte pranuar të na shoqërojë e të shënojë çdo

hap tonin drejt pushtimit të *Majës*. Apostafat kishte porositur një kamerë e mjete të tjera përcjellëse. Azemi iku e Gurakuqi buzë Bisticës së ftohtë numëron xhenazet e sakatosura sa aparati nuk ia kap.

Ndërkaq, në Hajlë doli një mik i fëmijërisë. Në dhomën time me kamerën e tij ma zdeshi deri në asht Hajlën. E pashë atë që pëshpëritej e nuk doja ta besoja. Nga ajo ditë nuk më bie ndërmend për Majën. Më dhimbet Azem Shkreli, që nuk e pa këtë maskenball shqiptar, këndeje e andej Murit - me tyrlë mahlukati, bashibuzukë...

E nesër? E nesër kam vendosur të protestoj haptas pse vërtet nevojtoret tona nuk paskan pasqyra? Aman, or zot, nuk dimë ç'të bëjmë me tërë këtë tru tonin. Paskemi tepër e, atje në fund na buzëqesh Atlantida. Ju lutem, një karrige të fortë, se i ka gjashtë bythë e një kërthizë, ku humbet edhe mbretëria.

Kërkoj falje nga puritanët e fiseve.

(1998)

PUSHKALLA

1. Mesjeta

Nacionalizmi serb është specifik, mbështetet në rrenë dhe në hegjemonizëm. Është e logjikshme se një ditë do të dështojë. Pra, e vërteta atë do ta qërojë. Dhe ky dallon nga nacionalizmi im, i cili ngritet mbi të vërtetën, në vetëmbrojtjen e qenies kombëtare, në mbrojtjen e etnisë dhe nuk është agresiv çfarë na paraqitet nacionalizmi serb.

Për fat, ne jemi realitet. Dimë edhe për etnogjenezën e fqinjëve (shek. VII), të cilët nuk mundën të shkoen nga e kaluara e dyshimtë. Fabrikime të llojlojshme vazhdojnë edhe mbi gjëra më të imëta shqiptare. Pakkush e gëlltit atë, që e bluajnë mullinjtë e tyre të erës. Kapen për do gjysmë të vërteta e bishta mjegullash. Kalojnë në histori gjithënacionale. Dikur bëhen të gërditshëm dhe nuk janë më atraktivë as për kuvende e as për fisin e tyre. Sheshelqe nuk mbrohet dinjiteti, as hyhet në Evropë. Apo, nuk iu intereson qytetërimi i ri? Më nuk dyshoj se fantastika nuk e ka edhe një damar të marrëzisë. Të qeshet kur dëgjon e lexon dëshmitë serbe për autoktoninë e të “drejtën” e tyre historike në një tokë të huaj.

Dhe, ka kohë që e parafytyroj atë farë *djepi serb*, që flitet aq shumë për të. Çfarë na qenka? E paskan bartur në shpinë nga Karpatet dhe e paskan ngulur diku-aty në një hapësirë vakuum. Sipas mendjes serbe, aty gjë e gjallë nuk paska ekzistuar më parë, edhe pse paska pasur një emër fisnik *Dardani*.

Duke lexuar e dëgjuar gjithfarë “margaritarësh”, nuk çuditëm nëse do të deklarohen brenda një kohe të afërt se edhe filan planeti është i tyre mbasi që në shek. VII paska aterruar aty diku një satelit i shkurrës. Po me paraardhësit, ç’paska ndodhur? Serbët e mençur e

dinë se ajo, që vazhdon të mbështetet mbi të ashtuquajturin *Mit i Kosovës* (1389) pakëz gjë mund të vërtetohet.

Me sa di, një fis që vret fëmijë e gra shtatzëna, nuk ka problem vetëm me psikoetikën e tij; se *krimi* nuk mund të mbështetet as në patriotizëm. Më habit, posaçërisht, se çfarë supermeni paska qenë ai burrë përrallash, që e paska bartur atë djep në shpinë nga shkurra deri te Rrafshnalta e Dardanisë. Me siguri ai ka qenë më dinjitoz e më i fortë se Shesheli, i cili nuk mund nguli as në Bosnjë, aty te stomi i Savës.

E ndiej veten të fyer se fqinjët asnjëherë nuk më treguan për atë mrekulli hyjnore dhe *djepin e artë serb*. Bile kisha mësuar edhe unë diç, si duhet t'ua zë derën të tjerëve, ose djepin tim ta hedh në një tokë të huaj e shpejt e shpejt t'i nxirrja tapitë për të dëshmuar dhe për të bezdisur botën se nuk bën të fyhet as djepi im, bën mrekullira edhe ai. Por një i shenjtë më kishte pëshpëritur se nuk ka nevojë: E ke rrënjën aty thellë. Poetesha e ndjerë, Desanka Maksimoviq, e cila kishte qejf të fliste edhe për të parët e saj, shpesh ma kujtonte: edhe Beogradi ka pasur emër ilir. Unë sheshelqe as drashkoviqqe nuk dëshiroj t'i fyej fqinjët. Kam pakëz dinjitet dhe respektoj të drejtën e secilit për të jetuar.

Në dy librat e shenjtë të njerëzimit, *Bibël e Kuran*, thuhet se sendi i huaj është haram, nuk mund t'i shpëtojë dënimit askush. Bisedat me tone mesjetare e të mërzitshme se *dubët* apo *nuk dubët* lejuar botën të mbikëqyrë të drejtën, që shihet e dihet edhe në ferr, e kuptoj se historia po ia përcaktuaka njeriut edhe më të keqen - *vetërobërinë*. A do të dialogohet me ata, që vrasin edhe fëmijë e gra shtatzëna, duhet ta peshojë më parë viktima. Thonë se azganllëku është e zeza e fisit. Në këtë kontekst e parafrazoj një shkrimtar të mençur serb: kjo mund të jetë lufta e fundit, që serbët e bëjnë me këtë emër (S. Basara).

Tupanat, megjithatë, bien për ata që kanë veshë. Fundshekullin XX fqinjët e mbyllin me çepenga aziatikë, duke u fotografuar pranë trupave të pajetë të viktimave dhe duke puthur alltitë mbi kokat e "fituesve", t'i kenë ato së paku relikte nga marshimi i tyre i marrë në toka të huaja. Nuk dëshiroj fqinjët t'i shoh në hijen e rekuimit

sheshelian e azganëve të tjerë, as nuk bën të harrojnë se shqiptarët nuk janë ata të viteve 1878 kur ndiqeshin e vriteshin Toplicës; po ashtu, lulekuqet mund të kenë një ngjyrë tjetërfare më të rëndë; vjollce, bie fjala, apo të shkrumit. Unë respektoj dinjitetin njerëzor, por dhuna nuk është stoli për kraharorin e njeriut. Me perëndimin e diellit, nuk mbyllet horizonti. Mund të ndodhë që, më në fund, serbët dhe shqiptarët të ndahen si fqinjë të mençur e këtë ta bëjnë për shkak të së ardhmes mbasi ajo vepron kundër logjikës së fiseve. Por aty poshtë ende shqirret sheshelqe, se Kosova na qenka çështje e brendshme e Serbisë (!) E, për Drenicën, Glogjanin, Llaushën e fshatra të tjera, që pakkush di edhe nga ne, hapen dosjet në Këshillin e Sigurimit. Meritë për këtë kanë mu fqinjët me primitivizmin e tyre. Na vrasin të na bëjnë të pavdekshëm. Robërohen për shkak të pavarësisë sonë. Këtë “nderim” nuk bën t’u harrojmë. Shkuan pas kambanës së shurdhër të nacionalizmit...

Revolta e mikut dhe vilat e shpirtrave

Kur e kam lexuar romanin *Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zyllo* të Agollit, i cili u botua së pari në vazhdime në *Hosten* të Niko Nikollës, kam pëshpëritur: qenka e mundur të shkruhet diç e tillë edhe në Shqipërinë e Enver Hoxhës (1971).

Në atë kohë Dritëro Agolli ishte kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë. Nikollën e kishte mik të muhabetit dhe të gotës. I tregon një ditë se ka ndërmend të shkruajë një roman, ku do të flasë pa dorëza për servilitetin e moralin e “njeriut të ri” në vendin e shqipeve, aty ku ëndërrohej se do të hanë “më lugë floriri”. Sapo e kishte dëgjuar Nikolla, pranon se duhet lëvizur gjërat. Përfundon botimi i romanit në vazhdime tërë në ankth, i del pastaj edhe si libër e qeveria, që kishte rrënuar shumë koka më të mëdha të kombit se ajo e devollitit, ishte bërë e shurdhër dhe kishte kapërdirë disi “shakanë” e hidhur me arsytim - si Dritëroi ashtu dhe Nikolla janë shakaxhinj dhe nuk mendojnë keq. Në Evropë mendohet ndryshe. Më kishin pyetur shpesh ca analistë të Ballkanit: a është e vërtetë se Agolli e ka shkruar

Zylon në kohën e Enverit dhe se atë e ka shkruar në Tiranë. Habitëse ishte kjo se në roman jepej serviliteti i “njeriut të ri”, korruptimi i shoqërisë, rënia e ngadalshme e rendit diktatorial, që “kishte gënjer popullin se do të hanin me lugë floriri”. Shkrimtarit të guximshëm nuk i shpëton gjë. Ai vështirë kapet edhe kur bie.

Gjatë *Javës së Kulturës së Kosovës* në Tiranë (1993) më kishte rënë të dëgjoj *fjalën shkërdhatë*. Pyes Dritëron për të. Lëshoje teposhtë, më kishte thënë. Është shthurur populli. Nuk di ç’flet. Besoj se do ta korrigojë një ditë edhe fjalorin. Qëndrimi i Agollit rreth demokracisë interpretohej nga të gjitha rrafshet. Nuk mungonin as etiketimet në adresë të tij në të cilat dyshoja. Përpara kisha atë, që kishte krijuar Zylon. Te miku shihja kurajën intelektuale, që u mungonte cave: demokracia në Shqipëri është gjysmake, pa lirinë e demokratizimin e Kosovës. Përkrahte një rend të ri në gjithë hapësirën shqiptare; dinjitoz ashtu siç kishte biseduar shpesh për Zylon me Niko Nikollën, të cilin e njihja. Me përpikëri ky kishte shënuar atë *gabimin gjeografik* të Lasgushit tek ishim përqaftuar përmallshëm me bardin. U besohet atyre, që nëpërkëmbin edhe krijuesin, personalitetin e tij?

Ditë më parë lexova se Dritëroi prapë ngrit zërin kundër meritokracisë. Fjalën *shkërdhatë* për të cilën e kisha pyetur e që ishte e përdorshme nga halabakët e trotuareve të Tiranës, i kishte vënë edhe bishtin-*kraci* Pra, nocioni më i ri *shkërdhatokracia* simbolizon pakënaqësinë e tij ndaj realitetit të egër shqiptar dhe tregon se kisha të drejtë kur besoja se devolliti e kishte nisur betejën shqiptarqe për demokratizimin e shoqërisë sonë. Zylloja ishte pasqyrë e thyer e një kohe, që nuk bën të përsëritet.

Tri herë pata rast të takohem me lidërsipin e demokracisë. Dhe, tek kishim mbyllur bisedën një herë, më kishte pyetur se ku isha vendosur. Pa hamendje i kisha thënë te Dritëroi. Pakëz i hutuar kishte shtuar: I kemi ca vila. Aty vendosen edhe Tuajt. Ende ka shpirtra aty, iu kisha gjegjur në të njëjtën mënyrë. Nuk mund të bëj gjumë të mirë në vila, ku shpirtrat zhurmojnë, po ashtu miqtë nuk i zgjedh sa herë ndërrohen qeveritë...

Rrëzë Sharrit, në Teçen famoze të bektashinjve në Tetovë, unë dhe një mik bisedonim me Dritëron. Bashkëshortes së tij seç iu kishte tekur: Ju të Kosovës e keni dashur, Salon! Më pak e kisha pritur unë mbasi në shtëpinë e Agollëve kisha bërë edhe gjumë. Ashtu është zonjë, i them. Një bisedë të gjatë për një javore të Kosovës e kam zhvilluar me tët shoq e jo me Salon edhe pse shtëpitë tona na i ndan një vrap kali...

Dritëroi ka të drejtë që revoltohet prapë. Është krijues dhe nuk mund të pajtohet me shkatërrimin, me turpin nacional. Shkërdhatokracia nuk mund i bëri dy shqiptarë bashkë, as të lirohet nga provincializmi i çatisë.

Vrastarja

E kishin lavdëruar, lavdëruar e lavdëruar sa nuk bën më. Por koqobashi nuk e kishte pasur një dhëmb e i fluturon ajo *fjala*. Viktimës nuk iu kishte dashur më as plumbi. Pushkalla e zotit...

HUMOR NË KOHË VDEKJEJE

Çeçeni dhe drinasi

E kush ka luftuar si Çeçenia? Ja, ai popull nuk paska këngë trimërie për gjithë ato luftëra, që ka bërë disa shekuj kundër Perandorisë Ruse. Assesi të kuptoja këtë. Çeçeni, i cili studionte letërsinë krahasimtare, disi forconte mendimin e djathtistit tim, i cili ishte mik i tij, dhe ndërmjetësonte në mes nesh. Duhet kryer punën, më vonë le të mendojë kush të dojë për veprën tënde, që ke bërë për çështjen kombëtare. E përsëriste qetas mendimin rreth pyetjes pse çeçenët nuk e kultivonin këngën e trimërisë. Njeriu ynë asnjëherë nuk ka shkuar në luftë duke menduar se çfarë kënge do t'i qesë populli nesër; ai ka dalë te vija e zjarrit, e ka ndërë obligim kombëtar se duhet dhënë diçka për rindërtimin e vendit. Tek thoshte këtë çeçeni i vendit të largët, djathtisti im shkonte edhe më tutje, duke vënë në pyetje edhe krijimin e heronjve tanë nacionalë e që vështirë e gëlltitja. Mund të pajtohesh me atë se çeçenët nuk na paskan këngë trimërie, por se ca heronj tanë na i kanë krijuar të tjerët, këtë nuk mund e merrja me mend as nuk doja të besoja. Sidoqoftë, gjendesha në mes dy të rinjve që, ndryshe i shikonin rrjedhat momentale, por dhe heroizmin e akcilit popull. Nuk e vazhdova më bisedën, sepse preknin në dy gjëra tepër delikate. Vazhduam të përcillnim edhe këngën tjetër të një grupi këngëtarësh nga diaspora, ku njeriu ynë gati i ngjante një qenie fantastike. Megjithatë, si çeçeni ashtu dhe djathtisti u duartrokitën. Nuk dija, a e kishin me zemër apo...

Nata në Vjenë i ngjante një trupi të bërë shoshë nga dritat e një bote krejt tjetër nga ajo që vija. Masmediat vazhdonin për masakrën në Drenicë. Çeçenit dhe djathtistit ua tregova dikur tregimin për një drinas, të cilit kur iu kishte mbushur shtëpia plot minj e gjarprinj, ia kishte vënë flakën. Kur e kishin pyetur pse kishte vepruar kështu,

kishte deklaruar se dëshironte të lirohej nga fantazmat. Djathtisti kishte ulur kokën, ndërkaq çeçenit i kishte rënë një hije. Me drinasin tim na kishte dalë punë tërë kohën e lume pastaj.

Albumi historik

Falë zotit, maskenballi kishte ndodhur. Miku që kishte marrë pjesë në atë testim, m'i tregonte ca fotografi nëpërmjet të të cilave donte të më bindte se deri ku kishte shkuar koqja e tij. E kisha shikuar me mërzi dhe fotografitë me rend, të cilat ishin bërë kur paria e kasabasë sonë kishte zbritur për herë të parë aty. Përmes ngjyrave e buzëqeshjeve fare mirë lexoheshin, por pas ndonjë hije, zoti e di se ç'fshihej. I thashë se për atë maskenball kam dëgjuar dhe një këngë fort të gjatë, gati më të gjatë se ato të Mujit e Halilit. Ia kisha përmendur emrin e rapsodit, i cili aty në hijen e rëndë të Katedrales së Këlnit ma kishte kënduar. Miku, me krenari kishte shtuar se aty diku zihet ngoje edhe emri i tij. Ia kisha përmendur edhe ca micsokola të tjerë, por miku ngulte këmbë se më shumë vend i kishte dhënë këtij.

E kishim zbrazur edhe një shishe uiski. Nuk doja t'ja prishja qejfin. Ai gjendej aty, në *Albumin historik*, siç e kishte pagëzuar koleksionin e atyre fotografive nga ai maskenball turistik. E kisha takuar pastaj edhe nëpër kafenetë e Alesë së Shpëtumtarëve të Kombit me ualkman në vesh dhe një ditë nuk munda pa e ndalur. Miku, si gjithmonë, me gaz në buzë që, më në fund, gjendej në një *Album historik* e që kishte nisur të dëgjohej edhe tej shtatë kodrave, ma zgjati dorën sikur donte të më tregonte atë që dëgjonte nga shiriti. Shiriti vërtet silllej mu aty ku rapsodi ngriste zërin për burrërinë e tij atje larg. Ja, pra, kështu krijohet historia, pëshpëriti. Kjo është vjetëruar. Tani ka shumë më të forta se kjo. Dhe, i tregova për një hall, që e kishte rrokur rapsodin. Kishte vendosur ta çkëndojë atë këngë për atë maskenballin se nuk i kishte dalë siç kishte menduar. E kishte hequr nga veshi ualkmanin për të dëgjuar atë që ia thosha e që nuk mund të besonte. Në të ndarë i thashë: punë i keni qitur edhe rapsodit të gjorë, kërkon mënyrën se si t'u nxjerrë nga kënga dhe *Albumi historik*.

Peliçja

Në një shtëpi aristokrate, në lagjen e aristokracisë vjeneze, një konteshë me të gjitha tiparet e një aristokrateje të rëndë, e kishte lënë hapur dollapin e rrobave, me gjasë duke zgjedhur se ç'duhej të vishte mbasi jashtë ngrinte marsi. Me vëmendje kisha përcjellë lëvizjet e garderobën e saj dhe sytë, nuk di as vetë, më kishin rrëshqitur në një peliçe, që nuk kisha pasur rast ta shihja një të tillë. Me siguri ishte e kohëve të fundit për historinë e së cilës nuk më foli as më vonë. Dhe, nuk kisha mundur ta përmbaja veten, kisha buzëqeshur tamam ballkanqe. I kisha propozuar se do të ishte mirë ta vishte mu atë peliçe. Më kishte shikuar rreptas dhe atë e kishte mbuluar me ca rroba të tjera. Megjithatë, nuk arrita ta shihja trupin e saj në atë lëkurë, që ndriste nga errësira e qimeve. Dhe, sapo pinim kafe, më kishte folur për bukurinë vrastare dhe për do nene të kodit evropian se vrasja e kafshëve është e dënuar me ligj; në to nuk guxohet të shtihet mbasi i mbron ligji.

Me një mik të pendës në Gjermani i kishim rënë një lagueje, ku ekzistonin edhe hotele për shtazë. Më kishte thënë pastaj se vetëm në këtë vend janë të siguruar afro njëzet milionë qen e maca, sigurimi i të cilave arrin një shumë fantastike. Në të vërtetë, ne udhëtonim në pjesën tjetër të ndritshme të Evropës, ku pakëz më ndryshe kuptohet edhe definicioni mbi *lirinë*.

Konteshën vjeneze nuk dëshirova ta shqetësoja më. Veshi çfarë deshi dhe si e ndiente veten më mirë. Pastaj kishim vazhduar aty ku kishim mbetur rreth asaj ç'ndodhte në Ballkan. Prapë kishim zënë ngoje familjet Ahmetaj, Jashari e ca të tjera, që eskadronet e mjerimit serb i kishin ekzekutuar para shtëpive. Kontesha kishte mbyllur sytë. Në bibliotekën e saj dikur pastaj kishte kërkuar një fjalor dhe fjalën *Ballkan*. Me një cinizëm kishte pëshpëritur: Nuk është çudi të ketë atje edhe peliçe nga lëkura e njeriut.

Ditën kur ikja nga Vjena, në një skaj letre kishte shënuar edhe këtë: më bukur shihet trupi jashtë peliçes, lëkura e njeriut është më gjentile. Dhe tek kishte shtuar edhe diç tjetër, më kishte rënë

ndërmend mëhalla ime, gratë me mintana të arit dhe peliçet, për të cilët burrat e gJORë shkonin deri në Sham. Aty edhe i varfri duhet të tregohej i pasur.

Palaço

Pikëlluese është kur fjala të tradhton. Kjo, disi, e kishte gjetur mikun tim, i cili kohëve të fundit kishte filluar të merret me shaka mbasi thoshin, iu kishte lagur baruti tek kapërcente vijën e përrockës. E kisha vërejtur këtë. Ai tani grindej më shumë me vetveten se me të tjerët. I dukeshin lojë tërë ato fjalë, që i kishte zbrazur duke etiketuar e sharë me rend sa një ditë kishte mbetur kalli vetëm. Nisi të merret me shaka, por gazi nuk i dilte, megjithatë. Dhe, a mund të ketë gaz në kohë vdekjeje? Duhesh të jesh i pacipë e të luash rolin e palaços së oborreve; të bësh dikë të qeshësh. Por miku im ishte nga ata që më me ëndje vazhdonte artin e vet, ku kishte treguar aftësi, bile për t'i argëtuar njerëzit edhe në kohë vdekjeje.

I bija Alesë së Shpëtimtarëve të Kombit dhe syri ma zuri trimin me barut të lagur. Nuk dija ku t'ia nisja. Drenica ishte diç e largët për të, tokë e huaj. Nuk i interesonte vija e zjarrit, por e tejmja, se vetëm atë mund ta shtrinte për tokë. Hajgarexhinjtë, megjithatë, e dinë kohën e vet. Prita ata i ka mësuar të jenë vigilentë dhe të trimërojnë popullin kur duhet. Zanati i tyre nuk është i lehtë. Çfarë palaçoje mund të jesh kur nuk mund të bësh shaka edhe kur derdhet gjaku? Trim je ti, i them. Baruti ty nuk t'u ka lagur ende. Në syrin e tij kisha hetuar më vonë një pikë lot. Ishte në elementin e vet. Qante palaçoja i barutit të lagur, i cili kishte bërë "kërdinë" mbatanë përrockës. Por, ja u qeshka edhe në kohë vdekjeje!...

Zbulimi i Zululandit

Shkruhet të mos harrohen gjërat. Nëse ato harrohen pa rënë muzgu, atëherë mos i hyr. Isha gjendur në një det letrash. Cilën ta

shfletoja më parë. E uroja Faik Beun për zbulimin e Zululandit. Ç'mund të thuhet më tepër për një fis. Më ishte gozhduar syri te një thënie e “syrit të dytë”: “Çështja shqiptare par ekselans, është regjionale, bile çështje evropiane”, thoshte zoti Mile Gjukanoviq. Mirëpo raketimi i S. Basares mbi “babanë e kombit”, Dobrica Qosiqin, ishte një thirrje drejtuar ndërgjegjes së serbizmit: “E kjo do të jetë, në raport të forcave në botë, me gjasë lufta e fundit, që do ta bëjnë serbët me këtë emër”.

Hija e karriges

Njeriu ynë ka kohë dhe ndryshe i shikon punët. Bile, edhe nëpërmjet humorit përpiqet të ngjitet atje ku nuk është parë kush më parë. Zekeria Rexha, duke shkruar për *Ndodhitë e Talush Efendisë*, kishte thënë: burrat e fortë shka nuk mund tëbajnë... Unë, ka ditë që e shoh kronin tim duke rrjedhur telartë dhe njerëzit duke vrapuar vilajetit me karriga të mbërthyer nën zuzë. Kështu e ka, kur trimat fillojnë të bëhen edhe shakaxhinj. Megjithatë, unë nuk do t'ia fal shpirtin djallit...

KRIMINIMI I SHPIRITTT

Në anën e të mundurve

Xhelati nuk e kishte paramenduar se jetën e vet e mbyllte me të gjitha tehmenatë e viktimës. Kjo nuk i kishte shkuar ndërmend askujt e më së paku shqiptarëve, se ai do të përjetojë orgazmën, një vetëkënaqësi të shndërruar në një dhembje ndaj karikaturës së mërzitshme njerëzore çfarë na është viktimia.

Disa dekada i kishte rënë rreth Keopsit ish-sllav dhe nuk i kishin bërë vend kund. Askush, apo pakkush i kishte duartrokatur për elaboratet fashisoide mbi deportimin e popujve, asimilimin e pastrimet etnike që, në një farë mënyre, u bënë “art” dhe aplikohen.

Në Majën e turpshme, të mos ekzistonte këmbekrye viktimia, dhe populli i tij i poshtëruar aty te këmbët e xhelatit, një varg nuk do ta shkruaja për dhunën. Por, ajo që nuk shënohet, do të thotë se nuk ekziston, as nuk mund të dëshmohet se ka ekzistuar një kohë traumatike e elaborateve të zeza për zhdukjen e popujve, për pastrimet etnike më makabre në historinë e re të njerëzimit. Krijuesi i njëmendtë duhet të jetë në anën e të mundurve.

Fatkeqësisht, koha jonë pak gjë dallon nga e Vaso Pashë Shkodranit para një shekulli e tëhu, kur e shkroi poezinë e famshme të vajit burrëror e të mesazhit të fortë “*Mori e mjera Shqipëri*”, aktuale edhe sot kur bajraktarët më shumë çmojnë një karrige se atdheun e bërë skllotë. Përjetojmë, pra, të pabesueshmen: askush askë nuk e pranon as e merr si vlerë e as si gjak të vetin, nënçmohemi e shahemi tamam thuaj se jemi diku në mëhallë të madhe. Bile zihet në thua edhe në të vdekur, që nuk e preferon kodi ynë etik. Një shthurje marramendëse bëhet shqetësuese edhe për të nesërmen: çfarë do të jetë ajo, a do të ketë diçka tonën apo në vakuumin e mistershëm, që na hapet,

pavetëdijshtëm rrëshqasim me teshekoteshtë. Dhe po vazhdon me këto thyerje, në mileniumin e tretë hyjmë si fis i Zululandit të Faik Konicës.

Nga gjithë kjo le përshtypje se ne nuk mundemi pa suslllovë. Ata vulosën shpesh dhe fatin e kombit. Kush këtë e bëri me gishtin e dorës së djathtë e kush me atë të mëngjër. Kryesore, popullit i mbetën duart në zharavë, pjesa e vdekur e vetvetes. Thonë se diku mbi Shkodër e paskan parë një hije në kalë të zi, duke zbritur. Unë nuk mendoj se është Berisha apo Nano e më së pakti shoku Enver.

Viktima kishte zgjatur qafën nën vezullimën e shpatës së xhelatit, i cili nuk kishte kursyer as të zisë e thonit për atë që nuk është e nishanit apo e shkurrës. Dhe padiktueshëm ishte shembur Keopsi bashkë me turpin njerëzor. Bukla kishte dalë në fushë se “burra” të tillë do të ketë derisa ligji ynë nuk funksionon.

Vija magjike

Ekziston një vijë e cila ndan trimërinë nga qyqarllëku. Vija shfaqet rrallë kur vëhen ose rrënohen mezhdat dhe kur duhet dëshmuar guximi. Ata që i afrohen asaj, e shohin veten jashtë vetvetes, ose u ngjajnë atyre që kthehen nga Nazareti. Për mikun tim, Kim Mehmetin, kisha dëgjuar më të pabesueshmet. Por unë e kam një të keqe se vështirë u besoj “patriotëve” që marrin dynjallëkun nëpër gojë. Thashethemet më bënë të dyshoj në “sinqeritetin” e tyre dhe në atë që e trumpetnin si “zbulim” të nëntokës apo të kondorëve planetarë, bile edhe ata që merreshin me prostitucion shpirtëror. Dhe, sa më shumë që ma shanin, te ai zbuloja dinjitetin e kurajon e tij prej krijuesi e intelektual. Fatkeqësisht, ata ishin “patriotë”. Mendonin ndryshe nga unë. Patriotçe vazhdonin të murmuronin nëpër biruca e qebaphane anadollake se kush ishte e ç’na ish. Neveritëse ishte përmorravja e tyre, diç që i konvenonte vetëm hasmit. Kaq poshtë rrëshqiste çarshia jonë malokhane. Kisha një turmë amorfe para, më tepër e dhënë pas xhamisë së universitetit e librit. Miku im, megjithatë, e dinte këtë dhe nuk ua vinte veshin as nuk dorëzohej se nuk kishte pse të bënte këtë para llavës kur kohë e kriminuar sa nuk kishte

trokitur; kurajon krijuese e intelektuale të vinte në veprim. Kimi foli, pra, kur duhet, atëherë kur të tjerët u shujavën dhe nuk i zinte vrima, ose kur ende prostituoheshin shpirtërisht.

Ndodhi Gostivari me të gjitha dimensionet e shpirtit të kriminuar. U shfaq ajo vija në hapësirën nevrrike, e cila vuri në pyetje edhe guximin intelektual. Nga ata rrahagjokës pakkush u dëgjua, bile të shqirreshin në nevojtoje. Kimi, thuaj se vetëm ai ekziston. I revoltuar për atë ç'ndodh rreth tij e populli të fyer, kishte reaguuar publikisht se nuk e pranon shtetin e tillë maqedonas, që fyen e përgjak popullin e tij dhe që ia mohon çdo të drejtë të tij ligjitime. Nacionalizmi i kriminuar maqedonas revoltën e mikut e kuptoi si provokim gjithëshqiptar. Dhe guximit të tij prej intelektualit e krijuesi, çudia e zotit, iu bashkua vetëm një femër, Teutë Arifi, poeteshë e gazetare e ditur; e fyer, po ashtu, nga injoranca anadollake, e cila është e mendimit se politika bëhet edhe në qymeza, ose duke etiketuar njerëz, që nuk pajtohen me sjellje, bindje, veshje e qethje qervishhaneje. Por kush kishte pritur një i përbuzur të ngrisë zërin para atyre koxha patriotëve, që nuk mund të marrësh frymë prej tyre? Ja, ndodhka edhe kjo. Indinjata maqedonase nis satanizimin jo vetëm të mikut. Kurorëzohet me krim-farsën mbi prefektin e syrgjynosur ashpër, Rufi Osmanin, pse paska mbrojtur identitetin kombëtar (!) logjikë e patlixhanxhinjve të rinj!

Gjesti i mikut tim shtron dhe një pyetje: vërtet, ku janë gjithë ata intelektualë, apo më me qejf merremi me sharje e ndërskëmbëca mesvete. Nëse është kështu, atëherë pasqyra e intelektualit të vërtetë u thye atë ditë te ajo vija magjike, ku ndahet burrëria nga qyqarllëku...

Avash trima, avash. Edhe fyerja duhet të ketë bukurinë e vet. Tek lexoja se ç'shkruhej për satanizimin e popullit të nëpërkëmbur, m'u kujtua Faik Konica, thënia e tij domethënëse për diplomatin e shquar shqiptar ndërmjet dy luftërave, Rauf Fincon - "Ai ishte shqiptar kur nuk kishte Shqipëri". Gjeniale për njerëzit e urtë, që armikun e shohin tjetërku, jashtë lëkurës së vet.

Dada

Butonin e kishte prekur i shkalluari dhe gati cullak sa nuk kishte dalë para aparatit tim syshkruara buzëkafshuara. A e di ç'thotë Kadare në veprën *Ftesë në studio* për xhelozinë krijuese? Kishte pyetur zonjusha tërë në ethe; ndoshta e rrokur nga xekrri apo korrenti, që nuk mund e qëlloja saktësisht dhe prej nga telefononte. Fjalët e saj linin të kuptoja se ajo ishte në hall të madh. Zonjushë e nderuar, i them, xhelozinë krijuese nuk e kuptoj në formë të mazohizmit, por si nxitje krijuese në veprimtari. Po pse e xhelozoni, bukuroshin tim? Dhe, përmendi atë, që nuk e ka ai. Këtë ma kishte thënë njëri mbasi tërë një ishull të vdekur e kishte bezdisur me atë prapa. Më erdhi keq, që nuk e vazhduam bisedën me zonjushën e xekrraftë. Gjatë kisha menduar se në cilin roman të verdhë apo film të Hiçkokut e kisha hasur Bukuroshin e Dadës, që vështirë lirohet nga zanati i vjetër. Kodoshllëkul Racizmi shfaqet edhe brenda kombit, familjes.

Kibuci

Fatkeqësia më e madhe serbe është se hegjemonizmi serbomadn kriminoid shpirtin e popullit të vet të varfër. Por kur do të prajnë klounët e formatit të Sheshelit, Arkanit, Drashkoviçit - për të cilët nuk dihet saktë nga cila vezë dolën, varet nga shkopi magjik i sotmërisë serbe se cilin do ta nxjerrë si alternativë para mbylljes së Teatrit të absurdit serb në kibucin e fundit të diktaturës, këtu poshtë, te bishti i Evropës, ku nuk di a ka më nevojë për ndonjë xhelat të ri mbasi viktima nuk e pranon lojën që i ofrojnë GAS-i...

KOMANÇEROSËT

Teatri nacional

Njëri e kishte pyetur trimin se kur e kishte ndërë veten më keq. Shul shqip i përgjigjet ai: Kur më ka lavdëruar kurrkushi. Unë kisha dëgjuar një variant tjetër. Por kjo më dukej edhe më e tmerrshme se ajo për bukën. Vërtet, të lavdërohesh nga ndonjë i rralluar është e turpshme. Filozofia e kurrkushit. *Unë, unë, si unë askushi*. Vetëkënaqësi e marrë. As hijen nuk ia kap syri. Me vetveten nuk mund të krijosh harmoninë e kolektivitetit pa rënë në dakord, së paku, me nëntëdhjetenëntë bajraqe. Tek atëherë ke bërë diçka. Ndryshe syrgjynosesh në ëndërr. Digjesh pa të parë kush. Një logjikë të tillë e kultivojnë diktatorthit; ata kur duan të dëgjoen sapo loja merr fund, do të thotë pas gjamës...

Sortë mbi sortë takon çarshisë sonë. Edhe halabakë të atillë, me dy shkrola në xhep, e që bëjnë hyxhym, tamam si një farë qeni i Sverkës diku në Drenicë. Pa ia ditur takatin vetes, të mbajnë ligjërata mbi etikë e deri te Poetika (Kishi); të flasin për postmodernen, për sensibilitetin e ri e ngulfaten nga hiperiflacioni i fjalëve. Brenda një strofe tri nocione për një kuptim. U bubullojnë foljet si në fushë të mejdanit. Nuk dinë ku ia nisin e ku duan të dalin. Merr pjesë në teatër këmbënesh nacionalë, ku ngulin këmbë të gjorët se janë edhe zbuluesit e fundit të...

Prapë miku ma zu pritën: Nuk e shutove ende atë shkulë? Njeri as kalemxhi, kameleon i dorës së parë. Ndryshe unë i shoh gjërat: në ndërëtimin e sërishëm të tyre, në emancipimin dhe organizimin. Duhesh të japësh kontributin tënd në pavarësinë e akcilit. Pra, t'i japësh shans edhe shkartës e në fund t'ia tregosh se ku e ka vendin. Njeriu mbetet një enigmë... E, halabakët vazhdojnë të përqyrraven

hijeve se nga thashethemet e përçarjet jetojnë. Ky është i vetmi “art” i tyre që e përsosin. Fatkeqësisht.

Po në Kosovë, ka diçka të re? Kullat e Dukagjinit i kam vetëm në pikturat monumentale të mikut tim, Muslim Mulliqit... Aty çmallem me to. Po në Kosovë, u vra kush? Sa fshatra u bënë rrafsh me tokë? Dukagjini im ndërron imazhin... Me nishana të rinj zgjohemi. Po halabakët? Bëhen më kallaballëk. Ndonjë i krisur ofron copëzimin e mëtutjeshëm të etnisë para një servili, që i kishte rënë rastësisht germa s nga llagapi tek ngulej para syretlijës...

Majë kokorrit të Evropës

Kisha shpenzuar fjalë pakëz si tepër, por ç'të bëja. Për shokun bëhet edhe më shumë. Nga kohët e liga e njihja dhe kur dajakxhinjtë ia jepnin ndonjë flakareshë, ngritja zërin se mbroja edhe dinjitetin tim. Dikur për një farë sebeci, kaloi gardhin. Tani më çon fjalë. Nevojtoret e metropoleve nuk mund i krahason me dephanet tona në mes arave të shkreta. Dhe më thotë, a po më sheh? Vërtet, kam shpenzuar fjalë sa nuk bën. Por nuk më dhimbsen. I kisha thënë gjitha ato fjalë të zgjedhura për arsye se dëshiroja ai të duket dikushi maje kokorrit të Evropës dhe, së dyti, pakëz anash ma kishin lënë në vatan. Më vonë mësova se shokut tim i kishte hyrë vetja në qejf. Mendonte se ai i vetmi ishte edhe tej detit të vdekur. Se këtë e atë mund ta bënte. E, për trimëri, nuk dua të flas. E dimë ne frikacakët që bile një gardh nuk mund e shkulëm, as e kapërcyem. Qiellit të Drenicës e Rekës së Keqe tani i zëmë plumbat me dorë. Nuk do t'ua lëmë asnjë trimave. E, kjo nuk është patetikë e më së pakti retorikë, por një postmoderne e zymtë. Shokut i falet edhe totkun po të jetë. Fat ke pasur të kesh një të tillë, që nuk e kanë të tjerët. Sidoqoftë në hall kam rënë tani. Nuk qenka siç e kam vizatuar në fjalët e mia. Në mes tyre mungon diçka, që paskam harruar pa e thënë. E të gjitha ato fjalë i derdha! Nuk di si t'ia kujtoj se nuk është ashtu. Paskam parë në ëndërr se kam një shok. Mu për këtë kërkoj falje nga paria e letrave shqipe dhe vetë shoku im. Pata dëshirë të mos mbetet hokubet në kokorr të Evropës. Por, siç

duket, faj kam edhe unë se tepër fjalë paskam harxhuar për ëndrrën e tij. E, nuk e shihja se aty diku mund të rrëshqasë ai. Me kohë paska qenë dashur të ngul. Duhet ta fajësoj, ndoshta, edhe kodin familjar: atij që ia ha bukën, nuk bën t'ia kthesh me stupc... E shoku im, le të shajë! Nuk ka gjë. E di ai, se edhe nga sharjet unë mësoj. Por...

Flitet se diku në Kosovë e paskan vrarë “terroristen” më të rrezikshme, një plakë nëntëdhjetenëntëvjeçare. Bile paska qenë e shurdhët dhe memece. Thonë, po ashtu, ata të soldateskës, pasi ta vrasin edhe embrionin, do të kthehen në pashallëk. Unë mendoj se Haga ka edhe karrige të tjera. Ajo gjendet mbi kokorr të Evropës

Kalemxhia

Me Azem Shkrelin kuptoheshim mjaft mirë, pa e thënë edhe një fjalë. Qetësinë olimpikë nganjëherë ia prishte njëfarë kalemxhiu, bejtet e të cilit sa herë i lexonte aty-këtu, me rrëmbim pinte kafe e raki bashkë: Defatorja, bre burrë, m’i zhveshi edhe brekët! Me kaq merrte fund revolta e tij ndaj një bejtexhiu nga diaspora. Formën pezhorative të Sali Kabashit nuk e përmend. Mendoj se atje ka edhe burra. Viti i dytë që Azemi nuk është. E, kalemxhiu vazhdon t’ia zhveshë brekët rugovsit. More kur do të duket ky më insan, i kalemit? Ja lexova tefterin e fundit të bejteve, m’u dhimbtë vërtet miku im poet. Aman, or zot, sa të tmerrshëm bëhen klandestinët...

E në Kosovë lindet edhe duke kaluar fatkeqësinë.

Përse?

Miku kishte shënuar anash: *Si është e mundur? Përse?* Kuptoja dhembjen e tij. Por në kohën e diktaturës çdo gjë është e mundshme. Shokët kishin bërë edhe punën e huaj në emër të ideologjisë, pasojat e së cilës i përjetojmë tani nën çatinë tonë. Në mënyrë të turpshme na kthyen shpinën ata të Stalinit, të Moas, pastaj kopilat e sojit të *flamurit të shekujve*. Kështu shkëputja nga e kaluara nuk bëhet lehtë, se çdo gjë mund të shtrohet në mënyrën habitore.

Petraç Kolecicën e lexoj me një frymë. Kryesisht shkruan për autorët që i kam për shpirt. Nuk bën të skajohet as libri “*Këngë nga koha e keqe*”. Në më të riun “*Me Mitrushin*”, i cili nuk është në nivel të librit të mëparshëm për Lasgushin, prapë ka ruajtur sharmin letrar dhe përmes krijuesit të madh të letrave shqipe, bën fjalë edhe për diktaturën - se deri ku shkonte ajo. Në udhëtimin e fundit Kutelin e kishin përcjellë mezi katërdhjetë veta. Kjo do të thotë shumë edhe për pyetjet e mësipërme që i shtron miku. Dhe tek varri kishte ndodhur befasia: e kishin varrosur shkrimtarin e nderuar pa ia thënë kush nja dy fjalë te koka. Përmes mendimit të Atë Gjon Shllakut, Kolevica na rikujton: *Tjetërkund, njerëzit e idealit, në u mbyteshin për së gjalli, nderohen për së vdekuri. Ndër ne ata mbyten dy herë dhe harrohen.* Ky mendim na qet në shesh të keqen tonë edhe në ditën e sotme: Ne nuk respektojmë vlerat, as nuk pranojmë madhësitinë. Të gjithë jemi të mëdhenj.

Komqendrori (kompozitë përbuzëse e Kutelit për Komitetin Qendror), sipas Kolevicës, kishte shkruar edhe më larg. E kish shpallur atë *shkrimtar fashist* (!). Ku e mbështetnin këtë konstatim, mbetet enigmë edhe tani. Do zoti e nuk është kështu, siç mendoj, por kam përshtypjen se mediokri ynë më me qejf pranon postin e diktatorit, qoftë ai edhe në bythë të dephanës, se t’i heqë kapelën një vlere kombëtare.

Nëse nuk do të lirohemi nga e kaluara, nuk di çfarë na shfaqet e ardhmja. Komqendrori mund të shfaqet prapë në një formë tjetër e më hokubet. Është momenti të mbështesim vetëm *kombëtares*. Ajo na duhet më shumë se kurrë. Unë shtroj probleme dhe nuk merrem me individë. E gjet kush veten, më bëhet qejfi. Nuk e paskam shkruar kot as tekstin.

E, flitet se: shahen, grinden, përçahen e populli në istikame. Ajme për trurin tonë... E, në mënyrën habitore kishte pëshpëritur miku: *Si është e mundur? Përse?*

Diktatura reprizohet në forma më morbide derisa një dorë e plotëfuqishme ta shkulë...

(1998)

FALEMNDERIT, PLAGA IME

Damasku

Ai që nuk e ka parë Damaskun, nuk ka parë asgjë. Për Lindjen ky qytet është si Parisi apo Roma për qytetërimin perëndimor. Udhëtimi im i ngjante më tepër një ëndrre. Kishte diçka nga përrallat e *Një mijë e një netëve*. Dëgjoja jehonën dhe kërkjoja shqiptarët e Shamit, të cilët i kishte hedhur ndonjë betejë e pakryer larg trojeve të tyre. Kisha probleme me gjuhë dhe tinguj, që ky veshi im ballkanas kishte nisur të çmësohej. Por ajo që hapej para meje kishte formën e plagës sime, e cila kushedi kur do të mbyllet.

Java e Kulturës së Kosovës në Siri (1982) kishte një qellim më se njerëzor: afrimin e popujve dhe të kulturave. Muhamet Mufaku kishte bërë shumë për këtë, duke shkruar e përkthyer nga të dy kulturat. Shkurt, para nesh shtronte pyetje qeniesore se dhembja kudo është e njëjtë. Bëhen dy dekada nga ai udhëtim i përendërrt. Por, ai që nuk e ka parë Damaskun, vërtet nuk ka parë asgjë.

Arnautët

Ëndrrat, shqetësimet, traumat, rropatjet, shijen e hidhur të kurbetit ca nga shqiptarët e Shamit kishin filluar t'i qesin edhe në letrën e bardhë. Lexoheshin ato si kujtime, ditarë, bile edhe si shkrime imagjinative. Në Lindjen e largët, përmes tyre, kishte filluar të hapet edhe një kaptinë për ne, të flitet e të shkruhet. Abdyl Latif Arnauti me vëllanë e motrën, Muhamet Mufaku e ca të tjerë bënë punën e pionierit, që më vonë do të kurorëzohet me suksese të theksuara, qoftë nga fusha e veprimtarisë letrare, qoftë në kërkimin e plasimin e të vërtetës mbi ne. Dhe përmes gjuhës shqipe ata ishin treguar të

shkathët edhe në përkthimin e autorëve të tjerë të ish-bashkësisë. Nga shqipja ishte përkthyer një roman i Miroslav Kërlezhës, pastaj disa poetë të tjerë, që ishin botuar tek ne në Kosovë. Unë këtë e shihja si avancim të gjuhës e të kulturës sonë. Ndoshta pse isha rritur e edukuar në një mjedis që nuk dinte ç’është urrejtja apo që nuk tentonte kujt t’ia prishë qetësinë. Para së gjithash, në qëndrimin e popullit e shihja edhe ngadhënjimin mbi të keqen. Kjo më trimëronte edhe për arsye se ne me dinjitet hapnim shtigje të reja.

Plaku nga Toplica

Dhe kisha takuar shumë shqiptarë nga vilajetet tona. Nuk mund e harroj një plak, i cili ishte nga Toplica. E kisha pyetur, si u bë, kaq shqiptarë edhe në këtë qyshk. Ai kishte ngritur gishtin. Më kishte thënë me hidhërim atë që më turpëronte. Nga ky gisht deri atje ku pordhet, mendermethënë, nuk ma kishin operuar nervin kur kisha lindur. Mu për këtë ndodhi gjithë kjo aventurë; shkaku i gishtit, i cili pakëz kishte bërë në mbrojtjen e dinjitetit. I gjori kishte lëvizur vetëm atëherë kur ishim zënë ndërveti. Një dorëshkrim të tij e kisha lexuar me një frymë. Rrëqethës ishte ai udhëtim i tij deri aty në Sham. Dikur i kisha mbyllur sytë. Ai më kishte zgjuar: punët me lot nuk bëhen.

Dhe si fantazmë i kisha rënë poshtë e lart Damaskut. Ku me autobus e ku me taksì. Kisha takuar ata të “namurit”, fytyrat e të cilëve nuk mund i harroj as tash. Natën e fundit Partia kryesore e Sirisë kishte shtruar darkën lamtumirëse. Ballë nesh qëndronin shumë intelektualë e shkrimtarë arabë, po ashtu dhe shqiptarë që veten e quanin amaut. Në mesin e tyre kishte dhe anëtarë të Partisë së Asadit.

Në tryezë kishin filluar të renditën gjithfarë specialitetesh arabe. Dikur ishte dëgjuar edhe tingëllima e lugëve. Tek kapërdija kafshatën e parë, ballë meje, në buzë të një arabi, kisha veneruar njëllën e gjakut si zgjatje. Nuk dija gjë për specialitetin arab, për sallatën me mish të gjallë. Kisha brofur. Në ballkon të hotelit më ishte sjellë vërdallë i tërë Damasku. Me diç të tillë nuk isha mësuar. I takoja një populli të lashtë,

që pakëz ndryshe i shikon vlerat njerëzore, qoftë edhe në fërgimin e një kofshe mishi.

Makina e madhe

Më kishte interesuar ky specialitet dhe më vonë kisha lexuar ca tekste se në vendet kryesisht totalitare ndodh një gjë e tillë, ku përmes një ushqimi të posaçëm mbahen forcat speciale. Arsyet: humbja e ndjenjës, kthimi te një gjakftohtësi për të marrë vendim në momentin kur duhet kryer ndonjë aksion, qoftë ai edhe krim. Para meje njeriu si qenie me një vetëdije të lartë, me një arsye që bënte të dallonte nga kafsha pësonte një farë metamorfoze në perceptimin tim. Kisha para vetes edhe kipcin, i cili në vend të mbrojtjes së viktimës, e shihja në rolin e xhelatit. Por ne ishim mysafirë e me një sallatë të tillë donin të na përkujtonin ndoshta diç që mund të ndodhë.

Shumë vjet më vonë në Paris kisha parë një film triler. Kund gjak më shumë nuk ishte derdhur se aty. Në fund ishin parë vetëm aktorët e krimin dhe kishte ndodhur ajo e pabesueshmja: ata mbasi ishin lodhur duke vrarë dhe nuk dinin më ç'bënin, se i kishte tmerruar mjerimi i tyre njerëzor, kishin filluar të vrisnin njëri-tjetrin. Në mbyllje të atij akti makabër ishte dukur një makinë e madhe. I kishte mbledhur të vrarët dhe i kishte hedhur në një hon, që nuk shihej nga errësira.

Miku në mes viktimave

Dy dekada më vonë në Vocklaburck, në *Ditët e Kulturës Shqiptare*, pagëzuar me moto mjaft karakteristike: *Paqe për shqiptarë*, kisha parë në ekran edhe varrosjen e zhvarrosjen e drenicakëve. Në mes burrave, që merrnin pjesë në këtë ceremonial mortor dhe bënin identifikimin e viktimave, duke i vënë në arka për t'i zhvarrosur prapë, mbasi azganët e dhunës i kishin hedhur ashtu siç kishin dashur vetë, kisha njohur mikun tim, Zekeria Cana, i cili nuk ishte hera e parë që tregonte guximin e tij qytetar, sepse patriotizmi tregohet aty ku merr

plagë edhe druri. Pra, fatkeqësia zbulon edhe burrërinë. I shtangur, pa fjalë kisha mbetur. Numërimi i arkave me fëmijë e gra ishte i madh. Do të thotë se terrori shtetëror në ta kishte vrarë frikën e vet. Më vonë mësova se miku im kishte kaluar ca net në mes viktimave. E di se të pakta mund të jenë fjalët e mia për guximin e tij prej intelektual. Por duhet të besohet se bota u takon më shumë të guximshmëve se atyre që i nxjerrin thikat nga këllëfi.

Nuk e di si m'u kishte kujtuar ajo njolla e gjakut para dy dekadash në buzën e arabit, diku në një hotel në Damask, sallata speciale nga mishi i gjallë. Dhe pse? Në ekranin TV masmediat botërore nuk pushonin për atë që kishte ndodhur në Drenicë. E bënin vallë këtë, për shkak ndërjegjies njerëzore apo për diç tjetër.

Drenica dhe mjerimi i ideologjisë

Kosova nuk është çështje e brendshme e Serbisë, siç vazhdojnë të ngulin këmbë azganët e “demokracisë” serbe para botës. Falë arrogancës së tyre mesjetare, çështja e Kosovës vazhdon të internacionalizohet me të madhe. Ndoshta është koha që edhe ky fis të lirohet nga demoni i vdekjes. Në mes popujve të triumfojë arsyeja, se nën këtë qiell ka vend për të gjithë. Masakra e Drenicës nuk zbuloi vetëm sa e ku janë shqiptarët, por edhe diç kanceroze. Lidhjet tona të gabuara në të kaluarën. Miqësia me ca shtete në kohën e monizmit nuk paska qenë e sinqertë. Tinëzisht paskan vepruar kundër interesave tona kombëtare. Kjo u pa edhe këtyre ditëve kur i dolën krah krimi. Të tillët nuk mund të kontribuojnë drejt në zgjidhjen e konflikteve. Ky është ai mjerimi i ideologjisë kur për arsye të ndryshme harrohen dhe çështjet vitale të një populli të derdhur. Falemnderit, plaga ime! Më në fund më lirove nga iluzionet. Fatin e përcakton vetë njeriu. Tregimi mbi Drenicën nuk mbyllet me fjalë. Është kohë e kombëtares, e dinjitetit...

Fundi

Në një roman politik, që nuk dihet kur do ta shohë dritën e të cilin pata fat ta lexoj, zhvillohet edhe ky dialog diku në Beograd. - Ky kontejner i takon rajonit tim, si Kosova Serbisë - tha i pari. - Plehu i tij kundërmon më pak se i të tjerëve - ia pret i dyti.

Dhe me strajca i hynë njëri-tjetrit. Disa mbeturina të mbledhura u derdhën për tokë. Nga zhurma e krijuar, një qen e një mace, të fshehur pas kontejnerit, ua dhanë këmbëve si para pushkëve të gjahtarëve...

Euro News ka rubrikën, që ka zënë të duket edhe në shtypin tonë: *No Comment*. Luftën nuk do të thotë se e fiton ai që i pari ia nis. Por ai që beson në arsye, në dashuri dhe në vajin e fëmijës...

(1998)

LIRIZMI I PËRGJAKUR

Krimi nuk mund të fshihet

Para nëntëdhjetës, aty në Grykën e Kaçanikut ishte qëlluar një fëmijë, pastaj Afrim Prebreza në Sllatinë. Ishin shenja të qarta se mjeshtrit e dhunës nuk do të kursejnë as fëmijë. Mendja e errët arkitekturë tjetër nuk di. Dhembjen e kisha ndarë me një poezi “*A gjuben pëllumbat*”. Vetëm konstatoja. Ndaj asaj që ndodhte, edhe fjala ishte e pafuqishme. Njeriun e kishte nxënë gjaku i zi. I isha lutur zotit askund të mos ketë më morbiditet. Nuk ngrihet dorë mbi fëmijë, mbi gra shtatzëna, mbi pleq e mbi një popull të pambrojtur. Po këtë mund ta bëjë vetëm një kope e frikësuar. Para meje ishin shtruar edhe shumë probleme që më kot grithnin ndërgjegjen njerëzore, e cila shpesh i duartroket edhe krimin.

Për herë të parë kur kishte shkelur Vili Branti në Poloni, kishte rënë në gjunj para flakës së përjetshme të viktimave aty në një shesh të Varshavës. Në emër të popullit të vet kishte kërkuar falje. E kishte bërë këtë një burrë shteti i një populli të guximshëm e dinjitoz, që di të përulet edhe para viktimës. Gjesti i tij për të padinjitozët ishte befasues. Populli, që kishte vrarë e shkretëruar, kërkonte falje nga viktimat, sepse ishte momenti që njeriu më në fund të lirohet nga demoni i vdekjes. Serbët këtë nuk mund e bëjnë, as kurrë nuk e kanë bërë. Esnafit të tyre i mungon kodi etik. Të kërkojnë falje, po ashtu, duhesh të jesh trim; të kesh ca virtyte njerëzore. As këtë nuk e kanë fqinjët tanë. Në mes Njeriut dhe Bishës (Monstrumit) megjithatë, duhet të ekzistojë një shpresë se krimi nuk mund të fshihet më edhe me gjithë morbiditetin.

Ditën e dytë të masakrës në Drenicë nuk gdhinë masmediat botërore me sintagmën “terroristët shqiptarë”. Disi e kishin veneruar se në bisht të Evropës luhej një lojë e pabarabartë e fliqtë, që nuk i ka

hije as luftës. Fjala *terrorist* ishte vënë në thonjëza. Më kot rropatet propaganda serbe për të bindur botën se në Kosovë ndëshkoheshin të ashtuquajturit terroristë. Masakra e Drenicës shpaloste një kapitull të zymtë nga historia më e re e njerëzimit. Ende nuk ishte harruar Bosnja e kamerat e masmediave zbulonin trupat e copëtuar të fëmijëve, të grave shtatzëna, të pleqve dhe të njerëzve të pambrojtur. Krimi nuk mund të fshihej, ishte aty troq para ndërgjegjes njerëzore dhe akuzonte terrorin shtetëror serb. Askush nuk mund u besonte fjalëve, që vinin nga çarshia serbe. Ishte e pamundur të bindësh Evropën se Drenica nuk kishte marrë nishanet e parë të lirisë.

Tek afrohej fundi i *Ditëve të Kulturës Shqiptare* në Austri (5 mars), më kishte pyetur një reporter vjenez se ç'ndodhte në të vërtetë në Kosovë dhe a është e vërtetë se ka terroristë. Dhe pasi kishte dëgjuar mendimin tim, tërë i revoltuar kishte shtuar: të ma vrasë fëmijën, këtë askujt nuk do t'i lejoja; të ma derdhë familjen! Të mbrosh pragun e shtëpisë, dinjitetin, nuk është terrorizëm.

Vërtet, kush na e shpiku këtë të zejë, që në asnjë libër tonin në të kaluarën as të ditëve të sotme nuk është shënuar se shqiptarët kanë përdorur dhunën ndaj fqinjëve të vet. Dhe pse ndodhi në këtë moment? Unë nuk jam analist i problemeve ndërkombëtare, këto janë vrojtime e reagime të një krijuesi, që nuk pranon krimin si çelës të zgjidhjeve rajonale. Por kam përshtypjen se ajo *drita e gjelbër* për terrorizëm, që e tha herën e parë zoti Gelbart kur ishte në Kosovë, mund të jetë edhe fatkeqësi serbe. Se ç'do të ndodhë më vonë, varet nga dirigjuesi, që e lancoi këtë term për mbrojtësit e dinjitetit të pragut të shtëpisë. A ra në karem sistemi represiv serb?

E dhembshme është ajo që ndodhi në Drenicë. Masakra ka mundur të ndodhë edhe tjetërkund. Dhe, pa marrë parasysh numrin e viktimave, serbët dëshmuar se nuk janë për zgjidhje paqësore të Nyjes së Kosovës; se duan gjithsesi famën e humbur në Bosnjë e Kroaci ta kthejnë në shpinë të popullit të pambrojtur shqiptar. Megjithatë, zoti nuk është në anën e xhelatëve. Tash e tutje punët i kanë në dorë edhe të tjerët, por në mes shqiptarëve e serbëve nuk di a do të ketë kohë edhe për një fitilaç duhani.

Pakëz dhembje ballkanase

Në përfundim ishin takimet dhe Kristina fon Kol (6 mars) më tha se në mbrëmje do të takoheni edhe me ish-ministrin, zotën Alojs Mok. Nuk e pritja këtë. Kisha pakëz kohë. Por kur përmendi emrin e tij, nuk shkova në takimin tjetër letrar. Dhe në orën e caktuar, aty në hijen e trupit shtathedhur të Katedrales së njohur të Vjenës, të cilën nuk dija me kë ta krahasoja mbasi vështirë i gjendet shoqja kund, pashë zotën Mok, të cilin e kisha njohur përmes shkrimeve e reagimeve të tija ndaj çmendurisë ballkanike, por edhe për qëndrimin e tij konstruktiv rreth zgjidhjes së Nyjës së Kosovës. Qëndrimi, jo vetëm i tij më bënte të besoj në njeri, se të gjithë nuk shikojnë me sy të qelqtë. E kishte tmerruar posaçërisht inkvizicioni mesjetar serb ndaj çdo nishani shqiptar. Është absurd kjo për Evropën, të mbyllen shkolla e institucione, të rrënohen objekte monumentale e t'i mohosh dikujt të heqë dorë nga identiteti dhe e drejta e vet njerëzore e kombëtare. Evropa tenton në një mozaik gjithnjëor, ku secili të ruajë e kultivojë nishanin e vet. Vetëm si e tillë ajo mund të quhet Evropë e bashkuar.

Dhe tek shikoja përmes dritares Katedralen e Vjenës kisha parafytyruar atë të Këlnit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore forcat aleate e kishin rrënuar tërë qytetin, por Katedralen nuk kishin lejuar ta rrënonin. Pse? Sepse për gjërat kapitale të njerëzimit duhet të ketë nderim edhe vandali. Po në Dheun e Shqipeve kishte ndodhur ajo që nuk e kishte parë kush në ëndërr. Pse? sepse kemi problem me vetveten. Dhe kur e shikoja z. Mok bindesha se njerëzit e mëdhenj nuk vuajnë nga kurrfarë kompleksi, janë të gatshëm të ndihmojnë dhe të shpëtojnë ndërgjegjen njerëzore. Kryelartësia është veti e mediokrit dhe e akterëve, që duan të rrinë larg zjarrit, mbasi u mungon guximi njerëzor. Më fliste ai thuaj se njihemi tash e pesëqind vjet. Ishte i shqetësuar për atë që ndodh në Ballkan. Dikur tha: ju shqiptarët jeni tepër emocionalë. Po këtë ma kishte përsëritur disa herë edhe

zonja Kristinë. Vetëm di një gjë nga historia njerëzore - se të *mirën* askush nuk ka mundur ta shuajë. Dhe, e mira gjendet në anën tuaj. Pastaj m'u falënderua për librat e mi në gjuhën gjermane që ia kisha dhuruar dhe më pyeti a shkruaj më. Ka thënë Brehti se koha e ligë nuk është për lirikë. Edhe të ligën duhet shënuar. Ç'do të ndodhte me historinë e njerëzimit të mos ishin shënuar edhe gjërat morbide. Dikur ishim ngritur. Në "Cafe del'- Europa" kishim lënë pakëz dhembje ballkanase. Në orën dhjetë në mbrëmje në TV qendror të Austrisë zoti Mok i bënte thirrje ndërgjegjes njerëzore që po ndodh në Ballkan, konkretisht në Drenicë.

Krimi askë nuk e nderon. A e dinë këtë fqinjët tanë? Njeriu duhet liruar nga demoni i vdekjes. Para fatkeqësisë e kishte thënë një varg dinjitoz Gjergj Fishta i madh: *Çobu Kacel e merr labutën, pa na qit fare nuk vajtojmë...*

Numri i fëmijëve të vrarë shtohet: *a gjuben pëllumbat, bre?* Realitet bëhet krimi.

Ku bie Kosova?

Ditët e Kulturës Shqiptare në Austri kishin përfunduar për mua. Çudi derisa Evropa bën çmos për afrimin në mes popujve, në Ballkan thellohen ndasitë. Vriten edhe fëmijë e gra e pleq të pambrojtur në emër të një pastërtie kombëtare e farefisnore, që nuk mund quhet ndryshe pos pastrim etnik. Filozofia e re e Evropës vështirë të aplikohet aty ku çdo gjëje i vjen era vdekje. Në mes Njeriut dhe Bishës lëviz tyta e ftohtë.

Prapë më pyeti organizatori se a do të kthehem. E varfër apo e përgjakur Kosova, atje e kam shtëpinë dhe varret e mia, i thashë. Përmes korridorit të Kiro Gligorovit në aeroportin e Shkupit (9 mars) pashë vetëm dy-tre shqiptarë të frikësuar, që pritnin aeroplanin për në Pragë. Nuk munda pa u thënë: Andej Kosova nuk bie... Në mbrëmje më folën për protestat e reja paqësore. Prapë z. Gelbart në mes ballkanasve. Tani kishte

ndezur dritën e kuqe. Diku nën një kulm të ftohtë drenicas trupat e masakruar të fëmijëve, të grave e pleqëve pritnin përshëndetjen e fundit në praninë e tankeve. Në mesin e kufomave nuk mund e identifikova asnjë terrorist, bile as si duket ai. Masmédiat botërore vazhdonin të alarmojnë dhe pëshpërisnin edhe emrin guerilë. Ç'ka nuk ndodh aty ku arsyëja ndryshket e nis të pikojë gjak...

Po ku bie kjo Kosova?

(1998)

RAMBO I MILENIUMIT TË ARDHSHËM

Në mugëtirën e diktaturës

Afër Gjakovës, aty ku ndodh luftë, në kapërcyllin e viteve të gjashtëdhjeta, kishte kaluar kufirin familja Prelocaj. Për fatin e mëtejshëm të saj mësojmë më vonë nga libri *Kushëriri i engjëjve* i Ismail Kadaresë.

Disi u bë kjo dhe pikë e mundshme e interpretimit të fenomenit Angjelin Prelocaj. Shkrimtari kishte përcjellë, të themi, një jetë njerëzore. Kishte çjerrë edhe maskën e diktaturës, që e trajton si fatkeqësi kombëtare.

Mirëpo, te ky libër dua të përqendrohem te koincidenca e fateve, që u përsëritkan në nuanca. Fillet e artistit fascinues jo vetëm për publikun francez, imagjinata krijuese nis “aventurën” nga ai kalim i kufirit. Dhe përmes bisedës e mjeteve të tjera ndihmëse bën konstruimin e veprës me rrugën e mundimshme të një koreografi me famë, por dhe me gjëllimin traumatik të familjes shqiptare në mugëtirën e diktaturës. Kapërcimi i kufirit kishte qenë tragjik për shumëkë. Tek kapërcente atë, hapat e malësorës me fëmijë në bark gjatë një nate të ankthshme, te shkrimtari kishin zgjuar asociacione me lëvizjet e përsosura të koreografit. Mundësohet përmes tyre edhe interpretimi i vetë valles sonë.

Edhe në këtë, si në veprat e mëparshme, ngjarjet dhe idetë “lëvizin”, duke ruajtur lidhjen e fortë organike; barten nga një njësi në tjetrën, me çka është mësuar tani jo vetëm interpreti. Kërshëria e shkrimtarit: mjafton një detaj i rastësishëm e të nisë përsiatjet, të shtrojë bile edhe probleme të rënda, siç është braktisja e atdheut.

Duke lexuar këtë libër bindesh se Kadare ka diç të veçantë që e dallon në letrat shqipe. Vepra e tij ngrihet si një ombrellë e fatumit

kombëtar. Krijon nën të mozaikun më se të çuditshëm të ideve, mesazheve. Ballafaqimi me lëvizjet mahnitëse të koreografit i çel një deriçkë lexuesit dhe është e pamundur të mos kujtojë ndonjë insert nga krijimtaria e tij më e hershme. Hapave të malësore shtatzënë, tek kapërcente kufirin një natë, pa ditur se lindte një artist i formatit botëror, Kadareja kërkon lidhshmërinë: pra, te lëvizjet e artistit zbulon jo vetëm ritmin e çuditshëm, por dhe diç nacionale, mitikën ndoshta. Përpara meje shpaloset një poezi e viteve tetëdhjeta, *Vallja shqiptare*, që e kisha vënë si poezi hyrëse në librin *Buzëqeshja mbi botë* (Kompleti i veprave të Kadaresë, “Rilindja”, 1980). Nga ajo botë farfuritjesh veçoj:

Këmba sinjal i çon tokës

Dhe dora qiellit i jep lajm

Brenda këtyre dy vargjeve jepet madhështia e vallëzimit, i ngrihet një himn valles shqiptare, duke i dhënë dhe përmasa kozmike. Tentohet puçja e botërave se arti zbulon atë që nuk e kap syri. Hapat e malësore shtatzënë tek kalonte kufirin dhe lëvizjet mahnitëse të koreografit me famë ngacmojnë jo vetëm imagjinatën e krijuesit të formatit të një Kadareje.

Çmisticizimi i një propagande rrënuese

Fjalët kurrë nuk kanë qenë më të nevojshme se sot. Unë jam krijues dhe përmes tyre dua të vë në peshojë edhe ndërgjegjen time. Misioni i fjalës është punë e shenjtë. Nuk bën të keqpërdoret as kur duhet ndarë drejtësia, siç bie fjala, në konfliktin mes serbëve dhe shqiptarëve. Para së gjithash, kemi të bëjmë me hegjemonizmin serb, në njërin anë, dhe në tjetrën me përpjekjet tona të lirohemi nga një okupim klasik mesjetar, të mbështetur në njëfarë të “drejte” historike, që lexohet edhe si paranojë nacionale serbe, ku fjalët duhet ta zhveshin këtë. Në mes këtyre dy skajeve ekziston vullkani i tmerrshëm - se konflikti zhvillohet në dy binarë: të *krimit* dhe të *lirisë* (dinjitetit

njerëzor). Krimi ndodh ndaj popullsisë shqiptare, denbabadem në trojet e veta, siç do të thoshte Kuteli. Por ndëshkimi i soldateskës serbe kalon edhe hakmarrjen. Kjo mund të ilustruhet nga shkrimet e ndryshme edhe të masmediave serbe: letra, reagime, tekste editoriale nivelesh të ndryshme e të bindesh se çfarë loje e ndotur luhet në këtë hapësirë. Rrëfimet e dëshmitë e ushtarëve serbë mbi konfliktin serbo-shqiptar janë më se tronditëse. Aq larg ka shkuar çmendia njerëzore, sa të rinjtë urdhërohen nga eprorët e tyre të djegin e vrasin çdo gjë që guxon t'i dalë përpara makinerisë serbe! E krimet e paramilitarëve dhe të eskadriles policore janë evidente, mjaft transparente, kaptinë më vete. Në gjumë më shtiren edhe tani fytyrat e engjëllore të fëmijëve të masakruar në Drenicë (mars). E kisha lutur zotin të mos i ndodhë një gjë e tillë asnjë populli. Përgjegjësia e veprimeve makabre nuk bie vetëm mbi ushtarët e gjorë, por mbi kastën politike, që aplikon irracionalitetin, logjikën e tokës së djegur; pra dhe të pastrimeve etnike me pasoja të paparashikueshme edhe për vetë kryesit. Kjo “trimëri” e fqinjëve ne shqiptarëve na është e njohur nga rënia e Toplicës (1878), por si tolerohet nga bashkësia ndërkombëtare një turpërim i pashoq edhe për racën njerëzore!

Binari i dytë është ai i përpjekjeve për të ekzistuar, rrëmbit të lirisë së grabitur, kthimi i dinjitetit, ku dëshmohet se shqiptarët dinë të bëjnë politikë paqësore, por kur një opcion i tillë nëpërkëmbet, atëherë dinë edhe t'u dalin zot të drejtave të tyre njerëzore-kombëtare. Me sa jam informuar edhe nga masmediat serioze serbe, nuk është shkruar as folur kund se forcat shqiptare kanë vrarë fëmijë, gra, pleq e fatkëqij. Diç e tillë nuk mund të ndodhë në taborrin serb, se ndjenja e krimit është aty *urdhër*. E, të luftosh për liri, krimin nuk mund ta pranosh si filozofi të zgjidhjes së konfliktit. Mu për këtë shqiptarët edhe në kultivimin e njerëzores kanë epërsi, avancojnë një politikë çfarë u rri ndesh forcave serbe, gogolëve të fundit të nazidiktaturës. Është e tmerrshme kur me fqinjin tënd zihesh për diç që secili ka të drejtë të *jetojë*.

Mospranimi i krimit si akt nga shqiptarët çmistifikon, para botës e vetë serbëve, propagandën e tmerrshme që nga e kaluara e këndeje, të pseudoshkencës dhe të të ashtuquajturve “demokratë” alla

Drashkoviç e Sheshel: se shqiptarët janë fis, pa kulturë; nuk kanë histori, janë vrasës ordinarë, rrënues, dhunues, plaçkitës; kanë shembur etninë serbe dhe kanë rrënuar manastire e tempuj, pastaj sa objektet i kanë shndërruar në “nevojtoare publike” e në tempuj të një fundamentalizmi, që kërcënon qytetërimin evropian (!). Së pari, shqiptarët nuk rrënojnë manastire as në ditë të sotme, ato i konsiderojnë edhe si tempujt të tyre. Së dyti, shqiptarët nuk frikësohen nga hija e manastirëve se tolerojnë dhe pranojnë multikulturën e bashkëjetesën në hapësirë, e kjo tmerron forcat ekstreme serbe. Së treti, shqiptarët kurrë nuk kanë krijuar elaborate kundër fqinjëve dhe, së katërti, shqiptarët nuk e kanë kompleks se janë në tokë të huaj dhe u kanë bërë të tjerëve ndonjë të keqe. Ka edhe segmente të tjera, që respekti ndërkombëtar rritet dhe është në anën shqiptare.

Disa herë u është bërë me dije fqinjëve tanë se të keqen duhet kërkuar në mesin e tyre sa nuk është vonë. Siç tha një historian francez, mik i serbëve, tkurrja e tyre vështirë ka të ndalur. “Ka ardhur koha që t’i mbrojmë serbët nga vetvetja” (Jacques Jucliard). Shkaktar për këtë rënie nuk është faktori i jashtëm, e më së paku shqiptarët, por pamundësia serbe për t’u liruar nga iluzionet, irracionaliteti. Në letyrën e nacionalizmit serb nuk pranoj të luaj, jam krijuar dhe çmoj vlerat e mirëfillta kulturore-kombëtare të akcilit popull. Por serbët duhet të pranojnë realitetin, edhe pse i hidhur duket. Këtë duhet ta bëjnë edhe për hir të qytetërimit evropian, që pranon të vërtetën: gënjeshtreve mbi shqiptarët nuk ka kush t’u besojë më...

Rambo i mileniumit të ardhshëm

Krimi nuk mund të fshihet. Falë masmediave botërore, përcjell tragjedinë më të përgjakshme të popullit tim në mbyllje të mileniumit të dytë. Nuk besoja se përsëritet Toplica, për të cilën kisha lexuar e mësuar nga shumë libra neveritës të shkruar kryesisht nga “ngadhënyesit” e pastrimeve etnike. Për herë të parë shihja dyndjet e gjata të popullit të hutuar, kalimin e kolonave të pafundme aty, ndoshta, ku kishte kaluar edhe familja Prelocaj. Dyndjet ishin

dykashhe: kosovarët i shpëtonin vdekjes, ndërsa Prelocajt e të tjerët kërkonin tokën e premtuar. Kjo egërsi kishte ndërruar edhe peizazhin. “Ngadhënjimin” e fqinjëve e lexoja si mjerim nacional serb. Soldateska u edukua se duhet rrënuar çdo gjë që nuk përkon me të. Por kasta intelektuale sërbe, a duhet të përkrahë logjikën e krimit. Le të mbesë kjo në ndërgjegjen e tyre.

Serbët vazhdojnë të trumpetojnë se nuk ndodh pastrimi etnik në Kosovë e kolonat e gjata ngjiten malit nën syrin magjik të masmediave botërore. Kallëzojnë se gjatë këtij rrugëtimi edhe lindin. Një grua e re, sapo kalonte kufirin, kishte lindur. M'u kishte kujtuar malësorja e Prelocajve me fëmijë në bark, e cila më vonë do t'i gëzohet famës së të birit, Angjelin Prelocajt. Fëmija i nënës së re do të ketë fatin e një artisti, apo ai do të jetë një Rambo i mileniumit të ardhshëm...?

Mund të këndojmë tash...

(1998)

VARGU NË GURIN E MIKUT

Sporti i zi

Ende nuk ishte ulur mirë aeroplani në aeroportin e Cytihut e në Kosovë kishte arritur faksi i nënshkruar nga ca të gjysmidentifikuar. Për shkak të sjelljeve të një miku tim, siç shkruanin, shutohesha edhe unë. Këtë nuk e mora punë serioze. Fabrikimi i intrigave është cilësi e njerëzve sakatë prej truri, që nuk kanë besim më vete, ose që rrogëtarojnë kushedi për cilin zotëri. Të tillët mund t'i futësh lirisht në thesin e të kompleksuarve, që më vonë shndërrohen në skizofrenë të tmerrshëm. Për një ecje normale, shoqëria është e detyruar të flakë këtë “edukatë” fisi si një shpërlarje zuze.

Nuk jam iluzionist. Njerëzit i pranoj ashtu siç janë, se vështirë mund t'u ndërrosh sistemin e logjikës. Prekëse është se kjo dukuri e primitivizmit bëhet më rentabël me produkte të reja nga të gjitha nahijet; se intriga po bëhet profesion i teneçexhinjve. Nga kjo sjellje u jetuaka ndoshta! E, fundi është terribelë për ata që kanë dy fije mend.

Nga etika dihet, lindet e vdiset me një fytyrë. Si duket disave u duket pak një pëllembe, kërkojnë më shumë hektarë të jetë ajo; t'u shihet njolla edhe nga aeroplani. Ku ta di. Soji i tyre ballëçelik. Kur nuk ke ç'të bësh, duhet vrarë miza, thotë poeti astriak Frid, ose duhet shitur lëkura minjsh, në mënyrë seriale, duke riprodhuar injorancën.

Është e çudshme në ca mjedise në diasporë më shumë kanë averzion ndaj intelektualëve se ndaj do zabitllarëve, që mezi i lidhin dy fjalë. Pse? Këtë duhet parë si defekt nga rrafshi i nivelit kulturor, apo se duan të aktrojnë bodrumeve të metropoleve atë që nuk jemi. Dridhen e përdridhen pa e pështyrë fatin që i ka ngujuar aty. Alarmi lë të kuptohet se në punë të tyre “botërore, elitiste” nuk bën të

përzihesh. Kështu paraqitja e rrallë e ndonjë intelektualit nuk bën pa u etiketuar - se duhet përsosur “zanati”.

Faksa të tillë tek lexoja, nuk më linin qetë fjalët e një shkrimtari tonë të ngujuar diku në një mal Evropë, ku nuk besoj se veten e dënoi: Më dhimbseni, bre burra, për kë e vini kokën në thes... Nuk di, miku im e kishte përnjëmend apo... Ma merr mendja se ne shqiptarët as në këtë sport të zi nuk kemi shoq; jemi kampionë, bile pa konkurrencë.

Zhënjimi im kuptohet si lutje: të merremi pakëz me punë më serioze. I mjerë vatani, që rrit këtë sortë edhe për eksport...

Një “Mëmëdhe” pak për një Atdhe

Gati nuk e kisha humbur kokën. Kërkoja mikun, i cili bridhte në Kantonin e Sangallës. Kisha filluar të brengosem. Nuk ishim dëgjuar moti. Është i sojit të burrave. Dhe, pasi i rashë në gjurmë, nëpër një natë të errët e me fërfëllazë, bëja udhëtimin. Pas çdo serpentine, ia shihja fytyrën vdekjes. Vali nuk mund e kontrollonte Dulin, i cili ishte i vetmi shofer, që ekzistonte atë natë. Më kishin thënë se ata ndryshe e shikojnë zgjidhjen e çështjes kombëtare. Megjithatë, isha trimëruar, dëshiroja të dëgjoj edhe të tjerët - se liria nuk do të jetë vetëm imja.

E gjeta poetin kokrros në mesin e të “pabindurve” me fjalorin e tyre karakteristik. Rrallë njëri-tjetrit i përziheshin në fjalë. Ishte lehtë të kuptosh kush e ç’ishte. Sofra e shtruar. Pakëz allafanga. Biseda vëllazërore. Sillej rreth çështjeve fundamentale. Nuk lëshonte pe asnjëra anë. Kishim mbetur prapë zogj të qyqes. Në kujtesë të njëri-tjetrit kushedi si latoheshim. Linin përshtypjen se tërë barra kombëtare rëndon mbi shpatulla të tyre; se vetëm ashtu, siç thonin, mund të zgjidhet edhe çështja e etnisë. A pakëz sakrifica bëhen në Kosovë? Përditë zbardhet me një këmishë të kuqe. Vizitova bibliotekën më vonë. Muret të stolitura me fotografi të martirëve që shtohen. As aty nuk e pashë fotografinë e mikut nga fëmijëria dhe më erdhi keq. I pyeta se çfarë dallimi ekziston në mes Gërvallës dhe Hadrit. Është e

tmerrshme t'i ndashë martirët edhe për së vdekuri, të cilët ranë për të njëjtin ideal, megjithëse udhët e tyre ishin të ndryshme ndoshta.

Me Gërvallën kishim qenë disa vjet në një redaksi. Në dy përmbledhjet e tij e në katër përkthime gjendet emri im si redaktor. Nga një mik i vdekur nuk kërkoj lavd, siç vepronte një bashibozuk, i cili saherë vinin festat, gazetat detyroheshin të nxirrnin fotografinë e tij bashkë me Bokin e Rokin. Kjo është punë karakteri. Ata që nuk kanë, bëjnë çmos të duken diku, bile dhe në bisht. Të tillë ka edhe tani që, në një farë mënyre, i imitojnë të mëparshmit; të mos them se bëjnë biznes patriotik.

Dhe, derisa shikoj bibliotekën e rregulluar me elegancë, më kishin fotografuar disa herë. Nuk mund them se isha i pari poet, që i vizitonte, por isha nga ata që nuk ka shumë shqiptarë për të humbur. Injoranti bën udhën vetëm. Në të ndarë ma dhuruan një libër. Thumbohej aty Rugova, unë e ca krijues të tjerë. Politikën e kishin kuptuar si “art të të mundshmes”, me zigzage, por një- lineare. E panë se unë kisha dhembje më shumë për ta. Para meje qëndronin njerëz të sakrificës që, fatkeqësisht, mendonin se janë idealistë dhe mund të vdesin vetëm ata për diç të shenjtë.

Si në romane të Kadarese prapë shiu më përcolli tërë udhës. Pas dy ditësh miku nga Skrapari kishte ikur. Ndërkaq unë zihesha me vetveten, më mungonin fjalët për shqiptarët e bërë pikë e pesë Evropës. As armiku nuk do t'i përçante më mirë! Sindrom i hatashëm lëviz në mes nesh. Më mungonin të gjorat fjalë. Nuk pranoja të çoj dorë nga asnjëri. Isha budalla unë apo loja e atdhetarizmit mbetej për mua një kashelashë. Sidoqoftë, një “Mëmëdhe” është pak për një Atdhe tamam.

Vargu në gurin e mikut

Si gjimnazist ishim shoqëruar e bërë shokë. Me shkrime merrej kur i tekej. Ishte tepër inteligjent. Që atëherë hetoheshin ca lëvizje të tij që shprienin në vetmi. Por nuk më kishte shkuar mendja asnjëherë se

në gurin e tij të varrit do ta gjej vargun tim me emër e mbiemër. E ky varg më kishte qitur në bela.

Ka shtatë vjet që nuk është më ai. Herën e fundit e takova në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Frankfurt. Më fliste me një fjalor diplomati se ç'zihet rreth nesh në Parlamentin Evropian në Strasburg. Nuk kaloi shumë kohë e dëgjova se e kishin vrarë para një semafori në një udhëkryq në Bruksel. E, kur nuk ke pushtet as shtet, siç thotë një poet, i bie kavallit. Më ishin skuqur majat e veshëve nga turpi. E shkruaj këtë tekst me një vonesë prej shtatë vjetësh. Nuk kërkoj asgjë, dua t'i shpreh admirimin mikut edhe për atë copë fëmijëri, që na mbet rrugëve të Dukagjinit.

Në Bruksel nuk kisha qenë më parë. Me patriotë të zellshëm nuk mund të shtyhesha. Atje më çoi poezia ime. Në mes dy mbrëmjeve letrare pyeta se ku e kanë varrosur. Një i tij, që më shoqëronte, më shpuri të nesërmen aty nga nuk mund të vinte miku i fëmijërisë në mbrëmjen time.

Pas një copë udhe u gjeta para gurit të tij të akullt. Aty fillonte jeta e dytë e Enver Hadrit. Amshueshmëria. Befas më ishin ngulitur sytë tek shënimi në gur: *Kosova është gjaku im që nuk falet*. Ishte xhiruar një dokumentar dhe shtypur një plakati i Partisë Liberale me këtë varg. Në të dy rastet ishte shumësi i përemrit. Mungonte revolta ime personale. U solla prapë rreth asaj ftohtësie mortore. Nuk fola gjë. Nëna më thoshte, në raste të tilla nuk flitet për të vdekurin, as për varrin. E lashë mikun aty në veri, nën kujdesin e engjëllit të akullt, nësa një re u zbraz mbi shkronjat e emrit të tij dhe vargut tim në gur.

Zgjata shuplakat. Pakëz ujë mblodha për sytë e mi.

(1997)

KODI ETIK I BALLKANASVE

1.

Vetëm unë e dija se Lumi nuk ka shpëtim. Që të nesërmen mund të binte nga qafa ime dhe unë të mos e shqetësoja më Evropën. Në cep të shtratit prej druri isha ulur. Në fund të korridorit të një spitali ballkanik dy fëmijë të lodhur, gati të këputur, zgjasin duart e verdha. Marrin terapinë e citostatikëve. Nëpër dritën e vogël tërhiqen pastaj ngadalë, pa nxjerrë zë. Mbyllen në dhomat e tyre.

Pak më vonë vjen Vëllami. Do të na gëzojë me diç të re ndoshta. Dhe, sapo shkëput shikimin nga fëmijët, shkallëve dëgjohet zëri i tij. Ia shoh kokën, trupin. Luhartet tamam si Isa tek udhëtonte galopëve me kalë për në Vlorë. Pëshpërit të njëjtat fjalë, që i kisha dëgjuar kushedi sa herë. Të dy fëmijët lëngonin nga e njëjta e keqe dhe ishin në dorë të zotit. Pas një kohe, Lumin e përcollëm nga nuk kthen më, ndërsa Balsha vazhdoi udhëtimin. Zoti kishte qenë në anën e tij. Më vonë, ky do të shkruajë edhe libra. Emrin e tij tani kur e pëshpëris ma kujton atë, Fatprerin.

2.

Tek shëtisnim bregut të Cemit nga shihet Mbishkodra e derdhur kodrinave deri atje poshtë buzë Liqenit, Vëllami pajtohej se Balsha mban emrin e një princi shqiptar. Dhe, në gaz shtonte: ndoshta edhe unë jam shqiptar, ilir... Ma lexonte poezinë, të cilën ma kishte dedikuar. Përmes saj qëronte hesapet me Çarshinë serbe, me komneniqët. Ballkani është një përzierje e madhe, thoshte. Ky konstatim u bë lajtmotiv në ca poezi të poetit e disidentit malazias Jevrem Bërkoviç, i cili do ta kalojë kufirin shqiptar, të shpëtojë kokën. Të fundit nga Tirana e kishin përcjellë Dritëro Agolli dhe Xhevahir Spahiu.

3.

Tri net e tri ditë nuk i kisha mbyllur sytë aty pranë urës, ku ishte vrrarë Isa. Armën e ftohtë e kisha vënë në dritare. Kërkoja të ziun, që na kishte kurthuar. Do të vdesim si Bora e Ramizi, kishte shtuar Vëllami. Më kishte ardhur të qesh: Ata moti kanë vdekur, poet. Ne do të vdesim për shkak të etikës. Dhe Zuvdi Berisha me Balshën në dritaren tjetër përgjonin se ç'ndodhte jashtë: *Smrt šiptarima! Smrt Izdajnici!* Gruaja e Vëllamit, një malësore e rrallë, kishte shkruar Z. Cana, na sillte kafe pas kafe të mos na zënë në gjumë çetnikët e Jogurtrevolucionit.

Balsha është autor i disa librave. Përmes tij kërkoj Lumin tim aty në fund të korridorit të errët të një spitali ballkanik. Ai nuk u kthye ende.

4.

Pas sa vjetësh lexoj në një gazetë të Beogradit shqetësimin e Vëllamit ndaj gjestit të pakontrolluar të të birit, i cili ka lënduar edhe kujtimin tim për Lumin. Teksti i Jevrem Bërkoviçit është plot helm. Nuk mund të pajtohet me të birin se lëndoi rëndë dinjitetin atëror dhe kombëtar: “Me dhembje të madhe në shpirt - alarmon opinionin ai - mbase me dhembjen më të madhe që deri më tani kam pasur, e shkruaj dhe e nënshkruaj këtë tekst - ndizet shqetësimi i tij - E shkruaj se duhet: kam obligim moral ndaj miqve të mi në Mal të Zi e më gjerë, ndaj lexuesve dhe ithtarëve të mi, t'i njoftoj se paraqitja e djalit tim, *Balsbës*, në sheshin (serb) të poetëve në Budua është vendim i tij... Një paraqitje e tillë më ka goditur mua si baba, edhe si njeri, edhe si shkrimtar të ndjekur, edhe si luftëtar të denjë për Malin e Zi sovran e të pavarur... Megjithatë, nuk mund e kuptoj sesi ka qenë e mundur biri im, Balsha, të paraqitet në këtë shesh famëkeq (të Ularoviçit) të poetëve serbë, duke lënë anash (jashtë etikës, memories së tij) të gjitha ato fakte, ç'është e vërteta, një histori kriminale-gjenocidale... Sheshi i poetëve është menduar dhe themeluar në ditët më të rënda të invazionit të mitingjeve serbomadhe në Mal të Zi... Në Sheshin e poetëve në Budua, e drejta, në sheshin e nacionalizmit serbomadh, e

logjikisht të çetnikizmit të xhindosur fashisoid... propaganduesit e spastrimeve etnike, të krimeve dhe të varreve masive, të përdhunimeve shtazarake dhe të turpit veror malazias... Nuk mund t'ia shpjegoj vetes sesi Balsha im më vete, në etikën dhe krenarinë e tij, mundi të harrojë edhe faktin rrëqethës se për çdo verë nga ai shesh, nga ajo turpësi, nga ajo pështy more, pështynë në babanë e tij..."

Dhe bardi malazias kërkon përgjegjësi nga i biri, të deklarohej haptas se çfarë e shtyri të merrte pjesë aty. Por letrën e Balshës nuk dua ta hap. Lëndon kujtimin për dy fëmijë, që çdo ditë merrnin terapinë e citostatikëve aty në fund të korridorit të një spitali ballkanik. Nuk dua edhe për hir të Vëllamit, i cili beson në etikën njerëzore, në pastërtinë e trimërinë e individit. Zatën, krijues i vërtetë nuk mund të jetë ai, që nuk është në gjendje të dënojë edhe pjellën e vet, kur prish kodin etik të Kombit. Te ne ky kod rrënohet e dezekuilibrohet çdo gjë jona. E shkelin shpesh edhe ata nga të cilët nuk pritet. Do të thotë se ne shumë pak kemi mësuar nga baballarët tanë. Kot krenohemi se jemi të besës dhe të trimërisë. Për disa morali i ngjan një shamie, të cilën duhet larë vazhdimisht. Është burrëri të mos e mashtrojmë më veten se mund të na i rrahin teneqetë...

5.

Dritëro Agolli e ka një tregim që vështirë mund të ndeshet edhe në letërsinë botërore. Ai quhet *"Balada e maleve"*. Tema është nga alpet shqiptare; pra, nga Cepi Verior i Ilirisë, konkretisht nga Bjeshkët e Namuna. Një nënë kishte tre djem. Njëri nga ta e pren mikun në besë. Sapo e zbulon fajtorin ajo, i urdhëron dy të tjerët të vrasin vëllanë. Fyerja ishte derdhur në prag. Dhe, dy vëllezërit e shpiejnë atë rrëzë malit. Pushka nuk dëgjohet. Nuk kanë zemër të shtijnë në vëlla. Del Nëna vrap nga kulla, ia rrëmben armën njërit. E shikon fajtorin në lule të ballit dhe ia shkrep. Ajo që ndodhi mund e kërkonte në antikitetin tonë për të cilin injoranca evropiane nuk i beson as Ptolemeut se shqiptarët janë pasardhës të ilirëve dhe se janë denbabadem në këto dhera.

6.

Sheshi i përmendur nga Vëllami gjendet pranë kishës shqiptare në Budua. Aty ishte dëgjuar moti edhe fjala jonë. Me një antifashiste tërë natën ishim rrokullisur buzë Ujit të Madh. Ishte koha kur rrënonim diktaturën nga brendejashtë dhe kur Jevremi vinte dorën në shokë e betohej në kokë të Balshës. Tek lexoja shqetësimin e tij, dyshoj edhe në origjinën e Taras Bulbës. Me siguri ai nuk është i gjakut të shkurrës...

7.

Lumi do t'i kishte njëzet e tre vjet. Unë vazhdoj, megjithatë, të bind Evropën se ai ekziston dhe gjendet diku në askund...

(1996)

ROLETAT

MË I VDEKUR NUK BËN

Asgjë nuk është më e rastit. Lexon e dëgjon: shthurje totale. Krizë vlerash. Morali luhatet. Askush i kënaqur. Gati nuk ulërihet. Se, me rrenë filloi rrënimi ynë material e kulturor e me rrenë gati mbyllet. Pakkush i beson vetes. Nga të gjitha rrafshet sheh: njeriu humb pamjen, durimin, shpresën; ushqehet gjithnjë më shumë nga instikti. Në bibliotekë gjithnjë e më pak Fishta, Konica, De Rada, Naimi. Truri kombëtar zëvendësohet me diç trivale, boshe...

E, bota vazhdon avazin e vjetër. Thotë se solidarizohet me të shkelurit, me të përbuzurit. Dërgon telegrame, fjalë; nxjerr rezolutë pas rezolute për shkeljen flagrante të të drejtave të shqiptarëve diku në bisht të sorrës e pak shihet efekti i tyre.

Dhe ne, pikë e pesë. Kurrë më të përçarë e të shkapërderdhur. Gjë tjetër nuk dimë, as duam. Kënaqemi me mjerimin tonë... Me duar në xhepa shëtit rrugëve, dherave, kontinenteve. Luli i Vocërr të mbështillet nëpër këmbë, megjithëse Migjeni kaheër nuk është. Nuk mund të bësh një hap të qetë nga duart e zgjatura, nga fytyrat e mavijosura. Vdiset në këmbë. Kudo vdiset. Edhe në bodrum. Falsifikohen gjëra.

Historia. Kultura. Paraqiten manipulatorë. Përfitues. Trimërohen burracakët se mungon ligji. Dryri është bërë sinonim i mjerimit.

Del në cilindo lokal, në cilindo vendbanim. Të merr malli për miqtë e dikurshëm. Aty-këtu ndonjë këmben, palaço, sharlatan: ndonjë mizantrop... Dhe, dëgjon kaq e kaq dhe e pat... Nuk ekziston ligji yt. Dhe derdhet çdo gjë se ekzistojnë vetëm ata, që dinë të shkatërrojnë, të rrahin, të vrasin... Po shkolla jote, libri yt, kultura?

Kalon rrugën. Nuk përshëndetesh më as me fqinjin. Ai ta mat hijen. Pret rrëshqitjen tënde për ta marrë edhe kafshatën e fundit. Ndërkaq, profesori yt, nga i cili ke mësuar gjuhë e histori – shtet mollë, qepë, vezë. E inkurajon veten se edhe pas kësaj dite, edhe pas kësaj vere do të bëhet mirë...

Dhe, bie të dëgjosh njeriun e uritur, njeriun llafazan, bile edhe atë që flet për demokraci me librezë të partisë ende në xhеп e që sa net e vjet ka kaluar korridoreve të... Deklarohet publikisht burri i botës se vetëm ai mund ta dridhë. Dhe, Moisiu ynë ngjitet Malit kur plas se filan filani na ishte i tillë e i atillë, se ai kishte bërë këtë e atë... Dhe, kur t'i peshosh të dijsmin, shpëtimtarin, mençura kun, mizantropin, zë e shan Çajupin dhe atë Adhamutin që na përzihen edhe në kohën tonë... E kthen mbarë e mbrapsht: një tru sa i pulës... Fyhet intelektual, profesori, krijuesi - se për ta vendosin kurrkushët.

Përsëri dëgjon e lexon. Ishin njerëz edhe ata. Kishin prindër. Mbronin këtë copë dhe. Por ja u bënë dhe. Numra në dosje të fshehta. Pëshpërimë odash, vatrash... Ç'të bësh: nuk mund ta dallosh njeriun... Dhe i mbyll sytë. E heq shikimin. Përpiqesh të lirohesh nga çdo gjë e keqe, i bindur se populli yt di ç'janë vrasjet, rrahjet, ndjekjet.

Se *Populli* e ka të qartë. Monedhë kusuritje nuk bëhet më. As urë. E di rrugën e vet. Prandaj i duron edhe fyerjet, edhe rrahjet, edhe kazamatet, edhe vrasjet... Beson ai në mundin e trimërinë e vet, beson në varfërinë e ekzistencën e vet, beson edhe pse ndokush në tragjedinë e tij ngrihet e i ndërron flamujt si

këmishat. I pastron dhëmbët, thonjtë. Kreh leshrat. Shpalon ndërgjegjjen para vetes. E shikon. Buzëqesh me të. E palon pastaj ngadalë me kujdes si shaminë dhe e fut në xhepin e bythës. E, telallxhinjtë vazhdojnë të trumbetojnë lugut të shqiptarisë... bindesh dikur se merr pjesë në mjerimin e popullit tënd: se në kurrizin e tij të thyer bëhet palla e qejfit! Luaje macë kryet e buallit...

Vërtet, ky popull më i vdekur nuk bën të jetë... Po ndërgjegja?

(1995)

NË PANTEON NUK KA VEND PËR TË GJITHË

Rreth mbrojtjes e krijimit të majave ndodhin mrekulli nga më të çuditshmet. Majat nuk janë vetëm orientim i një udhëtimit, por edhe vlera, që stolisin një kulturë. Dhe, nuk ka kulturë që nuk i ka majat e veta - kush më të larta e më shumë, kush më të ulëta e më pak. Se ku gjendemi momentalisht, më së miri dëshmojnë ato. Është jashtë logjikës pikat orientuese të udhëtimit t'i fshijmë me gomë dhe t'ia fillojmë nga hiçi. Majat lypset të shtohen dhe të përpiqemi që ato të duken edhe më të larta. Por te ne ndodh diçka krejt tjetër. Nuk pranojmë askënd, se të gjithë jemi maja. Nuk pranojmë, sepse veten nuk mund ta shohim në hijen e tjetrit. Kreativitetin krijues e përcjell edhe smira. Pra, llomotitet më shumë se ç'punohet. Lihet përshtypja se më me qejf kërkohet të jemi fushë. Të dukemi pakëz edhe nëse nuk jemi të urtë e të bukur. Dhe, ç'është e vërteta, mediokrët ecin pa kallauz...

Shkaktari i këtij turravrapit është fakti se në mes nesh vështirë pranohet madhështia. Duam të jemi të njëjtë: të kemi të njëjtat këpuçë, të njëjtat fanella, të njëjtët pantollona: të pimë të njëjtat cigare, pije. Na pëlqen disi uniforma. Apo - ai që dallon, le të jetë i çatisë sime, i katundit apo i fisit. Ma merr mendja se kështu nuk ecet, as ndërtohet gjë. Bile, edhe kombi del pakëz teknefes, i mungojnë gjymtyrët, rrita e shtrirja normale. Ose nëpërmjet konjunkturave, klaneve, nahive shprehet mjerimi ynë si vlerë; se duke rrënuar majat duam të ngulim mbi rrënim. Kjo logjikë primitive shpie te mbyllja e rrugës për të dalë jashtë margjinave. Kështu krijojmë bunkerizmin kulturor, kënaqemi me atë që të tjerët e kanë kaluar ose derdhur me kohë. Dihet, nga kurrëgjëja nuk mund të mësohet asgjë. Ndoshta, vetëm një mësim - se si nuk duhet të veprohet.

Harrojmë se secili sistem apo babaxhan i ka pikëmbështetjet e veta, ku ngrit ngrehinën e filozofisë së vet. Por afrimin e karrigës varet

se si e kuptojnë personat që ulen në to. Ndërkaq, recipienti si i “lexon” sjelljet e pushtetarit dhe veprimet e atyre rreth karriges. Ndodh ata të jenë edhe njerëz kukulla, fatkeqësinë kolektive ta shndërrojnë në një vetëkënaqësi, së cilës herëdokur i del duçi.

Nga historia botërore ka shumë shkrimtarë, të cilët kanë vepruar kundër predikimit të tyre në vepër. Kujt nuk i kujtohet Ezra Paundi? Animi i tij ndaj fashizmit, lavdërimi i një sistemi që kishte çuar në kasaphane gjysmën e Evropës. Qëndrimi i Paundit kishte tmerruar edhe bashkëvendësit. Njësi të mëdha ishin detyruar ta deportonin poetin në një kafaz tigrash nga Italia në Amerikë, ta shpëtonin nga përlyerja e mëtutjeshme me ideologjinë fashiste. Dhe pse e bënë këtë amerikanët, kur kanë mundur ta ndëshkonin Paundin aty në veri të Italisë? E bënë këtë se të pasurit nuk pranojnë të lëndojnë një pjesë të trurit, nuk pranojnë asnjë majë të veten ta rrënojnë. Nuk e ndëshkuan Paundin, as nuk e hoqën nga librat e institucionet, përkundër qëndrimit të tij ndaj filozofisë së Musolinit. Ndërkaq, kulturat e vogla vuajnë nga puritanizmi. Bëhet çmos që çdo gjë të jetë puro dukat. Me ndërrimin e sistemit politik gati mënjanohet gjysma e popullit.

Hiç më pak se Paundi nuk kishte gabuar as Borhesi i famshëm, i cili lexohet e respektohet shumë te ne, bile ka ndikim të dukshëm edhe te ca krijues tanë. Ndodhi puçi në Kil e Borhesi kaloi në anën e Pinoçetit. Pra, në anën e vrasësve, të asgjësuesve. A ju kujtohet Stadiumi i Santiagos? Një gjakderdhje të tillë e kishte përkrahur gjeniu argentinas, por kujt nuk i ra ndër mend nga populli e kultura espane ta mënjanojë. Po ç’ndodhi me Konicën, Fishtën, Koliqin, Mit’hat Frashërin, Martin Camajn, klerin katolik e shumë intelektualë të nderuar edhe nga metropolet evropiane? Rreptësisht u ndalua hyrja e tyre edhe në ndonjë doracak përkujtues të mëhallës.

Ne ndoshta shpesh, në mënyrë të pavetëdijshme, reaguam ndaj qëndrimit të tyre kritik. Por në jetën e kulturën tonë u shfaqën golo të tmerrshme që me vite nuk u plotësuan. Dhe kurrë nuk e patëm të qartë se xhuxhmaxhuxhi ynë më së shumti na shkatërron neve si kulturë e komb. Që të shpëtohet nga një fatkeqësi më e madhe mendoj se duhet pajtimi kombëtar, pastaj brenda vetëdijes të ndodhin edhe katarizat individuale. Nëse Hoxha ra, nëse Berisha shkoi, kjo nuk

do të thotë se duhet të përgjysmohet edhe kombi. A duhet zotërinj, sa herë ndërrohet klasa politike, të ndërrohet edhe populli me gjithë çka ka?

Ne nuk bën të jemi sakatët e qytetërimit evropianë, ekzemplarë të pastërtisë. Librin tonë nacional kurrë nuk do ta kemi tamam. Pra, ku të kemi maja sa më shumë, pa marrë parasysh konjunkturën. Rrënimi i tyre është dhe shkatërrimi ynë. Ngadalë, pra, micsokola se në Panteon, megjithatë, nuk ka vend për të gjithë.

HALLAKATJA E NJË “NOBELIST” TË ARDHSHËM

Para butakëve se ç’i kishte bërë pluhur artet këndeje e andej Drinit një skriboman. Ku ishte nisur e ku ishte dalë. Lakmi t’i keshë për trimëri! Dhe, ia zë derën një ditë një shkrimtari, që merrej edhe me përkthim. Ç’u bëra, bre zotëri? - Pse nuk ma përktheni filan librin. Me vjet nuk zbret nga toplista? Bile këtë vlerë e ka shënuar edhe ylli i pasmesnatës. Ngoje kishte zënë Kadarenë, Beketin, Dostojevskin... Radhë-radhë - të gjithë më të mëdhenj se shoqi. Garë e kishte kuptuar artin. E kishte bërë për pesë para mikun, i cili ishte dhe shkrimtar me nam e që kishte shumë miq në veri.

Pasi i kishte zbrazur të gjithë rafalet, shkrimtari i nderuar që ishte edhe përkthyes, kishte sjellë një numër të gjatë dhe kishte ngritur telefonin. Dhe, si me porosi, pas disa vjetësh dëgjon zërin e njërit nga veriakët. Pas kurtuazisë, i thotë se ka para vetes një shkrimtar të madh, i cili mund të jetë nobelist i ardhshëm e bota fatkeqësisht ende nuk ka dëgjuar për të; pakëz bile ia kalon edhe Kadaresë e të mos flasim për fiqfiriqët e tjerë, që nuk çojnë në kandar as sa një sharje e tij. Botuesi me vëmendje dëgjon propozimin e lavdërimet e mikut dhe; i ngazëllyer nga ky zbulim epokal ballkanas, ia kujton përkthyesit të nderuar se ky është rast fenomenal, përmes vlerave të veprës së propozuar të ngritet për disa oktavë edhe çështja shqiptare. Në mbarim të javës përkthyesi, edhe shkrimtar me nam, merr honorarin nga botuesi për punën që ende nuk ia kishte nisur. Dhe, as dy muaj nuk kalojnë e i bie në fund librit të nobelistit të mundshëm shqiptar.

Tregojnë pastaj se kishin pirë e hëngër deri në mëngjes nga “Sefaja” e në “Atdhe”. Evropa rjepacake më në fund do të ketë rastin të lexojë një margaritar të vërtetë nga letrat shqipe, që kishte pasur disa botime para se të harxhohej i pari. Dhe, ik muaji i parë, shpejt kalon i dyti, pastaj i treti, i katërti e kështu me radhë dhe viti. Një ditë, përkthyesi tek merrej me punë të veta letrare, bie telefoni. E njeh zërin

e botuesit veriak: Mik i dashur honorarin ta kam dërguar. Të lutem, mbaje se atje bëhet luftë edhe me shpirtin. Vepra e shkrimtarit tuaj fort të ndritshëm nuk mund të botohet. Kadare megjithatë, është më avangard. “Nobelisti” ynë nuk ishte mposhtur. Kishte çuar fjalë se bota nuk e kupton e më së pakti sjellja arrogante e një veriaku. Kishte vazhduar të trokasë te të tjerët mbasi ia bënin secili me hile. Dhe thonë se ende troket...

Mediokrët janë më të tmerrshëm se diktatorët. Ata janë potencial i madh i së keqes. Dinjiteti nuk përcakton vetëm karakterin...

KUJDES NDAJ FJALËVE

Një poet pat thënë: *më vram fjala*. Nuk mund të mos i besohet. Më përcjell ky varg se ma forcon një konstatim tjetër fort të urtë: *fjala është jotja derisa e ke brenda dhëmbëve, kur ajo del, je rob i saj*. Komiti i vjetër predikonte kështu. Ndërkaq, poeti kishte pranuar se atë e kishte vrarë fjala dhe ishte koha të ikte se nuk kishte ç'thotë tjetër.

Askush nuk mund të më bindë se *Sali Berisha* në historinë e modernitetit shqiptar nuk do të mbetet figurë qendrore në rrënimin e diktaturës, të njëjës sosh më të egër. Profetët që i përcaktojnë një fat tjetër, besoj se gabojnë. Nuk mund të pajtohem se ai nuk është patriot dhe i ndershëm. Gabimi i tij kardinal: besoi se pas rrënimin të diktaturës gjithkush do t'ia zgjaste dorën. Shqipëria do të shndërrohej në një kopsht ballkanik. Nuk dua të mohoj meritat e tij në senzibilizimin e çështjes kombëtare. Fataliteti i tij qëndron se nuk ishte mjeshër në ndërtimin e shtetit, i mungoi sensi për afrimin e trurit kombëtar. Veprimi shpesh siç kishin vepruar paraardhësit e tij, ishte një *neo*. Nuk pajtohem, po ashtu, se në Evropë hyhet me britma. Nëse do të ishte kështu, moti kishin hyrë komançerosët e Bosnjës serbe. Evropa pranon vlerën, çmon urtinë, sjelljet, organizimin e brendshëm e të jashtëm të një vendi, shkallën e diplomacisë...

Në rrënimin e tij nuk mungoi as dora e huaj, por nuk mund të më bind kush se atë e rrënuan vetëm socialistët, të revoltuarit dhe piramidat e fajdeve. Para së gjithash, ai ra viktimë e fjalëve të veta, të cilat i thoshte shpesh pa kurrfarë kontrolli. Ju kujtohen sintagmat: *Fronti i kuq kulshbedra komuniste* etj. etj.? Ishin irituese këto, e sidomos kur i thotë personi që ka fatin e një shteti në dorë. Dhe, kur thuhet sintagma të tilla, nuk kemi të bëjmë me guximin intelektual, as me një njeri të rryer që njeh politikën. Por shtrohet pyetja: a mund të udhëtohet më tutje?

Unë përkrah opcionin demokratik se besoj në paqe e mirëkuptim njerëzor, mirëpo kjo nuk do të thotë se unë pranoj të bëhem urë. Po ashtu, nuk do të thotë se socialistët nuk janë për procese demokratike, se nuk i përkrahin ato dhe janë më pak shqiptarë; se çështjen kombëtare do ta nëpërkëmbin e do të lozin rolin e servilëve. Duhet të pajtohemi se shteti e populli janë dy gjëra të shenjta që afrohen e rrinë larg në të njëjtën kohë. Pushteti askujt nuk i takon me tapi, por as monopoli mbi popullin, i cili është zotërues dhe përcaktues i fatit të vetë atdheut.

Partia Demokratike dhe Berisha bënë atë çka nuk mund e bëri askush më parë: e shkulën përgjithmonë komunizmin nga trojet shqiptare dhe truri ynë. Na liruan nga një dogmë pansllave, që Fishta e shihnte si të keqe të madhe. Kujt nuk i bie ndërmend të pranojë prapë të kaluarën. Vetë momenti i ri botëror nxit të besosh se as socialistët nuk do të ecin rrugës së diktaturës dhe do të ruajnë drejtpeshimin nacional; pra, nuk do të bien në mikro as makropolitikë. Populli shqiptar nuk është i dënuari i Ballkanit, që duhet larë të gjitha mëkatet e padituritë e bajraktarëve. Kujdes, pra, ndaj fjalëve. Ato tradhtojnë, rrënojnë dhe varrosin perandori e sisteme kur bëhen të neveritshme...

Fjala më vrau, pat thënë një poet.

(1997)

MARRAMENDTHI

Kërkohej edhe vlerat e njëmendta të hidheshin në pleh që të fshehet arpallëku. Kjo ishte doktrinë e shtetit totalitar. Romani *Tumeli* i Dh. Xhuvanit ishte bërë kartuç pse kishte dëshmuar se kurvnohet edhe në kantjerë të Partisë. Përkundër mbylljes së vendit, njerëzit kishin vënë kokën në thes. Mund ta quajmë këtë edhe si disidencë shqiptare. Dhe, kishin nxjerrë disa ekzemplarë jashtë. Njëri më kishte rënë në dorë, por nuk e kisha parë më. Në kujtesë më kishte mbetur fillimi: vringëllimat e rrotëve të një kamioni në një kthesë mbi një kanion shqiptar.

“*Tumeli*” nuk ishte libri i parë as i mbrami, që ishte bërë kartuç. Kishte edhe shumë të tjerë. Fat të tillë kishin pasur edhe gjashtë vepra të ish-Kryetarit të LSHA të Shqipërisë, D. Agollit (“Drita”, Tiranë, 12 mars 1995). Mezi kishte arritur Xh. Spahiu t’i shpëtojë tre ekzemplarë të librit të vet. Njërin ma kishte dhënë në besë në të kthyer nga Tirana. Kartuç ishin bërë edhe ca libra të shkrimtarëve nga Kosova. Tregonin se *Ahmet Kosbutani* i R. Kelmendit telashe u kishte nxjerrë tërë Redaksisë së botuesit. Pas njëzet vjetësh një mik imi ma kishte sjellë librin tim *Thirrjet* (1972) nga Brukseli, të cilin ia kishte dhënë një skrapariot, mik i përbashkët. Librat e ndaluar, megjithatë, kishin gjetur udhën deri tek lexuesit. Por duhet të pajtohemi se çfarëdo pastrimi i tepërt, është i dhembshëm, shkatërrues. Ha edhe koka.

Në ditët e para të demokracisë, një grup artistësh nga Tirana bënë një turne nëpër Zvicër me recitalin e poezive të mia. Tek bisedonim një natë në Redaksinë e gazetës “*Demokracia*” na u kujtua Dh. Xhuvani. E luta një aktore të bëjë çmos për të ma gjetur një ekzemplar të *Tumelit*. Mund të botohej te ne. Kisha harruar kur mora librin. Në një faqe shkruante: “Ali Podrimjes, si vëlla, ia dhuroj për kujtim këtë kopje të vetme të mbajtur kyçur e të fshehur në shtëpi. Të falemnderit që pas 25 vjetësh, me guximin e dashamirësisë sate, po më

liron nga kjo ndrydhje”. Në fund ishte nënshkrimi i shkrimtarit të nderuar. Viti 1991. Sall nuk di pse qëndronte 9 maji. Shënonte ngadhënjimin mbi diktaturën apo fashizmin?

Tunelin e lexova prapë dhe e përgatitëm për shtyp. Por ka disa vepra, që i ndjek fati ogurzi. As të ne nuk arriti të botohet. E kishte gjetur e zeza edhe “Rilindjen”, të cilës nuk po i ndahet as sot. *Tuneli* ishte shkapërderdhur edhe në mesin tonë...

Bisedonim me një krijues rreth përditshmërisë sonë kur tha: A ke dëgjuar? *Tuneli* u botua aty ku ishte bërë kartuç. Tani veten e ndieja më të lehtë për shkak të fjalës së dhënë mikut. Kjo vepër kishte shqetësuar kalemxhinj e diktatorthë: nuk kurvnohet tek ne... Më ishte bërë se dëgjoja vringëllimat e rrotëve të një kamioni në një kthesë mbi një kanion shqiptar. Disi ëndërrueshëm buzëqesha.

Tek fillonte një marramendth shqiptar me pleonazma, kakofoni, sinkopa dhe retorikë pakëz si të tmerrshme...?

(1994)

PUDROSJET

1.

Në kasabanë tonë shtohen frazerët e zëshëm. Kozmetika tepër e lirë. Asnjëherë më lirë nuk ka kushtuar. Mëse e padurueshme e retorike. I lexon mbarembarsht. I shkund nga bishti në kokë. Ushtrues të lartë të ekulibrizmit. Asgjë konkrete, asgjë imja nuk merr frymë aty. Sillen rreth *problemit*. Frikësohen të marrin në thumb shkaktarin. Të merren me qeniesoren: pse Kosova zgjohet në ekzil? Frikësohen nga vetvetja e fjalët. Dridhen rreth *vrëmës*, që na kishte tërhequr vëmendjen një i dëshpëruar. Aq burrëri kanë. Skalpi i tyre pakëz pret, gjë nuk pikon. Se frazerët: 1) Kënaqen me retorikën e boshllëkut, 2) Ua kënda të dëgjojnë jehonën e fjalëve boshe si përplasen pa më të voglën zhurmë për çatitë tona të thyera dhe 3) Zgjohen vonë, si zakonisht, kur bryma ka shkrumuar edhe sythin e fundit.

Vërtet një prostitucion i lartë kulturo-shpirtëror. Njërin, që shkrimtaron për dreq, e kisha pyetur: pse nuk harxhon pakëz energji për të përditshmen tonë, e cila i ndërron rrobat në mëngjes e mbrëmje? Pakës në habi më kishte shikuar, gati sa nuk më kishte thënë: nuk e prish rahatinë time. Dhe, dikur me atë fjalorin lavdërues, kishte shtuar me cinizëm: mua më lexojnë ambasadat. Po ç'të keqe ka or i zi nëse ambasadat paskan nderin të lexojnë përmes teje edhe diç për tmerrin që quhet *Kosovë*? E kishte ndërruar temën. E dija se ai frikëson nga e vërteta, sepse vështirë thuhet gjërat kur fjala pikon gjak e jeta shndërrohet në gjësend pa vlerë. Guximin e tij prej intelektualit dëshironte ta pudrosë, pastaj ta hekurosë, të dalë në pazarë e të aktrojë të gjithëdijshtin, mos më të dijshtin në Vilajetin *Kukunënë*. Edhe tani shihet birucave me atë ndjenjën e negacionit.

2.

Ne shqiptarët kemi problem më tepër me vetveten. Ruajna zot, të mos ekzistonte topuzi i kralit, do të harronim se jemi gjallë. *Problemi ynë parësor* mbetet *lirimi* nga vetvetja, nga gllabërimi i vetvetes, nga të marrurit për së tepërmi me vetveten. Por mazohizmi ynë gjithnjë e më ekzemplar. Dihet, e mira nuk pritet nga ai që të vret edhe në pikë të ditës si qen. Ne, a bën të lozim para tupanit të tij, që humb kumbimin vazhdimisht?

Të ekzistosh nuk mjafton vetëm *buka, uji*. Para së gjithash, lëvizja e mban gjallë një popull. Ai që lëviz mund t'i kapërcejë grackat. Dhe vetëm kur fitohet besimi në forcën nacionale dhe kur të merremi seriozisht me Serbistanin, bota do të na shikojë me të dy sytë. Dhe fjalët tona nuk i fsheh atëherë as pudra më e shtrenjtë e Parisit apo e Londrës. Do të zënë vend ato. Aty ku duhet. Të gjorat, fjalë! Fatkeqësisht, propaganda sllavo-ortodokse është më rrënuese se fuqia jonë, bën çmos të na devalvojë në arenën ndërkombëtare si komb e vlerë. Përmes kanaleve, që vetëm ajo i di, përpiqet të na japë goditje të përqëndëruar, siç thuhet me fjalorin e diktaturës.

Dhe në këtë marshim të tyre të marrë i inkurajon grupizimi ynë në bazë të interesit, fisit, regionit. Debaklin tonë mu aty e kërkojnë. Bile edhe brenda partive tona të brishta. Në një kohë terribël e mundëson këtë mosekzistimi i ligjit tonë. Në një tekst të hershëm kam theksuar se ai që ka vjedhur e bërë një mijë të zeza në kohën e komunizmit, shumë më lehtë e ka në demokraci. E çuditshme kjo, por i përlyeri veprimin e mjeshtërinë e vet do t'i mbrojë me patriotizëm të rremë dhe rrugën e ka të çelur... Krijimi i idhujve, të rënit e famës në kokë, keqpërdorimi i institucioneve, mungesa e komunikimit jo vetëm brenda partive, paralajmëron shpirtin bizantin në shkallën më të lartë. Ky është ai arti i zi, që na ofron armiku.

3.

Mbrojtja nga dhuna e të tjerëve *dubet* të jetë problem qeniesor i ekzistimit tonë, nëse duam të jemi sovran. Lë përshtypjen se te disa çështja kombëtare u shndërrua në çështje personale. Kjo lexohet e shihet mirë. Na ka lexuar edhe armiku. Nuk e fsheh se më ka marrë malli të dëgjoj nga krerët se liria e atdheu nuk është çështje personale, se kontributi i askujt nuk bën të mungojë në asnjë rrafsh. Për të keq pakëz ngritet zëri se udhën duam ta bëjmë bajrakçe e rapsodi të na këndojë. Tepër luksoze është kjo në një kohë mëse traumatike, me pasoja të gjithëfarshme. A na fal historia pse nuk deshëm të bëjmë historinë?

Pra, nuk është kohë e retorikës, e patriotizmit provincial, është kohë e tërmeteve, e çmurosjeve nacionale... Përndryshe, Kosova vazhdon të zgjohet në ekzil. Dhe nuk bën të na çudisë po qe se një ditë shpërngulet me kulla e qenefhane diku në Polin Verior. Këto fjalë prekin ndoshta edhe sedrën e profiterëve dhe puritanëve, por tek ne nuk dihet ka të ndalë rrokullisja e qerres sonë. Problemet tona nuk bën t'ua lëmë fëmijëve, brezave të ardhshëm... Nuk është dinjitoze *Dosja e Kosovës* të hapet prapë pas sa vjetesh, e cila mbyllet apo nuk guxon të mbyllet pa praninë tonë. Kosova ka filluar të ngajë në zog shtegtar: tash shihet, tash nuk shihet. Fundin nuk dëshiroj ta them, por e keqja luftohet para se ta përfshijë trupin. Në një kohë të ligë pudrosjet janë të dëmshme. Vendi i saj i lihet guximit, nishanit. Robit i ka hije shembja e mureve. Të gjithave. Edhe të bajraqeve Vetëm ai nacional të ekzistojë. Na mbron nga e keqja.

(1995)

PËRSE NUK JEMI MË TË MIRË?

Skajshmëritë më tepër shënohen me debakle. Frikësohem se urrejtja merr përmasa të një patologjie. Ndodh kjo në një kohë, që nuk mund të jetë fatlume për askë. Askush askë nuk e duron. Secili ka mend më shumë se ç'mendon. Për një këmbëz karrige, për një shpërblim apo për diç, të themi, më tepër bizare, jemi në gjendje të derdhim tërë arsenalin rrënues; të ecim edhe nëpër kufoma. Ku fshihet e vërteta? Dëgjon shkarje. Në mesin tonë të bëhet se nuk ka gjë më të rëndësishme se grindjet, se sharjet...

Dhe disi turpshëm, me gjysmë zëri, themi se këto fërkime në mes nesh bëhen për çështje fundamentale; se shqiptaria fillon nga ne dhe ne jemi ata që e mbrojmë. Prandaj ai që na pengon ose përpiqet të na korrigjojë është kundër çdo gjëje që shpie përpara. Harrojmë se të arrihet qëllimi, ky mund të jetë dhe ideal brezash, udha nuk është gjithmonë drejtvizore; ka serpentina dhe gola. Shumëçka e nënvizuar tani ka qenë dashur ta kalojmë në fillim. Njëri-tjetrin të mos e shikojmë nën vetulla, fërkimet brenda nesh të mos shndërrohen në krurje të llahtarshme.

Nëpër kufoma nuk parafytyrohet sukcesi. Ruajna zot të bëhet karrierë! Është e turpshme kur hija e zezë na mbështjell nga tepja e kokës deri te thembra. Ata që mendojnë ndryshe, besoj se nuk e kanë gjatë. Ndonjë forcë e rrufeshme shfaqet e do të na këndellë, ose do të na bëjë tokë. Fatkeqësisht, “trurit” tonë nuk i ha palla. Vepron ashtu siç i teket: herë majtas, herë djathtas. Edhe në mënyrë më të poshtër. Në vend se grupet të shkrihen ose të afrohen, ato shndërrohen në leukuni ndjekjesh, akuzash. Nuk e pranojmë as nuk e ndiejmë fatkeqësinë. Kryesore, mua nuk më ka qëlluar. Ja, pra, logjika e çatisë, e klanit. Harrojmë se kur vritet a fyhet kush, të gjithë jemi vrrarë e sharë nga pak. Kështu në tyrli ëndrrash humbemi. Por në kodin tonë etik nuk shkruan kund se duhet të nëpërkëmbën edhe të vdekurit për shkak të ambicieve; se ata janë fajtorë për ngecjet tona; se ata asgjë nuk

na lanë. Se, këtë që bëjmë ne, ka qenë dashur ta bëjnë ata... E, kështu nuk arrihet kund. Të mendohet ende se mirëqenia njerëzore-kombëtare na pikë nga qielli, ose do të na e ofrojnë të tjerët në pjetë, është iluzion. Nëse fshatrat e derdhura nuk mjaftuakan të na bindin se kryeveti asgjë nuk bëhet, atëherë nuk di a mund ta konsiderojmë veten popull.

Na tmerrojnë kalemxhinjtë, rrahagjoksët, për diçka që është parë nga fillimi. Pra, ku ishin këta micsokola atëherë, t'i dilnin para të keqes qoftë edhe përmes një vargu? Parandjenja e zyrtë që shfaqej aty-këtu si diçka e mundshme, esnafllëkut të çarshisë i ngjante në një shkallim, në diçka të pamundshme, bizare; se në logun e micsokolave nuk mund të ndodhë hataja e sidomos në mbyllje të shek. XX. Por, ja hija na shkurtohet; se jemi të paprekshëm, se parashenjat mund të jenë fikcione, pjellë e pagjumësisë. Në të vërtetë; të tillët që ëndërronin këndim tjetërfare, pakëz “lules”, vazhdojnë shkarravitjet e historisë njerëzore dhe të fatit kombëtar. Por ky është dhe mjerimi intelektual se, tekefundit, nuk shkruhet për të na lexuar arinjte.

Të kemi diçka tonën, që të dëshmohet se kjo është jona dhe se tonën e dallojmë në mes të njëqind “arnave”, ne duhet ta lëmë shenjën tonë sa më të theksuar. Por të arrihet kjo, duhet t'i gëzohemi dhe guximit tonë njerëzor: njëri-tjetrin ta shikojmë në dritë të syrit. Liria nuk është plaçkë e atdheu më së paku. Dhe, kurrë nuk ka shumë. Në Majë nuk dilet para se të mbyllet udhëtimi, i cili, megjithatë, nuk bëhet vetëm. Në shkretëtirën e absurdit Beketi thoshte edhe këtë: S'ka gjë. Provoje prapë. Dështo sërish. Dështo më bukur...

Mirëpo “truri” ynë larg ka shkuar, frikësohesh se pranon edhe rolin e kasapit. Kështu ballafaqimi me vetveten i ngjan shpesh puqjes së trupave të zbrastë, komunikimit në furtunë. E, fajtor për “treni”, para së gjithash, na është mentaliteti i çatisë, nga i cili vështirë ndahemi. Disa ende veprojnë me logjikën e fisit.

Vërtet, përse nuk jemi më të mirë?

As tani nuk është vonë. E ardhmja të mos na gjejë më xhuxh...

(1995)

ROLETAT, DRYNAT

Ndërgjegjja

Kalli në krye të rrugës. Në dritare i kanë lëshuar roletat dhe në shumë dyer i kanë vënë nga dy dryna. Janë shndërruar në shpirtëra të blinduar. A thua vetëm një grusht njerëz qenkan në anën e Kosovës? Bëj pazarin e ditës e ulem pranë makinës së shkrimit. Nuk di ku t'ia nis. Roletat, drynat - bëhen shqetësues. Para meje grimcohet familja. Ç'rrenë t'u them mbasi asgjë nuk paskam bërë për të. Me siguri nesër do të bëhet mirë, u them me një gaz të hidhur pas ditarit të fundit TV. Nuk do të na harrojnë. Shikojeni çfarë fenomeni ndodh; më shumë kthehen se e braktisin Kosovën. Hap dritaren krah më krah. Le të dihet se ende jetohej në këtë shtëpi. Po shokët, miqtë? Rrallohen. Poshtelart i bie rrugës. Këndon vetmia. Bile një mace ta prishte këngën trishtuese. Pëshurr burrërinë e burrecave, që përmorraven bodrumeve të metropoleve dhe ranishtave të Mesdheut. Dëgjoj se një profiter në zë ishte paraqitur si refugjat diku në det. Aty kishte qëndruar aq sa e kishte planifikuar pushimin. Ç'nuk pjell mendja e shpërlarë, e kalkulantit...

Në mesnatë bie telefoni. Një zë i largët nga një metropol. Dëshiron të dijë, a jam gjallë dhe si jetoj. Pastaj merr guximin e m'i propozon ca zgjidhje. Dikur i them: Nuk mundem pa Kosovën. Përkthyesi e shkrimtari i shquar austriak prapë insiston: këtë e kemi bërë edhe për shkrimtarë të tjerë të Ballkanit. Pse të mos e bëjmë edhe për ty?. Diç ngjashëm më kishin propozuar edhe ca miq nga Këlni, Munihu, Cyrihu. Një person më kishte treguar bile edhe ku m'i kanë lënë çelësat. Pastaj këmbëngulja e tyre: Pse të mos e bëjmë edhe për ty? Por ata nuk kanë pasur një Kosovë çfarë e kam unë dhe nuk di a kanë shkruar aq shumë sa kam shkruar unë për timen. Nata kalon me

telefonata. E njëjta kërkesë. E njëjta përgjigje: Nuk mundem pa Kosovën...

Prapë të nesërmen në krye të rrugës. Hedh plehun dhe bëj pazarin e ditës. Pyes ndonjë mik të rrallë për miell, sheqer, vaj... Për inat nuk e kthej shikimin nga dritaret e dyert e blinduara. Dëshifroj vetminë. Më thellë depërtoj në thelbin e çështjes. Ia zë pisk bishtin një maceje. Zë nuk nxjerr e gjora. Dhe më intrigon prapë vargu i Beçë Cufajt, poet nga Dukagjini me qendrim të përkohshëm në kurbet; *I kujt je ti Atdhe?* Varg ky që vë në pëshojë ndërgjegjen e secilit nga ne. Se, Atdheu a mund të jetë i atyre që ia kthejnë shpinën në momentin më kritik, që e derdhnin pikë e pesë, që e hedhin në bixhoz? A mund të jetë Atdheu i pëshpëritësve, i shpifësve, i intrigantëve, i përçarësve, i profiterëve? Tevona më del përpara Lulëzim Tafa me vargun: *Në këtë luftë do të vritem*. Më trondit se njeriu ka vendosur të bëjë çdo gjë për lirinë e vet dhe vështirë se mund ta kthejë kush nga udha e përcaktuar. Bindem se gjërat linden dhe rastësisht, por në kontekstin historik marrin dimension tjetër. Në vargun e parë kemi të bëjmë me ndërgjegjen: mbasi yni nuk qenke, i kujt je ti Atdhe? Në të dytën me viktimizimin për idealin, për diç të shenjtë. Në mes rebelimeve të këtyre dy poetëve të brezit më të ri, rropatet diku edhe Kosova e njeriu i saj...

Vërtet, nëse nuk ke bërë asgjë për Atdheun, bile ndaje dhembjen me të. Edhe të tjerët i ka lindur nëna...

Në një bodrum të shekullit njëzet

Diku në katin e mesëm fqinji im sa më sheh hap derën dhe nis ta pastrojë armën e ftohtë. E fshin dhe buzëqesh me një zë të veçantë, që më së paku i ngjan gazit të njeriut. Kështu vepron gati çdo ditë. Por unë e di kush ia ka dhënë atë armë vdekjeprurëse dhe në cilën çetë vrasësh do të rreshtohet. Vetëm nuk di i gori a e di se edhe unë kam të drejtë të jetoj? Shkruaj këtë tekst të dëshmoj se unë rroj në një vend me emrin *Kosovë*, ku fëmijë as të rritur nuk dinë kur janë kërshëndellat, Viti i Ri apo ndonjë festë kombëtare.

Në kokërr të shpinës shkruaj dhe lexoj yjet para se të fiken në një bodrum të shekullit njëzet kur po merr fund edhe bashkimi i Evropës së dresuar. Ndoshta më mirë është të veproj kështu se sa të zbres në mes gogolëve, të cilët kanë zënë t'ia djegin bishtin Evropës. Oh Evropë, si do të dukesh pa bisht! (*Buzëqeshja në kafaz*). Kujtova një shkrim timin të viteve tetëdhjeta; se nën verandën time tani fqinji im pastron "Jugon" me automat mbi karroceri. Nuk ka kohë as për fitilaq, megjithëse kujt nuk i kërset. Frika nuk është më njerëzore. Ndërkaq, hipokrizia evropiane kërkon barazpeshën në mes viktimës dhe xhelatit! Poeti Visar Zhiti lajmëron nga Roma për mesazhin tim drejtuar poetëve të Mesdheut: Detyra ime është të rri me viktimat e mia në Kosovë. Dhe akuzonte mjerimin e diplomacisë evropiane - thotë ai. Pastaj, Zhiti vazhdon: u lexuan poezitë e tij (Aliut), të cilat u pritën me duartrokitje dhe publiku u ngrit në këmbë... (*Zëri*, 23 maj 1998).

Fatkeqësisht, Kosova përpëlitet ende në një bodrum të shekullit njëzet.

Nderi

Vështirë se do të përsëritet rasti i Uilsonit në mbrojtjen e qenies sonë. Në të dy anët bëhet tregti e çuditshme me popuj. Do të fitojë ai i cili do të japë më shumë dhe që ka shtrirje të madhe.

Në Muzeun e Nazim Hikmetit në Stamboll përplot dëgjues, përfundonte Turneu i poetëve shqiptarë nga etnia. Mbrëmja mbyllet me poezitë e mia. Ndërkohë, përkthyesi na kishte njohtuar se ditëve të fundit shtoheshin autobusët nga Kosova. Marrëveshja e nënshkruar në mes dy luftërave botërore mes dy ish-qeverive, gati kishte zbrazur Kosovën. Dëshmohej kjo edhe në mesin e të pranishmëve kudo. Ju kisha drejtuar ndërgjegjes së krijuesve e intelektualëve turq; Një gjë e tillë të mos përsëritet. Do të ishte më se katastrofike. Elaborate e marrëveshje të tilla kanë vetëm një qëllim: pastrimin etnik të Kosovës. Mbrëmja ishte mbyllur me ankth...

Fjalët e patrikut të ortodoksizmit botëror, Atenagorës: Pasi mbrojti në mënyrë të mrekullueshme krishtërizmin, Evropa duhet ta shikojë me nderim Shqipërinë... Dhe e kishte këshilluar intelektualin e mirënjohur arbëresh Guiseppe (Zef) Ferrarin: Detyra juaj tani është të bashkëpunoni për ndërtimin e një Shqipërie të re...

Mirëpo roletat e drynat lajmërojnë diçka tragjike. Kosova nuk mbrohet duke u zbratur e, më së paku, të bëhet etnia duke u përçarë. Në postet më të larta të dy kishave botërore kishin qenë edhe njerëzit tanë. Nuk dihet sa kishin bërë për çështjen kombëtare. Por në ballin tonë mund të ketë vend për dy gishta nder. Kështu do të thoshte Atenagora. E Evropës i intereson më tepër pazari. Humaniteti i saj!

(1998)

DHOMA E KUQE ME PERDE TË KALTRA

Ditë traumatike

Shtëpisë që qet tym ia mësyn gjithkush. Por kurrë veten më keq nuk e kam ndjerë se atë ditë kur më trokiti në derë një baba fatzi e nuk pata dinar t'i jap për djalin e vdekur. Pamja e atij fatziu, nuk do të më hiqet sysh përjetë. Besa e zotit nuk kisha dinar në xhep. Ishte ditë traumatike, e dhembshme edhe për turpin e shtëpisë. E kërkova dikur të gjorin t'i ndihmojë diç, por nuk e pashë më. Unë nuk jam si ai kapoja, që nuk i zbret aeroplanit në emër të injorancës e nuk skuqet as kur miqtë ia rrahin telin. Për të jetuar duhet pakëz guxim e burrëri, por a di kush, ku shkojmë?

Në xhamin e dritares nuk më hiqet fytyra e babait fatzi. Derë për derë kishte trokitur për të mbledhur ndonjë dinar për xhenazen, që i kishte mbetur mbi dhé. Kishte trokitur edhe në timen.

Vështirë ishte për të, por vështirë edhe për mua.

Letra

As sot nuk ma shkrove letrën, poet - më thotë gati çdo ditë një vetullzi mustaqepicegjatë, që më rri karshi tërë gaz. Paj, si ta shkruaj, ore trim, kur nuk ta njoh as familjen, as fëmijët, as... E dua një letër të fortë, shyp. Ngul këmbë burri dy metra. Dhe atë fjalën *shyp* e posaçërisht germën y e thekson në mënyrë të çuditshme, por me zemër. Rri karshi meje e më shikon me sy të lëvizshëm në lule të ballit. Nis t'i fërkojë duart. Dikur fytyrën e ndezur e fsheh në mes shuplakave të mëdha dhe pas pak kohe ngrit kokën. Ia shoh sytë, kanë një dritë të çuditshme, më tepër ëngjëllore të një pafajësie, përzier me një tis turpi: Zoti poet, ende nuk ma shkrove atë letër?... Ka tri vjet që

gruaja e fëmijët nuk dinë gjë për mua... i gjallë apo i dekur jam... në fshat nuk ka telefon, as unë nuk di... veç dy-tri fjalë e ca numra.

Mbylli sytë dhe nxjerr një klithmë të mbytur. Trimi kallushan e koxha burrë hynte në mileniumin e ri pa ditur t'i shkruajë letër të dashurës atje poshtë. Ndjeva dikur ajrin e ftohtë kur më preu në brez. Kishte ikur në majë të gishtërinjve. Më tepër nga turpi ndoshta. Nuk është i vetmi, që kishte kapërcyer ca kufij e besdis botën edhe për një letër... A e di vallë ku bie Kosova?

Shitësi i miellit

Vetëm ti mund të na shpëtosh, më thotë tregtari i miellit, i cili nuk di si u gjet para meje. Vetëm ti, por nuk dëshiron. Idiot na qenke! Të paska hyrë vetja në qejf. Më i keq qenke se këta, që na ndjekin fërkem pas fërkemi... Pse nuk shkruan se nuk jemi të tillë, as të atillë?... Ne shpëtuam edhe Evropën, kapitali i saj të mos kalojë oqeanet... Jemi në luftë të hapët me latinoamerikanët, aziatët, turqit e me dreqin e mallkuar... Ja ulëm çmimin miellit dhe e pastruam Evropën nga ndyrësitë e xhunglës. Por ti qenke vërtet idiot, bir idioti. Nuk shkruan as për guximin tonë më të poshtër, që bëjmë para ligjit e kombit!... Burgjet gumzhijnë nga ne...

Zbraz me fund gotën, nuk di të satën dhe prapë murmuron duke u dridhur. I them pastaj se vërtet jam idiot; se jam më i keq se ata që iu ndjekin fërkem pas fërkemi. Por - nguli - ne menduam se do na bashkëkoheni me dinjitet, sjellje e burrëri; se do na ndihmoni në hapjen e dyerve të tjera, që vështirë na i çel Evropa. Dhe ja, në saje të burrërisë suaj, iu falënderuar burrërisë suaj, ne paguajmë haraq jo vetëm ndaj Serbisë.

Ai më shikon. Shtrengon dhëmbët. I bie tavolinës fort. Buzëqeshja e tij ma kujton një film të Bekim Fehmiut. Nuk pranoj të ma paguani kafënë - i them. Rrëmbimthi ngritet. Ma thyen edhe filxhanin. As këtë nuk do ta paguanit. Idiot! - bërtet. Ik tym. Pas pak kohe arrin profesori, karapidik si unë. Nuk vritet as për gjak.

Dhe nata na zuri duke i ndërruar kafiteritë dhe duke u ikur syve të monafikëve...

Kapoja dhe Sekreti

Ne i kemi ligjet e rrepta. Që të mos bëhet më keq, ua tërheqim vërejtjen se një bashibuzuk juaji nënshkruhet ashtu siç ka ëndërruar ndoshta. Dhe ne kemi verifikuar diplomën e tij, por ai vazhdon të nënshkruhet ashtu siç nuk e lejon ligji ynë. Nuk duam ta bëjmë të madhe, por nuk mundemi as ta ndërrojmë ligjin për shkak të një bashibuzuku tuaj. Ju lutem, ia bëni me dije se bën vepër penale. Dhe mbyllet letra me shenjë *sekret*.

E, ne në Kosovë mendojmë se në Evropë bëhen vetëm martesat në të zezë!

Erzi

Turpshëm, pakëz si tinës, kishte hyrë zotëria aty ku ia mësyjnë ata, që duan të bëjnë qejf me para të veta. Dhe pasi ishte mbyllur në dhomën e kuqe me perde të kaltra, kishte zënë të zdishet, duke e shikuar trupin e zonjës, që i rrinte pip me duar para namuzit. Dhe sa kishte nxjerrë një ofshamë ajo, zotëria i zgataraqur në shtrat kishte brofur në këmbë. E kishte shikuar gruan lakuriq me sy të turbulluar dhe mëzi kishte pëshpëritur: E jona, na qenka? Ajo ishte dridhur. Kishte sharë në gjuhën e zotërisë, i cili shpejt e shpejt ishte veshur. Mbi një tavolinë kishte lënë të holla më shumë seç duhej. Duke pështyrë ishte lëshuar shkallëve. Në një karrige të verdhë pastaj ishte ulur gruaja lakuriq. Kishte qarë ngadalë, dikur me zë. Më vonë e kishte larë fytyrën dhe, pa e parë kush, e kishte braktisur dhomën e kuqe me perde të kaltra, ku pas një kohe ishte vendosur një mullate, dera e së cilës rrinte më shumë mbyllur se çel...

Fabrikat për coftina

Në shekullin XXI nuk do të hyjmë si ata që ishim dikur: trima me fletë. U bë raxha e gabelëve se dikush lëshoi sangjakun në sherif e populli vazhdon të nxjerrë prapë gështenja nga zharava...

Tek derdhja mllefin, kaloja pranë Durrachit e lumit Iler. Nuk u besoj atyre që thonë se deri këtu në dherat gjermane na paskan arritur të parët. Nëse Shën Albani nga Iliria kishte bekuar këtë popull që në shekullin e dytë, ai kishte parandjerë se nipat e tij nuk do ta ndalin vrapin as këtu.

Pakëz më larg rrugës fabrika për djegien e coftinave; të ruhen njerëzit e ambientit nga sëmudjet ngjitëse. Besën ju dhashë, edhe te ne do të ketë fabrika të tilla. Por, për kë?

(Kaufbeuren, 1995)

DUAJE ATDHEUN

I Hasit shpesh theksonte se njeriun duhet marrë ashtu çfarë është. Në moshë të shtyrë pakëz gjë mund të ndërrosh tek ai. Unë mbështes mirësinë, mbylljen e çarjeve. Se njeriun duhet qitur në udhë të zotit edhe po qe se çalon. Në shkrime të mia shpesh kam thënë: unë nuk kam shqiptarë të humbas. Ndoshta kjo është dhe njëra nga fatkeqësitë e mia.

Tek dëgjoja kryeredaktorin robus të një fletushke, që nisi e para të na tregojë sa të “bukur” e “patriotë” jemi në nevojtoare - Defatorja, Livadhi, Bashçeliku e ca të tjerë më dukeshin edhe më të mjerë. Ndjeja dhembje se prostituimi shpirtëror e moral ishte në një shkallë qerpazi. Shpirti prej mediokri lexohet edhe në pikë të natës. Kryeredaktorin robus e kisha lutur ta ndërrojmë temën. Gjestin tim e kishte kuptuar si të një idealisti të pandryshuar, që nuk e pranon humbjen. Zhgënjimi vërtet ishte i thellë edhe për arsye se në formimin e tyre të parë, kisha kontribuar pakëz, aq sa kisha mundur e ditur. Mu për këtë nofkat i lamë të digjen në mjerimin e tyre. Njerëz të pritave. Të pamrit. Po e nesërmja?

2.

Gjendesha në qytetin G. emri i të cilit thoshin kishte origjinë ilire. Toponimin e lidhnin me *gjurin*. Nuk ua prisha as kur ngulnin këmbë se edhe kantonet e vendit, ku kaloja javën e parë, ishin krijuar, po ashtu, në bazë të principatave shqiptare. Ku të ishte ky fat, mendoja. Dhe, duke bredhur buzë liqenit, më kishte rënë ndër mend Nositi i Lasgushit, fluturimi i të cilit më bëhej se ishte ngrirë në ajër, aty diku mbi kokën e bustit të Skënderbeut punuar nga dora mjeshtrorë e Odhise Paskalit.

Tevona isha sjellë rreth tij, në hijen e errët të shelgjeve vajtuese dhe kur dilja nga kurora e dendur, pakëz më tutje kisha zgurdulluar shikimin në një skulpturë, që simbolizonte një kalë slloven. Ishte vendosur në pishë të diellit e në vend të dukshëm. Prapë e kisha shikuar bustin e Heroit Kombëtar. Tani kisha një buzëqeshje tjetër. Nga mesi i liqenit një valë e trenuar sa nuk na kishte bartur.

Në krye të rrugës qendrore të qytetit G. e cila quhet *Rruga e Prostitutave* e për të cilën një shkrimtar yni kishte përfunduar librin e tregimeve mu për të dhe po me këtë emër, e cila shumë vjet më parë ishte quajtur ndryshe dhe aty kishte lindur e ishte rritur Rusoi. Thoshin se i ati, sa herë e kishte vënë në prehër, i kishte pëshpëritur: *Duaje Atdheun!* Nën këtë dritë magjike ishte rritur e edukuar mendimtari i shquar, që vazhdimisht do t'ua kujtonte të vetëve: Atdheun duhet dashur... Por ta duash Atdheun, nuk është punë e lehtë. Duhet të pranosh edhe rrezikun. Nuk mund të jetë vetëm ikonografi dashuria me të. Njeriu duhet ta dijë se ku shkel. Në të kundërtën, ai që nuk ka Atdhe, nuk di ç'është liria...

3.

Për pak kohë, lashë qytetin G. dhe në përcjellje të dy kalorësve dardanë u gjeta në Kështjellën Dardania (Le Chateau Dardagnue), e cila ishte ngritur që në vitin 1200 nga kalorësi Aynion e që nuk dihej nga kishte ardhur dhe pse këtij lokaliteti i kishte vënë një emër antik. Tek i binim poshtelart, hetova se Dardania e kalorësit të largët fare pak dallonte nga Dardania ime. Kishte gati të njëjtin konfiguracion e peizazh, mure e shtëpi të ulëta e të brishta. Por rruga deri aty ishte me plot serpentina e gryka. Supozohet se kalorësi kishte kërkuar strehim të sigurt, t'i shpëtojë ndonjë masakre të egër. Aty ishte edhe kështjella prej guri të latuar. Përgjasimet e tjera mes dy Dardanive sa vinin e zhdukeshin. Përpara kisha një qytetërim tjetërfare se në Dardanië time, siç thoshte njëri nga kalorësit, *anomie* kishte bërë aty të veten në shembjen e identitetit.

4.

Njeriu vazhdon të më besdisë me andrrallat e veta. Mëdyshem vetëm se a bën ta kërkosh atë në *grumbull*. Në udhëtimet e mia isha përpjekur t'i mbyll çarjet në mes njerëzve. Por, a mund të ofrohen edhe shqiptarët kur zihen për asgjë edhe në kohë të liga? Emancipimi bëhet çështje.

Pasi isha shkëputur nga *grumbulli*, mbi lëkurën time më vonë kisha ndier peshën e hirit të fjalëve të një bote tjetër. E kisha të qartë se njeriu mbetet enigmë para se cilës duhet të kihet kujdes, posaçërisht kur ai nuk arrin të realizohet. Dhe nuk ka gjë më gërditëse se kur ai heq shpirt edhe në ëndërr.

Qytetin G. kushedi kur do ta shoh. Në kujtesë ngulitet edhe më maksima: *Duaje Atdheun!* E kisha dëgjuar këtë në variante edhe në Dardaninë time. Megjithatë, unë nuk jam humbës. E di udhën time ku shpie. Varet nga moti se a do t'ia dal në krye...

5.

Dhe kurrë mos thuaj se kam bërë mjaft... Për Atdheun nuk është kurrë shumë. Ai duhet në shumë mënyrë. Duhet përcaktuar për një rënë. Më të mundshmen.

(1998)

BALADË PËR NJERIUN E VETMUAR

I Hasi të Gurit ishte ai që trokiti një natë dimri dhe në shtëpinë time u mbyll peizazhi i Pashtrikut. Zu vend në krye të dhomës. Kishte shikim mali e mustakë përrallash. Disa herë më tha se zbrët nga Hasi. Më tregoi më vonë pse e kishte qitur udha këndejpari dhe kallëzimin e vet e mbylli paramesnatës. Nuk mund të pajtohej se ka ekzistuar pa i parë edhe njëherë në Kullë fëmijët e tij të shpërndarë Evropës. E kishte rrokur një parandjenjë e çuditshme. Rrëqethëse ishte ajo që pëshpëriste. Nipa e mbesa nuk i kuptonte as kur i dëgjonte ndonjëherë. Zoti i tij ishte një poliglot i rrallë. Nuk ngjante aspak me atë të Majës së Pashtrikut, që e kuptonin edhe gurë e bar. Ku di sa gjuhë i fliste ai i Rrafshit. Plaku ishte këmbëngulës. Pa i parë e kuptuar fëmijët e fëmijëve nuk ia merrte mendja të iki. I shtrova dikur. Në mëngjes pashë se sytë i kishte të lagur ende, të mjegulluar...

Verës që iku kishte rënë para soldateskës mortore. Nuk kishte pranuar ta lëshojë Kullën. Trupin ia kishin gjetur aty te Pusi i Akullit, ku shuante vapën. E kokën nuk dihet se ku ia kishin hedhur. Tregojnë se shpirti i kishte fluturuar pastaj si në një legjendë të moçme. Pyeta për nipat e mbesat e tij. Nuk ma tha kush një fjalë. Atë nuk do ta mbajë as varri...

Ishte nga Hasi i Gurit. Frikës nuk i merrte dorë.

(1998)

POETI

Ai nuk deshi të vdesë në dhé të huaj. Është turp të të gjejë vdekja tjetërkund. E kishte tërhequr fuqia e padiktueshme. Më e fortë se fjala e tij. Vrapin e mbylli një mbrëmjeje aty në një livadh. Iu bashkua korit të të mëdhenjve, që preheshin nën trupin e tij sapo ndahej me buzëqeshje guri.

Nga perspektiva e zogut kishte parë Kosovën për herë të fundit. Lehtë, krejt lehtë ishte lëshuar aty. Kurrë më nuk do të ndahemi. Në vesh i kishte pëshpëritur edhe shumëçka. Ia kishte besuar të gjitha fshehtësitë. Edhe dashurinë e besnikërinë. Po më vjen keq, i kishte thënë, që nuk mund bëra më shumë për ty. Dhe loti iu kishte ngrirë në mes qepallave. Ishte shtrirë gjëregjatë, t'ia dëgjonte frymëmarrjen dheut dhe ndonjë vargu të pathënë për të. Inat i kishte ardhur të vazhdonte edhe më vajin.

A qan burri?

Me një fije bari në buzë të thara shkoi dikah pastaj Azem Shkreli. Rrafshnalta e Kosovës i bëhej se ishte pika më e lartë e Globit Tokësor. Pa e arritur atë, nuk vdes burri...

Pushtimi i tij i fundit ishte Ajo

(1997)

NËNA TEREZE

Personalitetin e Nënë Terezës e shikoj, para së gjithash, nga rrafshi ynë ekzistencial. Nga viti 1928 moto e udhëtimit të këtij simboli të humanizmit gjithënjëzësor: *dëshpërimin* e mori si shpresë të njeriut, i cili e vë atë në veprim të vazhdueshëm. Kaloi në anën e të varfërve, të të mundurve dhe të të harruarve edhe nga zoti. Në një farë mënyre, dëshmoi dhe aktualizoi humanizmin tonë të qemotshëm nga Shën Albani, Jeronimi e shumë shenjtër të tjerë. Në mes një llave bëri atë ç'mundi edhe për çështjen kombëtare. Mjafton vetëm prania e saj, se një popull i vogël nuk prodhon vetëm varfëri. Nga personalitete të tilla kombi pret më shumë, por nën hijen e saj nuk frymonim vetëm ne... Shkoi Nënë Tereza, në momentin tonë më kritik, kur na bënë pikë e pesë dhe kur qenia jonë kombëtare nuk u sha e mohua kurrë më shumë, bile edhe nga vetë shqiptarët. Ajo mahnti njerëzimin dhe na mësoi se dëshpërimi mund të shndërrohet në fitore. Personaliteti i saj na kurajoi dhe hipokrizisë së diplomacisë botërore i tregoi se besimet të shqiptarët ndodhën aksidentalisht dhe se ata i bashkon gjaku, gjuha dhe historia; se në fatin e tyre të shthurjes patën dorë shpesh të mëdhenjtë dhe fqinjët grabitës, që nuk mund e pranuan lashtësinë as autoktoninë shqiptare në këtë hapësirë nevrrike... Shkoi Nëna Tereze, simboli i mirësisë, nga predikimet e së cilës mund të mësojmë se për të ngadhënjyer duhet dashur dhe respektuar njerëzjetrin; se fatkeqësia njerëzore, konkretisht kjo kombëtare, nuk bën të gëzojë askë. Ajo pamje hyjnie nga një vend i vogël, akuzoi dhe padrejtësitë në botë, në një farë mënyre edhe hipokrizinë e diplomacisë botërore, e cila na i preu teshat kur deshën e si deshën.

Do Zoti e figura e saj e ndritshme të na bashkojë, të na lirojë nga injoranca e bajraktarizmi primitiv, nga mëhalla e çatia...! Lutemi për Nënë tonë të Madhe, se lutemi për të gjitha nënat shqiptare. Pas një udhëtimi të gjatë e të mundshëm, prehja e saj në mesin tonë do të

na kthente pakëz dinjitetin kombëtar të nëpërkëmbur e të fyer. Urtësia e saj u bashkohet kokave të urta të kombit, që ekzistencën e panë vetëm në dinjitet e bashkim kombëtar. Nënë e dashur, prano lutjen time dhe për një popull, që nuk di ku e ka kokën dhe i cili gdhin në mes të smirës dhe idealit. Pakëz guxim! Faqebardhë të dalim nga kjo pis kohë.

(8 shtator 1997)

KRIMI NUK ËSHTË VETI CIVILIZUESE...

Nga dy tetori deri më katër nëntor ishte në Gjermani poeti ynë i mirënjohur Ali Podrimja. Gjatë Panairit Ndërkombëtar të Librit në Frankfurt mori pjesë në disa mbrëmje letrare. Veçojmë posaçërisht ato në *Literatur Haus* (Shtëpia e letërsisë) në Hamburg (16 tetor) dhe në Moers (21 tetor). Publiku gjerman e përcolli me interesim. Ky ishte prezent, poashtu, në masmediat gjermane. Me këtë rast shkoqisim ca pyetje e përgjigje nga biseda dhjetëminutëshe në TV gjerman, programi i parë shtetëror 3 SAT, ARD (8 e 9 tetor). U reprizua biseda edhe në kanalet TV Babiloni, ARTE etj. Në pyetjen e intervistuesit gjerman se ç'mendon për Slobodan Milosheviqin, poeti ishte përgjigjur: Zoti Slobodan Milosheviq është shahist i shkathtë. Mund të dalë fitues edhe këtë herë ndaj Bashkësisë Evropiane dhe SHBA. Cinizmi i tij arrin kulmin e absurditetit. Derisa përshëndeste fëmijët e Ballkanit në Beograd, diku në Kosovë vritej fëmija i njëqindëgjashhtëdhjetënjë. Në pyetjen se pse ekziston urrejtja në mes shqiptarëve dhe serbëve, ky kishte shtuar: Shqiptarët nuk dinë të urrejnë. Serbët vuajnë nga kompleksi se janë ardhacakë e shqiptarët autoktonë. Në pyetjen si do të ishte zgjidhja më e mirë, poeti kishte theksuar: Këta dy popuj më mirë të ndahen si miq e të kuptojnë se Kosova nuk shpërngulet në Mars. Pastaj kishte rënë fjala edhe për besimet brendashqiptare, ky kishte thënë: Ne ishim paganë dikur. Por krishtërimi ynë kap dy mijë vjet. Të dy kishave botërore u dhamë dy njerëz të parë. Kishës katolike Klementin XI (1700), kurse në mes dy Luftërave Botërore, Patrikanës së Stambollit, Atenagorën. Besimi ynë më i ri është myslimanizmi (aksidentalisht). Mirëpo te ne feja kurrë nuk ka luajtur rol vendimtar. Ne shqiptarët jemi tolerantë. Nga kjo mund të mësojë edhe Evropa. Ndaj pyetjes rreth fërkimeve brendapartiake në Kosovë, poeti kishte shtuar: Si në çdo shoqëri plurale ndodhin fërkime edhe te ne, që kanë një qëllim: të gjendet

zgjdhje sa më fatlume rreth çështjes sonë kombëtare. Ndoshta, ka pakëz edhe nervozë, por do të tejkalohen. Në pyetjen e fundit: Besoni se NATO-ja do të sulmojë Serbinë, poeti kishte shtuar: NATO-ja nëse nuk vepron, atëherë i bashkohet krimit kundër shqiptarëve...

Në sallën imponante të *Kishës Evangjeliike* në Moers (21 tetor) u mbajt tubimi humanitar për refugjatët kosovarë. Merrnin pjesë paria e qytetit e firma të njohura gjermane. Me atë rast u shfaq dokumentari TV i ZDF për Kishnarekën. Filmi rrëqethi shikuesit e shumtë. Në fund u lexuan poezitë e Podrimjes në gjuhën gjermane, i cili mbylli mbrëmjen me fjalët: Më vjen mirë që në kishën gjermane u bë fjalë për refugjatët shqiptarë. Gjestin tuaj e kuptoj se shqiptarët nuk janë fundamentalistë çfarë përpiqet të na paraqesë propaganda serbe. Ne jemi popull me orientim properëndimor. Ajo që më gëzon është se në kishën tuaj, ju luteni për nipat e mbesat e Nënës Terezë, e cila u nda nga ne para sa kohe dhe tërë bota iu përkul hijes së saj në Kalkutë.

Në *Literatur Haus* në Hamburg (16 tetor), në praninë e dy poeteshave shqiptare *Mimoza Ahmeti* (Shqipëri) dhe *Kate Xukare* (arbëreshe, Itali), Podrimja kishte shtuar: Paraqitja këtu ka një simbolikë të dhembshme. Flet qartë për fatin tragjik shqiptar. Në mbyllje të *Homazhit për Kosovën* në Dusseldorf (24) kishte thënë: Unë nuk mund të bëj gara me artistë si Lajçin, Nallbanin, Tushën, Kabashin, Shaqirin, Vladin, Lushin, Çelon. Këta i bëjnë nam kombit ku paraqiten, por shpalosja e këmishës së përgjakur e Kosovës nga këta, ka një mesazh jo vetëm kombëtar: krimi nuk është veti civilizuese...

(“Kosova sot”, 16 nëntor 1998)

MINIROMAN

ZAGARIA

Ai ishte krekosur mirë e mirë para pasqyres. Ishte kthyer vrik në drejtim të shkamit me një buzëqeshje triumfuese:

- Nuk do e lëshoja kurrë të mos ishte vdekja - kishte pëshpëritur. Me dorën e djathtë e kishte lëmuar lëkurën e zezë, që e kishte mbështjellë fundekrye atë dhe me dorën e majtë kishte paluar edhe një ble flokësh në anën e djathtë të kokës së vogël. Çuditshëm e kishte shikuar truproja, zëri i të cilit mezi kishte arritur te veshi i Bajraktarit:

- Të mos ishte vdekja, Lartmadhëri, nuk do ulëshit aty.

Tërë i mërdhezur ky e kishte shikuar. Me dorë kishte urdhëruar t'ia sjellë kafenë e mëngjesit dhe fjalët pakëz më të imëta. Tek përbinte gërçin e parë, nga jashtë pa frymë kishte vrapuar roja tjetër:

- Lartmadhëri, ra zjarri në Vilajet!

- Nuk ka ç'na bën - ishte përgjigjur ky pa i luajtur qerpiku i syrit dhe me dorën e djathtë kishte zënë një mizë. Më vonë kishte qeshur vetmevete.

- Ra zjarri në lagje, Lartmadhëri - kishte alarmuar në hundebuzë tjetri.

- Le të bjerë ore - ishte dëgjuar prapë sapo sharronte më thellë në shkamin e mbështjellë prej lëkurës së zezë. Dhe nga gishtërinjtë pis kishte fshirë edhe ca gjak të mizës, që e kishte mbytur pakëz më parë.

- Na ra zjarri në shtëpi, burro - ishte dëgjuar tek rrokullisej shkallëve Hanemshahja topolake e Vilajetit të Errët.

Syzygurdulluar kishte brofur Bajraktari nga shkami. Kishte fërkuar duart disa herë: Kjo është ëndërr e keqe! Kur e pashë apo ma tregoi kush? Pas dy hapave, përpak ishte shtangur. Një rën dorë me dhembje e kishte lëvizur nga pjesa e prapame e trupit: Këtu të mos bjerë zjarri...

Dikur ishin dëgjuar rrapëllimë të forta në dyer të hekurta të Kështjellës së lashtë dhe zëra të paartikulluar, që bëheshin gjithnjë më të fortë. Zbratësia e sallonit të madh e kishte tmerruar. I lemeritur vraponte. Kërkonte një skutë, vrimë. Nga xhamat e thyera të dritareve të shumta vështirë përbirohej.

- Vdekja! Vdekja paska ardhur...!

Në fund të sallonit truproja, që tërë jetën e kishte përcjellë gjatë kohëve të përjargura, për herë të parë ishte zgërdhirë. Gazi i tij më së pakti i ngjante njeriut:

- Pasardhësi... Çlirimtari. Ose ndonjë zagat më i madh...

Dyert kishin rënë nga brenda. Shkami i mbështjellë në lëkurë të zezë, që nga larg i ngjante lëkurës së përcëlluar të njeriut, luhatej i zbrazët në krye të sallonit të çrregulluar e të frikshëm. Ishin dëgjuar më vonë hapa në drejtim të tij. Një gaz histerik. Dhe hijet orë e çast thyheshin e ndërroheshin, dendësoheshin e blindoheshin. Dikur nuk ishte parë asgjë...

Se ç'ndodhi pastaj, e kuptoni më mirë po qe se e lexoni sërish këtë kallëzim të zi. Më dhemb shpirti t'ua them fundin. Bën kohë qeni.

SHËNIMI I AUTORIT

Zoti nuk mund të jetë në anën e vrasësve, të rrënuesve të qytetërimeve të lashta e, më së pakti, serb. Do të vepronte atëherë kundër mirësisë, do të ishte pjellë e djallit. Në një qark, ku gjendemi, vetëm guximi intelektual e urtia kombëtare na shpëton nga më e keqja. Copëzimi i mëtutjeshëm i etnisë, përçarjet e bajraktarizmi shpienë në vetëvrasje, Ja pse e pagëzova këtë libër HARAKIRI.

Tani për tani nuk di ku dallon njeriu nga kafsha... Miti i Kosovës është trillim, ngushëllim i disfatistëve paranoikë.

Ulpianë, 15.I.1999

PËRMBAJTJA

LOJA NËN DIELL 7

Vjeshta e vonë e një moti	9
Loja nën diell	18
Deti.....	25
Matanë lumit.....	33
Kujtimi për gruen e çmendun	38
Ai	43
Qyteti i takoi Emilisë	50
Letra	56

BURGU I HAPUR.....61

Fotografia.....	63
-----------------	----

NË FUND TË RRUGËS SË BREHITIT 64

Cungnjeriu.....	64
Liria absolute	67
Albani.....	71
Vdekja në Bohemi.....	77
Miu rus.....	81

Çelësi i humbur	83
Tregimi ku flitet për të gjithë ngapak dhe një mace të bardhë	88
Në fund të Rrugës së Brehtit.....	92
Njeriu që krijonte edhe re	96
ZOGU I TEJDUKSHËM	99
Miti për djaloshin që nuk ekziston	99
Fytyra e përhënë.....	103
Zogu i tejdukshëm	108
Gazi i kombit.....	112
Fundi i mitit	116
Ditari i një shkodrani.....	121
Në mbretërinë e karkalecave	124
Vrasësit e padukshëm	127
Lemba	131
JARGAVANI I PËRGJAKUR.....	132
Tragjika e një fjale	132
Malësori dhe Atenagora	134
Shkami	136
Davidi	137
Pasqyra.....	140
Shumësi i Mediokrit.....	142
Kokëçarje me një fjali.....	143
Vendlindja në dy gozhda.....	144
Jargavani i përgjakur	146
Poeti nga diaspora.....	148
Klithma në ëndërr.....	149
NËPËR ËNDËRR	151
Burgu i hapur.....	151
Rrënimi i tempullit.....	156
Çanta magjike	158
Nëpër ëndërr.....	160
Bukuria me syza	163

Guaska	165
Shënim	166
HARAKIRI	167
Ju falënderoj për durimin akademik	169
BIZONI I PLAGOSUR	173
Demokracia në mënyrë ballkanase	173
Ridënimi	179
Refuzimi i bizares	184
Bizoni i plagosur	189
Revolta e një brezi	194
Harmonia nga kaosi	198
Çka më tutje?	201
A duhet shkruar libri i ri i dhimbjes?	204
KARAMBOLLI SHQIPTAR	208
Babilonia shqiptare	208
Shqipëria fotografi e dhembshme e Ilirisë	211
Ju lutem, pakëz dashuri, dinjitet	214
A është profesion vrasja?	217
Dikush kishte luajtur me një popull	220
Frika nga realiteti	224
Në kërkim të së vërtetës	228
Tezë pa mbështetje	233
Karambolli shqiptar	237
Bajraktarët dhe qentë	242
Rënia e fantastëve	247
A i gëzohemi fatkeqësisë?	251
LIRIZMI I PËRGJAKUR	255
Kohë fisesh	255

Pushkalla.....	260
Humor në kohë vdekjeje.....	265
Kriminimi i shpirtit.....	270
Komançerosët.....	274
Falemnderit, plaga ime.....	278
Lirizmi i përgjakur.....	283
Rambo i mileniumit të ardhshëm.....	288
Vargu në gurin e mikut.....	293
Kodi etik i ballkanasve.....	297
ROLETAT.....	301
Më i vdekur nuk bën.....	301
Në Panteon nuk ka vend për të gjithë.....	304
Hallakatja e një “nobelisti” të ardhshëm.....	307
Kujdes ndaj fjalëve.....	309
Marramendthi.....	311
Pudrosjet.....	313
Përse nuk jemi më të mirë?.....	316
Roletat, drynat.....	318
Dhoma e kuqe me perde të kaltra.....	322
Duaje Atdheun.....	326
Baladë për njeriun e vetmuar.....	329
Poeti.....	330
Nëna Tereze.....	331
Krimi nuk është veti civilizuese.....	333
MINIROMAN.....	335
Zagaria.....	335

ALI PODRIMJA

VEPRA

Vëllimi i shtatë

Prishtinë, 2013

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Design: ZENI BALLAZHI

Radhitja & faqësja: BURIM REXHEPI

Lektor & korrektor: SHEFQET RIZA

Madhësia: 21.43 tabakë shtypi

Tirazhi: 500 kopje

Formati A5 (14.8 x 21 cm)

Shtypi: FOCUS-PRINT, Prishtinë-Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-32

Podrimja, Ali

Vepra = Works / Ali Podrimja. - Prishtina : Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës : Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, 2013. - libra ; 21cm.

Vëllimi 7 : Loja nën diell : tregime ; Burgu i hapur ;

Harakiri : (ese, shënime nga esnafi dhe një miniroman). - 343 f., portreti i autorit

ISBN 978-9951-615-14-3

ISBN 978-9951-615-21-1